



RAPORTI NARRATIV KOMBËTAR I SHQIPËRISË PËR ZBATIMIN E PLATFORMËS PËR VEPRIM **PEKIN+30**





Raporti Narrativ Kombëtar i Shqipërisë për zbatimin e Deklaratës dhe Platformës për Veprim të Pekinit u përgatit me mbështetjen e UN Women. Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të UN Women, Kombeve të Bashkuara apo të çdo organizate tjetër të lidhur me to.

**RAPORTI NARRATIV KOMBËTAR
I SHQIPËRISË PËR ZBATIMIN E
PLATFORMËS PËR VEPRIM
PEKIN+30**

PËRMBAJTJA

SHKURTESA DHE AKRONIME	5
SEKSIONI I PARË: ÇËSHTJET KRYESORE	8
SEKSIONI I DYTË: PRIORITETET, ARRITJET, SFIDAT DHE PENGESAT	11
SEKSIONI I TRETË: PËRPARIMI NË DYMBËDHJETË FUSHAT KRITIKE	24
3.1 ZHVILLIM GJITHËPËRFSHIRËS, PROSPERITET I PËRBASHKËT DHE PUNË E DENJË	24
3.2 ELIMINIMI I VARFËRISË, MBROJTJA SOCIALE DHE SHËRBIMET SHOQËRORE	34
3.3 LIRIA NGA DHUNA, STIGMA DHE STEREOTIPAT	48
3.4 PJESËMARRJA, LLOGARIDHËNIA DHE INSTITUCIONET E PËRGJIGJSHME GJINORE	67
3.5 SHOQËRI PAQËSORE DHE GJITHËPËRFSHIRËSE	80
3.6 RUAJTJA, MBROJTJA DHE REHABILITIMI I MJEDISIT	91
SEKSIONI I KATËRT: INSTITUCIONET DHE PROCESET KOMBËTARE	96
SEKSIONI I PESTË: TË DHËNAT DHE STATISTIKAT	105
SEKSIONI I GJASHTË: PËRFUNDIMI DHE HAPAT E RADHËS	111
SHTOJCA	114
SHTOJCA 1. TË DHËNA NË MBËSHTETJE TË PËRGJIGJEVE TË PYETJEVE PËR DIMENSIONIN E PARË “ZHVILLIM GJITHËPËRFSHIRËS, PROSPERITET I PËRBASHKËT DHE PUNË E DENJË”	114
SHTOJCA 2. TË DHËNA NË MBËSHTETJE TË PËRGJIGJEVE TË PYETJEVE PËR DIMENSIONIN E DYTË “ELIMINIMI I VARFËRISË, MBROJTJA SOCIALE DHE SHËRBIMET SHOQËRORE”	115
SHTOJCA 3. TË DHËNA NË MBËSHTETJE TË PËRGJIGJEVE TË PYETJEVE PËR DIMENSIONIN E TRETË “LIRIA NGA DHUNA, STIGMA DHE STEREOTIPAT”	120
SHTOJCA 4. TË DHËNA NË MBËSHTETJE TË PËRGJIGJEVE TË PYETJEVE PËR DIMENSIONIN E KATËRT “PJESËMARRJA, LLOGARIDHËNIA DHE INSTITUCIONET E PËRGJIGJSHME GJINORE”	125
SHTOJCA 5. TË DHËNA NË MBËSHTETJE TË PËRGJIGJEVE TË PYETJEVE PËR DIMENSIONIN E PESTË “SHOQËRI PAQËSORE DHE GJITHËPËRFSHIRËSE”	131
SHTOJCA 6. TË DHËNA NË MBËSHTETJE TË PËRGJIGJEVE TË SEKSIONIT TË KATËRT TË RAPORTIT	132
SHTOJCA 7. TË DHËNA NË MBËSHTETJE TË PËRGJIGJEVE TË SEKSIONIT TË PESTË TË RAPORTIT	133
REFEENCA	139

SHKURTESA DHE AKRONIME

AFA	Akademia e Forcave të Armatosura
AFMIS	Sistemi i Informacionit të Menaxhimit Financiar Shqiptar
AGD	Aleanca e Grave Deputete
Agjenda GPS	Agjenda “Gruaja, Paqja dhe Siguria”
AIDA	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
AKDF	Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve
AKKSHI	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AMA	Autoriteti i Mediave Audiovizive
AMSHC	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
AP	Avokati i Popullit
ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BE	Bashkimi Evropian
BPGJ	Buxheti i Përgjigjshëm Gjnor
BMA	Bimëve Medicinale dhe Aromatike
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
GREVIO	Grupi i eksperteve/ekspertëve për veprime kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje
DPAP	Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar
DPPS	Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale
DPPSBGJ	Drejtoria e Politikave të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjnore
DRAP	Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar
DHBGJ	Dhunë me Bazë Gjnore
DHF	Dhunë në Familje
DHnG	Dhunë ndaj Grave
ESGJ	Edukimi seksual gjithëpërfshirës
FA	Forcat e Armatosura
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar

GNP	Grupi Ndërmënor i Punës
GJOGJF	Gjymtimi i organeve gjenitale femërore
HPV	Virusi Papiloma i Njeriut
IAL	Institucione të arsimit të lartë
IBGJ	Indeksi i Barazisë Gjimore
INSTAT	Instituti i Statistikave Shqipëri
IPPF	Federata Ndërkombëtare e Prindërimit të Planifikuar
ISHPSSH	Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Sigurimeve Shoqërore
JAPFP	Jo në arsim, punësim, formim profesional
KF	Kodi i Familjes
KKBGJ	Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjimore
KKP	Raporti i Kontributit Kombëtar të Pikësnyuar
KKSAT	Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Anti -Trafik
KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
KDIMDHP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KP	Kodi Penal
LGBTIQ+	Persona lesbike, gej, biseksualë/e, transgjimore/e, transseksualë/e, interseks dhe cilëdo persona të tjerë orientimi seksual, shprehja e identitetit gjinor dhe/ose karakteristikat e seksit të të cilëve/ave janë të ndryshme nga heteroseksualët/et
LKGV	Linja Kombëtare e Këshillimit për Gra dhe Vajza
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sporteve
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MKR	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit
MM	Ministria e Mbrojtjes
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NBGJ	Nëpunëse/Nëpunës i Barazisë Gjimore
NJMF	Njësi e Mbrojtjes së Fëmijëve
NJV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OJF	Organizatë Jo-Fitimprurëse
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
ONP	Organizata Ndërkombëtare e Punës
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PAK	Persona me Aftësi të Kufizuara

PATP	Programet aktive të tregut të punës
PBA	Program Buxhetor Afatmesëm
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PGR	Programi i Garancisë Rinore
PKEC	Plani Kombëtar për Emergjencat Civile
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit
PPGJ	Prokurimi i Përgjigjshëm Gjinor
PSZ	Programi i Statistikave Zyrtare
PSH	Policia e Shtetit
PVP	Platforma për Veprim e Pekinit
PVVBGJ	Plan Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore
QKEDH	Qendra Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm
QPKMR	Qendra për Parandalimin e Krimeve të të Miturave/Miturve dhe të Rejave/ Rinjve
SASPAC	Agjencia Shtetërore për Planifikimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndhmës
SBZHRP	Strategjia për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin
SKBGJ	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore
SKNK	Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike dhe Planet e Veprimit
SKPA	Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi
SKZHIE	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian
SKZRF	Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë
SNDM	Strategjia Ndërsektorale e Drejtësisë për të Mitura/Mitur
SNLT	Strategjia Ndërsektorale e Luftës kundër Terrorizmit
SNMVK	Strategjia Ndërsektorale e Mbrojtjes së Viktimave të Krimit
SNSK	Strategjia Ndërsektorale e Sigurisë në Komunitet
SNPEDHLNT	Strategjia Ndërsektorale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit
SSK	Strategjia e Sigurisë Kombëtare
SHTIM	Shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VT/VMT	Viktima të trafikimit /viktima të mundshme të trafikimit
ZVAP	Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar

SEKSIONI I PARË

ÇËSHTJET KRYESORE

- Nga vlerësimi i kryer është evidentuar se shteti shqiptar ka bërë përpjekje të rëndësishme për të avancuar politikat dhe masat në të dymbëdhjetë fushat kritike të Deklaratës dhe PVP, por në progres kanë ndikuar tërmeti i vitit 2019, pandemia e shkaktuar nga COVID-19 dhe lufta në Ukrainë. Masa me rëndësi janë marrë për përparimin e barazisë gjinore në fushën e punësimit; pakësimin dhe rishpërndarjen e kujdesit dhe punës së papaguar në shtëpi; ngushtimin e ndasisë digjitale ndërmjet gjinive; nxitjen e punësimit dhe mbështetjen e start-up, sipërmarrjet e grave; mbrojtjen sociale përfshirë masa të posaçme për mbrojtjen e nënës dhe fëmijës; zgjerimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror dhe të shërbimeve mbështetëse të specializuara; përmirësimin e rezultateve shëndetësore dhe rritjen e informimit mbi shëndetin seksual e riprodhues, etj.

Qeveria e Shqipërisë e filloi përgatitjen e raportit kombëtar për zbatimin e Deklaratës dhe Platformës për Veprim të Pekinit (PVP), në datën 8 shkurt 2024, përmes një procesi gjithëpërfshirës drejtuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), si autoriteti kryesor përgjegjës i mekanizmit kombëtar për barazinë gjinore, në nivel ministrie. MSHMS udhëhoqi, koordinoi dhe mbështeti Grupin Ndërmnistror të Punës, si dhe ndoqi të gjithë hapat e nevojshëm deri në përfundimin dhe dorëzimin e këtij shqyrtimi kombëtar. Pyetësi për mbledhjen e informacionit u nda me anëtarët/anëtarët e Grupit të Punës dhe aktorë të tjerë si: njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e pavarura dhe të drejtave të njeriut, organizata të shoqërisë civile, organizata të punëtorëve / punëtorëve, organizata ndërkombëtare, etj. Gjatë procesit të përgatitjes së raportit u ftuan të japin kontribut rreth 189 (njëqind e tetëdhjetë e nëntë) institucione dhe organizata dhe u mbajtën 7 (shtatë) takime pune, konsultuese e vlerësuese. Pas përditësimit të përmbajtjes bazuar në të gjitha kontributet e dërguara me shkrim, si dhe nga komentet dhe sugjerimet e dhëna gjatë takimeve, raporti i përfunduar u dërgua për një konfirmim me shkrim nga të gjitha ministritë përkatëse të linjës, si dhe u miratua në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore (KKBGJ), në datën 27 maj 2024. Dorëzimi i shqyrtimit kombëtar u bë sipas afateve, në datën 1 qershor 2024.

Për shkak të urgjencës dhe pa parashikueshmërisë si të dëmeve ashtu edhe të pasojave sociale, ekonomike dhe shëndetësore të shkaktuara nga kriza e pandemisë COVID-19, ishte e pamundur të kryheshin analiza të thelluara të ndikimit të masave financiare tek burrat dhe gratë. Këto masa për të zbutur krizën e shkaktuar, u bazuan vetëm në të dhënat e disponueshme në momentin e hartimit të tyre.

Megjithatë gjatë zbatimit të këtyre masave të rëndësishme, institucionet përkatëse janë ndeshur edhe me vështirësi dhe sfida, që kanë ndikuar në nivelin e përparimit në disa nga fushat kritike, si dhe në rezultatet e arritura për gratë, të rejtat dhe vajzat, apo për të gjitha grupet e cënueshme në shoqëri. Për shembull,

fakti që shumë gra në bujqësi nuk kanë pronësi të barabartë të pronave dhe asetëve, pjesërisht për shkak të praktikave patriarkale të trashëgimisë së tokës, ndikon në arritjen e rezultateve të duhura në drejtim të fuqizimit ekonomik të tyre. Ndryshimet klimatike gjithashtu ndikojnë në rritjen e sfidave me të cilat përballen gratë në bujqësi. Situata rëndohet më shumë nëse flitet për gra rome, egjiptiane, apo me aftësi të kufizuara dhe që jetojnë në zonat rurale. Pra janë pikërisht aspekte të tilla të ndërthurjes së përkatësive të shumëfishta (intersectionality), që tërheqin vëmendjen për nevojën për analiza gjinore më të thelluara dhe masa që duhet të ndërmerren në përputhje me nevojat specifike të këtyre grupeve, në çdo fushë.

Tendencat pozitive në normat e punësimit dhe pjesëmarrjen e grave/të rejave në tregun e punës u ndërpre në nga COVID-19, duke çuar në humbje të vendeve të punës dhe ulje të pjesëmarrjes në fuqinë punëtore. Për këtë arsye, menjëherë pas kapërcimit të situatës emergjente, Qeveria e Shqipërisë ndërmori masa për adresimin e papunësisë veçanërisht të të rejat/rinjve. Programi i Garancisë Rinore që synon përfshirjen në tregun e punës të të rejave/të rinjve jo në arsim, punësim, formim profesional; rritja e nivelit të pagës minimale; zvogëlimi i hendekut gjinor në paga; apo angazhimi në Përsheptuesin Botëror për Punë të Denjë dhe Mbrojtje Sociale për Tranzicione të Drejta, që synon krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin e aftësive në sektorët kryesorë të ekonomisë mjedisore dhe digjitalizimit, etj., janë disa prej shembujve konkretë të masave të ndërmarra për të përparuar drejt zhvillimit gjithëpërfshirës, prosperitetit të përbashkët e punës së denjë.

Digjitalizimi i shërbimeve publike, një hap i rëndësishëm për të cilin Shqipëria është vlerësuar, shoqërohet me probleme të aksesueshmërisë për komunitetet e cënueshme për shkak të arsimit, mungesës së aftësive dhe kufizimeve financiare. Strategjia e re e Arsimit (2021-2026) thekson nevojën për zhvillimin e infrastrukturës në zonat urbane dhe sugjeron ripërdorimin e hapësirave ekzistuese në shkollat rurale. Masat e ndërmarra për ngushtimin e ndasive digjitale, të cilat po zbatohen që në klasat e para të arsimit nëntë-vjeçar, janë një tjetër shembull i përpjekjeve për adresimin e vështirësive të ndeshura, sa i takon aksesit në e-shërbime të grave, të rejave, e vajzave nga të gjithë grupet në shoqëri.

Shërbimet publike të kujdesit ndaj fëmijëve apo të rriturave/rriturve në nevojë ndikojnë në mënyrë disproporcionale në pjesëmarrjen e grave në tregun e punës. Kujdesi afatgjatë njihet zyrtarisht për individët me aftësi të kufizuara dhe ato/ata të moshës 65+. Qeveria e Shqipërisë përmes Fondit Social ka filluar përpjekjet e para për ofrimin e shërbimeve të asistencës shtëpiake, me dy tipologji inovative: asistencë shtëpiake dhe njësi të lëvizshme, në disa bashki të vendit. Skemat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nuk mbulojnë përfitimet në para dhe në natyrë për ato/ata që kërkojnë kujdes dhe kujdestare/kujdestarë joformalë. Fuqizimi i mëtejshëm i shërbimeve të përkujdesit, zgjerimi i tyre në mbarë vendin dhe për të gjitha kategoritë apo grupet e cënueshme, do të mundësonte adresimin edhe të kësaj pengese që mban gratë dhe të rejat larg tregut të punës, si dhe do të ndikonte në balancimin e kohës së punës dhe jetës sociale, duke përmirësuar dukshëm cilësinë e jetës për të gjitha/gjithë.

Arritje ka pasur në garantimin dhe mbrojtjen nga forma të ndryshme të dhunës me bazë gjinore, por viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit hasin problematika në zbatimin efektiv të legjislationit; shërbimet mbështetëse të specializuara që ka nevojë të zgjerohen dhe të mbulojnë të gjithë territorin e vendit; informimin për të drejtat e tyre (sidomos ku flitet për persona me aftësi të kufizuara në shikim, dëgjim, etj.); ndikimin që kanë stereotipet gjinore dhe qëndrimi fajësues e paragjyqës që shoqëria mban në këto çështje; shtimin e rasteve të femicidit, si dhe problematika në funksionimin dhe efektivitetin e Mekanizmave të Koordinuar të Referimit të rasteve në nivelin vendor. Dhuna digjitale, ngacmimi dhe dhuna seksuale, nevojiten të adresohen me të gjitha mjetet e duhura që sigurojnë mbrojtjen e nevojshme.

Pjesëmarrja e grave në vendimmarrje dhe politikë është një shembull i mirë, rezultatet dhe mekanizmat e të cilit Shteti Shqiptar mund t'i ndajë me vende të tjera. Aktualisht, kabineti qeveritar ka në përbërjen e tij 55% gra, një Zëvendës Kryeministre grua dhe dhjetë ministre gra (nga 17 ministre/ministra gjithsej), ndërsa Kuvendi drejtohet nga një Kryetare grua dhe në përbërje ka Komisione e Nënkomisione të drejtuara e me

pjesëmarrje në numër të konsiderueshëm të grave. Megjithatë ka nevojë të ecet në të njëtin drejtim edhe për fuqizimin e pozitës vendimmarrëse të grave në nivelin vendor, për shembull si kryetare bashkie.

Po kështu, pavarësisht masave pozitive të ndërmarra për mbrojtjen e paqes, sigurisë dhe rritjen e përfaqësimit të grave në këto çështje, ka nevojë për ndërhyrje të mëtejshme për të pasur gjithashtu rezultate të kënaqshme të përfshirjes së grave edhe në ato fusha që prej vitesh janë konsideruar si “neutrale” nga këndvështrimi gjinor (për shembull mjedisi, infrastruktura, menaxhimi i rrezikut të fatkeqësive natyrore, etj.).

Qeveria shqiptare ka vendosur në fokus të politikave dhe masave që do të ndërmerren në të ardhmen inovacionin dhe praktikën transformuese, për të udhëhequr ndryshimin që do të ndihmojnë për të adresuar objektiva strategjike në fushat e energjisë, bujqësisë, turizmit, industrisë përpunuese dhe fusha të tjera të rëndësishme. Inteligjenca artificiale do vendoset në krye të agjendës së qeverisë, për të siguruar që askush nuk do të lihet pas në transformimin digjital. Një shembull pozitiv është digjitalizimi dhe ndërlidhja e sistemeve digjitale nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania, i cili vepron si një pikë e vetme për ofrimin e shërbimeve publike të institucioneve qeveritare. Ky portal ofron aktualisht 95% të të gjithë shërbimeve publike dhe ka bërë të mundur kursimin e shumë viteve pritjeje dhe shumë parave që qytetaret/qytetarët dhe bizneset shpenzonin për këto marrjen e këtyre dokumenteve dikur. Megjithatë, kjo praktikë pozitive duhet bashkëshoqëruar me më shumë investime për rritjen e aksesit të grupeve të marginalizuara në këto shërbime.

Buxheti i Përgjigjshëm Gjinor (BPGJ) është një tjetër shembull pozitiv, për t’u ndarë në kuadër të këtij rishikimi kombëtar, pasi politikat buxhetore të përgjigjshme gjinore kanë luajtur një rol me rëndësi në arritjen e objektivave të barazisë gjinore. Fondet e buxhetit të shtetit kanë pësuar rritje, ku përqindja e totalit të shpenzimeve buxhetore në Programet Buxhetore Afatmesme (PBA) për çështjet gjinore është rritur nga 2,3% për PBA 2017-2019 në 9% për PBA 2022-2024 si dhe 10 % për BPGJ. Në tre vitet e fundit, fondet buxhetore për BPGJ rezultojnë: 90 milion USD në PBA 2017-2019; 120 milion USD në PBA 2018-2020; 285 milion USD në PBA 2019-2021; 348 milionë USD në PBA 2020 - 2022, 506 milion USD në PBA 2021-2023 dhe 410 milion USD për PBA 2022-2024.¹

.....
1. Raport për zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), raundi i parë i vlerësimit tematik: “Krijimi i besimit përmes sigurimit të mbështetjes, mbrojtjes dhe drejtësisë”, korrik 2017-dhjetor 2022, fq.15. Shih: <https://rm.coe.int/state-report-addressed-to-grevio-/1680ac0c69>

SEKSIONI I DYTË

PRIORITETET, ARRITJET, SFIDAT DHE PENGESAT

1. Cilat kanë qenë arritjet, sfidat dhe pengesat më të rëndësishme lidhur me progresin drejt barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave gjatë pesë viteve të fundit?

Në pesë vitet e fundit, Qeveria e Shqipërisë ka bërë përparime të rëndësishme në fushën e barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave, por ende përballet me sfida dhe pengesa që duhen adresuar përmes përpjekjeve të vazhdueshme, për të arritur një barazi në praktikë, të vërtetë dhe të qëndrueshme.

Shqipëria ka një kuadër normativ përgjithësisht solid për promovimin, zbatimin dhe monitorimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit për shkak të gjinisë. Në Bazën Globale të të Dhënave të OZHQ-ve² Shqipëria është vlerësuar për vitin 2022 me 100 pikë (nga 100 të mundshmet) për sa i përket shkallës në të cilën kuadri legjislativ promovon, zbaton dhe monitoron barazinë gjinore; 88,9 pikë për dhunën ndaj grave; 80 pikë për punësimin dhe fuqizimin ekonomik, si dhe me 90,9 pikë për martesën dhe familjen. Shqipëria nuk është palë në Konventën e OKB-së mbi Dhënien e Pëlqimit për Martesë, Moshën Minimale për Martesë dhe Regjistrimin e Martesave (1962), por ka ratifikuar Konventën 190 të ONP-së mbi Dhunën dhe Ngacmimin në Botën e Punës. Ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri” e ka përmbushur synimin për të cilin u hartua në fillim në vitin 2008 dhe tashmë është në proces rishikimi për t’iu përgjigjur situatës dhe sfidave aktuale të barazisë gjinore në Shqipëri. Janë hartuar akte ligjore gjithëpërfshirëse për promovimin, vënien në jetë dhe monitorimin e parimit të mosdiskriminimit për shkak të gjinisë, e një sërë karakteristikash individuale, përfshirë dhe orientimin seksual apo shprehjen e identitetit gjinor, por ende pritet që Shqipëria të zbatojë reforma të tjera

2. Të administruar nga UN Women. Shih: <https://unstats.un.org/sdgs/dataportal/countryprofiles/alb#goal-5>

në sektorë të ndryshëm, në përputhje dhe të harmonizuara me *Acquis* të Bashkimit Evropian për barazinë gjinore. Pavarësisht përparimit në nivel legjislativ e politikash, është e nevojshme që Shqipëria të forcojë zbatimin në praktikë të tyre, llogaridhënien dhe mekanizmat e monitorimit, për të siguruar arritjen e të gjithë objektivave dhe treguesve gjinorë në kuadër të Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm, si dhe për të trajtuar në mënyrë specifike ndikimin që COVID-19 pati tek gratë dhe burrat, të rejtat dhe të rinjtë, vajzat dhe djemtë, nga të gjitha grupet në shoqëri.

Vendosja e grave dhe vajzave në qendër të zhvillimit të qëndrueshëm dhe integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian (BE). Strategjia e re Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian, Strategjia e re Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe strategji të tjera sektoriale që janë aktualisht në proces zbatimi apo përditësimi, ofrojnë mundësi për identifikimin e masave kryesore që duhen ndërmarrë për promovimin e barazisë gjinore të plotë. Vendosja e grave, të rejave dhe vajzave në qendër të përpjekjeve për zhvillim të qëndrueshëm dhe integrim në BE, duhet të mbështetet në boshte strategjike, të tilla si: shtimi i investimeve për eliminimin e mangësive në zbatimin e angazhimeve ekzistuese; statistika gjinore të plota dhe të sakta; mekanizma të fuqizuar për bashkërendimin e veprimeve dhe monitorimin e rezultateve; përdorimi i aftësive drejtuese të grave dhe kapaciteteve udhëheqëse të pakufizuara të tyre; si dhe përfaqësimi dhe pjesëmarrja e barabartë e grave në vendimmarrje në të gjitha nivelet.

Shtimi i fondeve për ndërhyrjet në fushën e barazisë gjinore është me rëndësi thelbësore për arritjen e rezultateve të zhvillimit të qëndrueshëm. Ndonëse Shqipëria ka bërë mjaft përparim në planifikimin dhe zbatimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, duhet bërë më shumë për të siguruar që shpërndarja dhe përdorimi i burimeve publike t'u përgjigjet drejtpërsëdrejti shqetësimeve të vazhdueshme lidhur me pabarazitë gjinore dhe të drejtat e grave, të rejave e vajzave nga të gjitha grupet në shoqëri. Gjithashtu, zbatimi i strategjive dhe programeve kombëtare duhet të shoqërohet me fuqizimin e kapaciteteve dhe mekanizmave monitorues të kosto-efektivitetit të këtyre dokumenteve, bazuar në burimet financiare të alokuara dhe shpenzuara.

Mangësive ekzistuese në statistikat gjinore, duhet t'u kushtohet vëmendje për të mundësuar matjet e duhura të rezultateve të arritura në fushën e barazisë gjinore dhe për të vlerësuar me objektivitet ndikimin e politikave dhe të investimeve. Mungesa e të dhënave të ndara në bazë të seksit, moshës, vendbanimit etnisë, aftësive të kufizuara, orientimit seksual e shprehjes së identitetit gjinor, statusit civil, të punësimit, migrantes/migrantit, azilkërkueses/azilkërkuesit, etj, si dhe situatës social-ekonomike dhe ligjore në të gjithë sektorët, përbën një sfidë të cilës duhet t'i jepet zgjidhje përmes gjenerimit dhe vënies në dispozicion të të dhënave të besueshme, të krahasueshme ndër vite e të përditësuara rregullisht.

Udhëheqja efektive dhe bashkërendimi efikas i aktorëve në nivelet qendrore dhe vendore janë me rëndësi thelbësore për të siguruar trajtimin e vazhdueshëm të pabarazive gjinore në të gjitha fushat e veprimit të qeverisë. Ligji për Barazinë Gjinore krijoi një mekanizëm të posaçëm kombëtar të barazisë gjinore, që përfshin: Këshillin Kombëtar të Barazisë Gjinore; Drejtorinë e Politikave të Përfshirjes Sociale e Barazisë Gjinore, si dhe Sektorin e Politikave të Barazisë Gjinore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; por edhe një rrjet nëpunësesh/nëpunësish të barazisë gjinore në ministri, institucione të tjera dhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Megjithatë, në organizimin e përgjithshëm të tyre vërehen dhe mangësi për shembull në qartësinë e roleve dhe përgjegjësisë, fonde të pamjaftueshme, kapaciteteve në nevojë për fuqizim, bashkëpunim jo gjithmonë sistematik ndër-institucional, si ndërmjet aktorëve në nivel qendror, ashtu edhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore, etj. Ndaj dhe nevojitet aplikimi i integritit gjinor në çdo fazë, pra të hartimit, zbatimit, monitorimit e vlerësimit të politikave mbi bazën e të cilave funksionon mekanizmi kombëtar për barazinë gjinore.

Me rëndësi thelbësore është zgjerimi i rolit udhëheqës të grave dhe vajzave. Është e pamohueshme që janë bërë përparime të konsiderueshme në fushën e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit politik të grave. Si rrjedhojë e vendosjes së kuotave gjinore, numri i grave deputete në Kuvendin e Shqipërisë dhe i grave anëtare në këshillat bashkiakë ka ardhur duke u rritur. Me 55% për qind të posteve ministrore që përfaqësohen nga gra, Shqipëria renditet ndër dhjetë vendet e para në botë; apo me 42,8 për qind të anëtareve/anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë gra dhe me një Zëvendëskryetare grua të këtij Këshilli, krahasuar me mesataren prej 20,3 për qind në bankat qendrore të vendeve të Bashkimit Evropian. Promovimi i vazhdueshëm i rolit të grave, të rejave e vajzave si agjente ndryshimi dhe si kontribuuese - njësoj si burrat, të rinjtë dhe djemtë – ndikon pozitivisht në marrjen e vendimeve të duhura dhe orientimin e mëtejshëm në rrugën e zhvillimit të vendit, gjatë viteve të ardhshme. Zgjedhjet e fundit parlamentare ofruan mundësi për rikrijimin e një mjedisi politik gjithëpërfshirës, që respekton të drejtat e grave dhe familjareve/familjarëve të kandidatëve/kandidateve burra dhe gra dhe përkrahëseve/përkrahësve të tyre, duke u kushtuar vëmendje nevojave dhe interesave të ndryshme të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, duke u mundësuar atyre që nuk kanë zë që ta thonë fjalën e tyre, si dhe duke promovuar pjesëmarrjen e elektoratit votues dhe jo votues.

Eliminimi i të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore, praktikave të dëmshme dhe dhunës ndaj fëmijëve. Dhuna ndaj grave dhe vajzave vijon të mbetet një nga çështjet që kërkon vëmendje dhe ndërhyrje prioritare. Normat patriarkale të rrënjosura thellë përjetësojnë dhe përligjin dhunën, abuzimin dhe diskriminimin, duke krijuar kështu pengesa të mëdha për arritjen e barazisë së vërtetë ndërmjet grave dhe burrave, vajzave dhe djemve. Mekanizmat e Koordinuar të Referimit (MKR), të ngritura në të 61 bashkitë në vend, ndeshen me vështirësi gjatë funksionimit të tyre; shërbimet mbështetëse të përkujdesit shoqëror dhe ato të specializuara, me gjithë financimin e vazhdueshëm nga shteti nuk janë të mjaftueshme në numër. Përkufizimi ligjor i përdhunimit në Kodin Penal vazhdon të bazohet tek përdorimi i forcës dhe barra e provës bie mbi viktimën. Legjislacioni ka mangësi në fushat e sigurisë në përdorimin e internetit dhe mungojnë dispozitat ligjore për mbrojtjen e viktimave të veprave penale të tjera përveç dhunës në familje (si për shembull, përndjekja, ngacmimi apo sulmi seksual); për rrjedhojë, MKR-të nuk janë të detyruara me ligj që t'i trajtojnë raste të tilla. Rezistenca kulturore ndaj ndryshimit dhe ekzistenca e diskriminimit gjinor të shumëfishtë e të ndërthurur, kufizojnë aksesin në drejtësi për viktimat e dhunës me bazë gjinore që u përkasin grupeve të ndryshme, përfshirë komunitetin rom dhe egjiptian, emigrantet/emigrantët dhe refugjatet/refugjatët, komunitetin LGBTIQ+, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarat/moshuarit, si dhe fëmijët viktimat të krimit ose në konflikt me ligjin. Gjatë pandemisë së COVID-19, dhuna me bazë gjinore çoi në krijimin e një 'pandemie të fshehur' të cilën politikë-bërëset/bërësit duhet ta trajtojnë në tërësinë dhe kompleksitetin e saj, ndër të tjera duke i dhënë përparësi tri qasjeve strategjike:

I) Sigurimi të udhëheqjes dhe llogaridhënies: Aktorët shtetërorë, ndër të cilët parlamenti, qeveria, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut (si Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi) dhe organet gjyqësore, duhet t'u japin përparësi çështjeve të dhunës me bazë gjinore; autoritetet përgjegjëse për promovimin e barazisë gjinore duhet të fuqizohen dhe të pajisen me burimet dhe kapacitetet e duhura për të udhëhequr veprimet reaguese dhe bashkërendimin e tyre. Udhëheqja politike është tepër e rëndësishme, ndër të tjera edhe përmes Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore. Institucionet kombëtare duhet të nxisin ndërmarrjen e veprimeve, të mbikëqyrin përparimin dhe të përshtatin veprimet, duke nxjerrë mësim nga sukseset dhe dështimet. Këtu përfshihet edhe nevoja për një bashkërendim më të mirë të punës me aktorët vendorë: kryetaret/kryetarët e bashkive dhe këshillat bashkiakë, policia dhe gjykatat, mekanizmat e koordinuar të referimit, personeli i shkollave, OJF-të vendore dhe punonjëset/punonjësit socialë. Të gjithë këta aktorë janë në vijën e parë të frontit dhe duhet të jenë të aftë të përmbushin përgjegjësitë e tyre.

II) Më shumë investime: nevojiten më shumë burime për të siguruar zbatimin e plotë të ligjeve ekzistuese. Ndonëse Shqipëria ka bërë përparim të rëndësishëm në harmonizimin e kornizës së saj legjislative me standardet normative ndërkombëtare, është e nevojshme të bëhen ndryshime të tjera për të luftuar në

mënyrë efektive dhunën seksuale, ngacmimin seksual dhe përndjekjen, qoftë online ose jo. Paketa e plotë e shërbimeve për mbrojtjen, trajtimin deri në integrim të viktimave/të mbijetuara/mbijetuarve të dhunës me bazë gjinore, duhet të jetë lehtësisht e aksesueshme nga të gjithë personat në nevojë, pavarësisht vendbanimit të tyre, duke u plotësuar shërbimet aty ku mungojnë, qoftë dhe në formën e shërbimeve të lëvizshme. Këtu përfshihet edhe forcimi i një qasjeje që vë në qendër viktimën dhe siguron më shumë mbrojtje për viktimat/të mbijetuarat, përmes ofrimit të ndihmës juridike dhe zbatimit në kohë të urdhrave të mbrojtjes. Duhet të rritet aksesin në shërbimet e këshillimit shëndetësor dhe psikologjik, mbrojtjes sociale, strehimit, si edhe mundësitë për sigurimin e të ardhurave. Gratë, të rejtat dhe vajzat nga të gjitha grupet në shoqëri, përfshirë edhe gratë azilkërkuese dhe refugjate, duhet të kenë akses në strehëza emergjence funksionale e me standarde. Linjat telefonike kombëtare në ndihmë të qytetareve/qytetarëve dhe rrugët e referimit duhet të bëhen të qëndrueshme, të kenë objektiva të qarta, fonde dhe burime njerëzore të mjaftueshme. Duhet të mbështeten përpjekjet e shoqërisë civile, ndër të tjera edhe ato për trajtimin e dimensioneve të ndërthurura të dhunës me bazë gjinore (si për shembull, prejardhja etnike, moshë, aftësitë e kufizuara, vendbanimi, etj.).

III) Trajtimi me përparësi i edukimit, dialogut dhe ndërgjegjësimin publik. Burrat, të rinjtë dhe djemtë shqiptarë vazhdojnë t'u përmbahen stereotipeve e roleve gjinore, që shpesh lidhen me një rreth të mbyllur agresiviteti. Nevojitet një angazhim i mbarë shoqërisë, me shkollat të pajisura dhe të përgatitura për të qenë në pararojë të promovimit të të drejtave të njeriut dhe të luftës kundër qëndrimeve patriarkale, përmes mobilizimit të nxënësve/nxënësve, prindërve, kujdestareve/kujdestarëve dhe anëtarëve/ anëtarëve të komunitetit, në diskutime mbi tema si mbrojtja e fëmijëve, barazia dhe mosdiskriminimi, diversiteti kulturor dhe racor, edukimi në lidhje me seksualitetin, maskulinitetin pozitiv, fuqizimi i vajzave dhe vetëmbrojtja, si dhe përdorimi i sigurt i internetit. Një rol të jashtëzakonshëm për çrrënjosjen e kulturës së stereotipizimit gjinor, dhunës dhe abuzimit, luan edhe informimi i publikut. Mediat duhet të jenë pjesë e zgjidhjes, përmes raportimit mbi zbatimin e ligjeve dhe politikave, mbështetjes së të mbijetuarave në vend që të përligjin autorët e dhunës, si dhe duke u ofruar mundësi të rinjve dhe të rejave që nuk pajtohen me këtë status-quo, që të shprehin mendimin e tyre. Përveç kësaj, duhet t'i jepet përparësi edhe mbrojtjes së privatësisë së viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve: publikimi i informacioneve me të dhënat personale të viktimave (veçanërisht të të miturave/miturve) nuk duhet të tolerohet.

Forcimi i drejtësisë ekonomike dhe fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave. Në Shqipëri vazhdojnë të ekzistojnë pabarazi gjinore në mundësitë ekonomike, të lidhura me pjesëmarrjen në fuqinë punëtore, nivelet e informalitetit dhe aksesin në burimet prodhuese. Ndonëse është rritur në mënyrë të qëndrueshme punësimi për moshat 15-64 vjeç, pjesëmarrja e grave në forcat e punës vazhdon të jetë më e ulët (66,6 për qind) se sa e burrave (80 për qind).³ Zgjedhjet që bëjnë gratë dhe vajzat ndikohen edhe nga ekzistenca e stereotipeve në punësim, që i orientojnë ato kryesisht në fushën e shërbimit shëndetësor dhe social, në arsim, apo bujqësi – që të gjithë këta sektorë të karakterizuar nga paga të ulëta. Bujqësia mbetet sektori parësor i punësimit të grave (33,9 për qind gra, krahasuar me 23,7 për qind burra).⁴ Përveç kësaj, aksesin në grave në tregun e punës ndikohet edhe nga adresimi i duhur i nevojave të përkujdesit për fëmijët, apo familjarë të tjerë në varësi. Pjesëmarrja e grave në biznes është rritur gjatë dhjetëvjeçarit të fundit dhe 31,2 për qind e bizneseve në vend drejtohen nga gra ose janë në pronësi të grave. Megjithatë, pjesa më e madhe e sipërmarrjeve të grave janë biznese të vogla me kapital të pamjaftueshëm dhe me normë fitimi të ulët (për shembull në manifakturë dhe bujqësi). Pjesëmarrja aktive e grave në zhvillimin e sektorit privat mbetet e ulët, sidomos për gratë në zonat rurale dhe ndikimi i sjelljeve dhe normave diskriminuese gjinore është i pranishëm në të gjitha nivelet. Pabarazitë gjinore në aksesin në kredi gjithashtu luajnë rol në këtë drejtim, së bashku me faktin që titujt e pronësisë mbi tokën vazhdojnë të jenë më së shumti në emër të “kryefamiljarit” (kryesisht bashkëshorti, vjehri, vëllai, babai, gjyshi), çka kufizon të drejtat e grave mbi burime prodhuese, si e drejta për regjistrimin e biznesit, e drejta për përfitimin e kredive dhe të shërbimeve këshillimore bujqësore, si dhe mundësitë e tyre për t'u larguar nga një marrëdhënie e dhunshme. Për të përshpejtuar fuqizimin e grave dhe të vajzave, duhet t'u jepet përparësi veprimeve të mëposhtme:

3. Shih të dhënat e INSTAT nga botimi “Burra dhe gra, 2023”, faqe nr.71 <https://www.instat.gov.al/media/12598/burra-dhe-gra-2023.pdf>

4. Shih të dhënat e INSTAT nga botimi “Burra dhe gra, 2023” faqe nr.78 <https://www.instat.gov.al/media/12598/burra-dhe-gra-2023.pdf>

I) Promovimi i punës së denjë, pagave të barabarta dhe të drejtave të punonjëseve/punonjësve, si dhe i kalimit të grave nga ekonomia informale në atë formale, përmes zvogëlimit të ndarjeve gjinore në tregun e punës, si dhe rritjes së rolit drejtues të grave dhe fuqisë së tyre negociuese në familje, mbi vendimet ekonomike. Nevojiten investime më të mëdha në shërbime cilësore të përkujdesit, reforma në legjislacion dhe politika, krijimi i punëve të denja të përkujdesit për njohjen, reduktimin, rishpërndarjen dhe shpërbimin e punës së papaguar të përkujdesit, si dhe për garantimin e të drejtave dhe përfaqësimin e personave që punojnë në fushën e përkujdesit.

II) Nxjtja dhe fuqizimi i sipërmarrjeve të grave dhe i bizneseve të drejtuara nga gratë, përfshirë sipërmarrjet sociale dhe aksesin në financime përmes ofrimit të skemave investuese inovative, që promovojnë krijimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të drejtuara nga gratë. Ndër veprimet e tjera të synuara duhet të përfshihen edhe shërbimet për zhvillimin e bizneseve dhe mbështetja e punësimit, si dhe punësimi në ekonominë e gjelbër. Është e nevojshme të krijohet një mjedis që mundëson aktivitetet ekonomike të grave dhe aksesin e tyre në burimet prodhuese, përfshirë aksesin e grave në përdorimin e tokës, në të ardhurat nga emigracioni, në teknologji dhe financë.

III) Kundërvënja ndaj normave gjinore ekzistuese brenda familjes dhe në tregun e punës, përmes njohjes së roleve dhe përgjegjësisë në familje të burrave dhe djemve, duke nxitur reforma ligjore si përfshirja në ligj dhe zbatimin në praktikë i dispozitave për lejen e paguar të atësisë.

Investime për shëndetin dhe arsimimin e grave. Shqipëria shpenzon afërsisht 3 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) për shëndetësinë dhe arsimin, krahasuar me 9,9 për qind të PBB-së që shpenzohet mesatarisht në vendet e Bashkimit Evropian. Pavarësisht përmirësimeve në këtë drejtim, ka ende nevojë për ndërhyrje veçanërisht për grupe të caktuara, si për shembull për gratë që jetojnë në zonat rurale dhe të thella, si dhe për gratë rome dhe egjiptiane të cilat e kanë më të kufizuar aksesin në shërbimin shëndetësor parësor dhe në shërbimet e shëndetit seksual e atij riprodhues. Lindshmëria në adoleshencë është zvogëluar gjatë vitit 2022 krahasuar me një vit më parë (10 lindje për çdo 1,000 vajza të grup moshës 15-19 vjeç, krahasuar me 12.1 lindje në vitin 2021).⁵ Siç janë parashikuar në Planin e Veprimit 2021-2027 për personat LGBTIQ+, po hidhen hapa për hartimin e protokolleve përkatëse dhe masave të tjera të parashikuara për foshnjat dhe individët interseks. Megjithatë, është e rëndësishme të përshkallëzohen veprimet për zgjerimin e programeve të edukimit gjithëpërfshirës mbi shëndetin seksual e riprodhues, për të siguruar që gratë, të rejat dhe vajzat, nga të gjitha grupet, të gëzojnë të drejtat e tyre shëndetësore pa diskriminim. Këtu duhet të përfshihen:

I) Përmirësimi i aksesit në shërbimet shëndetësore dhe shërbimet e parandalimit në shëndetin publik, sidomos për sa i përket aksesit në këto shërbime të grave që u përkasin pakicave kombëtare dhe të vajzave të reja, si dhe për parandalimin e HIV-it dhe zhvillimin e edukimit seksual gjithëpërfshirës;

II) Marrja e masave të efektshme për eliminimin e diskriminimit të personave LGBTIQ+, sigurimin e aksesit të tyre pa diskriminim në shërbimet shëndetësore, si dhe përfshirja e edukimit lidhur me personat LGBTIQ+ në programet shkollore.

Rezultatet arsimore gjithashtu ndikojnë në orientimin e vajzave dhe të rejave në përzgjedhjen e degëve të studimeve të larta, si dhe më pas në aksesin e tyre në tregun e punës. Në arsimin profesional, pjesa më e madhe (afërsisht 82 për qind) janë djem, kryesisht për shkak të ekzistencës së stereotipeve lidhur me “profesionet e burrave”, mjedisit social në shkollat profesionale, llojeve të programeve shkollore të ofruara, si dhe perspektivave për punësim të vajzave pas mbarimit të shkollës. Nga ana tjetër, në arsimin universitar, 58,7 për qind e studenteve/studentëve janë vajza, krahasuar me 41,3 për qind djem.⁶ Ndonëse numri i vajzave

5. INSTAT, “Burra dhe gra, 2023” faqe nr.15. Shih: <https://www.instat.gov.al/media/12598/burra-dhe-gra-2023.pdf>

6. INSTAT, “Burra dhe gra, 2023” faqe nr.58. Shih: <https://www.instat.gov.al/media/12598/burra-dhe-gra-2023.pdf>

që marrin diplomë universitare është më i madh krahasuar me atë të djemve, numri i vajzave që bëhen pjesë e forcave të punës është më i ulët dhe nuk i përgjigjet nivelit të kualifikimit të tyre arsimor. Shkollat dhe universitetet mund të luajnë gjithashtu një rol shumë më aktiv për zhdukjen e mendësisë patriarkale dhe stereotipeve gjinore që vazhdojnë t'i lënë gratë pas, si dhe të rishikojnë kriteret e regjistrimit për të lejuar përfshirjen e më shumë djemve dhe vajzave refugjate në sistemin arsimor. Për kapërcimin e këtyre sfidave duhet të ndërmerren veprime të bashkërenduara në këto fusha:

I) T'i jepet përparësi arsimit gjithëpërfshirës dhe të përballeshëm financiarisht, përmes krijimit të strukturave arsimore më të forta dhe më të përgjigjshme gjinore për promovimin e barazisë gjinore, mosdiskriminimit dhe gjithëpërfshirjes. Masa e ndërmarra e që po zbatohet në vazhdimësi, të tilla si ofrimi i bursave, transportit për nxënëset/nxënësit që jetojnë në zona të largëta, programet e formimit dhe zhvillimit profesional të mësueseve/mësuesve, rikontruksioni dhe ndërtimi i objekteve arsimore të cilat plotësojnë standardet e aksesueshmërisë dhe barazisë gjinore, etj., duhet të vijojnë dhe të fokusohen veçanërisht në ofrimin e arsimit cilësor për grupet e cënueshme.

II) Të investohet më shumë në arsimimin e vajzave për të arritur akses të barabartë në të gjitha format e arsimit dhe të formimit profesional, me më shumë fokus në fushat e shkencës, teknologjisë, inxhinierisë dhe matematikës, njohuritë dhe aftësitë digjitale, si dhe në arsimin dhe formimin teknik dhe profesional.

III) Luftimi i stereotipeve gjinore. Shkollat e të gjitha niveleve duhet të shërbejnë si pika hyrjeje strategjike për të luftuar stereotipet gjinore, normat sociale dhe qëndrimet diskriminuese që ende i lënë gratë dhe vajzat pas, duke u fokusuar mbi zvogëlimin e dhunës me bazë gjinore, si dhe rritjen e mirëqenies dhe sigurisë fizike/mendore si të djemve, ashtu edhe të vajzave.

2. Cilat kanë qenë pesë prioritetet kryesore për përshpejtimin e progresit të grave dhe vajzave në vendin tuaj përmes ligjeve, politikave dhe/ose programeve gjatë pesë viteve të fundit?

1. Politikat, legjislacioni, shërbimet në lidhje me barazinë dhe mosdiskriminimin sipas ligjit dhe aksesit në drejtësi. Barazia gjinore është një nga objektivat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030 dhe ndërhyrjet specifike kontribuojnë në arritjen e Objektive të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) si dhe të Agjendës së OKB-së 2030. Në SKZHIE, vizioni i barazinë gjinore synon “Një shoqëri e cila vlerëson barazinë dhe drejtësinë gjinore si kushte të domosdoshme drejt zhvillimit të qëndrueshëm social, ekonomik e politik të vendit, fuqizon të gjithë individët për të gëzuar të drejta dhe mundësi të barabarta në të gjitha fushat e jetës, nuk lejon që askush të mbetet pas, si dhe që mbështetet në parimin e tolerancës zero kundër praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, duke ndëshkuar dhunuesit dhe duke mbrojtur, rehabilituar e riintegruar personat e dhunuar”. Për të avancuar më tej Qeveria e Shqipërisë ka miratuar “Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030 (SKBGJ 2021-2030) dhe Planin e saj të Veprimit”, ku parashikohen masa dhe veprime të cilat harmonizohen edhe me plotësimin e OZHQ dhe të Agjendës 2030. Të gjitha ministratë e linjës dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë marrë masa dhe planifikojnë vazhdimisht veprime për të përmbushur qëllimet e këtyre dy strategjive të rëndësishme, në bashkëpunim dhe me partnerët, organizatat e shoqërisë civile e ato ndërkombëtare. Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar⁷ është përafëruar me aktet e BE-së, jo vetëm nga aspekti juridik por edhe si perceptim më i avancuar shoqëror dhe institucional i parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit. Ndryshimet kryesore

7. Miratuar me Ligjin Nr. 124/2020 datë 15.10.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi””.

konsistojnë në: shtimin e shkaqeve që ndalojnë diskriminimin si shtetësia, karakteristikat e seksit, jetesës me HIV/AIDS dhe pamjes së jashtme (Neni 1); shtimin e formave të diskriminimit si, diskriminimi i shumëfishtë, diskriminimi për shkak të përkatësisë së shumëfishtë (intersectionality), gjuha e urrejtjes, veçimi, shqetësimi seksual, diskriminimi i strukturuar, nxitja dhe ndihma për diskriminim, qëllimi i shpallur për diskriminim, përkufizim i ri për “viktimizimin” (Neni 3); parashikimin e ri ligjor dhe dyfishimin e sanksioneve për format e rënda të diskriminimit (Neni 3/1 dhe neni 33); detyrimin e autoriteteve publike për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre (Neni 7, pika 3); ndryshimin e kompetencave të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi lidhur me shqyrtimin e ankesave nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar edhe kur janë anonime, nga organizatat me interes legjitim, e drejta për të paraqitur padi në gjykatë në mbrojtje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, e drejta për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, monitorimin e zbatimit të Ligjit “Për barazinë gjinore në shoqëri”, për çështje që lidhen me interesa kolektive (Nenet 32, 33); zgjatjen e afateve për paraqitjen e ankesës, “zhvendosjen e barrës së provës”, duke i kaluar subjektit ndaj të cilit pretendohet se ka kryer sjellje diskriminuese (Neni 33); detyrimin e medias kombëtare për të publikuar vendimet e Komisionerit që kanë gjetur diskriminim përmes gjuhës së urrejtjes, etj.

Aksesi në drejtësi. Në raportin e mëparshëm kemi sqaruar miratimin e ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, që mundësoi krijimin për herë të parë të një rrjetëzimi institucionesh përgjegjëse dhe të angazhuara në ofrimin dhe garantimin e shërbimeve juridike. Në muajin shtator 2020, ligji u bë tërësisht funksional me miratimin e të gjitha akteve të fundit nënligjore në zbatim të tij, 13 (trembëdhjetë) gjithsej, të cilat rregullojnë çdo fushë specifike të ndihmës juridike. Të drejtat, mbrojtja dhe përfshirja e grave dhe vajzave janë në fokus të punës të pushtetit vendor, ku shumë prej bashkive kanë ndërmarrë një sërë masash në nivel politikash, ndër të cilat, nënshkrimin nga 18 (tetëmbëdhjetë) bashki të vendit, të Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore dhe përgatitjen e miratimit në Këshillat Bashkiakë të Planeve Vendore të Veprimit për Barazinë Gjinore nga 12 prej tyre; apo përgatitja e Planeve Sociale të miratuara në Këshillin Bashkiak, ku janë përfshirë edhe masa për viktimat e dhunës dhe trafikimit, sikurse dhe për grupet e tjera të pa favorizuara të grave, përmes të cilave bashkitë mund të aplikojnë në Fondin Social për të përmbushur nevojat e tyre për shërbime sociale për grupet në nevojë.

2. Eliminimi i dhunës ndaj grave dhe vajzave ka qenë në fokus të nismave ligjvënësë të miratuara nga shteti shqiptar, duke i dhënë përparësi zbatimit të rekomandimeve të GREVIOs apo Komitetit CEDAW, të cilat kanë mundësuar miratimin e një sërë masash gjithë përfshirëse dhe të bashkërenduara për luftën ndaj dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës me bazë gjinore ndaj grave. Janë përmbushur **rekomandimet urgjente që lidhen me përmirësimin e legjisllacionit**, përmes miratimit të ndryshimeve në ligjin ekzistues kundër dhunës në familje, plotësimit të kuadrit nënligjor, ndryshimeve në Kodin Penal dhe miratimit të ligjeve të reja. **SKZHIE 2022- 2030** një nga shtyllat kryesore të forcimit të të drejtave të njeriut synon ‘Demokracinë dhe fuqizimin e institucioneve dhe qeverisjes së mirë’, ku disa nga objektivat strategjike që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me SKBGJ 2021-2030 fokusohen te zvogëlimi i dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Masa të tjera që lidhen me arritjet në këtë drejtim konsistojnë në: ngritjen e Mekanizmave të Koordinuar të Referimit (MKR) të rasteve të dhunës në familje në mbarë vendin (61 bashki); shtimin e numrit të shërbimeve mbështetëse të specializuara për trajtimin e viktimave/të mbijetuarave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore (35 gjithsej); rritjen e përqindjes së dhunuesve të ndëshkuar e më pas të rehabilituar; rritjen e numrit të profesionisteve/profesionistëve të trajnuar që punojnë me viktimat e dhunës me bazë gjinore (gjyqtare/e, prokurorë/e, mësues/e, police, oficerë/e të policisë gjyqësore, koordinatorë/e vendor, përmbarrues/e gjyqësorë, mjek/e etj); organizimin e fushatave ndërgjegjësuere dhe aktivitete të edukimit ligjor duke bërë pjesë të zgjidhjes edhe burrat dhe djemtë, etj.

3. Pjesëmarrja dhe përfaqësimi politik. Qeveria Shqiptare ka bërë përparime me rëndësi në pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje. Indeksi i Barazisë Gjinore në vend, i publikuar për herë të parë në vitin 2020, sipas metodologjisë evropiane, e rendit Shqipërinë më mirë se mesatarja e anëtarëve të BE-së në fushën e

pushtetit, ku zbatimi i kuotave gjinore ka rezultuar rritje të ndjeshme të përfaqësimit të grave dhe vajzave në jetën politike dhe vendimmarrje. Numri i deputeteve gra në Kuvendin e Shqipërisë ka ardhur duke u rritur, nga 36 (29.5%) në vitin 2019, në 50 (35.7%) në vitin 2024. Në zgjedhjet Parlamentare/për Kuvendin, të datës 25 Prill 2021, u regjistruan 1,841 kandidatë/kandidate (732 gra dhe 1109 burra) dhe u zgjodhën 140 deputete/deputetë (50 gra dhe 90 burra). Kryetarja e Kuvendit është grua; nënkryetare/nënkryetarë një grua dhe një burrë; nga tetë Komisione të Përhershme gjithsej, katër ose 50% drejtohen nga gra; Qeveria drejtohet nga një Kryeministër burrë, një Zëvendës kryeministër grua dhe përbëhet nga 17 ministër/ministra nga të cilat/cilët 10 gra. *Pushteti vendor*: Nga zgjedhjet vendore të 2019 rezultojnë 8 kryetare bashkie gra nga 61 bashki gjithsej (ose 13%). Krahasuar me vitin 2016 ku ishin 6 kryetare bashkie ose 9.8% kemi një rritje prej 3.2%. Në zgjedhjet e pjesshme vendore të marsit 2022 u regjistruan gjithsej 19 kandidatë/kandidate për kryetare/kryetarë bashkie (3 gra dhe 16 burra) dhe në 6 bashkitë që u zhvilluan këto zgjedhje rezultuan fituese/fitues 6 kryetare/kryetarë bashkie (2 gra dhe 4 burra). Gratë në Këshillat Bashkiakë përbëjnë rreth 44% të numrit të përgjithshëm të këshilltareve/këshilltarëve. Arritje të tjera konsistojnë në: promovimin e angazhimit të grave në politikë dhe inkurajimin e tyre për të marrë pjesë në zgjedhje si kandidatë ose votuese; sensibilizimin dhe trajnimin e të gjithë personelit zgjedhor për të siguruar përmbushjen e kuotave gjinore dhe respektimin e të drejtave të grave në procesin zgjedhor; monitorimin dhe raportimin e të dhënave në lidhje me përfaqësimin e grave në politikë dhe në organet zgjedhore për të identifikuar ndonjë mungesë apo sfidë në këtë drejtim.

4. Mbrojtja sociale e përgjigjshme gjinore (p.sh. mbulimi shëndetësor universal, transfertat në para, pensionet). Në avancimin e barazisë gjinore në fushën e mbrojtjes sociale, Shqipëria ka bërë disa përpertime të rëndësishme. Fokusi në mbrojtjen sociale përfshin edhe mbulimin shëndetësor universal, transfertat në para dhe pensionet, ku politika dhe programet për mbrojtjen sociale të përgjigjshme gjinore janë thelbësore për sigurimin e barazisë. Shqipëria ka ndërmarrë hapa për të përmirësuar aksesin në shërbimet shëndetësore për të gjitha/gjithë qytetarët/qytetarët, duke përfshirë edhe gratë. Ka programe specifike për shëndetin e nënës dhe fëmijës, duke siguruar kujdes prenatal dhe postnatal, depistimin e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, kancerin e gjirit, të organeve riprodhuese, etj. Po kështu rëndësi i kushtohet gjithnjë e më shumë edukimit gjithëpërfshirës mbi shëndetin seksual e riprodhues. Qeveria shqiptare ka zbatuar programe të ndryshme të ndihmës sociale që synojnë të mbështesin familjet me të ardhura të ulëta, duke përfshirë transfertat në para që mund të ndihmojnë gratë në situata më të pafavorshme ekonomike, duke e trefishuar mbështetjen ekonomike të tyre. Sistemi i pensioneve në Shqipëri gjithashtu ka përfshirë dispozita që synojnë të mbështesin gratë e moshuara.

5. Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor (BPGJ). Fondet e buxhetit të shtetit gjatë këtyre pesë viteve kanë ardhur në rritje, ku përqindja e totalit të shpenzimeve buxhetore në Programet Buxhetore Afatmesme (PBA) për çështjet gjinore është rritur nga 2,3% për PBA 2017-2019 në 9% për PBA 2022-2024 si dhe 10% për Buxhetimin e Përgjigjshëm Gjinor në tre vitet e fundit. Fondet buxhetore për BPGJ në PBA 2017-2019 rezultojnë 90 milion USD⁸ dhe 410 milionë USD për PBA 2022-2024. Për herë të parë në vitin 2020, Sistemi i ri Informativ i Menaxhimit Financiar Shqiptar mundësoi monitorimin e ekzekutimit të buxhetit dhe bëri të mundur llogaritjen e sasisë së saktë të fondeve të BPGJ-së të shpenzuara nga institucionet qendrore. Ligji për financat e vetëqeverisjes vendore gjithashtu ka krijuar mundësitë për përfshirjen e efektshme të BPGJ në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit financiar vendor (programimi i buxhetit vjetor dhe afatmesëm, monitorimi dhe raportimi, vlerësimi dhe auditimi). Në mënyrë të detyrueshme, Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (NJVV-ve) u ngarkohet që të paktën në një nga objektivat e politikave të programeve të adresojnë problematika të pabarazisë gjinore ose respektimin e plotë të barazisë gjinore, duke identifikuar qartazi produktet dhe treguesit gjinorë.

8. Llogaritjet luhaten edhe në bazë të kursit të këmbimit USD/për të gjitha

3. Cilat veprime të veçanta keni ndërmarrë për parandalimin e diskriminimit dhe promovimin e të drejtave të grupeve të marginalizuara të grave dhe vajzave gjatë pesë viteve të fundit?

Në masat legislative parimet e barazisë dhe ndalimit të çdo forme diskriminimi ndaj grave dhe grupeve të cënueshme si viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit, dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje, nënat e reja, personat me aftësi të kufizuara, minoritetet, personat LGBTI, të moshuarat/moshuarit, etj., janë përfshirë në ligjet e reja apo të përmirësuara mbi: shërbimet e kujdesit shoqëror, punësimin dhe programet e tij, sigurimet shoqërore, sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, strehimin social, pronësinë, arsimin, ndihmën juridike, përshtatjen dhe aksesueshmërinë, mbrojtjen e fëmijëve, Kodin e Procedurave Penale, etj.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka ndërmarrë një sërë masash për plotësimin dhe intensifikimin e përpjekjeve për promovimin e barazisë gjinore dhe parandalimin e diskriminimit, përfshirë atë të shumëfishtë e të ndërthurur, si: zhvillimin e seancave publike të Komisioneve të Përhershme të Kuvendit dhe raportimet vjetore të Prokurorit të Përgjithshëm, Avokatit të Popullit, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, etj., ku është kërkuar/dhënë informacion për çështje që lidhen edhe me barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin, rekomandimet e CEDAW, etj.; zhvillimin e seancave dëgjimore me gra/vajza rome dhe egjiptiane, një pjesë e të cilave viktimat të dhunës në familje, si dhe me të rinj/të reja mbi diskriminimin gjinor, bulizmin, dhunën në shkollë e dhunën me bazë gjinore; ngritjen e Nënkomisionit për Zhvillim të Qëndrueshëm; ushtrimin e kontrollit parlamentar mbi zbatimin nga institucionet qendrore, vendore apo të pavarura, të parimit të barazisë (parashikuar në ligjin për barazinë gjinore); rritjen e përfaqësimit të grave në parlament dhe organet e tij (50 gra deputete në këtë legjislaturë); në organizatat ndërkombëtare dhe delegacionet e përhershme; në organet kushtetuese dhe të krijuara me ligj, si dhe në shërbimin gjyqësor, etj.

Institucionet e pavarura e të të drejtave të njeriut ndërmarrin vazhdimisht veprime në këtë drejtim. Për shembull: **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** ka ndërmarrë disa masa për parandalimin e diskriminimit dhe promovimin e të drejtave të grupeve të nën përfaqësuara të grave dhe vajzave në procesin zgjedhor si: organizimin e fushatave informuese dhe edukuese për të rritur ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në procesin zgjedhor, duke theksuar rëndësinë e votimit dhe të drejtave të tyre zgjedhore; bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit për të monitoruar dhe raportuar raste të mundshme të diskriminimit gjatë procesit zgjedhor dhe për të ofruar mbështetje dhe ndihmë në rastet e nevojshme; krijimin e platformave dhe mekanizmave për të dëgjuar dhe adresuar shqetësimet dhe nevojat e grave dhe vajzave në lidhje me procesin zgjedhor; spote televizive dhe në radio dedikuar grave, vajzave dhe rëndësisë së përfshirjes së tyre në procesin zgjedhor, etj. **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi** ka dhënë disa rekomandime lidhur me: zbatimin e parimit të barazisë gjinore në organet e emëruara të pushtetit vendor; çështjet e mbrojtjes nga diskriminimi në shpërblim në marrëdhëniet e punës; marrjen e veprimeve pozitive, në pikat kufitare, duke i dhënë përparësi të moshuarave/moshuarve, fëmijëve, personave me gjendje të rënduar shëndetësore, personave me aftësi të kufizuara dhe grave shtatzëna; miratimin e një fondi shtesë të skemës së ndihmës ekonomike, në vlerën prej 500 lekësh në muaj, për çdo fëmijë të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, të cilët ndjekin rregullisht procesin mësimor; procesin e hartimit të kontratave të dhurimit edhe në emër të grave për banesat e përfituara nga grantet e rindërtimit si pasojë e dëmtimeve të tërmetit të vitit 2019; marrjen e masave për të garantuar përfitimin në mënyrë efektive të ndihmës ekonomike, nga ana e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare, etj. **Avokati i Popullit** po fuqizon veprimtarinë e tij për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve/qytetarëve, nxitjen e llogaridhënies nga organet qeveritare, monitorimin e zbatimit të Konventave të rëndësishme të ratifikuara, hartimin e raporteve të veçanta në fushën e barazisë gjinore (mbi dhunën ndaj grave, ngacmimin moral dhe seksual në administratën publike,

situatën e komunitetit LGBTQ+, monitorimin e buxhetimit gjinor, etj.). Iniciativa e fundit e ndërmarrë në lidhje me Observatorin e Femicidit, është gjithashtu një tjetër veprim me rëndësi në këtë drejtim dhe një model shumë i mirë i punës së institucioneve të fokusuara në mbrojtje të të drejtave të njeriut.

Në politikat kryesore për barazinë gjinore, parandalimi i diskriminimit dhe promovimi i të drejtave të grupeve të marginalizuara të grave dhe vajzave theksohet jo vetëm në përshkrimin e tyre, por edhe në të gjitha masat dhe veprimet që parashikohen për zbatim dhe përmbushjen e qëllimeve për të cilat këto politika hartohen (si shembull sjellim Strategjinë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2021-2030 që i thekson këta elementë në tërësinë e saj dhe në objektivat strategjike, specifike dhe masat e planifikuara).

Institucionet përgjegjëse qendrore dhe të vetëqeverisjes vendore zhvillojnë vazhdimisht ndërhyrje me qëllim parandalimin e diskriminimit të shumëfishtë e të ndërthurur dhe promovimin e të drejtave të grave, të rejave e vajzave nga të gjitha grupet në shoqëri (sikurse është sqaruar në përgjigjet e pyetjeve në vijim, veçanërisht në seksionin e tretë të këtij raporti).

Trajnimi i profesionsteve/profesionistëve mbi instrumentet ndërkombëtare, promovimin e barazisë gjinore dhe veprimeve kundër diskriminimit gjinor, janë gjithashtu të rëndësishme për të adresuar në mënyrën e duhur çështje të diskriminimit gjinor dhe të respektimit të të drejtave të grave, të rejave e vajzave nga të gjitha grupet në shoqëri. Siç sqarohet në përgjigjet e pyetjeve sidomos në seksionin e tretë të këtij raporti, këto aktivitete të ngritjes dhe fuqizimit të kapaciteteve profesionale, në çdo fushë, janë zhvilluar me përparësi dhe duke iu kushtuar vëmendjen e duhur, falë edhe bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile dhe ato ndërkombëtare.

Ngritja, fuqizimi dhe shtrirja e shërbimeve të kujdesit shoqëror, është gjithashtu një tjetër masë e rëndësishme e ndërmarrë gjatë pesë viteve të fundit me synim ofrimin e shërbimeve për të gjitha/gjithë individët në nevojë, me fokus, gratë, të reja dhe vajzat nga grupet e cënueshme dhe me qëllim që askush të mos mbetet pas.

Sa më sipër, si dhe të gjitha sqarimet e dhëna më tej në përgjigje të pyetjeve në seksionet specifike të këtij raporti, tregojnë se Shqipëria mban në vëmendje adresimin në mënyrën e duhur të diskriminimit gjinor të shumëfishtë e të ndërthurur (përfshirë intersectionality) si dhe njohjen, respektimin, gëzimin dhe mbrojtjen e të drejtave të grave, të rejave e vajzave, nga të gjithë grupet në shoqëri.

4. Si ka ndikuar ndërthurja e krizave të ndryshme në zbatimin e PVP -së në vendin tuaj dhe çfarë masash keni marrë për të parandaluar ndikimin e tyre negativ në progresin për gratë dhe vajzat gjatë pesë viteve të fundit?

Krizat mbarë botërore dhe ato kombëtare të kaluara në pesë vitet e fundit si pandemia e COVID-19, lufta në Ukrainë, tërmeti i vitit 2019, etj., padyshim që kanë ndikuar në masat dhe veprimet e ndërmarra për zbatimin e Platformës për Veprim të Pekinit, duke bërë ndonjëherë edhe tkurrjen e burimeve në dispozicion të këtyre masave për periudha të caktuara.

Tërmeti i nëntorit 2019 dhe pandemia COVID-19 kanë ndikuar në zbatimin e programeve sociale të strehimit dhe kanë nxjerrë në pah nevojën e gatishmërisë për përballimin e rrezikut të fatkeqësive në këtë sektor, në nivele të ndryshme. Tërmeti i vitit 2019 la rreth 11,490 njësi banimi të dëmtuara ose të shkatërruara rëndë dhe afërsisht 19,000 të tjera me dëmtime mesatare. Pasojat e tërmetit ishin të rënda në zonat rurale ku banorë/banorët humbën shtëpitë e tyre dhe objektet e tjera bazë, të nevojshme për aktivitetet e tyre të përditshme. Fondet e alokuara për tërmetin arrijnë në pothuajse 90% të buxhetit të përgjithshëm të alokuar për banesat sociale.

Mungesa e sigurimit të pronës e bizneseve ka rezultuar jo vetëm në humbje individuale për pronaret/pronarët e prekur drejtpërdrejt, por edhe në një barrë më të madhe për buxhetin, borxhin publik dhe brezat që do të vijnë. Qeveria dhe siguresit privatë kanë njohur nevojën për përpjekje të intensifikuara për të rritur mbulimin e sigurimit në të ardhmen. Një projektligj për futjen e sigurimit të detyrueshëm të banesave është hartuar së fundmi (në gusht 2023) duke përfshirë një formulë për llogaritjen e tij, të lidhur me zonën ku ndodhet shtëpia dhe madhësinë e saj. Detyrimi për blerjen e sigurimit ndaj tërmeteve vlen edhe për banesat sociale me qira dhe njësitë në proces legalizimi. Për kategoritë në nevojë, primet do të përballohen nga buxheti i shtetit. Projektligji i hap rrugën krijimit të një Fondi Kombëtar për Tërmetet, i cili do të financohet kryesisht nga primet e mbledhura nga publiku, financime nga buxheti i shtetit dhe donacione.

Rritja e përgjithshme e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) ka mbetur në nivele të qëndrueshme vjetore prej 3-4%, me përjashtim të periudhës së pandemisë COVID-19, kur rritja e PBB-së përjetoi pikën më të ulët dhe më të lartë midis 2021 dhe 2022.

Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet që pas periudhës 2019-2020, është rivendosur theksi në të dymbëdhjetë fushat kritike dhe janë parashikuar masa e veprime për të parandaluar edhe ndikimet negative që këto kriza mund të kenë në jetën e grave, të rejave dhe vajzave në të ardhmen (përfshirë këtu edhe në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030).

Shqipëria do të vijojë të monitorojë, analizojë dhe reagojë ndaj efekteve të jashtme në zhvillim, nëpërmjet veprimeve kryesore të politikave dhe strategjive monetare, fiskale dhe të tjera makroekonomike, strategji të cilat do të kenë ndikime që priten të sjellin ndryshime në të gjithë sektorët e ekonomisë dhe shoqërisë shqiptare.

5. Cilat janë prioritetet për përshpejtimin e progresit për gratë dhe vajzat në vendin tuaj nëpërmjet legjislationit, politikave dhe/ose programeve gjatë pesë viteve të ardhshme?

1. Prioritizimi i arsimit cilësor, trajnimit dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës për gratë dhe vajzat në Shqipëri në pesë vitet e ardhshme është thelbësor për promovimin e barazisë gjinore, zhvillimin ekonomik dhe përparimin social. Këto përpjekje jo vetëm që kontribuojnë në fuqizimin e grave dhe vajzave, por gjithashtu krijojnë një bazë për një shoqëri më të begatë dhe të drejtë. Shteti shqiptar nëpërmjet këtij prioriteti synon të adresojë pabarazitë gjinore që vijnë të hasin vajzat dhe gratë në qasjen e tyre në arsim dhe në aksesin në arsim cilësor. Prioriteti i arsimit ndihmon në ngushtimin e hendekut gjinor, duke siguruar mundësi të barabarta për të mësuar dhe për të zhvilluar aftësi. Arsimi dhe trajnimi janë thelbësorë për përgatitjen e grave, nga të gjitha grupet në shoqëri, me aftësitë e nevojshme për tregun e punës, duke përmirësuar kështu punësimin e tyre dhe duke ulur pabarazitë gjinore në normat e punësimit. Gratë e arsimuara kanë më shumë gjasa të marrin pjesë në forcën e punës, duke kontribuar në rritjen ekonomike. Duke përmirësuar arsimin për gratë dhe vajzat, Shqipëria mund të shfrytëzojë plotësisht potencialin e saj ekonomik. Arsimi nxit sipërmarrjen. Gratë që marrin trajnime janë më të përgatitura për të filluar dhe për të mbajtur biznese, duke nxitur inovacionin dhe diversifikimin ekonomik. Promovimi i arsimit për gratë dhe vajzat ndihmon në sfidimin dhe ndryshimin e roleve dhe stereotipeve tradicionale gjinore, duke krijuar një shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe të barabartë. Arsimi u siguron grave mjetet e nevojshme për pavarësi ekonomike, duke reduktuar kështu cenueshmërinë e tyre ndaj varfërisë dhe duke rritur rezistencën ndaj problemeve ekonomike. Ky prioritet përputhet me të gjitha masat që Shqipëria ka marrë por edhe me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), veçanërisht OZHQ 4 (Arsim cilësor) dhe OZHQ 5 (Barazi gjinore). Ndërsa Shqipëria ka përafëruar legjislationin me Bashkimin Evropian, përmirësimi i arsimit për gratë dhe vajzat demonstroi një përkushtim ndaj vlerave dhe standardeve të BE-së për barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut.

2. Prioritizimi i eliminimit të dhunës ndaj grave dhe vajzave tregon përkushtimin e Shqipërisë ndaj parimeve themelore të drejtësisë dhe barazisë. Ky angazhim lidhet jo vetëm me zbatimin e ligjeve por edhe strategjive që kanë parashikuar aktivitete dhe masa konkrete për t'u realizuar deri në vitin 2030. Gjithashtu, si pjesë e mekanizmave ndërkombëtare në vitet e ardhshme do të zbatohen edhe rekomandimet përkatëse të CEDAW⁹, rekomandimet që do të jap grupi i eksperteve/ekspertëve GREVIO, etj. Zbatimi efektiv i këtyre konventave kërkon veprime konkrete dhe të vazhdueshme për të eliminuar dhunën ndaj grave. Gjithashtu, dhuna ndaj grave është një fenomen kompleks, që ka ndikime të rënda fizike dhe psikologjike. Gratë që përjetojnë dhunë shpesh vuajnë nga probleme shëndetësore afatgjata, probleme të shëndetit mendor dhe probleme të shëndetit riprodhues. Dhuna në familje prek jo vetëm gratë, por edhe fëmijët dhe gjithë familjen. Kjo ndikon negativisht në stabilitetin dhe mirëqenien e familjeve dhe komuniteteve. Eliminimi i dhunës ndaj grave është thelbësor për fuqizimin e tyre dhe përfshirjen aktive në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike. Dhuna pengon pjesëmarrjen e plotë të grave në shoqëri dhe ndikon në mundësitë e tyre për zhvillim personal dhe profesional. Dhuna ndaj grave ka një kosto të konsiderueshme ekonomike, përfshirë shpenzimet për shëndetin publik, shërbimet sociale dhe produktivitetin e humbur. Investimi në parandalimin e dhunës dhe mbështetjen e viktimave mund të çojë në kursime të mëdha ekonomike për shtetin. Gratë që janë të sigurta dhe të mbështetura janë më të prirura të marrin pjesë në tregun e punës, duke kontribuar kështu në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të vendit. OZHQ 5 (Barazia Gjinore) kërkon arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave. Eliminimi i dhunës ndaj grave është një pjesë kyçe e këtij objekti dhe është thelbësor për përparimin e qëndrueshëm. Parandalimi i dhunës ndaj grave ndihmon gjithashtu në arritjen e objektivave të tjerë, si shëndeti dhe mirëqenia (OZHQ 3), arsimi cilësor (OZHQ 4) dhe paqja, drejtësia dhe institucionet e forta (OZHQ 16).

9. Plani i veprimit të përbushjes së rekomandimeve të dhëna nga Komiteti CEDAW në tetor 2023, i miratuar në KKBGJ, më datë 27 Maj 2024

3. Gratë në sipërmarrje dhe sipërmarrja e grave është në fokus të politikave shqiptare. Është krijuar një strategji e posaçme, e cila synon sipërmarrjen e grave dhe vajzave; nisma të tjera të tjera konsistojnë në krijimin e start-up dhe fuqizimin ekonomik të grave sipërmarrëse, të cilat rrisin pavarësinë e tyre ekonomike dhe reduktojnë varësinë nga burimet e tjera të të ardhurave, duke i dhënë mundësi grave të kenë më shumë kontroll mbi jetën e tyre dhe familjet e tyre. Strategjitë dhe politikave që shteti shqiptar do të zbatojë në vitet e ardhshme synojnë të nxisin krijimin e programeve dhe politikave që rrisin qasjen e grave në financime, grante dhe kredi. Kur gratë kanë sukses në sipërmarrje, ato kontribuojnë në përmirësimin e standardeve të jetës jo vetëm për veten e tyre, por edhe për familjet dhe komunitetet e tyre. Gratë sipërmarrëse sjellin ide të reja dhe inovative, duke ndihmuar në diversifikimin dhe përmirësimin e ekonomisë shqiptare. Sipërmarrjet e grave krijojnë vende pune dhe ndihmojnë në uljen e papunësisë, veçanërisht në komunitetet rurale dhe të marginalizuara. Mbështetja e grave në sipërmarrje ndihmon në përmirësimin e balancës gjinore në sektorin e biznesit dhe promovon barazinë në vendin e punës. Kur gratë bëhen lidere të suksesshme në biznes, ato sfidojnë stereotipet gjinore dhe promovojnë ndryshime pozitive në perceptimet dhe normat shoqërore. Promovimi i grave në sipërmarrje është në përputhje me OZHQ 5 dhe OZHQ 8.

4. Përfshirja digjitale dhe financiare për gratë. Vitet e fundit, Qeveria e Shqipërisë ashtu si vendet dhe rajonet në Bashkimin Evropian (BE) ka zhvilluar Strategjitë e Specializimit të Zgjuar (S3) si një mjet i ri për nxitjen e inovacionit dhe zhvillimit rajonal. Qasja S3, synon të identifikojë disa fusha prioritare të ekonomisë rajonale/kombëtare ku ndikimi i investimeve publike në kërkim, zhvillim dhe inovacion mund të jetë shumë i rëndësishëm. Ajo thekson potencialin e lidhjeve ndërsektoriale, përveç industrive tradicionale dhe promovon diversifikimin në bazë të këtyre lidhjeve. Gjithashtu, shteti shqiptar ka digjitalizuar sistemet e brendshme qeveritare dhe një sërë masash janë marrë për përfshirjen e grave dhe vajzave në arsim digjital, punësimin e tyre dhe zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori. Inteligjenca artificiale është një tjetër synim drejt të cilës do të zhvillohen politikave të të ardhmes në vendin tonë. Në Shqipëri, ka ende një ndarje gjinore në aksesin dhe përdorimin e teknologjisë dhe shërbimeve financiare. Përmirësimi i përfshirjes digjitale dhe financiare të grave dhe vajzave do të ndihmojë në zbutjen e kësaj ndarjeje dhe në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe më të barabartë. Duke u siguruar qasje dhe përkrahje për to në fushën digjitale dhe financiare, Shqipëria mund të përfitojë nga potenciali i tyre për krijim dhe inovacion në ekonomi. Përmirësimi i aftësive digjitale dhe financiare të grave dhe vajzave do të ndihmojë në rritjen e shkollimit dhe zhvillimit profesional. Kjo do t'u hapë rrugë atyre për t'u përfshirë në profesione dhe sektorë të ndryshëm, duke kontribuar në rritjen e aftësive të tyre dhe të ekonomisë së vendit. Teknologjia dhe financat janë pjesë e jetës së përditshme, dhe përfshirja e grave dhe vajzave në këto fusha është e rëndësishme për mbrojtjen të drejtave dhe sigurisë së tyre në botën digjitale. Duke i përfshirë gratë, të reja dhe vajzat nga të gjitha grupet, mund të ndërmerren hapa për të adresuar sfidat dhe rreziqet që ato mund të hasin.

5. Mbrojtja sociale e përgjigjshme gjinore (p.sh. shërbimi shëndetësor universal, transfertat në para, pensionet, shërbime sociale e komunitare të integruara, etj.) si prioritet synon të promovojë barazinë gjinore, mirëqenien sociale dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Mbrojtja sociale e përgjigjshme gjinore është thelbësore për të adresuar ndarjet dhe diskriminimin gjinor në shoqëri. Sigurimi i qasjes së barabartë për gratë, nga të gjitha grupet në shoqëri, në shërbimet shëndetësore, transfertat në para, pensionet dhe shërbimet sociale do të ndihmojë në rritjen e barazisë gjinore dhe në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë për të gjitha/gjithë. Gjithashtu, sigurimi i një sistemi shëndetësor universal dhe i shërbimeve të integruara sociale për gratë do të ndihmojë në përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së tyre. Kjo do të rrisë cilësinë e jetës dhe do të ndihmojë në zvogëlimin e ndarjeve shoqërore dhe gjinore në aksesin në kujdes shëndetësor. Gratë shpesh mbajnë peshën më të madhe të përkujdesjes për familjet dhe fëmijët. Një mbrojtje sociale e përgjigjshme gjinore do të ofrojë mbështetje financiare dhe shërbime për të lehtësuar barrën e kujdesit dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës së familjeve dhe rritjen e fëmijëve. Mbështetja sociale për gratë ka potencialin për të kontribuar në rritjen ekonomike. Duke siguruar një mbrojtje sociale të përgjigjshme gjinore, gratë mund të kenë më shumë siguri financiare për të ndërmarrë risqe dhe për të ndikuar në zhvillimin ekonomik të vendit. Një sistem i fortë i mbrojtjes sociale për gratë ndihmon në rritjen e stabilitetit dhe paqes sociale në vend. Kur gratë kanë qasje të barabartë në shërbimet sociale dhe mbështetje financiare, rritet ndjenja e drejtësisë dhe barazisë në shoqëri, duke ulur tensionet sociale dhe duke kontribuar në paqen dhe stabilitetin e vendit.

SEKSIONI I TRETË

PËRPARIMI NË DYMBËDHJETË FUSHAT KRITIKE

3.1 ZHVILLIM GJITHËPËRFSHIRËS, PROSPERITET I PËRBASHKËT DHE PUNË E DENJË

FUSHAT KRITIKE TË MBULUARA

A. Gratë dhe varfëria

F. Gratë dhe ekonomia

I. Të drejtat e njeriut të grave

L. Fëmija vajzë

6.Çfarë veprimesh ka ndërmarrë vendi juaj për përparimin e barazisë gjinore në fushën e punësimit (përfshirë punësimin joformal dhe jo standard, si dhe sipërmarrjen) gjatë pesë viteve të fundit?

Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (SKPA) 2019-2022¹⁰ përmbante masa dhe veprime që synonin kryesisht: nxitjen e mundësive për punë të denjë, zbatimin e politikave të frytshme të tregut të punës, rritjen e aftësive përmes arsimit dhe formimit profesional cilësor për të rejtat/rinjtë dhe të rriturat/ rriturit, përmirësimin e sistemeve të kualifikimeve, vazhdimin e mbledhjes së të dhënave të ndara sipas seksit dhe statistikave gjinore, monitorimin përmes treguesve të ndjeshëm gjinorë, etj. **Si rezultat i zbatimit të SKPA 2019-2022**, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA) përgatiti një plan veprimi të qëndrueshëm për të adresuar nevojat e grave dhe burrave nga grupet e cënueshme të regjistruara pranë

10. VKM Nr.659, datë 10.10.2022. Shih: <https://arkiva.financa.gov.al/punesimi/>

saj. Sistemi i punësimit u integrua me sistemin e ndihmës ekonomike dhe pagesat e personave me aftësi të kufizuara, për ndërveprimin e të dhënave dhe lehtësimin e procedurave. Personat e papunë të regjistruar kalojnë nëpërmjet një procesi të zgjeruar intervistimi për të përcaktuar pengesat në punësimin e tyre (p.sh., kujdes ndaj fëmijës, mungesa e transportit, probleme shëndetësore...etj.). Intervista plotësohet me hartimin e një plani individual veprimi për programet aktive të tregut të punës.¹¹ Vëmendje e veçantë iu kushtua forcimit të qeverisjes dhe llogaridhënies për barazinë gjinore për përmirësimin e përgjigjshmërisë gjinore të politikave të punësimit dhe zhvillimit të aftësive. Përtej sigurimit të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (aktualisht Ministria e Financave), hartoi politika proaktive që u ofrojnë grave mundësi të barabarta me burrat, në punësim dhe përmirësimin e aftësive/ri-kualifikimit. U morën në konsideratë sfidat me të cilat përballen gratë në aksesin në tregun e punës dhe u hartuan masa specifike për adresimin e tyre (p.sh., shtesa për kujdesin e fëmijëve dhe transportin, ose zgjatja e kohëzgjatjes së programit të kualifikimit për gratë viktimë të dhunës në familje dhe trafikimit, etj.). Në arsimin profesional vajzat që regjistrohen në profesione jo-tradicionale marrin bursa mujore të lidhura me frekuentimin. Në monitorimin e tregut të punës dhe të gjithë treguesve të tjerë të SKPA-së, janë bërë përpjekje që të mbledhen, analizohen dhe raportohen rregullisht të dhëna të ndara sipas seksit dhe statistika gjinore. Më konkretisht, elementë të tillë si pjesëmarrja në fuqinë punëtore, shkalla e punësimit dhe papunësisë, hendeu gjinor i pagave, etj., monitorohen periodikisht dhe integrohen në të gjithë planifikimin dhe zbatimin e veprimeve strategjike.¹²

Buxheti i shpenzuar për programet e tregut të punës dhe arsimin e formimit profesional (AFP) për periudhën 2019 - 2022 pati rritje, përkatësisht: 4,175 miliardë lekë në vitin 2019; 4,448 miliardë lekë në vitin 2020; 4,903 miliardë lekë në vitin 2021 dhe 4,525 miliardë lekë në vitin 2022.¹³

Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (SKPA) 2023-2030¹⁴ synon krijimin e vendeve të punës cilësore dhe mundësive për punësim dhe aftësi në të gjithë vendin, arsim dhe trajnim cilësor për të rejtat/rinjat dhe të rriturat/rriturat, nxitjen e përfshirjes dhe kohezionit social, si dhe forcimin e sistemit të punës dhe kualifikimeve në treg. “Rritja e përfshirjes së grave në tregun e punës” është një masë prioritare e SKPA 2023 – 2030 e cila fokusohet veçanërisht në integrimin e grave joaktive, përmes politikave të përgjigjshme gjinore të aftësimit, punësimit fleksibël dhe vetëpunësimit, si dhe duke ofruar mbështetje specifike për aktivizimin e tyre. Për këtë qëllim, do të ndërtohen mekanizma për identifikimin e nevojave dhe profileve të grave joaktive nëpërmjet administratoreve / administratorëve socialë dhe nëpunësve / nëpunësve të barazisë gjinore në nivel vendor, si dhe mekanizma për të ofruar mundësi aftësimi dhe punësimi në sektorë të ndryshëm ekonomikë, përfshirë dhe atë të përkujdesjes. Gjithashtu, do të hartohen dhe zbatohen programe për rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës rural dhe bujqësor duke i informuar dhe mbështetur për të aksesuar dhe përfituar nga fondet për zhvillimin rural, agro-turizmin, etj. Institucionet do të mbështesin gratë joaktive me sipërmarrjen dhe ekonominë sociale, prodhimin e produkteve vendore apo ekonominë e gjelbër, aktivitetet e biznesit online, si dhe vlerësimin e mundësisë së stimujve fiskalë në këta sektorë. **Kosto e zbatimit të SKPA 2023-2030** llogaritet në vlerën 75,513,866,666 lekë, nga të cilat 50,949,415,955 lekë janë fonde nga buxheti i shtetit, 7,392,277,484 lekë janë financim i huaj dhe 17,172,173,227 ose 23% janë hendeu financiar.¹⁵

11. “Përgjigjet e Shqipërisë në lidhje me listën e çështjeve dhe pyetjeve në kuadër të raportit të pestë periodik kombëtar për zbatimin e Konventës për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave”, dorëzuar në Komitetin CEDAW në korrik 2022, paragrafi 112. Shih: https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CEDAW%2FC%2FALB%2FRQ%2F5&Lang=en

12. “Raport progresi për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019-2022, për vitin 2022”. Publikuar në 20.07.2023. Shih: <https://arkiva.financa.gov.al/punesimi-dhe-aftesimi-profesional/>

13. Po aty, fq. 86. Shih detaje edhe në tabelën 1 të “Shtojcat 1” në këtë raport.

14. VKM 173 datë 24.03.2023 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023-2030, planit të veprimit për zbatimin e saj, si dhe planit të zbatimit të garancisë rinore 2023-2024”. Shih: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/03/24/173/006a8e4b-bc79-4032-9553-60814bc2527f>

15. “SKPA 2023-2030”, fq.34. si dhe detaje në tabelën 2 të “Shtojca 1” në këtë raport.

Programi i Garancisë Rinore (PGR) 2023-2027¹⁶ fokusohet te nxitja e punësimit të të rejave/rinjve si një nga prioritetet e qeverisë shqiptare. Grupi i synuar janë të rejtat/rinjët jo në arsim, punësim, formim profesional (JAPFP), pasi përqindja e papunësisë për këtë grup është shumë e lartë. PGR filloi të pilotohet gjatë vitit 2023 me mbështetjen e të rejave/rinjve JAPFP të regjistruara/regjistruar në Zyrat e Punës, që përfitojnë ofertë punësimi/formimi profesional/arsimimi, brenda 4 (katër) muajve nga humbja e punës apo largimi nga arsimi profesional. Programi përmban dy faza, ku në fazën pilot (viti 2023-2024) parashikohen masa si: organizimi dhe funksionimi i strategjisë vendore për sinjalizimin dhe regjistrimin e të rejave/rinjve JAPFP; zhvillimi dhe testimi i sistemit informatik të AKPA që të regjistrohen hyrjet për Garancinë Rinore; reformimi i kriterëve për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit; ndryshimet e nevojshme ligjore për grantet e organizatave rinore; etj. Rezultatet e pilotimit do të udhëzojnë shtrirjen e programit në vitet në vijim. **Kosto e parashikuar për zbatimin e PGR-së** për të gjitha hapat (hartëzim, komunikim, faza përgatitore dhe faza e ofertave) për të dy fazat (pilot dhe vazhdimësi), për një periudhë kohore pesë vjeçare është përllogaritur në vlerën 55,523,803 EUR, nga të cilat 49,593,803 EUR janë fonde të BE-së, 5,191,250 EUR janë fonde të buxhetit të shtetit dhe 738,750 EUR janë fonde nga kontribute të tjera. Nga këto, 1,977,300 EUR janë planifikuar për fazën pilot (viti 2023); 6,732,500 EUR janë planifikuar për vitin 2024, 10,917,750 EUR për vitin 2025; 15,320,000 EUR për vitin 2026 dhe 20,541,250 EUR për vitin 2027.¹⁷

Masa dhe veprime që synojnë përparimin e barazisë gjinore në fushën e punësimit janë parashikuar dhe po zbatohen edhe në kuadër të strategjive kombëtare për barazinë gjinore (SKBGJ). Nga monitorimi i zbatimit të **SKBGJ 2016-2020¹⁸** rezultoi se veprimet e parashikuara për rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës, rritjen e aksesit të tyre në programet e punësimit dhe zvogëlimin e hendekut gjinor, u realizuan në masën 93,4%. Pjesë e këtyre veprimeve ishte edhe mbështetja e ofruar për gratë në sipërmarrje, përmes fondeve të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) ku gjatë vitit 2019 përfituese/përfitues të skemave mbështetëse ishin: 69,2% burra dhe 30,8% gra për fondin e inovacionit; 21,1% burra dhe 78,9% gra për fondin e start-up; 93,1% burra dhe 6,9% gra për fondin e konkurrueshmërisë dhe 20% burra dhe 80% gra për fondin e ekonomisë kreative. Në **SKBGJ 2021-2030¹⁹**, politika I, fokusohet në përmbushjen e të drejtave ekonomike dhe sociale për gratë, të rejtat, vajzat dhe burrat, të rinjtë, djemtë në shoqëri dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave *nga të gjithë grupet*, duke synuar një rritje dhe qëndrueshmëri të ekonomisë mjedisore (të gjelbër), si dhe pjesëmarrjen e tyre të barabartë në digjitalizim. Kjo politikë përmban një tërësi masash dhe veprimesh që fokusohen te zvogëlimi i barrierave që i mbajnë gratë, të rejtat dhe vajzat larg tregut të punës, si dhe te rritja e aksesit të grave, të rejave dhe vajzave *nga të gjithë grupet*, për punë të denjë edhe në sektorët jo-tradicionale të punësimit (në veçanti në shkencë, teknologji, inxhinieri, matematikë). Për matjen e efektivitetit të këtyre masave ka të parashikuar edhe tregues të ndjeshëm gjinorë. Nga monitorimi i zbatimit të SKBGJ 2021-2030 për periudhën 2021-2022²⁰, evidentohet se janë realizuar plotësisht rreth 35% e aktiviteteve të parashikuara mbi përparimin e barazisë gjinore në fushën e punësimit, 12% janë realizuar pjesërisht, 30% janë në proces realizimi, 18% nuk janë realizuar dhe për 5% mungon informacioni. Paralelisht me zbatimin e masave dhe veprimeve të tjera të parashikuara në SKBGJ 2021-2030 për përparimin e barazisë gjinore në fushën e punësimit, është e domosdoshme që institucionet përgjegjëse t'u kushtojnë rëndësinë e duhur planifikimit rregullisht të këtyre masave në planet e tyre vjetore, si dhe gërshetimit të tyre me masat e tjera të parashikuara në këtë drejtim si pjesë e SKPA 2023-2030.

16. VKM 173 datë 24.03.2023 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023-2030, planit të veprimit për zbatimin e saj, si dhe planit të zbatimit të garancisë rinore 2023-2024". Shih: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/03/24/173/006a8e4b-bc79-4032-9553-60814bc2527f>

17. "Plani i zbatimit të garancisë rinore 2023-2024", fq. 119. Shih VKM Nr. 173, datë 24.03.2023 (fq.58 e në vijim), në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/03/24/173/006a8e4b-bc79-4032-9553-60814bc2527f>

18. "Raport Vlerësimi: zbatimi i Strategjisë Kombëtare për barazinë gjinore dhe planit të saj të veprimit 2016-2020". Shih: <https://shendetesia.gov.al/barazia-gjinore/>

19. Miratuar me VKM Nr. 400, datë 30.6.2021. Shih: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2021/06/30/400/2387ac14-fd00-44cd-a291-bc00eb26f89f>

20. Shih raportet përkatëse në: <https://shendetesia.gov.al/barazia-gjinore/> Raporti i monitorimit të SKBGJ 2021-2030 për vitin 2023 është në proces përgatitjeje.

Rritja e nivelit të pagës minimale dhe zvogëlimi i hendekut gjinor në paga janë gjithashtu prioritete të Qeverisë së Shqipërisë. Niveli i pagës minimale është rritur nga 26,000 lekë për vitet 2019-2020 në 40,000 lekë për vitin 2023-2024. Synimi deri në vitin 2025 është që paga minimale të arrijë në vlerën 45,000 lekë.²¹ Megjithatë, edhe pse niveli i pagës minimale është i njëjtë për të dy gjinitë, duhet treguar kujdes që kjo masë të aplikohet saktë në sektorin privat. Hendeku gjinor në paga ka pësuar ulje gjatë periudhës së raportimit, respektivisht nga 10,1% në vitin 2019, në 6,6 në vitin 2020, në 4,5 % në vitin 2021 dhe në 6,2% në vitin 2022.²²

Konventa C190. Shqipëria ratifikoi Konventën (nr.190) për Dhunën dhe Ngacmimin në Botën e Punës të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP) në 03.02.2022²³ dhe po punohet për informimin dhe rritjen e kapaciteteve për zbatimin në praktikë të kësaj konvente. Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Sigurimeve Shoqërore (ISHPSSH) ka marrë pjesë në trajnimin e inspektoreve/inspektorëve të punës mbi përmbajtjen e Konventës C190 organizuar nga ONP gjatë vitit 2022. Gjatë vitit 2023, mes Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) dhe ISHPSSH, është lidhur një Marrëveshje Bashkëpunimi (Nr. 300 Prot., datë 22.02.2023), që synon rritjen e ndërveprimit mes tyre për parandalimin, zvogëlimin dhe adresimin e barazisë gjinore, mos-diskriminimit, dhunës dhe ngacmimit në botën e punës. Në zbatim të kësaj marrëveshje janë realizuar, ndër të tjera: takim informues mbi diskriminimin, dhunën dhe ngacmimin si çështje të sigurisë dhe shëndetit në punë (23 maj 2023); trajnim mbi inspektimin dhe monitorimin me fokus zbatimin e detyrimeve të Konventës C190 (22 – 24 qershor 2023); konferenca vjetore e ISHPSSH dhe KMD (11.12.2023), ku u pasqyrua bilanci vjetor i arritjeve dhe përvojave mbi zvogëlimin e diskriminimit, dhunës dhe ngacmimit në botën e punës, si dhe u dakordësua parimisht edhe për planin e veprimit për vitin 2024, në këtë drejtim, etj.

Angazhimi në Përsheptuesin Botëror për Punë të Denjë dhe Mbrojtje Sociale për Tranzicione të Drejta.²⁴ Shqipëria konfirmoi angazhimin e nivelit të lartë në Përsheptuesin Botëror më 1 gusht 2023 (përmes Zëvendëskryeminstres) dhe mekanizmi koordinues ndërministror drejtohet nga Ministria e Financave dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.²⁵ Me mbështetjen e Kombeve të Bashkuara u realizua hartëzimi i politikave (2023), gjetjet e të cilit udhëzuan procesin e hartimit të Udhërrëfyesit për zbatimin e Përsheptuesit Botëror²⁶. Fokusi kryesor është krijimi i vendeve të punës dhe zhvillimi i aftësive në sektorët kryesorë të ekonomisë mjedisore dhe digjitalizimit, si dhe zgjerimi i mbrojtjes sociale, në përputhje me qëllimin e përparimit të mëtejshëm drejt zhvillimit dhe integritit në BE. Udhërrëfyesi përshkruan një strategji gjithëpërfshirëse për zbatimin e Përsheptuesit Global duke shfrytëzuar politikat dhe planet ekzistuese për të arritur zgjidhje të qëndrueshme dhe të integruara, përfitime më të larta të produktivitetit, mbrojtje sociale në një mjedis mundësues dhe fuqizues për të gjitha/gjithë, etj. Më konkretisht, synohet rritje e ndjeshme e mbulimit të programeve të mbrojtjes sociale, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara (PAK), fëmijët, të moshuarat/moshuarit dhe banoret/banorët ruralë; përmirësimi i sasisë dhe cilësisë së përfitimeve nga programet e mbrojtjes sociale si dhe zvogëlimi i pabarazive gjinore në këtë drejtim veçanërisht për gratë/të reja të papuna; rritje e normave të punësimit, veçanërisht midis grupeve të cënueshme (si PAK, etj.); bashkëpunimi i suksesshëm me sektorin privat për të ofruar mundësi punësimi për të gjitha kategoritë, veçanërisht për PAK dhe grupet e tjera kryesore të identifikuara në këtë udhëzues, etj. Kostot paraprake të përlllogaritura si të domosdoshme për zbatimin e masave të parashikuara janë: 7 milionë euro (23% hendeq financimi) për integrim në tregun e punës, 23 milionë euro (12% hendeq financimi) për reformën e aftësisë së kufizuar,

.....
21. Shih tabelën 3 të “Shtojca 1” bashkëlidhur.

22. INSTAT “Gra dhe burra në Shqipëri”, botimet e viteve 2020, 2021 dhe 2022.

23. Ligji Nr. 13/2022 “Për ratifikimin e Konventës 190 “Konventa për dhunën dhe ngacmimin”, të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, 1986. Shih: <https://qzb.gov.al/eli/fz/2022/30/38f028cc-c3bc-4956-96cf-dc221db20efe>

24. Përsheptuesi Botëror është një nismë lançuar në shtator 2021 nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, që synon të përshpejtojë përparimin drejt Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) dhe të mbështesë krijimin e vendeve të punës të denjë, kryesisht në ekonominë e gjelbërta, digjitale dhe të kujdesit, si dhe të zgjerojë mbrojtjen sociale për njerëzit që janë të përjashtuar.

25. Shih: <https://unglobalaccelerator.org/pathfinder-countries/albania>

26. Udhërrëfyesi u përgatit nga Qeveria e Shqipërisë, ekipi i vendit i Kombeve të Bashkuara (UNDP, UNICEF, ILO, UN Women, FAO), nën drejtimin teknik të UNICEF-it dhe UNDP-së gjatë periudhës tetor – dhjetor 2023 . Pjesë e procesit të përgatitjes së tij ishte dhe konsultimi me shoqërinë civile dhe partnerët socialë në dhjetor 2023.

21 milionë euro (12% hendek financimi) për reformën e ndihmës ekonomike, 9 milionë euro (46% hendek financimi) për zhvillimin e aftësive të drejtuara nga industria dhe përputhshmërinë me kërkesat e tregut të punës, si dhe 1 milion euro për forcimin e menaxhimit të Kornizës së Integruar të Financimit Kombëtar (KIFK). Financimi i veprimeve përfshin një kombinim të burimeve vendase dhe ndërkombëtare, kërkon planifikim të kujdesshëm, bashkëpunim me palët përkatëse të interesit, si dhe mekanizma të fuqishëm monitorues.²⁷

7. Çfarë veprimesh ka ndërmarrë vendi juaj në pesë vitet e fundit për të njohur, pakësuar dhe/ose rishpërndarë kujdesin e papaguar dhe punën në shtëpi, nxitur ekuilibrin punë - jetë - familje dhe përforcuar të drejtat e punonjësve/punonjësve të kujdesit me pagesë?

Shqipëria ka ndërmarrë dhe zbaton një sërë masash ligjore që synojnë ekuilibrimin e balancës ndërmjet punës dhe jetës familjare, si: pagesa e lejes së lindjes; leja e paguar e përkujdesjes ndaj fëmijës për të dy prindërit; e drejta e ruajtjes së vendit të punës për marrjen e lejes prindërore katër mujore të plotë apo të ndarë, derisa fëmija të mbushë moshën 6 vjeç; mbështetja me pagesë kujdestarie për personat me aftësi të kufizuara, etj., siç janë paraqitur edhe në raportin e mëparshëm të shtetit në kuadër të Pekin+25. Masa të tjera mbështetëse bazuar edhe në rritjen e ngarkesës dhe punës së papaguar të grave (sidomos gjatë COVID-19), janë: aplikimi i bonusit të bebes (nga viti 2019); mbështetja me ndihmë financiare e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, apo grave kryefamiljare ose viktimave/të mbijetuara të dhunës në familje gjatë COVID-19 (2020 - 2021); trefishimi i mbështetjes ekonomike për viktimat/të mbijetuarat e dhunës në familje të pajisura me urdhër mbrojtjeje; mbështetja e veçantë për gratë e papuna me tre apo më shumë fëmijë deri 18 vjeç (nga viti 2023); etj., të cilat sqarohen më në detaje në këtë raport në seksionet në vijim (në përgjigjen për pyetjen 11).

Pakësimi dhe rishpërndarja e kujdesit dhe punës së papaguar në shtëpi, si dhe nxitja e ekuilibrit punë - jetë - familje, janë çështje të adresuara në edhe strategjitë kombëtare për barazinë gjinore. Në **SKBGJ 2016-2020**, reduktimi i punës së papaguar të grave në familje synohej të arrihej përmes rritjes së aksesit dhe cilësisë së shërbimeve sociale. Ky objektiv u zbatua në masën 57,5%²⁸ dhe ndër veprimet e përealizuara rezultoi edhe ofrimi i shërbimeve sociale në qendra komunitare nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për moshën e tretë, apo për fëmijët, gratë dhe nënat me aftësi të kufizuara, etj. **SKBGJ 2021-2030**, përmban një objektiv specifik me masa të fokusuara te ndarja e barabartë e punës dhe kujdesit të papaguar në familje, informimi mbi format e lejeve të paguara të lejueshme për secilin prind, përmirësimi i kuadrit ligjor dhe i politikave lidhur me fleksibilitetin e të punuarit nga shtëpia, zgjatjen e kohës së lejeve të paguara për të dy prindërit, etj. Nga monitorimi i zbatimit të SKBGJ 2021-2030 për vitin 2022²⁹, rezulton se vetëm 18% e aktiviteteve të parashikuara janë realizuar plotësisht, 10% pjesërisht, 18% nuk janë realizuar dhe për 54% nuk jepet informacion nga institucionet përgjegjëse.

Të dhëna për angazhimin e grave në punë të papaguara të kujdesit në familje, si dhe mbi politikat miqësore për balancimin e ekuilibrit punë - jetë - familje, janë mbledhur edhe nga studime të kryera nga OSHC-të dhe organizatat ndërkombëtare (2021-2022)³⁰. Gjetjet pohojnë se puna dhe kujdesi i papaguar në familje rëndojnë

27. Burimi: Draft Udhëzuesi për Përshpejtuesin Botëror për Shqipërinë, versioni i janarit 2024, vënë në dispozicion të konsulentëve nga UN Women, për efekt të përgatitjes së këtij raporti kombëtar (i pabotuar).

28. "Raport Vlerësimi: zbatimi i Strategjisë Kombëtare për barazinë gjinore dhe planit të saj të veprimit 2016-2020". Shih: <https://shendetesia.gov.al/barazia-gjinore/>

29. Shih: <https://shendetesia.gov.al/barazia-gjinore/> Raporti i monitorimit të SKBGJ 2021-2030 për vitin 2023 është në proces përgatitjeje.

30. Të realizuara nga UNFPA dhe IDRA Research & Consulting: "Politikat dhe dispozitat ligjore aktuale miqësore ndaj familjes në Shqipëri", shkurt 2021; "Fletë faktesh: Situata aktuale e barazisë gjinore në Shqipëri", mars 2021; "Analizë e financuar nga politikave

më shumë mbi vajzat/të rejtat/gratë (67% e vajzave dhe 30% e djemve të moshës 10-14 vjeç, 95% e vajzave/të rejave/grave dhe 38% e djemve/të rinjve burrave të moshës 15-64 vjeç, si dhe 86% e grave dhe 63% e burrave të moshës mbi 65 vjeç). Në sektorin privat, të punësuarat/punësuarit punojnë mesatarisht më shumë orë në javë në krahasim me ato/ata në sektorin publik (65% në sektorin privat kundrejt 14% në sektorin publik punojnë të shtunave, 37% në sektorin privat kundrejt 5% në sektorin publik punojnë në ditë feste dhe 29% e të punësuarave/punësuarve në sektorin privat nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga leja vjetore). Sektori privat ofron më shumë mundësi se ai publik për oraret fleksibël edhe pse të dy sektorët janë ende të ngurtë në këtë drejtim (pothuaj një në tre punonjëse/punonjës në sektorin privat ka një lloj fleksibiliteti gjatë orarit të punës, kundrejt vetëm 7% të punonjëseve/punonjësve në sektorin publik). Ka diferenca të konsiderueshme midis sektorit privat dhe atij publik në ofrimin e ambienteve për socializim apo konsumim të vakteve, ku punonjëset/punonjësit e administratës shtetërore jo vetëm nuk kanë ambiente të dedikuara, por nuk kanë të parashikuar as një orar pushimi për konsumimin e drekës. Të dy sektorët mbeten shumë prapa për ofrimin e shërbimeve të tjera si ambiente të dedikuara për gjidhënie apo në ofrimin e ambienteve për mbajtjen e fëmijëve (38% e bizneseve japin mbështetje për gratë shtatzëna apo në gjidhënie duke u dhënë mundësinë për t'u shkëputur nga puna dhe 4% ofrojnë hapësirë të dedikuar për nënat me gji). Vetëm gjysma e bizneseve të intervistuar (200 intervista me biznese në nivel kombëtar) kanë dëgjuar për politikat miqësore me familjen. 95% e bizneseve mendojnë që qeveria duhet t'i mbështesë për të nxitur zbatimin e politikave të përgjigjshme gjinore e miqësore me familjen përmes lehtësimit në taksa (79%), mbështetjes financiare (65%), promovimit (35%) dhe pjesëmarrjes në vendim-marrje (15%).

Në Planet Sociale të përgatitura nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV)³¹, integrohen zgjerimi i shërbimeve si çerdhet dhe kujdesi për fëmijët, si dhe shërbimet për personat me aftësi të kufizuara – ngritja dhe fuqizimi i të cilave lehtësojnë barrën e punës së papaguar të kujdesit për gratë dhe vajzat. Rol të rëndësishëm në këtë drejtim luajnë edhe aktivitetet e ndryshme të fokusuara te barazia gjinore, veçanërisht me djemtë dhe vajzat në shkolla, me synim promovimin e normave pozitive gjinore, vlerën e barabartë të djemve dhe vajzave në familje dhe shoqëri, rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë të djemve dhe vajzave në aktivitetet shoqërore dhe komunitare, por edhe në kryerjen e punëve të kujdesit në familje, etj. Bashkëpunimi i NJVV-ve me institucionet punëdhënëse për krijimin e shërbimeve mbështetëse e të kujdesit për fëmijët në ambientet e tyre, është gjithashtu një eksperiencë mjaft interesante, që ka filluar të pilotohet në Shqipëri.³² Paralelisht, NJVV po parashikojnë si pjesë të punës së tyre, veçanërisht përmes qendrave komunitare, apo shërbimeve në komunitet, edhe organizimin e kurseve të prindërimit pozitiv, duke evidentuar në këto kurse edhe rëndësinë e angazhimit të djemve, të rinjve e burrave në punë të kujdesit të papaguar në familje, sidomos në rritjen dhe edukimin e fëmijëve.³³

të përgjegjshme gjinore për familjen në Shqipëri”, qershor 2021; “Zbatimi i Politikave Miqësore për Familjen dhe Barazinë Gjinore në Sektorin Publik dhe Privat - Perspektiva e Bizneseve”, qershor 2022; “Zbatimi i Politikave Miqësore për Familjen dhe Barazinë Gjinore në Sektorin Publik dhe Privat - Perspektiva të Punonjëseve/Punonjësve”, gusht 2022; etj., shih: <https://albania.unfpa.org/sq/publications>

31. Të përgatitura me mbështetjen e UNICEF.

32. P.sh. Bashkia Tiranë në Bashkëpunim me Bankën Kombëtare Tregtare (BKT) hapën çerdhen e parë në ambientet e punës, në 2021.

33. Me mbështetjen e UNFPA, “Act for Society” përgatiti një manual për kurset e prindërimit pozitiv, të përshtatur për t'u përdorur nga qendrat komunitare në nivel vendor (2021) i cili u pilotua dhe plotësua më pas me punonjëset/punonjësit e Bashkisë Tiranë (2022). Gjatë vitit 2023, punonjëset/punonjësit e trajnuar u mentoruan për mbajtjen e kurseve të tilla dhe kjo eksperiencë tashmë po vijon të zbatohet nga Bashkia Tiranë. Ngjashmërisht, kurse të prindërimit pozitiv po realizojnë edhe një sërë bashkish të tjera në vend, me iniciativën e tyre apo edhe mbështetjen e OSHC-ve dhe organizatave ndërkombëtare.

8. Çfarë veprimesh ka ndërmarrë vendi juaj në pesë vitet e fundit për ngushtimin e ndasisë digjitale me gjinive?

Edhe pse numri i studenteve vajza të diplomuara në degën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) rezulton më i ulët se ai i djemve (përkatësisht: 3.7% vajza dhe 8.6% djem për vitin akademik 2018-2019; 3.4% vajza dhe 9.3% djem për 2019-2020; 3.3% vajza dhe 10.2% djem për 2020-2021; 3.8% vajza dhe 10.5% djem për 2021-2022)³⁴, aktualisht në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), si institucioni kryesor përgjegjës për TIK, mbizotërojnë të rejtat dhe gratë në pozicione drejtuese (55%)³⁵. Shqipëria ka përqindjen më të lartë grave dhe vajzave që kanë fituar gradën shkencore “Doktore” (62.3%) në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit. Nga viti 2021 është ngritur dhe funksionon Rrjeti i Grave Shqiptare në SHTIM (shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë), që synon të kontribuojë në fuqizimin social dhe ekonomik të grave dhe vajzave duke rritur përfaqësimin e tyre në SHTIM, si në fushën akademike ashtu edhe në kërkim shkencor dhe inovacion.

Trendi i përdorimit të internetit nga të dy gjinitë, gjithashtu është përmirësuar: gjatë periudhës 2018-2020, numri i grave dhe burrave që kishin përdorur internetin “gjatë tre muajve të fundit” u rrit shumë në Shqipëri, sidomos për gratë (12,2 pikë përqindje), me një rritje pothuaj sa dyfishi i rritjes së përdorimit të internetit nga burrat (6,9 pikë përqindje).³⁶ Pas vitit 2020 trendi është niveluar dhe deri në vitin 2022, 81,5% e grave dhe 83,7% e burrave të grup-moshës 16 - 74 vjeç kishin përdorur internetin “gjatë tre muajve të fundit” duke shënuar rritje prej 3,3 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2021.³⁷ Gjatë vitit 2023, 81,7% e grave dhe 84,6 % e burrave të grup-moshës 16-74 vjeç janë përdorues të internetit “gjatë 3 muajve të fundit”.³⁸

Qeveria shqiptare³⁹ ka ndërmarrë një nismë për të zhvilluar kompetencat digjitale tek vajzat/djemtë dhe të rejtat/rinjët, si një mundësi për ngushtimin e ndasive digjitale mes gjinive. Kjo nismë synon përfshirjen e lëndës “TIK dhe kodim” në klasat I, II dhe III në mënyrë interaktive, dhe në vijim, riformatimin e mësimdhënies së lëndës së TIK në klasat IV-XII në mënyrat më bashkëkohore dhe për t’u mundësuar nxënësve/nxënësve më shumë njohuri praktike në këtë fushë. Gjithashtu synohet pajisja e të gjitha shkollave të arsimit parauniversitar me laboratorë smart të aksesueshëm nga të gjitha/gjithë nxënëset/nxënësit, si dhe përgatitja e mësuesve/mësuesve të lëndës së TIK në arsimin parauniversitar për mësimdhënien e lëndës në mënyrë interaktive dhe në përshtatje me kurrikulat, platformat dhe pajisjet bashkëkohore. Faza e parë po zbatohet në klasat e para në 100 shkolla për vitin shkollor 2022-2023. Faza e dytë e këtij projekti, përgjatë viteve 2023-2025, synon ndërtimin e laboratorëve smart në 884 shkolla të arsimit parauniversitar në Shqipëri, shtrirjen e mësimdhënies për klasat e para në 984 shkollat me laboratorë dhe pilotimin e programit në klasat e dyta dhe të treta të 100 shkollave që u përfshinë në fazën e parë të zbatimit të projektit. Më pas projekti do vijojë të shtrihet në të gjithë vendin deri në vitin 2023.⁴⁰ Gjatë vitit 2022-2023 janë ngritur 108 SMART lab-e⁴¹ dhe gjatë 2023-2024 vijon furnizimi në 200 shkolla dhe janë planifikuar 216 SMART lab-e. Fondi i planifikuar për mbështetje financiare ishte 500 mijë dollarë.

34. Të dhëna nga INSTAT nga publikimet “Gra dhe burra në Shqipëri” për vitet 2020,2021,2022 dhe 2023. Shih: www.instat.gov.al/publikime/

35. Shih: <https://akshi.gov.al/grate-ne-tech-rol-i-tyre-ne-fushen-e-tik/>

36. INSTAT (2021). Anketa mbi ‘Përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) në familje dhe nga individët’ në vitin 2020. Shih: <https://www.instat.gov.al/al/temat/kushtetetsociale/teknologjis%C3%AB-s%C3%AB-informacionit-dhe-komunikimit-tik-n%C3%AB-familjedhe-nga-individ%C3%ABt/#tab2>

37. INSTAT (2023). Anketa mbi ‘Përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) në familje dhe nga individët’ në vitin 2022. Shih: https://www.instat.gov.al/media/11157/ict-2022_shqip.pdf

38. https://www.instat.gov.al/media/12854/ict-2023_shqip.pdf

39. Në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF)

40. Raport monitorimi për periudhën Qershor - Dhjetor 2023 “Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022 – 2026”, fq.14. Shih: <https://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2024/03/Plani-i-monitorimit-te-AD-per-vitin-2023.-1.pdf>

41. 100 lab-e të financuara pjesërisht nga buxheti dhe pjesërisht nga AADF (financim i laptop-ve për 100 shkolla), si dhe 8 lab-e me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA).

Programet mësimore të lëndës së TIK në arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të lartë synojnë të prezantojnë dhe të zhvillojnë kompetencat digjitale të nxënësve/nxënësve duke siguruar një qasje të barabartë për të gjitha/gjithë, pa dallime gjinore. Gjatë vitit 2022 në 1,194 shkolla me më shumë se 4,334 mësuese/mësues dhe rreth 120,000 nxënës/nxënës të moshës 10 – 15 vjeç, u zbatua programi “Shkollat e shekullit të 21-të”⁴², që kishte për qëllim pajisjen e nxënësve/nxënësve me aftësitë e të menduarit kritik, aftësi digjitale, të zgjidhjes problemore dhe kodimit, përmes të mësuarit në mënyrë zbavitëse, ndërvepruese dhe inovatore. Çdo shkollë e arsimit 9-vjeçar po pajiset me pajisje të quajtura micro:bit me anën e të cilave nxënës/nxënës mund të programojnë dhe t’i përdorin në të gjitha lëndët për të zgjidhur problemet e përditshme. Në grupet konkurruese mbi sfidat e kodimit, të organizuara në kuadër të këtij programi, u inkurajua veçanërisht pjesëmarrja e vajzave. Programi i Kodimit për të rejt/rinjtë lancuar në 23 janar 2023 ka të regjistruara/regjistruar 1068 të rejt/të rinj në kurset afatshkurtra (68 më shumë nga sa ishin planifikuar). Në kuadër të projektit “Zhvillimi i kompetencave për një sistem gjithëpërfshirës të zhvillimit profesional të mësuesve” (TEAVET)⁴³ si partneritet i Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (MAS) / Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) me 8 (tetë) institucione të arsimit të lartë (IAL) shqiptare dhe 3 (tre) IAL evropiane, për periudhën 2019-2020, u akredituan 16 module trajnimi mbi të nxënit digjital, strategjitë e mësimdhënies/nxënies, qytetaria aktive, gjithëpërfshirja në arsim, kultura e të nxënit, metodat e lexim-shkrimit, etj.; u krijua databaza e mësuesve/mësuesve të trajnuar; si dhe u mbajt një konferencë ndërkombëtare përmbyllëse me gjetjet kryesore nga zbatimi i këtij projekti.

Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026⁴⁴ synon ndër të tjera zhvillimin e kompetencës digjitale, nëpërmjet shfrytëzimit më të mirë të TIK për mësimdhënie dhe të nxënë. Përdorimi i TIK-ut në procesin mësimor kontribuon në zhvillimin e kompetencës digjitale të nxënës/nxënës dhe është domosdoshmëri për të mos ndërprerë procesin e të nxënit edhe në situata të jashtëzakonshme (siç ishte Covid-19). Vështirësitë dhe mësimet e nxjerra gjatë periudhës mars – qershor 2020 gjatë të zhvillimit të mësimin në distancë përmes krijimit të platformës akademi.al⁴⁵, plotësimit të njohurive përmes videoregjistrimeve, si dhe të nxënit e kombinuar në klasë dhe online, i kanë shërbyer MAS si udhërrëfyes për hedhjen e hapave të nevojshëm për nxitjen e arsimit të përgjigjshëm gjinor, sidomos në lëndët SHTIM. Sesionet informuese mbi thyerjen e stereotipeve gjinore që ndikojnë në zgjedhjet e profesioneve dhe në perceptimin e vajzave/të rejave për aftësitë që duhen në shkencat kompjuterike; diskutimet mbi dallimet gjinore në karrierë dhe mundësitë e barabarta për të gjitha gjinitë në fushat e SHTIM; krijimi i programeve dhe iniciativave të veçanta për nxitjen e interesit të vajzave në TIK dhe SHTIM, etj., janë bërë tashmë pjesë e veprimeve të planifikuara në kuadër të orientimit në karrierë të nxënësve/nxënësve. Gjithashtu janë trajnuar rreth 1200 mësuese/mësues për përdorimin e TIK-ut në procesin e mësimdhënie – nxënies dhe për sigurinë kibernetike. MAS ka hartuar “Programin kombëtar të zhvillimit profesional të mësuesve / mësuesve 2024 - 2025”, që synon përmirësimin e rezultateve të të nxënit të nxënësve / nxënësve përmes zhvillimit profesional të gjitha/gjithë mësuesve/mësuesve, të koordinuar dhe të institucionalizuar me të gjithë aktorët në fushën e arsimit, me fokus të lexuarit, matematikën, shkencat e natyrës (fizikë, biologji, kimi), bazuar në qasjen SHTIM.

Në kuadër të programeve të formimit profesional, kurset 3 -12 mujore në fushën e TIK, mbështeten në masën 50% ose 100% nga qeveria shqiptare sipas kategorisë së aplikanteve/aplikantëve, të cilat/cilët pas përfundimit të kursit, mund të integrohen lehtësisht në tregun e punës së teknologjisë. Këto programe që synojnë fuqizimin dhe mbështetjen e vajzave/të rejave janë të interesuara për ndryshimin e karrierës ose përmirësimin e situatës së tyre ekonomike në të ardhmen, zbatohen Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA).

.....
42. Nën udhëheqjen e British Council dhe financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar.

43. Financuar nga Komisioni Evropian, programi Erasmus+, me fokus kryesor ngritjen e kapaciteteve të stafëve akademikë të IAL-ve shqiptare për trajnimin e mësuesve/mësuesve, si dhe ngritjen e sistemit të trajnimit nëpërmjet qendrave të të nxënit gjatë të gjithë jetës në këto IAL (projekt 3-vjeçar 2017-2020).

44. Miratuar me VVKM Nr. 621 datë 22.10.2021 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”. Shih: <https://www.coursehero.com/file/151885569/Vendim-621-date-22102021-Per-miratimin-e-SKA-2021-2026pdf/>

45. Me mbështetjen e UNICEF-it.

Prodhimi i broshurave informuese⁴⁶ për fëmijët dhe prindërit e tyre mbi përdorimin e sigurt të TIK-ut, si dhe përgatitja e një grupi mbështetësesh/mbështetësish apo edukatoresh/edukatorësh në një numër shkollash, mbi sigurinë në internet, është një tjetër masë e rëndësishme që synon jo vetëm zvogëlimin e ndasisë digjitale, por edhe mundësinë për lundrim të sigurt në internet.

Në strategjinë ndërsektoriale **“Agjenda digjitale e Shqipërisë 2022-2026”**⁴⁷ theksohet se inteligjenca artificiale do vendoset në krye të agjendës së qeverisë, për të siguruar që askush nuk do të lihet pas në transformimin digjital: qytetaret/qytetarët duhet të kenë çdo mundësi për të fituar aftësitë që ato/ata kanë nevojë, duke ushqyer talentin si dhe duke nxitur barazinë gjinore dhe shumëllojshmërinë. Procesi i transformimit digjital ka filluar prej kohësh në Shqipëri dhe të gjithë aktorët publikë dhe privatë po punojnë fuqimisht në ndryshimin e mendësisë së qytetareve/qytetarëve në lidhje me këtë formë të re të pashmangshme të komunikimit. Prej vitit 2020, qytetaret/qytetarët dhe bizneset aplikojnë vetëm përmes platformës e-Albania dhe janë punonjëset/punonjësit e administratës publike ato/ata që mbledhin të gjitha dokumentet shtetërore të shërbimeve, që përdoren dhe ripërdoren, duke i çliruar qytetaret/qytetarët nga barra e grumbullimit të tyre fizikisht në letër në sportelet e shtetit.

Në raportin e monitorimit të zbatimit të “Agjendës Digjitale 2022-2026” për vitin 2023, AKSHI deklaroi se si rrjedhojë e rritjes së numrit të shërbimeve elektronike të ofruara online në platformën e-Albania, numri i përdorueseve/përdoruesve deri në dhjetor 2023 arriti në 3,074,325, ku përfshihen qytetare/qytetarë, biznese dhe punonjëse/punonjës të administratës publike. Numri i transaksioneve vjetore në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit, e cila është arkitektura bazë e shkëmbimit të të dhënave mes 60 sistemeve elektronike në kohë reale dhe në mënyrë të sigurt, arriti në 297 milionë për gjithë vitin 2023. Portali qeveritar e-Albania vepron si një pikë e vetme për ofrimin e shërbimeve publike të institucioneve qeveritare, duke ofruar aktualisht 95% të të gjithë shërbimeve publike, (plotësisht online pa nevojën për prezencë fizike të individit, mjetit apo mostër laboratorike). Vlerësohet se e-Albania u ka kursyer qytetareve/qytetarëve dhe bizneseve rreth 1000 vite pritje nëpër radhë për marrjen e dokumenteve shtetërore me vulë elektronike dhe rreth 9 milionë EUR në xhepat e tyre, nga heqja e tarifave të këtyre dokumenteve që ofrohen tashmë pa pagesë në platformë në versionin e tyre elektronik. Qasja e portalit qeveritar e-Albania ndaj digjitalizimit të shërbimeve është vlerësuar edhe nga raportet e organizatave ndërkombëtare, nga Kombet e Bashkuara, Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), Departamenti i Amerikan Shtetit dhe Komisioni Evropian, të cilët i japin Shqipërisë notën maksimale në qeverisjen digjitale.⁴⁸ Megjithatë, shqetësim në gjithë këtë zhvillim në lidhje me digjitalizimin, mbetet aftësimi i grupeve të caktuara për t’a aksesuar dhe përdorur lehtësisht platformën e-Albania, përfshirë këtu gra/të reja/vajza nga grupe të cënueshme, të moshuarat/moshuarit, PAK, etj.

Strategjia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030⁴⁹ është një tjetër dokument i rëndësishëm i politikave që nxitin përparimin drejt TIK dhe SHTIM përmes zbatimit të së cilës synohet: rritja e efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së sistemit për mbështetjen e kërkimit shkencor, të integruar në nivel ndërkombëtar, në të gjithë spektrin e fushave të shkencave natyrore, inxhinierike dhe teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale dhe humane; krijimi i një mjedisi që lehtëson dhe inkurajon mekanizmat e ndërveprimit dhe transferimit të teknologjive për bashkëpunim midis komunitetit të kërkimit, ekonomisë, inovacionit dhe institucioneve publike; promovimi i kulturës së shkencës dhe inovacionit në edukim për të siguruar një qasje didaktike me theksin në praktikat kërkimore dhe projektet. Të dhënat e përpunuara nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), evidentojnë se numri i projekteve fituese kombëtare dhe ndërkombëtare të drejtuara nga gratë dhe vajzat është më i lartë se ai i projekteve të drejtuara

46. Projekti i UNICEF-it për sigurinë në internet

47. Miratuar me VKM Nr. 370, datë 1.6.2022 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale “Agjenda digjitale e Shqipërisë” dhe të planit të veprimit 2022–2026. Shih: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2022/06/01/370/8fd7b0cf-6848-431f-8bcb-5d08d16deaa7>

48. Raport monitorimi për periudhën Qershor - Dhjetor 2023 “Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022 – 2026”, fq.10-11. Shih: <https://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2024/03/Plani-i-monitorimit-te-AD-per-vitin-2023.-1.pdf>

49. Miratuar me VKM Nr. 542, datë 20.09.2023. Shih: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/09/20/542/96f316d6-b135-42fb-a64a-abbfa9484c8>

nga burrat dhe djemtë. Të dhënat e vitit 2022 tregojnë se nga 84 propozime të vlerësuara nga AKKSHI në të gjitha fushat prioritare, u shpallën si fituese 46 projekte nga të cilat 31 projekte drejtoheshin nga gra dhe vajza. Megjithatë, arritjet e përmendura reflektojnë iniciativat për promovimin e barazisë gjinore vetëm në aspekte të veçanta të kërkimit shkencor. Në këtë kuadër, mbetet i rëndësishëm hartimi i një plani kombëtar për promovimin e barazisë gjinore në shkencë, teknologji dhe inovacion, me qëllim integrimin e perspektivës gjinore në të gjitha masat dhe veprimet që do mundësojnë arritjen e përparësive të kësaj strategjie.

SKBGJ 2021-2030 gjithashtu përmban masa konkrete për zvogëlimin e ndasive gjinore në digjitalizim, si dhe për nxitjen dhe mbështetjen e ideve inovatore që synojnë drejt ekonomisë mjedisore dhe digjitalizimit, në sipërmarrjet e grave dhe të rejave nga të gjithë grupet. Nga monitorimi i zbatimit të kësaj strategjie për vitin 2022, rezultojnë se gjatë vitit 2022, janë shtuar dhe zhvilluar kurse të reja, si: aftësia digjitale me 422 pjesëmarrëse/pjesëmarrës (45% gra/vajza); Graphic Design me 231 pjesëmarrëse / pjesëmarrës (56% gra/vajza); teknike/teknik rrjeti kompjuterik me 13 pjesëmarrëse/pjesëmarrës (23% gra/vajza); Web design me 118 pjesëmarrëse / pjesëmarrës (55% gra/vajza) dhe kurse të tjera me 8614 pjesëmarrëse/pjesëmarrës (51% gra/vajza).⁵⁰

9. Si ka ndikuar mjedisi i politikave makroekonomike dhe fiskale në zbatimin e PVP-në në vendin tuaj dhe çfarë politikash makroekonomike ka zbatuar vendi juaj në mbështetje të një ekonomie më të barabartë gjinore në pesë vitet e fundit?

Ecuria e financave publike të vendit tonë përgjatë pesë viteve të fundit është ndikuar nga disa fatkeqësi natyrore kombëtare dhe ngjarje ndërkombëtare si: tërmeti i nëntorit 2019, pandemia COVID-19, si dhe lufta në Ukrainë. Këto ngjarje kanë ndikuar jo-pozitivisht në rrugën e konsolidimit fiskal që qeveria shqiptare kishte ndërmarrë përpara vitit 2019 dhe ky trend negativ vërehet sidomos në vitin 2020 ku deficitin buxhetor shkoi 6.7% e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) krahasuar me një vit më parë që ishte 1.9% e PBB, diktuar gjerësisht nga efektet negative të pandemisë COVID-19. Gjithsesi, konsolidimi fiskal ka vijuar sërish pas këtij viti, me ulje graduale të nivelit të deficitit buxhetor dhe të stokut të borxhit publik, ku në fund të vitit 2023 deficitin buxhetor rezultoi 2.2% e PBB.

Për shkak të urgjencës dhe pa parashikueshmërisë si të dëmeve ashtu edhe të pasojave sociale, ekonomike dhe shëndetësore të shkaktuara nga kriza e pandemisë COVID-19, nuk ishte e mundur të kryheshin analiza të thelluara të ndikimit të masave financiare tek burrat dhe gratë. Masat financiare të hartuara për të zbutur krizën e shkaktuar, u bazuan vetëm në të dhënat e disponueshme në momentin e hartimit të tyre dhe nuk ishte e mundur të thelloheshin analizat për ndikimet e tyre në një të ardhme të paqartë e të pasigurt, në grupe të ndryshme shoqërore.

Gjithashtu, gjatë periudhës 2019-2024 janë ndërmarrë një sërë masash në lidhje me sektorin publik, veçanërisht në ristrukturimin dhe riorganizimin e kabinetit qeveritar, të cilat nuk rezultojnë në masa shtrënguese apo shkurtime të personelit. Këto ristrukturime synojnë riorganizimin më të mirë të pushtetit qendror përmes krijimit të ministrive apo portofoleve të përputhura me drejtimit përparësorë të programit qeverisës për një zhvillim të qëndrueshëm. Të dhënat për vitin 2024, evidentojnë se: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mban portofolin më të madh ministror prej 78,238,015,000 lekë (për nga struktura e Ministrisë është parashikuar që Shëndetësia dhe Mbrojtja Sociale të përfshihen në një Portofol Ministror); Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë pason me 57,137,485,000 lekë; Ministria e Arsimit dhe Sportit me 52,223,097,000 lekë; Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (krijuar me VKM Nr.30 datë

50. Raporti i monitorimit të zbatimit të SKBGJ 2021-2030, për vitin 2022. Shih: <https://shendetesia.gov.al/barazia-gjinore/>

17.01.2024) me 51,116,216,000 lekë; Ministria e Mbrojtjes me 48,338,376,000 lekë; Ministria e Brendshme me 25,950,856,000 lekë; Ministria e Drejtësisë me 14,734,650,000 lekë; Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me 14,180,500,000 lekë; Ministria e Financave (ndarë me VKM Nr. 31 datë 17.01.2024, nga ajo e Ekonomisë) me 10,926,750,000 lekë; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me 3,523,107,000 lekë; Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme me 3,239,300,000 lekë.⁵¹ Kabineti qeveritar aktual konfirmon 11 ministri me portofol dhe 6 Ministra të Shtetit pa portofol, përkatësisht; Ministri për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Ministri për Marrëdhëniet me Parlamentin, Ministri për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Ministër Shteti dhe Kryenegociator, Ministër për Pushtetin Vendor dhe Ministër për Rininë dhe Fëmijët. Gratë në kabinetin qeveritar mbajnë përgjegjësi për të shpenzuar 57.1% të buxheteve ministrore (tre ministritë e para me portofolin më të madh buxhetor drejtohen nga gra). Sa më sipër shkojnë në mbështetje të veprimeve për zbatimin e masave të ndryshme të Platformës për Veprim të Pekinit.

3.2 ELIMINIMI I VARFËRISË, MBROJTJA SOCIALE DHE SHËRBIMET SHOQËRORE

FUSHAT KRITIKE TË MBULUARA

A. Gratë dhe varfëria

B. Arsimi dhe formimi i grave

C. Gratë dhe shëndeti

I. Të drejtat e njeriut të grave

L. Fëmija vajzë

10. Çfarë veprimesh ka ndërmarrë vendi juaj për uljen/eliminimin e varfërisë së grave dhe vajzave në pesë vitet e fundit?

Politikat për uljen e varfërisë dhe nxitjen e punësimit. Në seksionet e mësipërme janë sqaruar masat legislative por edhe politike që shteti shqiptar ka ndërmarrë në lidhje me nxitjen e punësimit dhe uljen e varfërisë së grave dhe vajzave. Disa masa të tjera strategjike janë parashikuar edhe në SKBGJ 2021-2030 nën qëllimin Strategjik të I^ë që synojnë: uljen/eliminimin e varfërisë nëpërmjet përmbushjes së të drejtave ekonomike dhe sociale për gratë, të reja, vajzat dhe burrat, të rinjtë, djemtë në shoqëri; fuqizimin e grave, të rejave dhe vajzave, nga të gjitha grupet, duke synuar një rritje dhe qëndrueshmëri të ekonomisë mjedisore (së gjelbër); si dhe pjesëmarrjen e tyre të barabartë në digjitalizim. Shteti shqiptar deri në vitin 2030 synon të ndikojë në zbutjen e varfërisë⁵² duke rritur shënjestrimin e individëve, fëmijëve dhe familjeve të varfra, si dhe integrimin social të tyre, duke rritur në 50% pjesën e përfutueseve/përfutuesve të përfshirë në skemat e punësimit, duke e kthyer nga një skemë pasive në aktive.

Në Strategjinë Kombëtare të Rinisë⁵³ dhe Planin e saj të Veprimit 2022-2029, nën qëllimin e Politikës së 2^ë janë parashikuar masa dhe aktivitete që synojnë mbështetjen dhe nxitjen e inovacionit rinor, si dhe rritjen e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave/rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital, për të rritur dhe përmirësuar mundësitë e tyre për t'u integruar në tregun e punës. Në fokus të politikave janë vajzat e reja dhe grupet e marginalizuara të të rinjve/rejave.

51. <https://financa.gov.al/akti-normativ-nr-1-date-21-02-2024/>

52. Institucioni i Avokatit të Popullit ka realizuar një studim për minimumin jetik në vitin 2021 ku ndër të tjera, sugjeron ndryshimin e ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" dhe përfshirjen si dispozitë të veçantë të përkufizimit të minimumit jetik. Shih: <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Minimumi%20jetik%20ok.pdf>

53. Shih: <https://riniafemijet.gov.al/en/strategjia-kombetare-e-rinise-2022-2029-tashme-miraturar/>

Një Plan Veprimi për Zbatimin e Garancisë Rinore 2023-2024 u miratua në vitin 2023, që përmban masa për t'u ofruar një ofertë të denjë punësimi, trajnimi ose arsimit çdo të reje/riu (të moshës 15-29 vjeç) brenda katër muajve nga identifikimi i tyre, në përputhje me rekomandimet e BE-së. Angazhimi për t'u ofruar të rejave/rinjve punë të denjë dhe arsim cilësor, është në përputhje me OZHQ #8 (Punë e Denjë dhe Rritje Ekonomike) dhe OZHQ #4 (Arsim cilësor).⁵⁴

Një nga objektivat e **Strategjisë për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021-2027**⁵⁵ (SBZHRP) synon promovimin e zhvillimit lokal përmes përmirësimit të punësimit dhe mundësive të biznesit brenda dhe jashtë fermave, si dhe përmes iniciativave zhvillimore të udhëhequra nga komuniteti. Ndër të tjera, SBZHRP ka parashikuar të mbështesë fermerët/fermeret e rinj/reja për të ngritur dhe zhvilluar biznese bujqësore veçanërisht në mesin e të rinjve/rejave në nevojë, të zonave rurale. Nga monitorimi i zbatimit të SKBGJ 2021-2030 për vitin 2022⁵⁶, rezulton se Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) ka realizuar disa aktivitete ndërgjegjësuëse dhe trajnime me gratë dhe vajzat (1 takim për të drejtat pronësore mbi tokën⁵⁷, 10 ditë trajnimi⁵⁸ nga të cilat kanë përfutur 300 gra fermere, si dhe janë asistuar dhe u është ofruar akses në informacion⁵⁹ rreth 8100 grave fermer). Nga Skemat Kombëtare të mbështetjes kanë rezultuar fituese 505 aplikante gra.

Ministrja e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit në Shqipëri ka prezantuar Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative 2024 – 2030⁶⁰, që synon nxitjen e sipërmarrjes në vend, nëpërmjet një modeli të ri ekonomik të drejtuar nga inovacioni, zhvillimi gjithëpërfshirës, veçanërisht përmes fuqizimit të grave në sipërmarrje. Kjo nismë është në linjë me Agjencinë Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Start-Up dhe Lehtësuesve (Start-UP Albania)⁶¹, e cila ka iniciuar thirrje për grante në shumën totale 3 milionë euro, të financuara nga buxheti i shtetit shqiptar. 40% e aplikanteve/aplikantëve për grante janë gra, duke reflektuar një interes dhe pjesëmarrje në rritje midis grave sipërmarrëse. Strategjia përfshin dispozita për të lehtësuar dhe mbështetur gratë sipërmarrëse dhe avantazh në pikët e kualifikimit të granteve, në rastet kur pikët janë të barabarta ndërmjet aplikantëve burra dhe aplikanteve gra, përparësi u jepet grave, duke sinjalizuar një angazhim për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin në peizazhin sipërmarrës të Shqipërisë. (Për detaje referohuni te të dhënat e INSTAT për gratë pronare/administratore paraqitur në përgjigjen e pyetjes nr.22 të këtij raporti).

Programi 'EU for Youth'⁶², synon të mbështesë pjesëmarrjen dhe fuqizimin e të rinjve/rejave në politikë, jetën ekonomike dhe sociale të Shqipërisë. Aktivitetet e planifikuara për t'u zbatuar në kuadër të Planit të Veprimit do të fokusohen në tri fusha të mbështetjes në lidhje me të rejtat/rinjët në Shqipëri në përputhje me synimet e "Strategjisë së BE-së për Rininë 2019-2027"⁶³ dhe "Strategjisë së Sektorit të Rinisë e Këshillit të Evropës 2020-2030"⁶⁴. Sipas përllogaritjes të INSTAT, përqindja e të rejave /rinjve jo në arsim, punësim ose trajnim (JAPT/NEET) zë një peshë prej afro 27%.

54. Më shumë detaje për Programin e Garancisë Rinore u dhanë në përgjigje të pyetjes 6 më sipër, në këtë raport.

55. Miratuar me VKM Nr. 460 datë 29.06.2022 "Për miratimin e Strategjisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021–2027". Shih: <https://qzb.gov.al/eli/vendim/2022/06/29/460/a49807d6-28cb-4973-94ea-60d89bf8d41c>

56. Shih: <https://shendetesia.gov.al/barazia-gjinore/> Raporti i monitorimit të SKBGJ 2021-2030 për vitin 2023 është në proces përgatitjeje.

57. Realizuar në bashkëpunim me UN Women dhe FAO

58. Organizuar nga Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore në bashkëpunim me Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor

59. Nga Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor.

60. Draft dokumenti ka qenë i hapur për diskutim publik deri në datën 26.04.2024. Shih: <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/716>

61. <https://startupalbania.al/>

62. Përfshihet në Prioritetin Tematik 1: Politikat arsimore, punësimi, mbrojtja sociale, politikat gjithëpërfshirëse dhe shëndetësia, pjesë e kontratës së parashikuar nën Programin Kombëtar IPA 2022 me përfitues Ministrinë e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, institucionet e varësisë përkatëse. Shuma e financimit është 5 milionë euro.

63. [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:42018Y1218\(01\)](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:42018Y1218(01))

64. Shih: <https://rm.coe.int/a5-brochure-youth-sector-strategy-2030-albanian/1680a0d17a>

Programet aktive të tregut të punës (PATP)⁶⁵, i janë nënshtruar një procesi ridizajnimi të bazuar në dëshmi nga programet e kaluara dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare. Në vitin 2020, u miratuan tre VKM, duke prezantuar një grup prej tetë PATP-sh të reja. Prej tyre, pesë u hartuan bazuar në vlerësimet paraprake dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare, ndërsa tre të tjerët u formuluan në përgjigje të sfidave të paraqitura nga pandemia COVID-19. Gjithashtu, ligji për nxitjen e punësimit garanton përparësi për punësimin e grupeve të marginalizuara dhe kategorive të posaçme si gra/të reja viktimat/të mbijetuara dhune, trafikimi që përfitojnë nga programet e mëposhtme të PATP:

(1) Trajnimi në punë⁶⁶ synon punëkërkuueset/punëkërkuësit pa kualifikime dhe i trajnon ato/ata në punë, si dhe i siguron punëdhënëset/punëdhënësit një grant për 4 muaj, bazuar në një plan trajnimi të miratuar dhe të mbikëqyrur nga trajnerja/trajneri i caktuar nga punëdhënësjat/punëdhënësi; **(2) Subvencionimi i pagës**⁶⁷ është një kontratë pune e subvencionuar njëvjeçare, ku nevoja e punëkërkuëses/punëkërkuësit përputhet me profilin e punëdhënëses/punëdhënësit, paga caktohet në bazë të pagës së tregut dhe kohëzgjatja e subvencionit përcaktohet në bazë të punëkërkuëses/punëkërkuësit; **(3) Programi i punësimit në stazh**⁶⁸ siguron kalimin e shpejtë në tregun e punës për të sapo diplomuarat/diplomuarit e kualifikuar, në të njëjtën fushë ose të ngjashme me studimet e tyre, për një periudhë 6-mujore; **(4) Programi i Vetëpunësimit**⁶⁹, ndihmon në fillimin e biznesit dhe ofron grante financiare dhe mbështetje për punëkërkuëset/punëkërkuësit e papuna/papunë, të cilat/cilët kanë një ide dhe plan biznesi të mirë përcaktuar e të zbatueshëm; **(5) Programi i Punësimit dhe Trajnimit në Komunitet**⁷⁰, adreson nevojat e punëkërkuëseve/punëkërkuësve të papuna/papunë afatgjatë, me fokus në trajnimin e fuqisë punëtore, për të riintegruar punëkërkuëset/punëkërkuësit në tregun e punës, në përputhje me mundësitë lokale të punësimit dhe zbatohet në partneritet me komunitetet dhe OSHC/organizatat vullnetare; **(6) Ofrimi i trajnimit të nënkontraktuar**⁷¹ është një skemë subvencionimi për punëkërkuëset/punëkërkuësit e punësuar dhe të papunë, ku trajnimi ofrohet nga ofruesit privatë të trajnimit; **(7) Programi i Trajnimit në Shqipëri**⁷² për të rejtat/rinjat e moshës 15-29 vjeç, me kurse të shkurtra të formimit profesional përmes Qendrave të Formimit Profesional; **(8) Subvencione** për përshtatjen e vendit të punës që siguron financim deri në 1600 euro për të mundësuar përshtatjen e vendit të punës me nevojat e një personi me aftësi të kufizuara. Një subvencion i tillë është i integruar në të gjitha programet e lartpërmendura; **(9) Subvencionet për transportin dhe kujdesin ndaj fëmijëve** janë të disponueshme për të mbështetur integrimin e punëkërkuëseve/punëkërkuësve vulnerabël në tregun e punës.

Fondi Social i Punësimit. Ligji për Nxitjen e Punësimit prezanton gjithashtu një skemë kuotash për punëdhënëset/punëdhënësit publikë dhe privatë dhe krijon një Fond Social të Punësimit për financimin e programeve të punësimit dhe zhvillimit të aftësive që synojnë integrimin e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës, duke synuar si personat me aftësi të kufizuara ashtu edhe familjen e tyre. Kjo skemë kuotash/takse e sapo futur parashikon që çdo punëdhënëse/punëdhënësi me më shumë se 25 punonjëse/punonjës duhet të punësojë një person me aftësi të kufizuara dhe më pas një person shtesë për çdo 50 punonjëse/punonjës. Nëse punëdhënësjat/punëdhënësi nuk përmbush këtë detyrim, duhet të kontribuojë në Fondin Social të Punësimit një shumë të barabartë me 100% të pagës minimale në muaj për çdo detyrim të paplotësuar. Fondi nuk është ende plotësisht funksional.

Përfitimi i papunësisë⁷³ është një përfitim fiks, në masën 50% të pagës minimale bruto (20 000 lekë – rreth

65. Shih të dhënat e tabelës nr. 4 të "Shtojca 2" në këtë raport

66. VKM Nr. 17, datë 15.01.2020, i ndryshuar

67. VKM Nr. 17, datë 15.01.2020, i ndryshuar

68. VKM Nr. 17, datë 15.01.2020, i ndryshuar

69. VKM Nr. 348, datë 29.04.2020

70. VKM Nr. 535, datë 08.07.2020

71. VKM Nr. 646, datë 5.10.2022

72. VKM Nr. 264, datë 27.04.2023

73. Miratuar me VKM Nr. 161/2018

200 euro). Punëkërkuessa/Punëkërkuessi duhet të plotësojë disa kritere⁷⁴ dhe përfitimet e papunësisë jepen për një kohëzgjatje të kufizuar që varion nga tre muaj për ato/ata që kanë paguar kontribute sociale për të paktën 12 muaj, deri në maksimum 12 muaj për ato/ata që kanë kontribute 10 vjet ose më shumë. Gratë mbi 55 vjeç dhe burrat mbi 60 vjeç marrin 12 muaj përfitime papunësie për sa kohë që kontributet janë paguar për një minimum prej 12 muajsh. Nga kjo skemë përjashtohen të vetëpunësuarat/vetëpunësuarit.

Riintegrimi social. MSHMS në bashkëpunim me MFE (sot MF) dhe AKPA kanë hartuar strategjinë e daljes me qëllim kalimin nga skema pasive në tregun e punës. Një urdhër i përbashkët⁷⁵ ndërmjet Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministres së Financave dhe Ekonomisë është nënshkruar në janar 2022 për mekanizmin e referimit për punësimin dhe integrimin social të anëtareve/anëtarëve të familjes në moshë pune që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike (NE). Urdhri bazohet në modelin e referimit të pilotuar fillimisht për tre muaj në një nga bashkitë e vendit⁷⁶ dhe aktualisht modeli është përhapur në 12 rajone, që mbledhen çdo muaj, për të vlerësuar, referuar dhe punësuar anëtare/anëtarë aktivë në moshë pune. Mentorimi social është pjesë e planeve individuale të përgatitura për të mbështetur riintegrimin e përfituesve/përfituesve të NE.

Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore⁷⁷ (NJVV) kanë marrë masa në zbatimin e politikave qendrore për referim për punësim dhe kurse profesionale⁷⁸, punësim në biznese private (programi formimi i paguar në vendin e punës mundësoi punësimin e 18 rasteve nga këto 14 gra)⁷⁹. Janë organizuar panaire pune online⁸⁰ (gjatë pandemisë) por edhe fizikisht (2023) si dhe aktivitete për të promovuar gratë rurale ose produktet nga sektori i bujqësisë si: “Panairi i Artizanatit”⁸¹, Festivali i Bashtovës⁸² “Artizanët për Trashëgiminë Kulturore (ArtCult)”⁸³, Panairi “Kavaja zemra e Shqipërisë”, *ndërgjegjësim dhe edukim*⁸⁴ nëpërmjet organizimit të fushatave ndërgjegjësuere për punësimet e grave dhe vajzave, si dhe takime me komunitetin. *Sipërmarrja sociale, krijim biznesi janë mundësuar nga bashkëpunimi i bashkive⁸⁵ me OJF-të.*

Përveç institucioneve edhe **organizatat e shoqërisë civile⁸⁶** luajnë një rol me rëndësi në punësimin, strehimin, ofrimin e shërbimeve ligjore falas për kategoritë në nevojë, mbështetje për familjet, nëna kryefamiljare drejt punësimit dhe politikave aktive të tregut të punës përfshirë dhe intershipet apo mbështetje për iniciativat ekonomike, me fokus familjet e rikthyera nga migrimi i pasigurt dhe jo vetëm, mbështetje e komunitetit afgan prej tashmë rreth 3 vitesh duke siguruar transferta në cash gjatë kohës së qëndrimit në vendin tonë të ndërthurura edhe me një sërë shërbimesh të tjera të integruara. Rreth 2000 gra janë mbështetur⁸⁷ për

74. Duhet të ketë të paktën 12 muaj sigurim (jo të njëpasnjëshëm); të jetë i papunë/e papunë, i regjistruar si i papunë/e papunë në një zyrë punësimi; të jetë i gatshëm/e gatshme t'i nënshtrohet trajnimit dhe rikualifikimit dhe të mos ketë të drejtë për përfitime të tjera të sigurimeve shoqërore, përveç pensionit të pjesshëm të aftësisë së kufizuar.

75. Urdhër i përbashkët nr. 52 datë 26.01.2022.

76. Bashkia Elbasan

77. Informacioni i referohet vetëm Bashkive që i janë përgjigjur pyetësorit

78. Bashkitë Vau i Dejës, Selenicë, Pogradec, Lushnje, Lezhë, Durrës, Përrenjas

79. Bashkia Durrës

80. Bashkia Kavajë

81. Aktivitet i organizuar nga Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural në bashkëpunim me Bashkinë e Kavajës dhe me mbështetjen e UN Women Shqipëri në kuadër të projektit ‘Fuqizim ekonomik i grave në zinxhirin e vlerës së artizanatit në bashkinë Kavajë’, me mbështetjen financiare të Qeverisë Suedeze.

82. Aktivitet i organizuar në kuadër të projektit “Routes4culture,” financiar nga BE përmes programit EU4Culture zbatuar nga UNOPS në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe Bashkinë Kavajë.

83. Aktivitet i organizuar nga “Instituti i kërkimeve Urbane” URI, financiar nga BE në kuadër të programit “EU4Culture”, zbatuar nga UNOPS, në partneritet me Ministrinë e Kulturës dhe Bashkinë Kavajë.

84. Selenicë dhe Pogradec

85. Pukë, Krujë, Librazhd, Durrës (në kuadër të zbatimit të projektit “Riintegrimi i qëndrueshëm Socio-Ekonomik i Emigraenteve/Emigrantëve të kthyer në Shqipëri”, financiar nga GIZ, i cili zbatohet nga NISMA ARSIS në partneritet me Terre des Hommes - janë mbështetur 26 raste nga këto 22 gra

86. Qendra Psiko-Sociale “Vatra”, Vlorë dhe Nisma Arsisi

87. Nëpërmjet fondeve të SIDA-s janë mbështetur 3 programe; Programi i Zhvillimit Ekonomik Lokal/LED, programi për Olof Palme International Center (2018-2022 dhe 2023-2025), Programi Rajonal “Gratë në Biznes” në bashkëpunim me BERZH 2014-2022 (financimi total për BB: 73 MSEK),

kultivimin e Bimëve Medicinale dhe Aromatike (BMA/ MAP) të egra, mbështetje me pajisje bujqësore, trajnime mbi praktikën e mira bujqësore, pjesëmarrje në tryeza të rrumbullakëta, panairë, mbështetje për të lidhur kontrata bujqësore me biznese, gjë që sjell siguri në treg për produktet e tyre. Gjithashtu, 70 gra dhe vajza të punësuar në fasoneri janë mbështetur me ndihmë ligjore falas duke siguruar respektimin e të drejtës së tyre për tu paguar. Nëpërmjet një programi⁸⁸ shërbimet këshillimore për sipërmarrjet e drejtuara nga gratë ishin të disponueshme dhe në vitin 2021, në Shqipëri kishte 17 projekte këshillimore lokale, si dhe u organizuan kurse të ndryshme trajnimi, webinarë ad-hoc dhe mentorim.

11. Çfarë veprimesh ka ndërmarrë vendi juaj për përmirësimin e qasjes së grave dhe vajzave në mbrojtje sociale në pesë vitet e fundit?

Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2020-2023⁸⁹ ka synuar dhe ka pasur arritje me rëndësi për reformimin e politikave të mbrojtjes sociale nëpërmjet transformimit të skemës së ndihmës ekonomike (NE) në një skemë aktive që mundëson riintegrimin social; rishikimin e sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, ndërhyrjes dhe sigurimit të riintegrit të fëmijëve në familje dhe komunitet, duke kushtuar një kujdes të veçantë për jetimet/jetimet sociale dhe biologjike, duke siguruar ofrimin e shërbimeve të integruara të mirëqenies sociale dhe komunitare. Gjithashtu, strategjia ka mundësuar nevojën për të krijuar lidhje dhe integrim më të mirë ndërmjet politikave aktive të punësimit dhe politikave të përfshirjes dhe mbrojtjes sociale.

Qeveria Shqiptare ka miratuar së fundmi **Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale**⁹⁰ 2024-2030 me VKM-në nr.152/2024, duke marrë në konsideratë dokumentet strategjik të Komisionit Evropian mbi kujdesin social, në linjë me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, konkretisht OZHQ 5 - Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave (5.c Miratimi dhe forcimi i politikave të shëndosha dhe legjislatonit të detyrueshëm për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave dhe vajzave në të gjitha nivelet). Një nga shtyllat kryesore të Strategjisë është reformimi i skemave të pagesës, duke pasur parasysh këndvështrimin gjinor, konkretisht qëllimi i politikës është zbutja e varfërisë për çdo individ në nevojë dhe përmirësimi i jetesës për personat me aftësi të kufizuara përmes mbështetjes me skemat financiare dhe përfitimeve të përshtatshme, të përgjigjshme gjinore, transparente, të afta për përballimin e rreziqeve e krizave. Janë parashikuar masa për ofrimin e shërbimeve **për moshën e tretë**, ku do të mbahen në konsideratë diferencat gjinore mes grave dhe burrave të moshuar, duke ofruar shërbime që i përshtaten nevojave specifike të tyre.

Një vëmendje e veçantë i është dhënë mbrojtjes së nënës dhe fëmijës, të cilat kanë qenë edhe prioritetet që u synuan edhe nga Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2020-2023⁹¹. Mbrojtja dhe kujdesi ndaj nënës e fëmijës është thelbësorë për ushqyerjen dhe shëndetin e mirë, mirëqenien e nënave dhe fëmijëve të tyre, parandalimin dhe reduktimin e varfërisë dhe vulnerabilitetit, si dhe arritjen e barazisë gjinore në tregun e punës. Që prej muajit janar 2019 e në vazhdimësi, po aplikohet **“bonusi i bebes”** që synon mbështetjen e familjeve të reja, rritjen e numrit të lindjeve dhe zhvillimin e shoqërisë. Me anë të bonusit mbështeten familjet shqiptare në masën 40,000 lekë për lindjen e foshnjës së parë; në masën 80,000 lekë për lindjen e foshnjës së dytë; në masën 120,000 lekë për lindjen e foshnjës së tretë dhe kështu me radhë të foshnjave të tjera në vijim. Në total janë mbështetur rreth 210,000 fëmijë dhe në buxhetin e vitit 2024 për bonusin e bebes janë parashikuar 2,2 miliard lekë. Masa në lidhje me sigurimin e paketave të kujdesit për bebe dhe nëna u zbatua me shumë sukses edhe për nënat rome dhe egjiptiane që lindin në spital.

88. BERZH

89. <https://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/Strategjia-kombetare-2020-2023-okay.pdf>

90. <https://shendetesia.gov.al/legjislatoni-4/>

91. Miratuar me Vendimin Nr. 866, Datë 24.12.2019 ‘Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale, 2020-2023, dhe të Planit të Veprimit në zbatim të saj’.

Në vitin 2021 u bënë disa rishikime të masës së ndihmës ekonomike (NE) për kategori të caktuara si: dyfishimi i masës së NE për familjet me tre e më shumë fëmijë, ndërsa për familjet e tjera u parashikua një shtesë prej 10%, dhe trefishim i pagesës për jetimet/jetimët, viktimat e trafikimit dhe viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare. Në vitin 2022, u realizua një rritje tjetër e masës së NE për kategori të tjera si dyfishim i pagesës për gratë kryefamiljare me deri dy fëmijë, dyfishim për personat mbi 65 vjeç të cilët, nuk përfitojnë pension pleqërie apo pension social. Familjet e tjera të skemës përfituan edhe 10% më shumë mbi rritjen e fillim vitit 2022. Vitet e fundit, është rritur numri i grave rome dhe egjiptiane që janë mbështetur me ndihmë/përfitime ekonomike apo janë përfshirë në programet e riintegrit (nga 112 gra rome dhe 89 gra egjiptiane në vitin 2016 në 1,785 gra rome dhe 846 gra egjiptiane në vitin 2019). Gratë e dhunuara, të cilat kanë një urdhër mbrojtjeje, janë trajtuar me trefishim pagese. Përbërja gjinore e përfitueseve/përfituesve të ndihmës ekonomike është pothuajse e barabartë edhe pse numri i burrave është paksa më i lartë se i grave. Në kuadër të masave të marra për rritjen e masës së përfitimit të ndihmës ekonomike, në zbatim të VKM nr. 597/2019, të ndryshuar, rreth 1,000 viktima dhune dhe trafikimi që nga viti 2022, kanë përfituar trefishimin të masës së përfitimit të ndihmës ekonomike. Po kështu jepen pagesa për mbi 164 mijë gra/vajza dhe burra/djem me aftësi të kufizuara dhe kujdestaret/kujdestarët e tyre (shumica e të cilave/cilëve janë nënat/motrat/gratë etj., të këtyre personave). Për herë të parë ofrohet mbështetje e veçantë për gratë e papuna me tre ose më shumë fëmijë deri në moshën 18 vjeç, me të ardhura familjare deri në 100 mijë lekë në muaj, duke i mbështetur me pagesën e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën e kujdesit ndaj fëmijës deri në 5 vjeç.

Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale 2016–2020 (DPPS) është një dokument tejet i rëndësishëm i qeverisë shqiptare, që garanton një sistem bashkëkohor e të përgjegjshëm, për vlerësimin e përfshirjes sociale në politika të ndryshme sektoriale, si: mbrojtja sociale, punësimi dhe rritja e aftësive, shëndeti, arsimi, strehimi dhe siguri i nevojave bazë, si edhe në politikat e pjesëmarrjes sociale dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Ky dokument synon krijimin e një ambienti mbrojtës e riintegruar për grupet e kategoritë më të përjashtuara të shoqërisë shqiptare, përfshirë edhe gratë, personat që jetojnë në varfëri apo përjetojnë dhunë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, të rejtat/rinjët dhe të moshuarat/moshuarit që vuajnë përjashtimin social.

Në zbatim të Ligjit 121/2026 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, që nga viti 2019 është ngritur dhe funksionon Fondi Social, nëpërmjet, të cilit janë ngritur, 73 shërbime të përkujdesit shoqëror nga të cilat, kanë përfituar 51 bashki dhe 8 qarqe, me një fond të planifikuar në masën 1,2 miliard lekë, të ofruara, në total në vite (kumulative), për 32,869 individë, krahasuar me vitin 2020 ku u ngritën vetëm 14 shërbime, me fond 74 milion lekë, apo me vitin 2022, ku u ngritën 40 shërbime në 27 bashki dhe 6 qarqe, me financim total 600 milion lekë, për 5,644 përfituese/përfitues.

MSHMS vijon të ketë në fokus zgjerimin e shërbimeve mbështetëse të specializuara, përmirësimin e standardeve të tyre, dhe financimin e vazhdueshëm nëpërmjet buxhetit të shtetit por edhe me ndihmesën e vazhdueshme financiare që japin partnerët ndërkombëtarë. Përveç shërbimeve të specializuara të përmendura në pyetjen nr.16 në vijim në këtë raport, me mbështetjen e Agjencive të OKB⁹²-së janë ngritur tre qendra komunitare të reziliencës, për mbrojtjen sociale për gratë në nivel vendor⁹³, si dhe është realizuar Hartëzimi i Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror⁹⁴, që paraqet tipologjinë dhe llojin e shërbimeve, por edhe rolin e tyre në plotësimin e nevojave shoqërore të përfitueseve/përfituesve të shërbimeve. Rezulton se sot ofrohen shërbime në 391 institucione përkujdesi ose 16% më shumë se sa në vitin 2021 (339 institucione)⁹⁵. Këto institucione sigurojnë 1,147 shërbime ose 2,3 herë më shumë se sa në vitin 2021 (493 shërbime), për 36,642 përfituese/përfitues, individë në nevojë nga 10,000 në vitin 2021. Institucionet publike përbëjnë 61% të numrit të përgjithshëm të shërbimeve të ofruara në 61 Bashkitë dhe institucionet “Jo-Publike” përbëjnë 39%, krahasuar me vitin 2013

92. UNDP

93. Kurbin, Lezhë dhe Durrës.

94. Me mbështetjen dhe në bashkëpunim me UNICEF

95. Shih tabelën nr.5 të ‘Shtojca 2’

ku institucionet jo-publike përbënin 70% të numrit të përgjithshëm të shërbimeve të ofruara. Shërbimet e kujdesit shoqëror të ndara sipas grupeve përfituese, në përqindje ndahen; (1) shërbime për familjet në nevojë (37%); (2) shërbime për personat me aftësi të kufizuara (fëmijë dhe të rritura/rritur) (28%); (3) shërbime për të moshuara/moshuar (13%); (4) shërbime për fëmijë pa kujdes prindëror (8%); (5) shërbime për viktimat e dhunës dhe trafikimit (10%); (6) shërbime për të rejtat/rinjat në nevojë (4%). [Informacion më i detajuar për inventarin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror të familjeve gjendet në Shtojcën 2 të këtij raporti]

Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) kanë marrë masa konkrete si në zbatim të politikave shtetërore të mbrojtjes sociale por edhe angazhimeve në nivel vendor. Disa bashki⁹⁶ kanë ngritur shërbime të integruara edhe në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, ndërsa bashki⁹⁷ të tjera kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e ndërgjegjësimit dhe promovimin e pjesëmarrjes së barabartë të burrave dhe grave në jetën ekonomike, sociale e kulturore. Prioriteti i punës së bashkive⁹⁸ ka qenë trajtimi i grave me ndihme ekonomike, strehim (bonus qiraje, kredi e butë), punësim. Rezultatet nga hartëzimi i zonave me probleme sociale, një praktikë kjo që po realizohet në nivelin vendor⁹⁹, shërbejnë si udhërrëfyes për planifikimin e ndërhyrjeve sipas nevojave. Takimet dhe trajnimet e vazhdueshme për informimin e të drejtave të grave dhe vajzave kanë ndikuar në edukimin ligjor të grave dhe vajzave, nga të gjitha grupet, për mbrojtjen e të drejtave të tyre.

12. Çfarë veprimesh ka ndërmarrë vendi juaj për të përmirësuar rezultatet shëndetësore për gratë dhe vajzat gjatë pesë viteve të fundit?

Në themel të ndërhyrjeve të parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Shëndetësisë 2021-2030¹⁰⁰ është progresi drejt Mbulimit Shëndetësor Universal. Plani Kombëtar i Veprimit për HIV/AIDS 2020-2025¹⁰¹ kontribuon në arritjen e OZHQ 5 dhe veçanërisht në synimin 5.6: “Sigurimi i një qasje universale në shëndetin seksual dhe riprodhues dhe të drejtat riprodhuese në përputhje me Programin e Veprimit të Konferencës Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin dhe Platformën e Pekinit për Veprim”. Plani përmban masa konkrete për parandalimin e HIV-it në një kontekst më të gjerë të të drejtave gjinore dhe të shëndetit seksual dhe riprodhues, me fokus grupet më të cënueshme dhe riskuara, si vajzat adoleshente, gratë e reja që përfshihen në punën e seksit, komunitetet rome dhe egjiptiane, përdorueset/përdoruesit e drogave me injeksion dhe komuniteti LGBTIQ⁺. Testimi për HIV për gratë shtatzëna ofrohet në strukturat shëndetësore të kujdesit parësor (PMTCT është pjesë e paketës së kujdesit shëndetësor të shërbimit të kujdesit shëndetësor parësor), si dhe në maternitete. Numri i grave shtatzëna që testohen për virusin e imunodeficiencës njerëzore (HIV) është rritur ndjeshëm vitet e fundit. Në përputhje me protokollet, trajtimi dhe kujdesi për gratë shtatzëna që jetojnë me HIV para, gjatë dhe pas lindjes si dhe profilaksia e foshnjave është i disponueshëm dhe ofrohet falas. Gratë HIV pozitive dhe familjet e tyre marrin informacion, këshillim dhe mbështetje në lidhje me stigmën dhe diskriminimin me të cilin mund të përballen si rezultat i statusit HIV pozitiv. Instituti i Shëndetit Publik siguron në mënyrë periodike të dhënat mbi “Numrin e infeksioneve të reja të rasteve të HIV te popullata gra për 1,000 popullatë të paprekur”, që për periudhën e raportimit, për vajzat, të rejtat dhe gratë për të gjitha grup moshat) rezulton: 0.025 në 2019; 0.022 në 2020; 0.024 në 2021; 0.023 në 2022 dhe 0.024 në 2023¹⁰². Gjithashtu, parandalimi i transmetimit të HIV-it nga nëna te fëmija (PTNF) është një komponent kyç i përgjigjes kombëtare ndaj HIV-it dhe një nga objektivat specifike të Planit Kombëtar të

96. Vloja, Mati, Kruja

97. Selenicë, Vau i Dejës, Pustec, Korçë, Kavajë, Fushë-Arrëz, Devoll

98. Puka, Prrenjasi, Pogradeci, Memaliaj, Lushnje, Korça, Kamëz, Dropull, Devolli

99. P.sh. Bashkia Lezhë

100. Miratuar me VKM Nr. 210, datë 6.4.2022. Shih: <https://www.qbz.gov.al/eli/vendim/2022/04/06/210/8590c194-dc8b-4fa3-aa49-4140d87e11bb;q=strategjia%20>

101. Shih: <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2023/12/Plani-Kombetar-i-Veprimit-per-HIV-AIDS-2020-2025.pdf>

102. Tabela nr. 6 e plotë me këto të dhëna gjendet bashkëlidhur këtij raport

Veprimet për HIV/AIDS 2020-2025, për të cilin, ndërhyrjet në mbështetje përfshijnë promovimin dhe ofrimin e testimit për HIV/STI tek gratë shtatzëna nëpërmjet këshillimit të orientuar drejt institucionalitetit dhe kujdesit shëndetësor parësor. Është miratuar udhëzuesi kombëtar për depistimin e grave shtatzëna për HIV, sifiliz dhe hepatit “Udhëzues për testimin e grave shtatzëna për disa agjentë infektivë: HIV, Sifiliz, Hepatit B dhe Rubeolë”. Sipas këtij udhëzimi, grave shtatzëna u ofrohet testimi për HIV për të reduktuar rrezikun e transmetimit të virusit nga nëna tek fëmija, si dhe për të mbrojtur shëndetin e gruas. Ky dokument ofron informacion dhe udhëzime operacionale për të gjithë ofruesit e kujdesit shëndetësor të përfshirë në dhënien e kujdesit gjatë shtatzënisë. Janë rritur kapacitetet e stafeve mjekësore (256 mjeke/mjekë, infermiereve nga maternitetet, njësitë e kujdesit para linjës në gjashtë bashki¹⁰³, ndërkohë që vazhdon shtrirja e mëtejshme në bashki të tjera.

Shëndeti mendor: Ligji nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”, i ndryshuar, parashikon ofrimin e kujdesit shëndetësor për personat me çrregullime të shëndetit mendor në një mjedis më pak kufizues, kryesisht në nivel komunitar, për të shmangur sa më shumë shpërnguljet nga mjedisi familjar dhe për të lehtësuar integrimin dhe rehabilitimin social dhe krijimin e lehtësive për këta persona dhe familjet e tyre, përfshirjen në jetën sociale, si dhe ofrimin e kujdesit për personat me çrregullime të shëndetit mendor nga ekipe multidisciplinare që u përgjigjen në mënyrë komplekse nevojave mjekësore, psikologjike, sociale dhe rehabilituese. Ligji ka ndryshuar në vitin 2021¹⁰⁴ me qëllim forcimin e mbrojtjes ligjore të personave me çrregullime të shëndetit mendor në përputhje me rekomandimet e Avokatit të Popullit përmes Mekanizmit Kombëtar Kundër Torturës dhe Komitetit të Helsinkit dhe Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës e Këshillit të Evropës (CPT). Në nivel strategjik, shteti shqiptar ka zbatuar Planin e Veprimeve për Zhvillimin e Shërbimeve të Shëndetit Mendor 2013-2022¹⁰⁵ dhe Planin e Veprimeve për Shëndetin Mendor 2023-2026¹⁰⁶ të cilët përmbajnë masa e politika, të mbështetura në filozofinë e mbrojtjes së të drejtave të personave me çrregullime dhe nevoja të veçanta të shëndetit mendor, luftës kundër përjashtimit dhe diskriminimit shoqëror, fuqizimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor dhe aftësi të kufizuara mendore, ndërhyrjet me ndjeshmëri gjinore, decentralizimin e shërbimeve të shëndetit mendor dhe deinstitutionalizimin përmes reduktimit të numrit të shtretërve psikiatrik, si dhe ngritjes dhe fuqizimit të shërbimeve komunitare të shëndetit mendor. Gjithashtu, plani i ri (2023-2026), bazohet në parimet e mbulimit universal shëndetësor, të drejtave të njeriut dhe gjithëpërfshirjes, praktikës së bazuar në fakte, qasjes së integruar gjatë gjithë ciklit të jetës, qasjes social-shëndetësore dhe ndërsektoriale. *(Për një informacion më i detajuar për shëndetin mendor, lutemi referohuni në Shtojcën 2, bashkëlidhur këtij raport)*

Programi kombëtar i depistimit të kancerit të qafës së mitrës në Shqipëri bazohet në Dekretin e Këshillit të Ministrave Nr. 47 të janarit 2019, i cili përdor si ekzaminim primar testimin për Virusin Papiloma të Njeriut (HPV) me rrezik të lartë dhe synon gratë e grup moshës 40-50 vjeç. Politika synon që, brenda pesë vitesh, të gjitha gratë e kësaj grup moshe të mund të bëjnë një test për depistimin e HPV me rrezik të lartë, si pjesë e ekzaminimeve rutinë të bëra në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor (KSHP). Të gjitha testet e depistimit primar dhe ekzaminimet e mëtejshme sigurohen falas në pikën e kujdesit, pavarësisht nga fakti nëse pacientet janë të përfshirë ose jo në skemën e sigurimit shëndetësor. Numri i grave të depistuar çdo vit në kuadër të programit regjistrohet rregullisht dhe për periudhën 2019 – 2023 rezultojnë 52,080 gra¹⁰⁷ të depistuar. Në kuadër të parandalimit të Kancerit të Qafës së Mitrës në vitin 2022, MSHMS me Urdhrin me Nr.58 datë 17.10.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në kalendarin kombëtar të vaksinimit” ka shtuar vaksinën kundër HPV, 4 valente, për vajzat e lindura nga data 1 Janar 2009. Aplikimi i vaksinës së HPV është shtrirë në të gjithë vendin dhe ka pasur një rritje të vajzave të vaksinuara që prej fillimit të aplikimit. Gjithsej janë aplikuar 18,845 doza vaksinash nga nëntori i vitit 2022 deri në prill të vitit 2024.¹⁰⁸

103. Durrës, Shkodër, Fier, Korçë, Vlorë dhe Elbasan

104. Ligj 20/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 44/2012, “Për shëndetin mendor”, të ndryshuar”. Shih: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2021/02/15/2099aaf4f2-4855-4db8-a4b6-5ffae6b85502>

105. Shih: https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/Plani_i_Vperimit_per_Zhvillimin_e_Sherbimeve_te_Shendetit_Mendor_2013_-_2022.pdf

106. Miratuar me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë nr. 580, datë 8.09.2023

107. Për detaje lutemi referohuni tek tabela nr. 7 dhe grafik nr.1 në ‘Shtojcën 1’ si pjesë e këtij raporti

108. Të dhëna të detajuara mbi këto vaksinime, numrin e të vaksinuarave çdo vit dhe bashkitë përkatëse, i gjeni në tabelën

Programi i depistimit të kancerit të gjirit¹⁰⁹ i miratuar me VKM e muajit gusht 2020, rregullon aksesin në shërbimet falas për zbulimin e hershëm dhe përgjegjësitë në sistemin shëndetësor. Grupi fillestar target për depistimin me mamografi janë gratë 50-60 vjeç, për t'u zgjeruar në 50-70 vjeç. Ekzaminimi klinik i gjirit (CBE) u ofrohet grup moshave të tjera. Ftesa bëhet nga mjekët/mjekët e familjes. 13 mamografi stacionare mbulojnë të gjitha qarqet e vendit dhe 2 njësi të lëvizshme mamografie ofrojnë shërbime për zona të vështira për t'u arritur. Ndjekja është falas në pikën e kujdesit. Në Spitalin Universitar të Tiranës ka një qendër gjiri plotësisht funksionale, ndërsa 7 spitale rajonale ofrojnë trajtim kimioterapie. Programi mundëson kontrollin e vdekshmërisë nga ky kancer. Nga MSHMS në vitin 2023 është përcjellë Urdhri Nr.171, datë 24.03.2023 "Për miratimin e planit të veprimit të shëndetit seksual dhe riprodhues 2023-2030" një nga parimet bazë të këtij dokumenti është përmbushja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave.

Masa për ofrimin e shërbimeve të specializuara shëndetësore: (a) Përshtatja e standardeve të cilësisë dhe protokolleve bazë në të gjitha spitalet rajonale të vendit. (b) Përmirësimi i teknologjisë; trefishimi i gamës së testeve laboratorike që ofrohen falas në spitale dhe më shumë shërbime mjekësore emergjence, duke përfshirë 35 ambulanca të reja; (c) Krijimi i qendrave të reja urgjente hemodinamike kardiace në spitalet rajonale etj. Efekti i reformave shëndetësore të ndërmarra vitet e fundit dhe rritja e mbulimit universal të popullatës shqiptare nëpërmjet programeve dhe politikave të reja shëndetësore, në shërbime, financime, ka bërë që kjo të jetë e dukshme dhe e prekshme në rezultatet dhe treguesit shëndetësorë. Kështu, treguesi dhe tendenca e vdekshmërisë së standardizuar sipas moshës (një tregues i vdekshmërisë që shmanget efektin e plakjes së popullsisë) për disa grupe të rëndësishme sëmundjesh, ka filluar të ulet në Shqipëri. Masa janë marrë për rritjen e kapaciteteve të stafeve mjekësore¹¹⁰, aktivitete për përmirësimin e kurrikulave dhe përfshirjen në to të çështjeve të barazisë gjinore dhe sidomos të aspekteve të trajtimit të dhunës ndaj grave e dhunës në familje, janë organizuar edhe me Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, si rezultat i të cilave u mundësua përfshirja e temave mbi dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje në disa nga programet e lëndëve të studimeve të niveli Bachelor dhe Master për vitin akademik 2018-2019.¹¹¹ Synimi final është përfshirja në kurrikulën e këtij Fakulteti e një moduli të plotë mbi këtë çështje.

OSHC-të. Organizata të shoqërisë civile¹¹² ofrojnë shërbime të ndryshme që lidhen edhe me shëndetin mendor, ndërsa një rol me rëndësi luajnë dhe Agjencitë e OKB-së¹¹³ në promovimin e përfshirjes së baballarëve të rinj në kujdesin dhe rritjen e të porsalindurve; aplikacioni Bebbi ofron informacion të detajuar për nënat me fëmijë që prej lindjes së tyre; shërbimet shëndetësore specifike janë zgjeruar për gratë dhe vajzat, duke përfshirë shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues, shëndetin e nënës dhe shërbimet për HIV. Kontribute¹¹⁴ ka pasur në mbledhjen e informacionit për sjelljet e shëndetshme/të pashëndetshme dhe të rrezikshme të djemve dhe vajzave, në një mënyrë që zbuloi rreze të veçanta që lidhen me gjininë e fëmijës që është një burim informacioni në qasjet e vendit për parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve kronike dhe

bashkëlidhur këtij raporti si shtojca

109. Për detaje lutemi referohuni grafik nr.2 dhe grafiku nr.3 në 'Shtojcën 1' si pjesë e këtij raporti.

110. Një rol të rëndësishëm këtu ka luajtur mbështetja e UNFPA, me përgatitjen e modulit përkatës dhe me vijimin e trajnimeve të punonjësve(eve) të shëndetësisë. PNUD gjithashtu ka kontribuar në trajnimin e përfaqësuesve(eve) të institucioneve shëndetësore anëtarë të Mekanizmave të Koordinuar të Referimit në disa bashki të vendit. Qendra "Të Drejtat e Njeriut në Demokraci" gjithashtu ka ofruar trajnime për ngritjen e kapaciteteve të stafit të disa prej qendrave më të mëdha shëndetësore të Bashkisë së Tiranës dhe Bashkisë Kamëz në lidhje me përgjegjësitë që u ngarkon legjislacioni kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Kjo qendër, si një organizatë që monitoron prej vitesh institucionin e paraburgimit të grave/vajzave ka lobuar në mënyrë të vazhdueshme për përmirësimin e trajtimit mjekësor të tyre në ambientet e paraburgimit si dhe në spitalin e burgut.

111. Kjo iniciativë e UNFPA që zbatohet përmes organizatës partnere Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin ka filluar që në vitin 2017, duke mundësuar trajnime të stafit akademik të këtij Fakulteti me trajnerë ndërkombëtarë e kombëtarë. Po kështu janë vënë në dispozicion edhe një tërësi materiale mbështetëse dhe janë ndihmuar pedagoget(et) përgjegjës deri në përgatitjen e informacioneve specifike për temat e shtuara programet e lëndëve të tyre. Një ndër aktivitetet trajnuese me këtë fakultet ka konsistuar edhe në diskutimin e draft Paketës së Shërbimeve Bazë dhe Procedurave Standarde të Veprimit për shëndetësinë në trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, përkthyer dhe përshtatur për Shqipërinë nga UNFPA me mbështetjen edhe të UN Women.

112. Qendrës "Vatra"

113. UNICEF, UNFPA, etj.

114. UNICEF

jo të transmetueshme, sëmundjet që në ditët e sotme e kanë origjinën qysh në fëmijëri, si dhe është një aleat i fortë i Qeverisë së Shqipërisë në prokurimin e vaksinave të kontrolluara dhe cilësore për fëmijët, përfshirë ato kundër HPV. Gjithashtu, janë marrë masa për të mbështetur shëndetin mendor për vajzat dhe djemtë duke përfshirë aksesin në shërbime të specializuara dhe këshillim.

13. Çfarë veprimesh ka ndërmarrë vendi juaj për të përmirësuar arritjet arsimore dhe aftësitë për gratë dhe vajzat, përfshirë sektorët ku ato janë të nënpërfaqësuar, gjatë pesë viteve të fundit?

Masat e marra për miratimin e politikave dhe ligjit synojnë krijimin e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, bazuar në parimet e barazisë dhe mësimi gjatë gjithë jetës, rritjen e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor, mbështetur nga shërbimet e këshillimit për punësim dhe orientimit në karrierë me prirje nga të rejtat/rinjtë, rritjen dhe përmirësimin e mundësive për të hyrë në tregun e punës në bazë të shanseve të drejta dhe të barabarta për të arritur potencialin e plotë rinor, përpjekje të rëndësishme për të përmirësuar qasjen dhe të siguruar mbështetje për të rejtat/rinjtë e marginalizuara/margjinalizuar. (Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029¹¹⁵, Ligji nr. 75/2019 “Për Rininë”¹¹⁶).

Forcimi i kurrikulave arsimore për të rritur reagimin gjinor dhe eliminuar paragjykimet, në të gjitha nivelet e arsimit. Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar ndërtohet mbi parimet e mosdiskriminimit me qëllim garantimin e interesit më të mirë të nxënësve/nxënësve dhe respektimin dhe zhvillimin e plotë e të gjithanshëm të personalitetit të saj/tij, të cilat janë pjesë e të gjitha programeve shkollore, e veçanërisht, në lëndën “Qytetaria”, për klasat (1-10). Për mbështetjen e mësueseve/mësuesve në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar janë hartuar udhëzues lëndorë dhe materiale ndihmëse që përfshijnë trajtimin e çështjeve të të drejtave dhe antidiskriminimit. Janë akredituar 149 module në fushën e gjithëpërfshirjes (nga të cilat 24 trajtojnë tematikën e gjithëpërfshirjes në shkollë, barazisë shoqërore, bullizmin, braktisjen e fshehtë), për të cilat janë trajnuar mësuese/mësues, psikologe/psikologë shkollore, punonjëse/punonjës socialë, oficerë/oficerë të sigurisë në shkolla, etj., të cilat/cilët kanë përfshirë trajtimin e çështjeve që lidhen me respektimin e të drejtave të njeriut dhe mosdiskriminimin në programet e tyre.

Gjithëpërfshirja e fëmijëve dhe të rejave/rinjve romë e egjiptianë në arsim nëpërmjet reformave legjislativë, administrative e institucionale. VKM-të, udhëzimet dhe marrëveshjet në fuqi mundësojnë: a) tekste dhe transport falas për fëmijët në arsimin 9-vjeçar; b) prioritet për fëmijët romë për regjistrimin në kopsht dhe arsimin bazë dhe të mesëm me kohë të pjesshme; c) 50% ulje e tarifës së shkollimit për studimet universitare (cikli i dytë/master) për studentet/studentët romë dhe egjiptianë; d) thjeshtimin e procedurave të regjistrimit/kthimit në shkollë për fëmijët, të cilët për shkak të rrethanave të tyre, ose nuk ishin në gjendje të ndiqnin arsimin bazë për të paktën dy vite akademike, ose që kanë braktisur shkollën, janë fëmijë të rrugës ose nuk janë të regjistruar; e) lehtësimin për gratë që nuk kanë përfunduar arsimin bazë me kohë të plotë ta bëjnë këtë me kohë të pjesshme, duke i pranuar një ose dy klasa mbi atë të shënuar në dokumentin e fundit të shkollës që kanë, pas miratimit nga një komision përkatës; f) përjashtimin e studenteve/studentëve romë dhe egjiptianë nga tarifat e shkollimit për studimet universitare (cikli i parë/diploma bachelor); g) nënshkrimin e marrëveshjeve ndërministrorë për identifikimin dhe regjistrimin e të gjithë fëmijëve që i nënshtrohen arsimit të detyrueshëm, përfshirë fëmijët e rrugës; h) pajisjen e nxënësve/nxënësve romë dhe egjiptianë me tekstet shkollore falas edhe në arsimin e mesëm të lartë; i) eliminimin e qëndrimeve përjashtuese dhe të dorës së dytë ndaj fëmijëve romë dhe egjiptianë në komunitetin shkollos dhe j) ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit kulturor, ndër të tjera, të nxënësve/nxënësve dhe studenteve/studentëve romë dhe egjiptianë. Ministria e Arsimit dhe Sporteve (MAS), Ministria e Brendshme (MB) dhe MSHMS kanë bashkëpunuar për të identifikuar fëmijët

115. Shih: <https://riniafemijet.gov.al/2194-2/>

116. Shih: <https://riniafemijet.gov.al/wp-content/uploads/2022/07/Ligji-Nr.75.Date-4.11.2019-Per-Rinine.pdf>

nga grupet vulnerabël, rome/egjiptianë të moshës shkollore dhe kanë lehtësuar integrimin e tyre në kopshte e shkolla. MAS ka garantuar caktimin e punonjëseve/punonjësve të institucioneve arsimore vendore, përgjegjës për arsimin parauniversitar, në rolin e mediatores/mediatorit të grupeve vulnerabël, me qëllim ndërgjegjësimin dhe përmirësimin e aksesit të tyre në arsim dhe rritjen e frekuentimit në procesin mësimor. VKM nr. 666, datë 10.10.2019¹¹⁷, e ndryshuar ka parashikuar mbështetjen me bursa për nxënëset/nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, të cilat/cilët janë të regjistruar në arsimin bazë, por për shkak të pamundësisë financiare nuk ndjekin arsimin bazë, nxënëse/nxënës romë dhe egjiptianë, nxënëse/nxënës me një prind, nxënëse/nxënës jetim, etj.

Masa për Personat me Aftësi të Kufizuara. VKM nr.148, datë 13.03.2024¹¹⁸ ka parashikuar krijimin e institucioneve arsimore publike para universitare të arsimit special në qendra burimore (QB), si institucione që ofrojnë arsim special dhe shërbime të veçanta mbështetëse dhe rehabilituese për nxënëset/nxënësit me aftësi të kufizuara (AK), me qëllim përgatitjen dhe integrimin e tyre në shoqëri, duke nxitur rritjen e rezultateve akademike nëpërmjet përgatitjes profesionale të mësueseve/mësuesve dhe shërbimeve mbështetëse dhe rehabilituese për nxënëset/nxënësit me AK.

Forcimi i masave për të parandaluar shtatzënitë në adoleshencë dhe për t'u mundësuar vajzave adoleshente të vazhdojnë arsimimin e tyre edhe në rast të shtatzënisë dhe/ose mëmësisë. Programi për edukimin shëndetësor, me fokus “Edukimi seksual si aftësi për jetën në një mjedis të sigurt shkollor”¹¹⁹, synon të parandalojë shtatzënitë në adoleshencë dhe në modulet e përfshira në lëndët e biologjisë, edukatës shëndetësore dhe edukimit fizik janë integruar tematika të cilat trajtojnë çështje të abstinencës, të prindërimit si dhe të shtatzënieve të padëshiruara. Programet për grup moshat 10-12, 12-16 dhe 16-18 vjeç janë të detyrueshme dhe gjithsej parashikohen 140 orë mësimore, në të cilat trajtohen zhvillimi i trupit në grup moshë të caktuara, riprodhimi dhe organet riprodhuese, pjekuria seksuale, zhvillimi i fetusit gjatë shtatzënisë dhe ndikimi i drogave, sëmundjeve dhe dietës, metodat kontraceptive, aborti dhe marrëdhëniet seksuale në moshë të hershme, infeksionet seksualisht të transmetueshme (IST) më të përhapura në vendin tonë përfshirë HIV/AIDS, gonorreja, sifilizi etj. Në zbatim të programit janë realizuar një sërë veprimtarish si avokati për përfshirjen dhe zbatimin e edukimit shëndetësor me fokus në edukimin seksual, si dhe janë përgatitur materiale informuese për abuzimin seksual, si dhe për qasjen online. Po ashtu, janë identifikuar shkollat që do të shërbejnë si qendra koordinuese për vazhdimësinë e programit “Edukimi seksual si aftësi për jetën” në një mjedis të sigurt shkollor dhe krijimi i këtyre qendrave koordinuese. Një organizatë e shoqërisë civile¹²⁰ anëtare e akredituar e Federatës Ndërkombëtare të Prindërimit të Planifikuar (IPPF)¹²¹ sugjeroi që edukimi seksual të jetë pjesë e kurrikulës shkollore në mënyrë bashkëkohore dhe gjithëpërfshirëse për të trajtuar temat si martesat në moshë të re, shtatzënitë e hershme, shëndetin seksual dhe shëndetin mendor. Është e nevojshme të forcohet bashkëpunimi mes mësueseve/mësuesve, nxënëseve/nxënësve dhe prindërve për të përdorur metoda më efektive mësimi, duke përfshirë teknologjinë dhe mënyrat interaktive të mësimi.

Janë ngritur **Këshillat VENDORË TË RINISË**¹²² në 61 bashkitë, që kanë si qëllim të përfshijnë të rejtat/rinjte në aktivitete të ndryshme dhe t'i inkurajojnë ato/ata të japin kontributin e tyre në shoqëri nëpërmjet ndryshimeve pozitive dhe inovative. Në shumë raste, në përbërjen e tyre janë të reja/rinj nga zonat rurale, ku ka tendencë për të pasur më pak mundësi dhe përparësi për të rejtat/rinjte, sidomos për vajzat. Synimi i tyre është që të luftojnë stigmat dhe paragjykimet që vijnë nga shoqëria, duke inkurajuar përfshirjen e të rejave/rinjve të të dy gjinive në aktivitete dhe projekte.

117. Ndryshuar me VKM nr. 511, datë 27.07.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.666, datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensat dhe konviktet dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave nga studentët parauniversitar në institucionet arsimore publike”.

118. “Për kriteret dhe procedurat për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e institucioneve të arsimit special në qendra burimore, si dhe për mënyrën e organizimit e të funksionimit të tyre”

119. Program i ndërmarrë nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) në bashkëpunim me MAS dhe UNFPA,

120. Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin

121. Shih: <https://www.ippf.org/>

122. Përmes ndërveprimit institucional, aktivitetet e ndërgjegjësuere, shkëmbimit të praktikave të mira, të kryesuar nga Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë.

Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) gjatë periudhës 2019-2023 ka zhvilluar rreth 126 trajnime për ngritjen e kapaciteteve të punonjëseve/punonjësve të administratës publike bazuar në modulën “Barazia Gjinore dhe mosdiskriminimi”, “Buxheti i përgjigjshëm gjinor”, “Të drejtat themelore, mbrojtja nga diskriminimi, barazia gjinore”, duke trajnuar gjithsej 3157 pjesëmarrëse/pjesëmarrës.

Platforma punetembare.al ka mundësuar punësimin e studenteve/studentëve të ekscelencës në administratën publike. “Fondi i Ekselencës” i krijuar me VKM në vitin 2020¹²³ mbështet studente/studentë dhe shkencëtarë/shkencëtarë të reja/rinj që pranojnë të ndjekin një program studimi master ose doktoratë në një nga 15 Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) më të mirë të botës, sipas renditjes së Times Higher Education për vitin më të fundit. Pothuajse në të gjitha IAL-të shqiptare janë ngritur zyrtat e marrëdhënieve ndërkombëtare që në bashkëpunim me IAL-të e huaja realizojnë njohjen e lëvizshmërisë (mobilitetit) dhe diplomave të huaja të studenteve/studentëve, legalizimin e dokumenteve, transferimin e studimeve dhe marrëveshjet e ndërsjella. Zyrtat e marrëdhënieve ndërkombëtare mbulojnë zbatimin e marrëveshjeve bilaterale dhe shumëpalëshe dhe zbatimin e projekteve ndërkombëtare të cilat nëpërmjet programit Erasmus +, që prej vitit 2015, kanë bërë të mundur mobilitetin afatshkurtër në Evropë nga pjesë të tjera të botës për studente/studentë, kërkues/kërkues dhe staf.

Është kontribuar¹²⁴ në zbatimin e programeve për të rritur aksesin e vajzave në mbajtjen dhe përfundimin e arsimit fillor dhe të mesëm, si dhe në trajtimin teknik dhe profesional (AFP) dhe programeve të zhvillimit të aftësive; janë forcuar kurrikulat arsimore për të rritur reagimin gjinor dhe eliminuar paragjykimet, në të gjitha nivelet e arsimit; janë ofruar trajnime për barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut për mësueset/mësuesit dhe profesionistët/profesionistët e tjerë të arsimit; promovimi i mjediseve arsimore të sigurta, pa ngacmime dhe gjithëpërfshirëse për gratë dhe vajzat; është rritur aksesin në aftësi dhe trajnime në fusha të reja dhe në zhvillim, veçanërisht SHTIM (shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë) dhe rrjedhshmëri dhe shkrim-lexim dixhital; është siguruar aksesin në shërbimet e ujit të sigurt dhe kanalizimeve dhe lehtësimi i menaxhimit të higjienës menstruale veçanërisht në shkolla dhe mjedise të tjera arsimore/trajnimi; masa të forcuara për të parandaluar shtatzënitë e adoleshentëve dhe për t’u mundësuar vajzave adoleshente që të vazhdojnë arsimimin e tyre në rastin e shtatzënisë dhe/ose amësisë, veçanërisht ndërgjegjësimi i bazuar në komunitet për të dekurajuar martesat e fëmijëve, etj. Gjithashtu, janë ofruar klasa mbështetëse për arsimin passhkollor, shërbime transporti për sigurimin e frekuentimit të fëmijëve rom dhe egjiptianë në shkollë, aktivitete për grupet rinore për nivelin e arsimit të mesëm të lartë dhe arsimit universitar¹²⁵.

14. Çfarë veprimesh ka ndërmarrë vendi juaj për të siguruar që rimëkëmbja ekonomike nga pandemia COVID-19 të mbyllë hendeqet gjinore në varfëri, punësim, mbrojtje sociale, arsimim dhe/ose shëndetësi, të përkeqësuar nga pandemia?

Qeveria u kushtoi vëmendje të veçantë të drejtave të grave dhe barazisë gjinore gjatë pandemisë COVID-19 dhe në përpjekjet për rimëkëmbje. Gratë u përfshinë në të gjitha vendimmarrjet në nivelin qendror (MSHMS dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë – aktualisht Ministria e Financave, dy ministritë kryesore në përcaktimin e politikave për përgjigjen ndaj COVID-19, drejtoreshin nga gra), si dhe në nivelin vendor (si Prefekte, Kryetare Qarku, anëtare të Këshillave Bashkiakë, apo Kryetare të bashkive). Të dhënat mbi rastet e infektuara dhe ndjekjen e tyre janë mbajtur të ndara sipas gjinisë, grup moshave, vendbanimit, etj. Me përjashtim të javës së dytë të marsit dhe muajit maj 2020, Instituti i Shëndetit Publik vijoi shërbimet e depistimit për kancerin e gjirit dhe të qafës së mitrës për gratë, duke respektuar protokollet anti-covid. Gjithashtu, vijuan aktivitetet ndërgjegjëse për kancerin e gjirit (tetori rozë) dhe aktivitetet e parashikuara në rrethet mbi përmirësimin e

123. VKM nr. 160 datë 19.02.2020 “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)”. Shih: <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/02/VKM-nr-160-dt-19.02.2020.pdf>

124. UNICEF dhe Nisma Arsis

125. Nisma Arsis

ndjekjes me kolposkopi të grave pozitive në depistimin e kancerit të qafës së mitrës. Punonjëset e institucioneve të përkujdesit rezidencial për të moshuarat/moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe fëmijët, të cilat u vetëkarantinuan për shkak të COVID-19, u trajtuan me pagë shtesë.¹²⁶ MSHMS, disbursoi nga Fondi Social në prill 2020 fonde për 14 bashki fituese në vlerën 61 milion lekë. Një projekt ofronte shërbime emergjente kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Për vitin 2021 nga Fondi Social u financuan shërbimet për viktimat/të mbijetuarat e dhunës në familje, në katër bashki, në vlerën 11,258,165 lekë (u trajtuan 125 raste dhe u ofruan shërbime parandaluese dhe këshillim i vazhdueshëm i grupeve në risk). Më shtetja vijoi edhe për vitin 2022 në masën 7,126,725 lekë. MSHMS mbështeti shërbimet multifunkionale në tre bashki për vitin 2021, në masën 11,035,627 lekë (u trajtuan 158 raste të grave/vajzave në nevojë për mbështetje dhe fuqizim në situatë risku). Për vitin 2022 janë mbështetur katër shërbime multifunkionale dhe hapja e një shërbimi të ri multifunksional në dy bashki të tjera, në masën 16,179,731 lekë. MSHMS mbështet financiarisht tre shërbime të specializuara të antitrafikimit, në tre qarqe të mëdha të vendit, në masën 29,0879,324 lekë (për vitin 2021 u trajtuan 254 gra/vajza, si dhe fëmijët e tyre, sipas rastit).

Masa e ndihmës ekonomike për viktimat/të mbijetuarat e dhunës në familje të pajisura me urdhër mbrojtjeje deri në fund të dhjetorit 2021 ishte 3000 lekë/muaj. 694 viktima/të mbijetuara përfituan këtë pagesë për vitin 2021. Duke filluar nga janari 2022 pagesa është trefishuar në vlerën 9000 lekë/muaj.¹²⁷ 835 viktima/të mbijetuara të dhunës në familje të pajisura me urdhër mbrojtjeje, përfituan këtë pagesë për periudhën janar-mars 2022. U aplikua pagesë e dyfishtë e ndihmës ekonomike për 482 viktima/të mbijetuara të dhunës në familje, me urdhër mbrojtjeje dhe për 63,508 familje përfituese të ndihmës ekonomike, përfshirë 6000 gra kryefamiljare.¹²⁸ 4,524 familje që nuk përfitonin nga skema e ndihmës ekonomike u mbështetën me ndihmë financiare prej 16,000 lekësh.¹²⁹ U trajtuan me pako ushqimore, veshje, barna të rimbursueshme, ndihmë financiare, si dhe me dërgimin në banesë të pagesave të ndihmës ekonomike dhe për personat me aftësi të kufizuara, 233,248 familje.¹³⁰ U shpërndanë paketa ushqimore edhe për 17,381 fëmijë dhe 8,784 familje, pako higjieno-sanitare për 15,440 fëmijë dhe 8,120 familje si dhe u ndihmuan me para cash 524 familje.¹³¹

Gjatë pandemisë, u morën masa të menjëhershme për të siguruar vazhdimësinë e shërbimeve mbështetëse të specializuara për gratë, fëmijët dhe anëtarët/anëtarët e familjes në rrezik ose viktima/të mbijetuara të dhunës. U miratuan protokolle/udhëzime/rregullore të: funksionimit të shërbimeve të strehimit; menaxhimit të rasteve të dhunës në familje; fëmijëve të abuzuar; funksionimit të qendrës së trajtimit të sulmeve seksuale, shërbimeve rezidenciale për të moshuarat/moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, etj. U vlerësuan për nevojat emergjente 19 shërbime të specializuara strehimi të rasteve të dhunës në familje dhe trafikimit të qenieve njerëzore dhe u furnizuan me mjete dezinfektimi e informacion sipas nevojës. Staf i këtyre shërbimeve u trajnua dhe mentorua vazhdimisht, paralelisht me koordinatoret/koordinatorët vendorë të 61 Mekanizmave të Koordinuar të Referimit (MKR) në vend. 246 anëtarë/anëtarë të 18 MKR-ve që u përballën më shumë me menaxhim të rasteve gjatë periudhës së kufizimeve për shkak të pandemisë, u mbështetën me informacion dhe mentorim të vazhdueshëm.

U trajnuan online nga MSHMS në bashkëpunim me OBSH dhe UNICEF, 1800 profesioniste/profesionistë mbi shëndetin mendor dhe mbështetjen psiko-sociale në situatë emergjente.

U aplikuan shërbimet online nëpërmjet: Linjës së gjelbër 0884040 në faqen e MSHMS; Platformës; Linjës Kombëtare të Këshillimit për gra e vajza 116117, Linjës Kombëtare të Këshillimit për fëmijë ALO 116111; Psikologëve etj. U ofrua ndihmë juridike parësore nëpërmjet platformës dhe nëpërmjet numrit të gjelbër

126. VKM Nr.371/2020

127. VKM Nr.898/2021

128. VKM Nr.254/2020

129. VKM Nr.314/2020

130. Npërmjet bashkëpunimit midis pushtetit qendror dhe vendor, OSHC-ve dhe organizatave ndërkombëtare

131. Grupi i emergjencës i ngritur nga MSHMS në bashkëpunim me UNICEF dhe disa organizata të shoqërisë civile (Terre des Homes, Nisma Arsis, Save the Children, World Vision, Alo 116 111, Santa di Frontiera, etj),

pa pagesë 08001010. Një spot informues për të denoncuar rastet e dhunës në familje, me numrat ku mund të telefonohej pa pagesë (shoqëruar edhe me gjuhën e shenjave), u postua në faqen e internetit të MSHMS:

Policia e Shtetit mori masa të veçanta¹³² për: rritjen e vëmendjes dhe vlerësimin maksimal të çdo telefonate/njoftimi për dhunë në familje; bashkëpunimin dhe koordinimin e menjëhershëm me strukturat përkatëse në Bashki, për referimin rasteve; shtimin e vëmendjes nga shërbimet e policisë në terren për të marrë menjëherë në mbrojtje viktimën e dhunës në familje që thyen rregullat e kufizimit të lëvizjes për shkak të dhunës së ushtruar dhe njoftimin e strukturave përkatëse të policisë që trajtojnë rastet e dhunës në familje; përcaktimin me kujdes në përshtatje me situatën e viktimës, të masave të mbrojtjes që plotësohen në kërkesë-padinë drejtuar gjykatës, etj.

Drejtoria e përgjithshme e Përmbarrimit, gjatë pandemisë COVID-19 vijoi ekzekutimin e titujve ekzekutivë me objekt kujdesin, detyrimet dhe respektimin e të drejtave të të miturave/miturve, kujdestarinë, birësimin, ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, përkujdesjen dhe detyrimet për ushqim; urdhrat e mbrojtjes dhe urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes; ndërmjetësimin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në fushën penale, kur gjatë hetimit vlerësohet si e nevojshme për mbrojtjen e interesave të të miturës/miturit, etj.

Në Urdhrin¹³³ e Departamentit të Administratës Publike u formuluan masa me të drejta dhe detyrime të barabarta për punonjëset/punonjësit e të dy gjinive, në punësim dhe prindërim. U parashikua: a) përcaktimi i orarit të punës i ndryshuar në varësi të orarit që fëmija do frekuentonte mësimin, por duke siguruar që kohëzgjatja maksimale të mos ndryshonte; b) nëse të dy prindërit/kujdestarët ligjorë të fëmijës, ishin punësuar në institucionet e administratës publike, duhet të siguronin që përgjegjësinë për shoqërimin e fëmijëve sipas orareve të ndryshme të mësimin, të mos e kishte vetëm njëri prej tyre; c) prindërit/kujdestarët ligjorë të fëmijëve që frekuentonin arsimin parashkollor dhe arsimin bazë duhet të vinin në dispozicion të njësisë së burimeve njerëzore të institucionit ku punonin orarin e shkollës së fëmijëve dhe vërtetimin që prindi/kujdestari tjetër ligjor nuk po përfitonte në të njëjtën kohë, nga masat lehtësuese.

U falën kamatë vonesat e energjisë elektrike për të gjitha familjet rome dhe egjiptiane. Shpenzimet e qerasë për 385 familje që përfitonin strehim social, gjatë periudhës mars-prill 2020, u mbuluan nga Bashkia Tiranë. U ofrua mbështetje për Shoqatën Kombëtare Shqiptare të të Shurdhërve për dhënien e informacionit mbi COVID-19 në gjuhën e shenjave për komunitetin me dëmtim të dëgjimit, si dhe për funksionimin e një linjë telefonike 24-orëshe për informacione/shërbime referimi për këtë komunitet. Deklaratat ditore për shtyp nga MSHMS shoqëroheshin me interpretim në gjuhën e shenjave.

132. Letër Porosi Nr.2192/2020

133. Nr.80/2020

3.3 LIRIA NGA DHUNA, STIGMA DHE STEREOTIPAT

FUSHAT KRITIKE TË TRAJTUARA

D. Dhuna ndaj grave

I. Të drejtat e njeriut të grave

J. Gratë dhe media

L. Fëmija vajzë

15. Cilat forma të dhunës me bazë gjinore dhe në cilat kontekste dhe ambiente specifike kanë qenë prioritare për vendin tuaj gjatë pesë viteve të fundit?

Shteti Shqiptar ka marrë masa me rëndësi për të garantuar mbrojtje për forma të ndryshme të dhunës me bazë gjinore, duke zbatuar edhe rekomandimet e mekanizmave ndërkombëtare si GREVIO (Grupi i eksperteve/ekspertëve për veprim kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje) dhe CEDAW. Ndryshimet ligjore¹³⁴ kanë ardhur si pasojë jo vetëm e detyrimeve që shteti ka marrë përsipër në kuadër të konventave, por edhe si një nevojë e domosdoshme për të garantuar mbrojtje efektive për viktimat e formave të ndryshme të dhunës me bazë gjinore. Megjithatë, pavarësisht ndryshimeve pozitive në aspektin ligjor, por edhe të politikave, apo shërbimeve mbështetëse të specializuara, si dhe informimit për njohjen sa më të mirë të këtyre formave të dhunës e mbrojtjes që ofrohet, duhet pranuar që ende disa forma të dhunës me bazë gjinore nuk denoncohen sa duhet, apo nuk trajtohen si duhet në aspektin praktik.

Dhuna në familje e ushtruar nga pjesëtarë të tjerë të familjes. Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, është akti kryesor që synon të parandalojë dhe zvogëlojë dhunën në familje në të gjitha format e saj, si dhe të sigurojë më shumë mbrojtje për viktimat. Përveç ndryshimeve të rëndësishme që ky ligj pësoi në vitin 2018¹³⁵ të cilat janë prezantuar në raportin e mëparshëm (Pekin+25), është ndryshuar sërish edhe në vitin 2020¹³⁶. Prezantimi i qasjes gjinore në ligj dhe vendosja e theksit të garantitë e veçanta të mbrojtjes ndaj grave e vajzave si viktimat të dhunës, së bashku me fëmijët dhe të moshuarat/moshuarit; mbrojtja e veçantë për personat me aftësi të kufizuara në harmoni me konceptin e përshtatjes së arsyeshme (neni 1, paragrafi 1, neni 6 dhe dispozita të tjera në ligj); zgjerimi i rrethit të subjekteve që përfshihen në kategorinë e pjesëtareve/pjesëtarëve të familjes duke parashikuar mbrojtje të posaçme edhe për **personat që janë në lidhje afektive (intime)**, pavarësisht nëse kanë pasur një lidhje formale si martesë ose bashkëjetesë (neni 7); sigurimi i mbrojtjes edhe për rastet e dhunës në familje ndaj migranteve/migrantëve, azilkërkuesve/azilkërkuesve, personave pa shtetësi dhe të huajave/huajve në përgjithësi që ndodhen në territorin e Shqipërisë (neni 4); masa e urdhërimit menjëherë nga Gjykata të largimit të dhunuesit nga banesa për një afat kohor të caktuar, kur viktimat dhe dhunuesi banojnë në të njëjtën strehë (neni 10, pika 1); etj., janë garanci për një mbrojtje më të mirë të të gjitha grave/të rejave/vajzave nga

134. Informacion më i detajuar gjendet në shtojcën nr. 3 të këtij studimi

135. Me Ligjin 47/2018, duke përmbyllur rekomandimet kyçe të Vëzhgimeve Përfundimtare të Komitetit CEDAW (2016) dhe Raportit Fillestar Vlerësues të GREVIO (2017) për Shqipërinë. Ndryshimi i disa nga përkufizimeve në lidhje me dhunën në familje, për ta harmonizuar me nenin 3 të Konventës së Stambollit dhe referenca specifike në Kushtetutën e Shqipërisë, Konventën CEDAW dhe Konventën e Stambollit si baza të këtij ligji (neni 3), të cilat i bëjnë këto konventa drejtpërdrejtë të zbatueshme duke parashikuar të gjitha format e dhunës me bazë gjinore që garantohen në to.

136. Me Ligjin 125/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar”. Shih: <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/07/Ligj-Nr.125-2020-Shtesa-dhe-ndryshime-te-LDHF-6996-2016.pdf>

dhuna në familje. Disa nga ndryshimet e vitit 2020, u hartuan edhe për t'ju përgjigjur nevojës për adresimin e dhunës në familje në situata emergjencash civile, nisur nga kriza e pandemisë së COVID 19. Në zbatim të ndryshimeve ligjore janë miratuar edhe një sërë aktesh nënligjore në përputhje me Konventën e Stambollit dhe rekomandimet e GREVIOs, ku rëndësi të veçantë ka VKM e re (327/2021)¹³⁷ në bazë të të cilit funksionon Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (MKR) në nivelin vendor, si mjet i zbatimit të qasjes shumë-sektoriale të koordinuar të trajtimit të rasteve të dhunës në familje.¹³⁸ Përveç qartësimit të mëtejshëm të roleve dhe përgjegjësi të institucioneve dhe profesionistëve/profesionistëve për menaxhimin me efektivitet të rasteve të dhunës në familje, ky vendim krijon hapësira që aspekte të menaxhimit të rastit nga MKR të zbatohen, edhe në rastet e formave tjera të dhunës me bazë gjinore ndaj grave. Me ndryshimet që iu bënë Kodit Penal në vitin 2020¹³⁹, kriminalizohet për here të parë dhuna psikologjike në marrëdhëniet familjare, parashikohet përfshirja në këto marrëdhënie e personave në lidhje ose ish-lidhje intime me autorin e veprës penale (duke harmonizuar kështu përmbajtjen e nenit 130/a të Kodit Penal me nenin 3 të Konventës së Stambollit), si dhe ashpërsohen dënimet për disa figura të kësaj vepre penale.¹⁴⁰

Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerrë udhëzimin e përgjithshëm nr. 17/2020 “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave, dhunës në familje, dhe dhunës me bazë urrejtje”, që synon unifikimin e masave procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në mënyrë që hetimet dhe ndjekja penale për këto vepra të jenë në afate të shpejta, eficiente, dhe me kërkesa për masa dënimi efektive, proporcionale e frenuese. Gjithashtu, Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerrë dhe udhëzimin e përgjithshëm nr. 8, datë 15.11.2021 “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale me të mitur në konflikt me ligjin, viktimë dhe/ose dëshmitar” me synim rritjen e efikasitetit, efektivitetit dhe reduktimin e afateve, në hetimin dhe ndjekjen penale të çështjeve me/dhe ndaj të miturve/miturave, në konflikt me ligjin, viktimë/viktima dhe/ose dëshmitar/dëshmitare. Udhëzimi udhëhiqet nga parimet e një drejtësie penale sa më miqësore, bazuar në interesin më të lartë të të miturit/miturës si dhe garantimin e të drejtave të tyre, në mënyrë që të kontribuohet në uljen e kriminalitetit kundrejt të miturit/miturës, në rehabilitimin, riintegrimin e tyre. Ky udhëzim ka unifikuar dhe disa procedura e akte procedurale penale në çështjet me të mitur/mitura, në përputhje me praktikat më të mira dhe standardet ndërkombëtare në drejtësinë penale për të mitur/mitura.

137. VKM nr. 327, datë 02.06.2021 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimit e viktimave të dhunës, i cili ka shfuqizuar, VKM-në nr. 334/17.2.2011, Mekanizmi Kombëtar për bashkërendimin e punës për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe të rregullave mbi mënyrën e procedimit të tij. Shih: <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/07/VKM-Nr.-327-dat%C3%AB-2.06-00000002.pdf>

138. I cili ka shfuqizuar, VKM-në nr. 334/17.2.2011, Mekanizmi Kombëtar për bashkërendimin e punës për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe të rregullave mbi mënyrën e procedimit të tij. Shih: <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/07/VKM-Nr.-327-dat%C3%AB-2.06-00000002.pdf>

139. **Ligji nr. 35, datë 16.04.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”**. Shih: https://portavendore.al/wp-content/uploads/2020/04/Ligj-nr.-35-2020-P%C3%ABr-ndryshimet-n%C3%AB-Kodin-Penal_compressed.pdf

140. Shih nenin 130/a “Dhuna në familje” i Kodit Penal, i ndryshuar me nenin 1 të ligjit nr. 35/2020, i cili (neni 130/a) parashikon: “Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune fizike, **psikologjike**, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave), ose krushqi e afërt (vjehtë, vjehër, dhëndër, nuse, kunat/ë, thjeshtri, thjeshtra, njerku e njerka), ose **në lidhje apo ish-lidhje intime me autorin e veprës penale**, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim deri në tre vjet. Kanasja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave), ose krushqi e afërt (vjehtë, vjehër, dhëndër, nuse, kunat/ë, thjeshtri, thjeshtra, njerku e njerka), ose **në lidhje apo ish-lidhje intime me autorin e veprës penale**, me pasojë cenimin e integritetit psikik të tij, dënohet me burgim deri në katër vjet. Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave), ose krushqi e afërt (vjehtë, vjehër, dhëndër, nuse, kunat/ë, thjeshtri, thjeshtra, njerku e njerka), ose **në lidhje apo ish-lidhje intime me autorin e veprës penale**, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim deri në pesë vjet. Po këto vepra, të kryera në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve, dënohen nga një deri në pesë vjet burgim.”

Dhuna nga partneri intim, përfshirë dhunën seksuale dhe përdhunimin martesor, gëzon mbrojtje në legjislacionin civil dhe penal, pasi partneri intim konsiderohet si pjesëtar/pjesëtare i/e familjes (dhunë në familje), por edhe në legjislacionin penal (neni 130/a, Dhuna në familje) është përfshirë partneri intim si subjekt penal. Gjithashtu Ligji për Dhunën në Familje (LDHF) i ndryshuar, parashikon mbrojtje në procesin civil edhe për dhunën seksuale nëse ajo ushtrohet nga pjesëtarët e familjes. Dhuna seksuale (Neni 107/a, Kodi Penal) dhe përdhunimi martesor (Neni 102, Kodi Penal marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura, garantohet mbrojtje midis bashkëshortëve apo bashkëjetuesve) janë vepra penale të parashikuara në Kodin Penal. Megjithatë, dhuna seksuale nga partneri intim dhe përdhunimi martesor ende mbeten forma të dhunës më pak të denoncuar, për shkak të mentalitetit dhe stigmës që i shoqëron ato. Komiteti CEDAW në vërejtjet përmbyllëse për shtetin shqiptar në tetor 2023¹⁴¹, vëren me shqetësim se përkufizimi i përdhunimit në Kodin Penal ende bazohet në përdorimin e forcës ose të kërcënimit nga autori i dhunës dhe jo në mungesën e pëlqimit. OJF-të¹⁴² luajnë një rol me rëndësi në analizat ligjore që realizojnë dhe rekomandimet për ndryshime ligjore, konkretisht sugjerojnë: *Të ndryshojë përkufizimi i përdhunimit të grave të rritura në mënyrë që ky përkufizim të bazohet në mungesën e pëlqimit të dhënë lirisht dhe që nuk kërkon demonstrim e përdorimit të forcës apo rezistencës; (Ndryshimi i nenit 102 KP). Të ndryshojnë përkufizimi i përdhunimit me të mitura/mitur të moshës 14 - 18 vjeç në mënyrë që ky përkufizim të bazohet në mungesën e pëlqimit të dhënë lirisht dhe të mos kërkojë demonstrimin e përdorimit të forcës apo rezistencës. (neni 101 KP) Të parashikohet vepra penale sjellja seksuale pa pëlqimin e personit, sikurse e përshkruan Neni 36, pika 1, shkronjat b e Konventës së Stambollit: përfshirja me një person pa pëlqimin e tij/saj në akte të tjera të një natyre seksuale (përveç penetrimit); Të parashikohet si veprë penale nxitja që një person tjetër të përfshihet me një person të tretë në akte të një natyre seksuale pa pëlqimin e tij/saj; Të rishikohet neni 102.a i Kodit penal dhe në përgjithësi të gjitha nenet që parashikojnë krimet seksuale me qëllim që të shmangen parashikimet dhe gjuha diskriminuese për shkak të orientimit seksual. Në Planin e Veprimit të Shëndetit Seksual dhe Riprodhues 2022-2030 është parashikuar si objektiv parandalimi i dhunës nga partneri intim, si dhe ofrimi i mbështetjes dhe ndihmës së nevojshme për viktimat dhe për dhunuesit.*

Ngacmimi dhe dhuna seksuale në vende publike, mjedise arsimore dhe vende pune. Në lidhje me “Ngacmimin seksual”, është shtuar në vitin 2020 në ligjin Nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar¹⁴³ koncepti i “Shqetësimit seksual”, si një formë diskriminimi që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, verbale ose joverbale, e natyrës seksuale, e cila ka për qëllim ose efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për të (përqasur edhe me parashikimin e Konventës së Stambollit). Dhuna, ngacmimi, përfshirë ngacmimin seksual, janë dukuri të pranishme në mjedisin e marrëdhënieve të punës në Shqipëri. Krahas, Konventës së Stambollit, që rregullon format kryesore të dhunës ndaj grave, Shqipëria ka ratifikuar edhe Konventën No.190 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP) mbi Dhunën dhe Ngacmimin në Botën e Punës - të dy këto instrumente me rëndësi të cilat vendosin detyrime për përmirësime ligjore në fushën e dhunës me bazë gjinore në Shqipëri. Sipas Konventës Nr.190 të ONP-së, me qëllim zbatimin e përqasjes gjithëpërfshirëse, të integruar dhe të përgjegjshme gjinore, Shqipëria duhet të adresojnë dhunën dhe ngacmimin në botën e punës si dhe sigurinë dhe shëndetin në punë në legjislacionin për barazinë dhe mos-diskriminimin, si dhe në të drejtën penale, sipas rastit. Gjithashtu, në bazë të Konventës së Stambollit, Shqipëria duhet të marrë masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që çdo formë sjelljeje e padëshiruar verbale, joverbale ose fizike e një natyre seksuale, me qëllimin ose efektin e shkeljes së dinjitetit të një personi, veçanërisht kur krijohet një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues, t’i nënshtrohet një sanksioni penal ose sanksioni tjetër ligjor. Kodi Penal shqiptar, megjithëse nuk adreson në mënyrë specifike dhunën

141. <https://documents.un.org/doc/undoc/gen/n23/352/80/pdf/n2335280.pdf?token=xDUwUo8sR7leWbMMfE&fe=true>

142. Studimi u hartua në kuadër të një projekti “Përmirësimi i legjislacionit shqiptar në fushën e barazisë gjinore”, të zbatuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare me mbështetjen e Zyrës së UN Women dhe Zyrës së Përfaqësuesit të OKB-së në Shqipëri. Shih: https://www.qag-al.org/publikime/legal_review_report.pdf

143. Ndryshuar me Ligjin nr. 124/2020, datë 15.10.2020. Shih: <https://qgz.gov.al/eli/fz/2020/191/4a6fb792-6c8d-4637-ba0f-fa0ece007562>

dhe ngacmimin në fushën e marrëdhënieve të punës, ka miratuar dispozita për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut, të drejtave dhe lirive të njeriut për çdo person duke konsideruar gjithashtu mbrojtjen nga dhuna dhe ngacmimi edhe në këto marrëdhënie. Por, disa prej këtyre dispozitave dhe konkretisht Neni 108/a “Ngacmimi seksual” dhe Neni 121/a “Përndjekja” duhet të plotësohen duke specifikuar edhe dhunën dhe ngacmimin në botën e punës, duke nënvizuar veprimet brenda veprave penale të ngacmimit seksual dhe përndjekjes që kryhen në vendin e punës ose në lidhje me punën, si dhe pasojat që çojnë në çrregullime dhe sëmundje psikologjike, psikosomatike, fizike ose me ulje të produktivitetit të punës së të dëmtuarit/të dëmtuarës si pasojë e ngacmimit. Gjithashtu, është e rëndësishme të diskutohet nëse është e nevojshme që veprat të parashikojë rastet e abuzimit me autoritetin kur viktimat janë të vulnerabël për shkak të moshës, sëmundjes, aftësisë së kufizuar fizike ose mendore, shtatzënisë, ose është viktimë e dhunës në familje.

Dhuna ndaj grave dhe vajzave e lehtësuar nga teknologjia. Siç u cek edhe më sipër, ngacmimi seksual (Neni 108/a Kodi Penal), por edhe përndjekja (Neni 121/a Kodi Penal), ndërhyrje të padrejta në jetën private (Neni 121, Kodi Penal), pengimi ose shkelja e fshehtësisë së korrespondencës (Neni 123, Kodi Penal), janë forma të dhunës që gëzojnë mbrojtje nga legjislacioni penal por nuk kanë të përshtatur komponentin digjital. Për këtë arsye, Aleanca e Grave Deputete¹⁴⁴ ka marrë nismën për adresimin dhe garantimin e mbrojtjes së viktimave të dhunës kibernetike/digjitale nëpërmjet propozimeve për të ndryshuar legjislacionin apo veprimeve të tjera të nevojshme. Në këtë kuadër, janë organizuar një sërë aktivitete me aktorë të ndryshëm si ministrinë e linjës, Këshillin e Lartë Gjyqësor, Prokurorin e Përgjithshëm, gjyqtare/gjyqtarë dhe prokurorë/prokurorë, deputete, gazetarë/gazetarë, përfaqësues/përfaqësues të shoqërisë civile, partnerë ndërkombëtarë, etj. Një studim po realizohet me qëllim analizën e legjislacionit shqiptar dhe standardeve ndërkombëtare për të dhënë sugjerime konkrete si në aspektin legjislativ por edhe masa të tjera që duhet të merren nga institucionet përgjegjëse. Komiteti CEDAW në vërejtjet përmbyllëse të shtetit Shqiptar (tetor 2023)¹⁴⁵, vëren me shqetësim se dhuna kibernetike dhe femicidi nuk janë përkufizuar si vepra penale specifike. Gjithashtu, sugjerime të njëjta ka dhënë dhe organizata¹⁴⁶ që punojnë me viktimat e dhunës me bazë gjinore, pra që Kodi Penal ka nevojë të ndryshohet dhe të ndëshkojë format e reja të dhunës me të cilat po përballen gratë dhe vajzat, siç është bullizimi kibernetik me anë të ngacmimeve të vazhdueshme në rrjete sociale, kërcënimet, publikimi i imazheve të jetës personale, publikimi i një imazhi intim të manipuluar etj. Kjo mungesë e neneve specifike në Kod ka sjellë pamundësinë e organeve ligj zbatuese të nisin procedimet për autorët, që kanë kryer veprime të tilla, duke lenë një terren të lirë për dhunuesit.

Femicidi/Femicidi/vrasjet me bazë gjinore të grave dhe vajzave, e përkufizuar si vrasje me dashje për shkak të gjinisë, mund të nxitet nga rolet gjinore të stereotipizuara, diskriminimi ndaj grave dhe vajzave, marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit ndërmjet grave dhe burrave ose dhe nga normat shoqërore të dëmshme. Gjatë 13 viteve të fundit, 159 gra dhe vajza janë vrarë nga burrat në Shqipëri, kryesisht nga anëtarë të familjes. Në ndër nismat¹⁴⁷ më të fundit (8 Mars 2024), është ngritja pranë **Avokatit të Popullit** e ‘Observatorit të Femicidit’, që synon të mbledhë dhe analizojë të dhëna, me qëllim përmirësimin e politikave dhe mekanizmave për parandalimin e vrasjes të grave dhe vajzave. ‘Observatori i Femicidit’ do të bashkëpunojë me aktorët e përfshirë, që luajnë rol në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave rreth femicidit në Shqipëri. Të dhënat do të mblidhen dhe analizohen në përputhje me kuadrin statistikor të miratuar nga Kombet e Bashkuara. Kontribut në lidhje me këtë formë dhune ka dhënë edhe shoqëria civile¹⁴⁸, nëpërmjet studimit të këtij fenomeni si nga këndvështrimi legjislativ, i standardeve ndërkombëtare por edhe duke analizuar vendimet gjyqësore për vrasjet e grave.

144. Me mbështetjen e UN Women, Programit i Përbashkët i Kombeve të Bashkuara “T’i japim fund dhunës ndaj Grave”, i financuar nga Qeveria e Suedisë

145. <https://documents.un.org/doc/undoc/gen/n23/352/80/pdf/n2335280.pdf?token=xDUwUo8sR7leWbMMfE&fe=true>

146. Forumi i Gruas Elbasan

147. Kjo nismë është ndërmarrë në bashkëpunim me UN Women, si pjesë e Programit të Përbashkët të OKB-së “Fund dhunës ndaj grave në Shqipëri”, financuar nga Qeveria e Suedisë.

148. Vrasjet e Grave (Femicidi) dhe tentativa për femicid në Shqipëri (2017-2020), Qendra për Nisma Ligjore Qytetare dhe Femplaz, me mbështetjen e UN Women në kuadër të programit rajonal EVAW në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, 2023 Informacion i marrë nga studimi faqe 38 <https://www.qag-al.org/publikime/femicidi.pdf>

Dhuna me bazë gjinore ndaj grave në politikë, përfshirë mbrojtëset e të drejtave të njeriut të grave, nuk ka gjetur një mbrojtje adekuate si në legjislacion apo në pjesën e shërbimeve që ofrohen. Nisma janë marrë nga KQZ (sqsuar në përgjigjen për pyetjen nr. 22 në faqen 58 të këtij raporti) për të adresuar këtë formë dhune, si dhe është realizuar një studim 2021 “Dhuna ndaj grave gjatë zgjedhjeve dhe paragjykimet gjinore në mbulimin mediatik të zgjedhjeve të përgjithshme të Prillit 2021 në Shqipëri”¹⁴⁹ ku ndër të tjera evidentohet edhe mënyra se si gratë në politikë prezantohen nga media dhe roli që kjo e fundit mund dhe duhet të luajë në këtë drejtim (për më shumë referohuni te përgjigja e pyetjes 23 faqe 63 në këtë raport).

Dhuna me bazë gjinore në media, përbën një tjetër formë të dhunës që ka marrë përmasa sidomos këto vitet e fundit veçanërisht përmes mediave sociale. Ndryshimi që ka pësuar ligji i Mediave Audio Vizive, puna e institucionit të Avokatit të Popullit, institucioneve të tjera të pavarura e shoqërisë civile, (siç sqarohen edhe në pjesë të tjera të këtij raporti, sidomos në përgjigjen e pyetjes 23, fq.63) janë disa nga përpjekjet që po bëhen për adresimin në mënyrën e duhur të kësaj forme dhune.

Martësat e fëmijëve, të hershme dhe të detyruara. është një çështje e eksploruar pak, që prek vajza nga grupe të ndryshme shoqërore; nxitet kryesisht nga pabarazia gjinore, varfëria e përjashtimi social dhe ka një sërë efektësh të dëmshme. Në Kodin e Familjes (KF), mosha për të lidhur martesë është 18 vjeç. Ligji parashikon përjashtime për martesë nën moshën ligjore (18 vjeç), të cilat mund të autorizohen vetëm nga gjykata (Neni 7 KF). Vihet re mungesa e një dispozite që përcakton moshën minimale nën të cilën ‘gjykata’ nuk lejohet të japë këtë autorizim-leje si përjashtim nga mosha ligjore për t’u martuar dhe kjo është evidentuar edhe nga GREVIO si problematike për Shqipërinë në raportin e tij vlerësues në vitin 2017¹⁵⁰. Sipas INSTAT, numri i vajzave të martuara para moshës 18 vjeç gjatë vitit 2022 ishte 15 (krahasuar me 19 në vitin 2021). Përqindja e vajzave të martuara në moshat 15 deri 17 vjeç është shumë e ulët, ndërsa shënon vlerat më të larta në moshën 18 dhe 19 vjeç, përkatësisht 6,1 % dhe 4,7 %. Ndërsa djemtë nuk kanë martesë para moshës 18 vjeç dhe përqindja e djemve të martuar në moshën 18-19 vjeç është nën 1%.¹⁵¹ Komiteti CEDAW në vërejtjet përmblylëse për Shqipërinë, rekomandon “*Rishikimin e Kodit Civil për të hequr të gjitha përjashtimet ligjore për moshën minimale e martesës 18 vjeç, për vajzat dhe djemtë, si dhe të vazhdohen përpjekjet për të luftuar martesën e fëmijëve dhe të detyruar, duke përfshirë adresimin e shkaqeve kryesore të kësaj praktikë e dëmshme...*”¹⁵² Më tej për të mbështetur vajzat në rrezik dhe për të parandaluar martesat e hershme të fëmijëve parashikohen edhe në SKBGJ 2021-2030 (në Objektivin Specifik III.1, masat III.1.2, II.5.2.f, etj.). Rekomandime për ndryshime ligjore janë dhënë edhe nga OJF¹⁵³ në lidhje me: saktësimet ligjore për një moshë minimum, nën të cilën nuk mund të lejohet lidhja e martesës as me vendim gjykatë; saktësimin e legjitimitetit aktiv në procedimet lidhur me martesën nën moshë - saktësimin e formës së kërimit në gjykatë për çështjet me objekt ‘lejimi lidhje martese nën moshë’, etj. *Progres Raporti për Shqipërinë 2023*¹⁵⁴ ka identifikuar se vazhdimi i martesës së fëmijëve, i nxitur nga pabarazia gjinore, varfëria dhe përjashtimi social, mbetet një çështje shqetësuese. Mungesa e të dhënave zyrtare e bën të pamundur që të ketë një analizë të saktë të këtij fenomeni, ndërkohë që ligjet për mbrojtjen e të miturve/miturve nga martesat e fëmijëve janë përgjithësisht joefektive ose zbatohen në mënyrë jokonsistente. Megjithatë, që nga viti 2021, qeveria ka prioritet adresimin e martesës së fëmijëve në kuadrin e saj të politikave kombëtare të buxhetuar dhe Agjenda Kombëtare Për të Drejtat e Fëmijëve

149. Përgatitur nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të reja/Rinjve (Observatori) dhe mbështetur nga UN Women Shqipëri në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Fund dhunës ndaj grave në Shqipëri” financuar nga Qeveria e Suedisë nëpërmjet Fondit të Përsheptimit të

OZHQ në Shqipëri. Shih: https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2022-06/media_brief_web.pdf

150. <https://rm.coe.int/grevio-first-baseline-report-on-albania/16807688a7>

151. ISTAT, “Burra dhe gra, 2023”, fq.16

152. Vërejtjet përmblylëse për raportin e pestë periodik të Shqipërisë, 30 tetor 2023, 48/b, fq. 13. Shih: https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CEDAW%2F%2FALB%2FCO%2F5&Lang=en

153. https://www.qag-al.org/publikime/legal_review_report.pdf

154. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf shih faqe nr.38

2021-2026 përmban objektiva dhe masa për të luftuar këtë praktikë. Plani kombëtar i deinstitutionalizimit 2021-2023 përfshinte një program reformash ekonomike me një paketë financiare për zhvillimin e shërbimeve alternative të kujdesit për fëmijët dhe mbylljen e institucioneve të kujdesit social. Por, ligjet e familjes dhe të kujdesit alternativ shpesh zbatohen në mënyrë joadekuate dhe nuk zbatohen plotësisht. Nevojiten përpjekje shtesë për të zbatuar dhe trajtuar më tej të gjitha shkeljet e të drejtave të fëmijëve.

Gjymtimi i organeve gjenitale femërore (GJOGJF). GJOGJF nuk konsiderohet si problem shqiptar dhe deri tani nuk ka pasur nisma për të adresuar edhe këtë formë dhune në legjislacion dhe mbrojtjen që ofrohet. Gjithsesi në takimet dhe sesionet trajnuese e informuese të zhvilluara nga një tërësi aktorësh, edhe kjo formë dhune nuk lihet jashtë vëmendjes, shpjegohen jo vetëm shkaqet dhe pasojat, por edhe se cilat mund të jenë pasojat e mungesës së një parashikimi ligjor në legjislacionin vendas lidhur me këtë formë dhune.

Trafikimi i grave dhe vajzave.¹⁵⁵ Shqipëria parashikon mbrojtje në legjislacion dhe përmes politikave të dedikuara edhe për këtë formë të dhunës. Përveç parashikimeve në Kodin Penal (Neni 110/a “Trafikimi i personave të rritur” dhe Neni 128/b “Trafikimi i të miturave/miturve”), ekzistojnë një sërë politikash dhe mekanizmesh që trajtojnë këtë problem, si Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave, Mekanizmi Kombëtar i Referimit për identifikimin, referimin dhe asistencën e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit në nivel lokal, Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Anti -Trafik (KKSAT) ku përfshihen shërbimet e strehimit të ofruara nga shteti dhe nga OJF-të e specializuara, etj. Organizatat e Shoqërisë Civile të fokusuar në këtë çështje mbështetet prej 10 vitesh tashmë nga shteti, edhe përmes Fondit Social. (Informacion më i detajuar gjendet në përgjigjen për pyetjen 29, faqe nr.76 të këtij raporti).

Kuadri ligjor i mësipërm mbi format e ndryshme të dhunës ndaj grave dhe vajzave të adresuara në Shqipëri, është plotësuar edhe nga një sërë politikash që parashikojnë angazhime specifike dhe planifikim buxhetor përkatës për zbatimin e detyrimeve të ndryshme që rrjedhin nga legjislacioni, ndër të cilat veçanërisht e rëndësishme është: [Strategjia e katërt Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i saj i Veprimit, 2021-2030 \(SKBGJ 2021-2030\)](#)¹⁵⁶. Qëllimi Strategjik i tretë i “SKBGJ 2021 – 2030” fokusohet te “Zvogëlimi i të gjitha formave të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje”. Strategjia siguron një qasje gjithëpërfshirëse për adresimin e dhunës në familje dhe të gjitha formave të dhunës ndaj grave, thekson rëndësia e diskriminimit për shkak të përkatësisë gjinore të shumëfishtë e të ndërthurur (intersectionality), një sfidat që gratë dhe vajzat nga grupe të caktuara hasin jo vetëm për shkak të gjinisë, por edhe të faktorëve të tjerë, si dhe u kushton vëmendje të veçantë grave dhe vajzave, nga të gjitha grupet, sidomos nga zonat rurale dhe ato të pafavorizuara, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, nëna të vetme, të trafikuar, të moshuara, migrante dhe azilkërkuese.

Referuar Raportit të Avokati i Popullit “Mbi situatën e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në Shqipëri për periudhën Janar 2020 - Shtator 2021” realizuar në zbatim të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, është evidentuar se *vitet e fundit janë marrë masa shumë të rëndësishme në adresimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, veçanërisht për përmirësimin e legjislacionit dhe bazës nënligjore, por konstatohet nevoja për:* (a) Hartimin e një kuadri ligjor, që adreson në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, përveç dhunës në familje, pra edhe ngacmimi dhe dhuna seksuale, përndjekja, martesat e detyrueshme, etj. (b) Ndryshime në Kodin Penal që përputhen me Konventën e Stambollit si, përkufizimi i veprës penale të marrëdhënieve seksuale me dhunë, martesat e detyrueshme, vepra penale e sterilizimit të detyrueshëm dhe gjymtimit gjenital femëror.

155. Informacion për aktet nënligjore gjenden në shtojcën nr.3, të këtij raporti

156. Miratuar me Vendimin Nr. 400, datë 30.6.2021, “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021–2030 dhe Planit të saj të Veprimit”. Shih: https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2022-02/WEB_Strategjia%20Kombetare%20-%20EN.pdf

16. Çfarë veprimesh kanë qenë prioritare për vendin tuaj për të trajtuar dhunën me bazë gjinore gjatë pesë viteve të fundit?

Përmirësimi i legjislacionit ka qenë prioritet i shtetit shqiptar për të trajtuar të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, sqaruar në pyetjen e mësipërme. Gjithashtu, zgjerimi i shërbimeve ekzistuese të specializuara si dhe përmirësimi i standardeve të funksionimit të tyre kanë qenë në fokus të ndërhyrjeve të shtetit shqiptar, në bashkëpunim dhe me organizatat ndërkombëtare dhe OJF-të e specializuara në këtë drejtim.

Fuqizimi i shërbimeve. Aktualisht garantohen 35 shërbime të specializuara për viktimat e dhunës me bazë gjinore (DHBGJ), të cilat fokusohen kryesisht në shërbimet e strehimit, këshillimit, trajtimit të rasteve të dhunës seksuale, etj.

Strehëzat dhe/ose forma të tjera forma akomodimi të sigurt garantohen nëpërmjet: dy strehëzave shtetërore kombëtare (një për viktimat e dhunës në familje (DHF) dhe një për viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit); **tetë qendrave rezidenciale publike dhe jopublike (strehëzat afatgjata)** që ofrojnë shërbime afatgjata, për viktimat e DHBGJ dhe DHF që kanë shtrirje gjeografike në katër qytete¹⁵⁷; **gjashtëmbëdhjetë qendrave rezidenciale emergjente publike dhe jopublike** (strehëzat emergjente) që ofrojnë shërbime 24 -72 orë, për viktimat e DHBGJ dhe DHF të cilat ndahen në qendra të menaxhuara nga bashkitë¹⁵⁸, qendra të menaxhuara nga OJF¹⁵⁹-të, si dhe qendra të menaxhuara nga bashkia dhe OJF¹⁶⁰; si dhe **tre qendrave për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale**, konkretisht Qendra LILIUM në Tiranë e menaxhuar nga MSHMS dhe dy shërbime të reja të integruara “Qendra me një ndalesë” në spitalin rajonal Fier dhe Shkodër. Forma të tjera të akomodimit të sigurt janë edhe programi i strehimit, bonusi i qirasë, banesat sociale etj. Nga të dhënat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (aktualisht MF), për vitin 2021, rezultoi se 302 nga gjithsej 2700 përfituese nga programet e strehimit, ose 11.2% e përfituesve ishin gra kryefamiljare dhe viktimat të DHF. Shuma totale e fondeve të akorduara është 398,365,000 lekë ku rreth 11.2% ose afërsisht 44,616,880 lekë janë ndarë për gratë kryefamiljare dhe viktimat të DHF. Për vitin 2022, në fund të muajit gusht, rezultoi se nga afërsisht 2400 përfituese/përfitues, 174 ose 7.2% ishin gra kryefamiljare dhe viktimat të DHF. Shuma totale e fondeve të akorduara është 534,713,429 lekë ku rreth 7,2% ose afërsisht 38,499,366.9 lekë janë ndarë për gratë kryefamiljare dhe viktimat të DHF.

Linjat mbështetëse telefonike (helpline). Linja Kombëtare e Këshillimit për Gra dhe Vajza (LKGV) 116-117, shërbim 24/7, gjatë viteve 2019-2022 ka pritur 15,197 telefonata, ka realizuar 1,511 këshillime ballë për ballë, si dhe ka ofruar asistencë ligjore, shoqërim në gjykatë, mbështetje të tjera ligjore për 750 raste. LKGV ka funksionuar edhe gjatë situatës së mbylljes/izolimit për shkak të pandemisë COVID-19. Nga bashkëpunimi dhe mbështetja që i është ofruar LKGV në kuadër të projektit rajonal për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave në Ballkanin perëndimor dhe Turqi, mbi 3000 gra dhe vajza të mbijetuara të dhunës iu drejtuan këshillimit dhe shërbimeve të specializuara që trajtonin forma të ndryshme të dhunës. Që nga qershori 2021 deri në korrik 2023, 5,924 gra kanë telefonuar LKGV, nga të cilat 3050 kanë marrë informacion dhe këshillim; prej tyre, 926 kanë marrë edhe ndihmë juridike falas dhe 92 ndihmë juridike dytësore falas në formën e përfaqësimit gjyqësor (nga këto 142 ishin gra rome, 105 gra me aftësi të kufizuara dhe 206 fëmijë).¹⁶¹ Fëmijët e dhunuar mund të telefonojnë **ALO 116111**, shërbim i specializuar, pa pagesë 24/7, i një organizate jo-fitimprurëse,

157. 5 në Tiranë, 1 në Vlorë, 1 në Elbasan, 1 në Shkodër

158. Përmet, Pogradec, Roskovec, Sarandë, Urë Vajgurore, Krujë, Kukës

159. Shkodër, Korçë, Elbasan, Vlorë, Tiranë

160. Dibër

161. Në kuadër të mbështetjes së LKGV nga zbatimi i Programit rajonal të UN Women “Zbatojmë normat, ndryshojmë mendësitë II” me fonde të BE. Të dhënat janë marrë nga raporti final i fazës së II përgatitu nga UN Women për periudhën 1 shkurt 2020 – 31 korrik 2023

që mbështetet edhe nga buxheti i shtetit. Gjatë viteve 2019-2020 ka pritur 39,677 telefona, 1,962 raste të referuara të dhunës, abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit bullizmit. Në 3,570 telefonata, fëmijët kanë përfituar mbështetje psiko-sociale nga këshilluesja/këshilluesi në linjë. **Gjatë viteve 2019-2022**, Policia e Shtetit ka mundësuar në të gjithë territorin e vendit funksionimin e linjës 112,129 për raportimin e të gjitha formave të dhunës dhe janë pritur 7,909 telefonata për DHF.

Gjithashtu në Shqipëri janë funksionale edhe një qendër për komunitetin LGBTQ+ ku trajtohen 173 përfituese/përfitues, si dhe një shërbim i specializuar në Qarkun Lezhë i ngritur me mbështetjen e komunitetit fetar katolik, për gratë dhe vajzat në situatë vulnerabiliteti.

Shërbimet për gratë migrante, azilkërkuese, grupet etnike, etj. Bazuar, në legjislacionin në fuqi të shërbimeve shoqërore, të gjitha kategoritë përfshirë dhe azilkërkueset/azilkërkuesit janë pjesë e programeve mbështetëse për shërbimet për gratë e dhunuara. Mekanizmat e Koordinuar të referimit të rasteve të DHF trajtojnë me shërbime multidisiplinare dhe të specializuara gratë dhe vajzat viktime të dhunës, migrante, që janë pjesë e minoriteteve kombëtare apo etnike, si dhe azilkërkuese. Shërbime mjekësore dhe psikologjike ofrohen nga qendrat mjekësore, njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVV), OJF-të etj.

Avokati i Popullit ka kryer inspektim¹⁶² për shërbimet mbështetëse të specializuara dhe ndërsa mirëpret të gjitha përpjekjet dhe masat e ndërmarra nga Qeveria dhe Njësitë e Vetqeverisjes Vendore, për t'ju përgjigjur nevojave të viktimave të dhunës me shërbime të specializuara, duke alokuar edhe fonde nëpërmjet mekanizmit të Fondit Social, vazhdon të konstatojë se: ende këto shërbime duhet të përmirësohen, të shtohen në numër dhe të shtrihen në të gjithë vendin, të jenë të aksesueshme dhe të arritshme për të gjitha grupet e grave së bashku me fëmijët e tyre dhe ka rekomanduar përmirësimin e mëtejshëm të standardeve të përkujdesit shoqëror në qendrat emergjente për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje.

Ndihmë juridike falas, ofrohet në zbatim të ligjit nr.111/2017 në formën e ndihmës juridike parësore (këshillim ligjor), dytësore (përfaqësim pranë organeve gjyqësore) dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore dhe ato për ekzekutimin e vendimeve. Ndihma juridike parësore ofrohet nga 47 ofrues: 20 Qendra të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore¹⁶³, 12 Klinika Ligji pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe 15 Organizata Jo-Fitimprurëse të autorizuara për ofrimin e këtij shërbimi nga Ministria e Drejtësisë. Gjatë viteve 2020-2023 nga 26,877 raste gjithsej që kanë përfituar ndihmë juridike parësore 2,916 janë viktime të DHF, abuzimit seksual dhe trafikimit. Gjatë viteve 2020-2023 gjykatat kanë lëshuar 2,833 vendime gjyqësore për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat e procesit dhe/ose ekzekutim të vendimit, nga të cilët rreth 995 janë viktime të dhunës në familje, përfituese të skemave të mbrojtjes sociale dhe 1 viktimë trafikimi.

Trajnimet. Gjithashtu, në fokus ka qenë edhe rritja e kapaciteteve të aktorëve të ndryshëm që punojnë me viktimat e DHBGJ, të cilët kanë marrë trajnime të vazhdueshme. **Policia:** gjatë viteve 2019-2023 janë trajnuar rreth 811 punonjëse/punonjës policie, për çështje të DHF dhe ndryshimeve ligjore, DHBGJ, procedurat standarde të punës dhe hetimit të krimeve seksuale, parandalimit dhe keqpërdorimit të armëve të zjarrit në kontekstin e DHF. **Shkolla e Magjistraturës:** gjatë periudhës 2019-2024 janë realizuar rreth 30 aktivitete trajnuese të ndryshme disa ditore dhe janë trajnuar gjyqtarë/gjyqtare, prokurorë/prokurore, oficerë/oficere të policisë gjyqësore, staf akademik.¹⁶⁴ Në vitin 2023, **koordinatoret/koordinatore të viktimave në Prokurorinë**

162. Qendra Kombëtare për Trajtimin e Viktimave të Dhunës në Familje (2021-2022); Qendra për menaxhimin e rasteve të dhunës seksuale LILUIM (2021-2022); Strehëza afatgjatë të menaxhuara nga OJF në bashkëpunim me qeverisjen lokale si Qendra Vatra në Vlorë (2022); Qendra STREHA për të rinjtë LGBTI (2023); Strehëzat emergjente në: Kukës, Pogradec, Sarandë (2022), Gjirokastrë, Durrës (2023); Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit- çdo vit

163. Tiranë, Durrës, Elbasan, Lushnjë, Berat, Fier, Vlorë, Pogradec, Gjirokastrë, Lezhë, Shkodër, Dibër, Korçë, Kukës, Tropojë, Përmet, Pukë, Mat, Kavajë, Kurbin, 12 Qendra janë mbështetur me fonde të ADA

164. Informacion më i detajuar në shtojcë 3 të këtij raporti

e Përgjithshme kanë hartuar një manual trajnimi mbi çështjen e DHBGJ. Në këtë manual trajtohet dhuna seksuale online tek të miturat/miturit dhe trajtimi i rasteve të abuzimit seksual online, teknika mbi intervistimin, vendosjen e një komunikimi afatgjatë me viktimën e mitur si dhe trauma dhe efektet e saj. Janë trajnuar 16 koordinatorë/koordinatorë të viktimave të të gjitha prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe 19 oficerë/oficerë të policisë gjyqësore në prokurori. Janë trajnuar¹⁶⁵ gjithashtu edhe përfaqësues/përfaqësues të institucioneve arsimore, njësi për mbrojtjen e fëmijëve, oficerë/oficerë të policisë gjyqësore në polici, në Fier dhe Sarandë. **Shkolla Shqiptare e Administratës Publike:** në vitin 2021 janë trajnuar 1,288 pjesëmarrës/pjesëmarrës në 53 trajnime kurse online me certifikim dhe sesione informuese për “Barazinë Gjinore dhe Mosdiskriminimin” dhe “Dhunën në familje dhe rolin e autoriteteve përgjegjëse”.

Fuqizimi i strategjive dhe ndërhyrjeve për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave. Ministria e Arsimit dhe Sportit në zbatim të SKBGJ 2021-2030 po mbështet fuqizimin e kapaciteteve përmes trajnimeve të vazhdueshme. Njësitë arsimore vendore dhe drejtoritë e institucioneve arsimore programojnë dhe realizojnë trajnime me mësues/mësues dhe me komunitetin e prindërve dhe caktojnë një mësues/mësues përgjegjës në çdo kopsht/shkollë që të mbulojë dhe të koordinojë veprimtaritë në kuadër të planeve të veprimit. Janë njohur stafet e çdo institucioni me kërkesat dhe planifikimin për zbatimin e SKBGJ 2021-2030. Në çdo Zyrë Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) është përcaktuar një person përgjegjës që ndjek dhe monitoron veprimtaritë dhe aktivitetet në kuadër të kësaj strategjie në çdo shkollë. Gjithashtu edhe institucionet shkollore kanë caktuar një mësues/mësues koordinator që të mbulojë dhe të koordinojë aktivitetet në zbatim të SKBGJ 2021-2030, përmes planeve të veprimit të përgatitura nga çdo institucion arsimor parauniversitar (IAP) dhe veprimtarive, kryesisht informuese dhe ndërgjegjësuere, lidhur me zbatimin e strategjisë.

Policia e Shtetit dhe Policimi në komunitet për edukimin e të rejave/rinjve¹⁶⁶. Krijimi i funksionit të veçantë organik të Specialistes/ Specialistit dhe Ndhmës specialistes/specialistit të Policimit në Komunitet për edukimin dhe punën me të rejtat/rinjte në të gjitha komisaritet e policisë, ka përmirësuar dukshëm edukimin e të rejave/rinjve dhe realizimin e fushatave të ndërgjegjësimit të vazhdueshme me nxënëset/nxënësit dhe studentet/studentët (për tematika që lidhen me edukimin me rregullat e qarkullimit rrugor, efektet negative të përdorimit të duhanit, alkoolit, drogës, parandalimit të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, trajtimin të çështjeve të tjera të sigurisë), si dhe bashkëpunimin me organizata rinore, mësues/mësues, pedagogë/pedagogë, psikologe/psikologë, oficeret/oficerët e sigurisë së shkollave, për të identifikuar, trajtuar dhe zgjidhur së bashku problemet e bullizmit, krimit, dhunës në familje, shkeljeve të ligjit, në funksion të parandalimit të përfshirjes në veprimtari kriminale të të rejave/rinjve dhe rritjes së standardeve të sigurisë në institucionet arsimore dhe në komunitet.

Gjykata të specializuara. Çështjet e dhunës në marrëdhëniet familjare në procesin civil gjykohen nga gjyqtarë të seksionit familjar të gjykatave civile, ndërsa çështjet penale me të mitur/mitura gjykohen nga seksionet për të mitur/mitura të gjykatave penale. Gjithashtu, Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) ka miratuar një udhëzim¹⁶⁷ që lidhet me numrin e gjyqtareve/gjyqtarëve që gjykojnë në seksionet e të miturave/miturve, të cilat/cilët kanë detyrimin që të jenë dhe të trajnuara/trajnuar si dhe vendimin¹⁶⁸ për përsheptimin e çështjeve që shqyrtojnë të drejtat apo ndikojnë te të miturat/miturit. Në drejtim të monitorimit të veprimtarisë së gjykatave, ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ka krijuar institucionin e Inspektoriatit të Drejtësisë, i cili kryen inspektime institucionale e tematike mbi çdo aspekt të punës së gjykatave (adresuar rekomandimi i GREVIOs për monitorimin e praktikës së gjykatës).

165. Në bashkëpunim me UNICEF

166. Programi i Policimit në Komunitet 2017-2023 (Buxheti Total 41,4 MEK), financuar nga SIDA

167. Udhëzim nr. 79, datë 30.05.2019 “Mbi caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të drejtësisë për të mitur”;

168. Vendim nr. 78, datë 30.05.2019 “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykata e Apelit”

17. Çfarë strategjish janë përdorur në vendin tuaj për të parandaluar dhunën me bazë gjinore gjatë pesë viteve të fundit?

Fushatat ndërgjegjëse mbarë kombëtare. Ndërgjegjësimi i publikut për stereotipet dhe paragjykimet e dëmshme gjinore, për ndryshimin e mentalitetit dhe qëndrimeve në lidhje me dhunën ndaj grave, është një ndër strategjitë që përdoret prej vitesh në Shqipëri, që ka sjellë rezultate pozitive. Në vend zhvillohen vazhdimisht fushata ndërgjegjëse dhe aktiviteteve informuese dhe edukuese të koordinuara përmes MSHMS, në partneritet me ministritë e linjës dhe institucionet vendore e organizatat e shoqërisë civile, si dhe me mbështetjen e Agjencive të Kombeve të Bashkuara dhe organizatave të tjera ndërkombëtare. Shqipëria prej vitesh angazhohet në organizimin e aktiviteteve ndërgjegjëse në kuadër të fushatës botërore të 16 Ditëve të Aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore (25 nëntor-10 dhjetor). Aktivitetet në këtë kuadër janë zhvilluar të koordinuara dhe secila fushatë ka pasur slogane të përcaktuara. Fushata dhe aktivitete janë realizuar edhe gjatë muajit mars të çdo viti me rastin e ditës ndërkombëtare të grave. Veçanërisht në fushatat e viteve 2019-2021 u zhvilluan qindra aktivitete të organizuara në mbarë vendin, ku miliona ndërveprime (interactions) u arritën (reached out) nëpërmjet mesazheve, videove dhe infografikëve të shpërndara në mediat sociale (Facebook, Instagram, Twitter, Youtube) si dhe takimeve, ekspozitave, intervistave në TV, publikimit të mesazheve promovuese kundër dhunës në ekrane të qendrave tregtare, sheshe publike ose televizione.¹⁶⁹ Gjithashtu, aktiviteteve ndërgjegjëse u janë bashkuar edhe shumë biznese, përfaqësuese/përfaqësues institucionesh dhe media.¹⁷⁰

Gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, gjithashtu pati veprime që synonin mbështetjen e grave dhe vajzave në situata të dhunës me bazë gjinore. Gjatë vitit 2020 u zbatua një fushatë mbarëkombëtare me SMS përmes “Labororit Gjinnor”, që deri në janar 2021 arriti të informonte deri në 40,000 persona mbi shërbimet që ekzistojnë në mbrojtje nga dhuna ndaj grave.¹⁷¹ 310 studente/studentë universiteti dhe nxënës / nxënës të shkollave të mesme (86 djem, 228 vajza) u informuan mbi DHBGJ përmes 12 sesioneve informuese. 60 studente/studentë universiteti (49 vajza, 11 djem), sidomos nga zonat rurale, u informuan për DHBGJ veçanërisht në botën digjitale. Tre prej tyre më pas u përzgjedhën dhe zhvilluan takime ndërgjegjëse në shkollat e mesme lokale duke informuar 254 të reja/rinj (179 vajza, 75 djem) përmes një tërësi takimesh online dhe offline në shtatë shkolla të mesme në Bashkinë Elbasan dhe qarkun Elbasan.¹⁷² Rreth 350 postera u vendosën në hapësirat publike, zyrat e bashkive dhe në stendat e informimit publik në të shtatë bashkitë e qarkut Elbasan, duke arritur informimin e rreth 6,000 personave mbi shërbimet që ofrohen gjatë pandemisë në situatën e COVID-19.¹⁷³

Përfshirja e djemve dhe burrave. Janë zhvilluar një sërë aktiviteteve që fokusohen në përfshirjen e djemve dhe burrave¹⁷⁴, si për shembull, krijimi i “Be a man Club” në 11 bashki dhe në shkollat e mesme të qytetit të

169. Të dhënat janë marrë nga raportet vjetore të Programit të Përbashkët të OKB-së me MSHMS “T’i japim fund dhunës ndaj grave në Shqipëri”, Janar 2019-Qershor 2022, me mbështetjen e Qeverisë Suedeze, sipas të cilit, rreth 3,000,000 ndërveprime janë realizuar në këto fushata gjatë viteve 2019-2021.

170. Në fushatën e vitit 2020, rreth 150 biznese, institucione publike, media dhe institucione sportive ndryshuan logon e mediave të tyre sociale gjatë lëvizjes #Orangetheworld me mbështetjen e UN Women.

171. Realizuar nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rejave/Rinjve në kuadër të mbështetjes nga zbatimi i Programit rajonal të UN Women “Zbatojmë normat, ndryshojmë mendësitë II” me fonde të BE. Të dhënat janë marrë nga raporti final i fazës së II përgatitur nga UN Women për periudhën 1 shkurt 2020 – 31 korrik 2023

172. Realizuar nga Forumi i Gruas Elbasan në kuadër të mbështetjes nga zbatimi i Programit rajonal të UN Women “Zbatojmë normat, ndryshojmë mendësitë II” me fonde të BE. Të dhënat janë marrë nga raporti final i fazës së II përgatitur nga UN Women për periudhën 1 shkurt 2020 – 31 korrik 2023

173. Realizuar nga Forumi i Gruas Elbasan në kuadër të mbështetjes nga zbatimi i Programit rajonal të UN Women “Zbatojmë normat, ndryshojmë mendësitë II” me fonde të BE. Të dhënat janë marrë nga raporti final i fazës së II përgatitur nga UN Women për periudhën 1 shkurt 2020 – 31 korrik 2023

174. Në kuadër të programit të OKB-së kundër dhunës

Tiranës¹⁷⁵, iniciativë që mbledh të rejtat/rinj të diskutime në formë debatesh për çështje të barazisë dhe stereotipeve të dëmshme gjinore dhe DHnG-DHBGJ. Rreth 1,700 djem dhe vajza të reja, burra dhe gra morën pjesë në aktivitete që synojnë veçanërisht angazhimin e djemve dhe burrave.¹⁷⁶ Gjatë vitit 2022, rreth 360 djem të rinj, si dhe 20 profesioniste/profesionistë të arsimit u pajisën me njohuri bazë për barazinë gjinore, maskulinitetin pozitiv dhe DHBGJ.¹⁷⁷ Një grup i trajnuar prej 11 të rinjsh, u angazhuan në 16 sesione për transformimin e normave mashkullore tradicionale.¹⁷⁸

Përfshirja e komuniteteve fetare. Puna me komunitetet fetare në Shqipëri për t'i angazhuar si aleatë në përpjekjet kundër dhunës në familje ka vite që ka filluar. Gjatë vitit 2020, rreth 121 individë (36 burra dhe djem dhe 85 gra dhe vajza) nga komunitetet fetare në qarkun e Elbasanit u informuan mbi mbi barazinë gjinore dhe luftimin e normave të dëmshme gjinore përmes shtatë forumesh publike të fokusuara në rolin e komuniteteve fetare në këtë drejtim (link të forumeve i gjeni në shtojcën 3 të këtij raporti).¹⁷⁹ Në vitin 2023 dy MKR (Pogradeci dhe Vlora)¹⁸⁰ përfshinë për herë të parë zyrtarisht si anëtare të Komitetit Drejtues komunitetet fetare. Dy spote publicitare¹⁸¹ janë prodhuar me mesazhe nga 7 drejtues të komuniteteve fetare të Bashkisë Vlorë.

Përfshirja e aktorëve të tjerë: Ministria e Drejtësisë (Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas) ka zhvilluar/marrë pjesë në 775 takime/aktivitete ndërgjegjësuere (në vitet 2021 dhe 2023). **Policia e Shtetit**, është angazhuar gjithashtu në fushata ndërgjegjësuere të organizuara me mbështetjen e organizatave apo institucioneve që kanë në fokus të punës parandalimin e dhunës.¹⁸² Aktivitetet u ndoqën nga nxënës/nxënës të 95 shkollave të mesme. Në procesin e koordinimit të aktiviteteve të fushatës u angazhuan 40 OJF vendore, të cilat zbatonin projekte të Skemës së Granteve financuar nga SIDA. **MAS** ka ndërmarrë veprime specifike që konsistojnë në: (a) krijimin e mjediseve të sigurta, përfshirë shkollat, vendet e punës dhe hapësirat publike; (b) trajnimin e oficerëve/oficerëve të sigurisë në lidhje me abuzimin seksual ku janë prekur të gjithë komponentët që tek identifikimi, shpërndarja, simptomologjia, etj.; (c) trajnimin e punonjëseve/punonjësve të shërbimit psiko-social për mbrojtjen, sigurinë, identifikimin dhe referimin e rasteve në nevojë për mbrojtje (d) hartimin e një manuali me aktivitete praktike për edukimin kundër fenomenit të bullizmit që përfshin gjithë sistemin arsimor parauniversitar. (e) pasjen e një kurrikule të reformuar me bazë kompetencat (klasa përgatitore - klase 12) me qëllim që nxënës/nxënës të marrin njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm, të drejtat e njeriut, barazinë gjinore, përkrahjen e kulturës së paqes dhe jo të dhunës, qytetarinë globale dhe vlerësimin ndaj shumëllojshmërisë së kulturave dhe të kontributit që jep kultura për zhvillimin e qëndrueshëm; (f) bashkëpunim më i mirë mes shkollave dhe njësive të mbrojtjes së fëmijëve. MAS ka kontribuar për krijimin e sistemit për identifikimin, parandalimin dhe raportimin e dhunës, bullizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe minimizimit të gjuhës së urrejtjes në shkolla. Në bashkëpunim me partnerët, MAS-i zhvilloi një protokoll gjithëpërfshirës për parandalimin dhe raportimin e të gjitha formave të

175. Qasje rajonale mbështetur nga ADA dhe zbatuar nga CARE Austria, përmes ACT for Society

176. Mbështetur nga UN Women, UNFPA dhe UNDP

177. Nga Linja e Këshillimit për Djem dhe Burra, me mbështetjen e Programit rajonal të UN Women "Zbatojmë normat, ndryshojmë mendësitë II" me fonde të BE. Të dhënat janë marrë nga raporti final i fazës së II përgatitur nga UN Women për periudhën 1 shkurt 2020 – 31 korrik 2023

178. Nga organizata Gruaja te Gruaja, me mbështetjen e Programit rajonal të UN Women "Zbatojmë normat, ndryshojmë mendësitë II" me fonde të BE. Të dhënat janë marrë nga raporti final i fazës së II përgatitur nga UN Women për periudhën 1 shkurt 2020 – 31 korrik 2023

179. Realizuar nga Forumi i Gruas në kuadër të mbështetjes nga zbatimi i Programit rajonal të UN Women "Zbatojmë normat, ndryshojmë mendësitë II" me fonde të BE. Të dhënat janë marrë nga raporti final i fazës së II përgatitur nga UN Women për periudhën 1 shkurt 2020 – 31 korrik 2023

180. Me mbështetjen e Qendrës Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD) dhe UNFPA

181. Spoti i parë: <https://www.youtube.com/watch?v=U8YRSnwMuY8>, Spoti i dytë me intervista të drejtuesve fetarë është transmetuar në mediat sociale të Qendrës Aulona, ACPD pati rreth 9000 shikime, në TV 6+1 Vlora përgjatë 16 ditëve të aktivizmit si dhe në linkun e mëposhtëm: https://www.youtube.com/watch?v=AFsp82m4nEY&fbclid=IwAR1GF4tZDL-mAhiQWxTFE_P66t0bCJvA2KKUmUdAqnBIKJ_0eN1djxqB9Cag

182. Kontribut të rëndësishëm në këtë drejtim jep dhe Projekti Suedez i Policimit në Komunitet (SCPA)

dhunës (fizike, psikologjike, seksuale, neglizhimin, ngacmimin seksual, shfrytëzimin), homofobinë, bullizmin, gjuhës së urrejtjes dhe ekstremizmit në shkolla. Duke ndjekur praktikën më të mira në rajon, në shkolla janë krijuar ekipe të përbëra nga mësueset/mësuesit, nxënëset/nxënësit dhe prindërit që kanë për synim krijimin e mjediseve pa dhunë dhe zgjidhjen paqësore të konflikteve midis nxënëseve/nxënësve. Prioritet i MAS është edhe parandalimi dhe eliminimi i dhunës ndaj fëmijëve dhe të rejave/rinjve brenda dhe jashtë shkollës. Raste të dhunës në institucionet shkollore janë evidentuar dhe trajtuar në të gjithë vendin. Shërbimi psiko-social ka siguruar shërbime të drejtpërdrejta për të gjithë fëmijët në arsimin parauniversitar dhe me fokus të veçantë për fëmijët në nevojë. Bazuar në nevojën e komunikimit online si forma e vetme e komunikimit gjatë vitit shkollor 2020-2021 u krijua Këndi i Psikologut, në faqet zyrtare të institucioneve përgjegjëse për arsimin parauniversitar. Në këtë hapësirë, nxënëset/nxënësit apo prindërit kontaktonin me psikologe/psikologë për të marrë këshillim apo aksesuar materiale këshilluese në periudhën e pandemisë.

NJVV. Bashkitë¹⁸³ janë përfshirë në aktivitete të ndryshme ndërgjegjësuëse, për të sjellë ndryshime në sjellje, kanë shpërndarë informacione, fletëpalosje për parandalimin dhe përgjigjen ndaj dhunës me bazë gjinore. Bashkia së bashku me OJF¹⁸⁴ ka organizuar disa aktivitete ndërgjegjësuëse për dhunën me bazë gjinore, si: krijimi i një murale dhe ndjekja e një shfaqje teatrale me pjesëmarrjen e aktorëve të ndryshëm dhe rreth 100 të rejave/rinjve; aktivitete për punën me gra, burra dhe çifte për të përmirësuar aftësitë e tyre të komunikimit ndërpersonal, menaxhimit të konflikteve dhe vendimmarrjen e përbashkët¹⁸⁵; promovimi i marrëdhënieve jo të dhunshme familjare dhe praktikave pozitive të prindërimit¹⁸⁶; cikël trajnimesh mbi prindërimin pozitiv duke promovuar marrëdhënie të shëndetshme familjare¹⁸⁷. Në nivel vendor, ka vazhduar mbështetja e bashkive lidhur me hartimin e planeve për integrimin social dhe ekonomik të grave dhe vajzave viktime të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Gjatë 2021, në gjashtë bashki¹⁸⁸ në vend përfundoi hartimi i planeve të ri-integrimit social-ekonomik të viktimave të dhunës me bazë gjinore.¹⁸⁹ Gjatë 2022, ka vazhduar puna lidhur me zbatimin e këtyre planeve dhe ndërgjegjësimin e Bashkive lidhur me masat që ato përmbajnë, si dhe janë hartuar planet e ri-integrimit edhe në katër bashki të tjera.¹⁹⁰ Të gjitha planet fokusohen në ri/integrimin socio-ekonomik të grave dhe vajzave të dhunuara në fushat e fuqizimit ekonomik (të drejta pronësie, punësim dhe formim profesional), strehimit, arsimit dhe kujdesit social.¹⁹¹

.....
OJF-të kanë zbatuar projekte që lidhen me parandalimin e DHBGJ duke kontribuar në: *punën me gra, burra dhe çifte për të përmirësuar aftësitë e tyre të komunikimit ndërpersonal, menaxhimit të konflikteve dhe vendimmarrjen e përbashkët*;¹⁹² *fuqizimin e grave dhe vajzave për të promovuar pavarësinë e tyre ekonomike dhe aksesin në burime, dhe për të promovuar marrëdhënie të barabarta në familje, komunitete dhe shoqëri*;¹⁹³ *pakësimin e varfërisë përmes ndërhyrjeve të synuara për gratë ose familjet*;¹⁹⁴ *krijimin e mjediseve të sigurta, përfshirë shkollat, vendet e punës dhe hapësirat publike*;¹⁹⁵ *promovimin*

.....
 183. Devolli, Dropull, Lushnja

184. Bashkia Kavajë në bashkëpunim me Qendra Komunitare ‘Sot për të Ardhmen’

185. Kamëz

186. Në bashkëpunim me World Vision, si dhe në Tiranë, në bashkëpunim me ACT for Society dhe UNFPA – një manual trajnimi është përgatitur për këtë qëllim, dhe stafet e qendrave komunitare janë trajnuar (gjatë vitit 2022-2023) dhe e kanë pilotuar ato vetë zbatimin e manualit dhe të kurseve mbi prindërimin pozitiv (2023 e në vijim).

187. Vlorë, Korçë (me mbështetjen e Fondit Social dhe në bashkëpunim me Nismën Arsis) dhe Lushnje

188. Durrës, Tiranë, Pogradec, Elbasan, Vlorë, Shkodër

189. Si pjesë e projektit të UN WOMEN në bashkëpunim me organizatat “Të Ndryshëm dhe të Barabartë (D&E) dhe Rrjetin Shqiptar të Fuqizimit të Gruas (AWEN).

190. Kukës, Berat, Dibër dhe Korçë. Këto plane u hartuan nga organizata “Të ndryshëm dhe të barabartë” në bashkëpunim me bashkitë përkatëse.

191. Raporti i monitorimit të zbatimit të SKBGJ 2021-2030 për vitin 2022, fq.22.

192. *Vatra, Forumi i Gruas Elbasan, Ambasada Suedeze*

193. *Vatra, AWEN, Forumi i Gruas Elbasan, GIZ, Të Drejtat e Njeriut në Demokraci, Qendra për Drejtësi Gjinore, QK Kukës, RISI HELVETAS, UNICEF.*

194. *Vatra, AWEN, Forumi i Gruas Elbasan, Qendra për Drejtësi Gjinore, Nisma Arsis, RISI HELVETAS, UNICEF*

195. *Vatra, AWEN, OSCE, Të Drejtat e Njeriut në Demokraci, UNICEF;*

e marrëdhënieve jo të dhunshme familjare dhe praktikave pozitive të prindërimit;¹⁹⁶ promovimin e qëndrimeve, besimeve, vlerave dhe normave pozitive me barazi gjinore, veçanërisht te burrat dhe djemtë;¹⁹⁷ mobilizimin e udhëheqësve të komunitetit/të besimit/tradicionalë, politikanëve, personave me ndikim në opinion, gazetarëve ose personave me ndikim në media (si atletët ose personat e famshëm), për të ndikuar në normat pozitive;¹⁹⁸ rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për të ndryshuar qëndrimet dhe sjelljet;¹⁹⁹ promovimin e vlerave barazimtare gjinore në arsimin fillor dhe të mesëm, përfshirë edukimin gjithëpërfshirës për seksualitetin;²⁰⁰ Gjithashtu, është realizuar një podcast²⁰¹ për dhunën në familje në fushatën e 16 ditëve të aktivizmit. Gjatë vitit 2021, u lancua Platforma “Të sigurt nga dhuna me bazë gjinore dhe seksuale”, e cila ka për qëllim përmirësimin e kapaciteteve dhe njohurive për edukimin seksual gjithëpërfshirës (ESGJ) dhe dhunën seksuale për të rinjtë/rejat, mësues, prindër, komunitet.²⁰² Është hartuar dhe manuali për trajnere/trajnerë me përvojë, edukatore/edukatorë të edukimit seksual, aktiviste/aktivistë të OJF-ve, dhe profesioniste/profesionistë të tjerë që punojnë me të reja dhe të rinj në rrezik përjashtimi social, siç janë LGBTIQ+, romet/romët dhe të rejt/rinjtë në rrezik të diskriminimit gjinor. Në përfundim të kursit, pjesëmarrësit përveç rritjes së njohurive, aftësohen në zbatimin e ESGJ, evidentimin dhe trajtimin e dhunës dhe abuzimit si dhe referim të rasteve.

18. Çfarë veprimesh ka marrë vendi juaj për të parandaluar dhe për t’iu përgjigjur dhunës me bazë gjinore të lehtësuar nga teknologjia (p.sh. ngacmimi seksual në internet, përndjekja në internet, shpërndarja e imazheve intime pa pëlqimin e personi) gjatë pesë viteve të fundit?

Shqipëria është palë në Konventën e Budapestit për Krimin Kibernetik dhe ka nënshkruar protokollin shtesë të Konventës për bashkëpunimin e zgjeruar dhe zbulimin e provave elektronike. Gjithashtu, shteti shqiptar ka miratuar Strategjinë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike 2020-2025 dhe planin e saj të veprimit, nëpërmjet të cilës, janë krijuar mekanizmat e nevojshme për sigurinë e fëmijëve në hapësirën kibernetike. Bazuar në këtë strategji, në dhjetor të vitit 2020, me Urdhër të Ministrit të Brendshëm, është miratuar ‘Strategjia për Hetimin e Krimit Kibernetik’ dhe Plani i Veprimit 2021-2025, për ngritjen dhe zhvillimin e mekanizmave të duhur institucional, rritjen e nivelit të përgjigjes ndaj krimeve kibernetike në vend por dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm me partnerët ndërkombëtare. Gjithashtu, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në Departamentin e Policisë Kriminale është krijuar Drejtoria për Hetimin e Krimeve Kibernetike me një strukturë të posaçme nga viti 2023, Sektori i Hetimit të Pornografisë me të Mitura/Mitur, si dhe krijimin e seksioneve në drejtoritë vendore. Informacion i detajuar për hetimin e veprave penale dhe të dhëna konkrete paraqiten në Shtojcën 3 të këtij raporti. Është ngritur **Njësia e Koordinimit 24/7**, e cila shkëmben informacion me agjencitë homologe dhe partnerët për të gjitha veprat penale të kryera nëpërmjet internetit përfshirë edhe ato të pornografisë me të mitura/mitur. Gjithashtu, Policia e Shtetit (PSH) ka **pika kontakti** për krimet kibernetike me Europolin, Interpolin, 24/7 PoC Cybercrime Convention, 24/7 PoC High Tech Crime G7, NCMEC²⁰³ (**National Center for Missing and Exploited Children**), Liaisons Officers. Njësia është pikë

196. Vatra, AWEN, OSCE, Forumi i Gruas Elbasan, Qendra për Drejtësi Gjinore, Nisma Arsisi, Të Drejtat e Njeriut në Demokraci, UNICEF;

197. Vatra, AWEN, OSCE, Forumi i Gruas Elbasan, Qendra për Drejtësi Gjinore, QK Kukës, Ambasada Suedeze, UNICEF; si dhe “Unë Gruaja” Pograde, me mbështetjen e We Effect (2023)

198. Vatra, AWEN, OSCE, Forumi i Gruas Elbasan, Ambasada Suedeze, UNICEF.

199. Vatra, AWEN, OSCE, Forumi i Gruas Elbasan, Të Drejtat e Njeriut në Demokraci, Qendra për Drejtësi Gjinore, Nisma Arsisi, Ambasada Suedeze, UNICEF.

200. Vatra, AWEN, UNICEF

201. Realizuar nga OSCE, Shih: [Gender Equality Dialogues \(buzzsprout.com\)](http://genderequalitydialogues.org/)

202. Nga Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin, shih: <http://acpd.org.al/?p=1054>

203. Dërgon raporte ditore dhe materiale të konstatuara në internet që kanë të bëjnë me pornografi me të mitura/mitur, shfrytëzim

kontakti për projektin analitik **AP TWINS të Europolit** i cili mbështet parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të kriminalitetit që lidhen me shfrytëzimin dhe abuzimin seksual. Në kuadër të programit/paketa “Siguria e të Rejave/Rinjve” që PSH ka me MAS, që zbatohet në të gjitha qarqet ndër temat që zhvillohen në shkollat publike/jopublike janë: veprimet kundër dhunës në familje dhe trafikimit; kundër bullizmit/bullizmit kompjuterik, për të cilat janë trajnuar edhe punonjëset/punonjësit e policisë të përfshirë te nisma. Në një vit shkollor ky program zbatohet në rreth 1,296 shkolla, prej të cilave 1,192 shkolla publike dhe 106 shkolla jopublike, dhe përfituese/përfitues janë rreth 25,800 nxënës/nxënës.

Masat e marra nga MAS. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), në vitin 2023 ka hartuar “Manualin për sigurinë në internet”²⁰⁴, i cili ofron një paketë udhëzimesh dhe këshillash lidhur me promovimin e përdorimit të internetit në mënyrë të sigurt dhe efektive nga nxënëset/nxënësit dhe mësueset/mësuesit dhe trajton çështje si cyberbullying, ngacmimet seksuale, hackimi i të dhënave personale, varësia nga lojërat online, etj. Gjithashtu, ASCAP dhe Instituti Shqiptar i Medias, gjatë vitit 2023 kanë trajnuar rreth 150 mësuese/mësues (pjesë të 10 shkollave) mbi edukimin për median, sfidat dhe rreziqet në botën virtuale, rregullat e privatësisë dhe disa nga rreziqet kryesore që mund të hasen përgjatë përdorimit të internetit. Projekt është pilotuar edhe me drejtueset/drejtuesit e rrjeteve të Shkencave Sociale dhe Biologji-Kimisë, ku 120 drejtuese/drejtues rrjetesh kanë marrë pjesë në këto trajnime (viti 2023). Është ngritur dhe funksionon rrjeti profesional i mësueseve/mësuesve të TIK-ut (2021-2022), të cilat/cilët në takime mujore diskutojnë, ndajnë eksperiencën dhe vlerësojnë nevojat, ndërsa grupi i koordinatorëve/koordinatorëve të shkollave kryejnë raport vlerësimi për sigurinë kibernetike. Gjithashtu, lidhur me sigurinë kibernetike të nxënësve/nxënësve dhe mbrojtjen e tyre nga përmbajtje të paligjshme dhe të dëmshme në institucionet arsimore parauniversitare janë miratuar aktet e mëposhtme: Udhëzimi i përbashkët midis MAS dhe MSHMS nr. 658, datë 23.09.2019, “Për procedurat dhe veprimet që ndërmarrin strukturat arsimore, në bashkëpunim me strukturat e mbrojtjes së fëmijëve, në rastet kur në mjediset e institucionit arsimor parauniversitar konstatohet se një fëmijë është duke aksesuar në internet përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme për moshën e saj/tij”; Udhëzimi nr. 34, datë 16.11.2018, “Për ndalimin e telefonit celular në institucionet arsimore parauniversitare, si nga mësuesja/mësuesi ashtu edhe nga nxënësja/nxënësi”; Për shërbimin psiko-social janë miratuar dokumentet: “Praktika e punës së shërbimit psiko-social”²⁰⁵ dhe “Parimet e përgjithshme etike të shërbimit psiko-social”²⁰⁶, të cilat trajtojnë situata të dhunës, bullizmit dhe abuzimit online në shkollë.

Mësueset/Mësuesit, Oficeret/Oficerët e Sigurisë dhe shërbimi psiko-social kanë realizuar një sërë aktivitete ndërgjegjëse mbi çështjen e sigurisë me nxënës/nxënës dhe mësuese/mësues me tematikë: “Përdorimi i internetit, rreziqet e sjelljeve ekstremiste në internet”; “Fëmijë të sigurt në internet dhe mbrojtja nga dhuna virtuale”, organizuar me nxënëset/nxënësit e klasave të arsimit të mesëm të ulët me përfaqësuese/përfaqësues të Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve (NJMF), Koordinatorës/Koordinatorit kundër Dhunës në Familje dhe psikologeve/psikologëve të institucioneve. Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Sigurisë në Internet janë zhvilluar aktivitete me mesazhe sensibilizuese në shkollë.²⁰⁷ Publikimi i Rubrikës “Raporto përmbajtje të paligjshme” në faqen zyrtare të MAS, Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP), Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP), Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) dhe institucioneve të arsimit parauniversitar, e cila është ndërlidhur me portalin online www.cesk.gov.al të AKCESK, për mbylljen e aksesit të faqeve të internetit me përmbajtje të paligjshme, e cila ju vjen në ndihmë fëmijëve, personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të tyre dhe të rejave/rinjve, për të raportuar përmbajtje të paligjshme të hasura gjatë lundrimit të tyre në internet.

seksual apo me përmbajtje të tjera të dëmshme.

204. <https://www.ascap.edu.al/kurrikula>

205. <https://www.ascap.edu.al/praktika-e-punes-se-sherbimit-psiko-social-shkollor/>

206. <https://www.ascap.edu.al/parimet-per-etiken-profesionale-te-sherbimit-psiko-social-shkollor/>

207. <https://arsimi.gov.al/udhezim-nr-34-date-16-11-2018-per-ndalimin-e-telefonit-celular-ne-institucionet-arsimore-parauniversitare/>

Aplikacioni BrightSky. Programi “T’i japim fund dhunës ndaj grave”²⁰⁸ mbështeti partneritetin midis Vodafone Albania, MSHMS dhe Ministrisë së Brendshme (MB) për të hartuar dhe lançuar aplikacionin Bright Sky, një program i ri mbështetës online për gratë viktimat/të mbijetuara të DHF dhe DHBGJ i aksesueshëm që nga qershori 2021. Aplikacioni shkarkohet falas dhe mund të përdoret në një telefon celular dhe/ose pajisje tjetër inteligjente dhe ofron mbështetje dhe informacion për këdo që mund të jetë në një marrëdhënie abuzive, ose për ata që shqetësohen për dikë që njohin. Aplikacioni mund të përdoret për të siguruar informacione për këdo që dëshiron të mësojë për abuzimin në familje e deri te disa nga llojet e mbështetjes në dispozicion. Po me mbështetjen e këtij programi 70 gra nga grupet e marginalizuara (Rome, LGBTQI+ dhe gra me aftësi të kufizuara) u pajisën me 70 telefona inteligjentë të dhuruar nga Vodafone Albania dhe u aftësuan për përdorimin e aplikacionit BrightSky.²⁰⁹

OJF-të kanë dhënë kontributin e tyre për trajnimin e profesionisteve/profesionistëve të medias²¹⁰ për të inkurajuar krijimin dhe përdorimin e imazheve jo-stereotipike, të balancuara dhe të ndryshme të grave dhe vajzave në media, duke përfshirë mediat sociale; mbështetje²¹¹ për viktimat e dhunës digjitale, aktivitete ndërgjegjëse, rekomandime për hartimin e një ligji specifik për parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës digjitale, etj.

NJVV. Bashkitë janë angazhuar në aktivitetet ndërgjegjëse²¹² me nxënëse/nxënës, të reja/rinj, djem, mësuese/mësues, prindër për abuzimin në internet, përndjekjen, rreziqet që sjell teknologjia, stereotipizimi i figurës së grave dhe vajzave në internet me video tallëse, shpërndarjen e imazheve, përdorimi i sigurt i internetit, pasojat dhe veprimet që mund të ndërmerren për parandalimin e kësaj forme dhune, etj. Përveç aktiviteteve informuese me gjithë komunitetin janë organizuar takime me Aleancën e Grave Këshilltare dhe punonjëse në bashki²¹³ ku është diskutuar për këtë çështje si dhe janë realizuar dy video me figura të shquara të qytetit edhe një video me anëtarët e MKR-së me qëllim parandalimin e dhunës me bazë gjinore. Aktivitete të tjera të organizuara nga bashkitë janë: trajnime të ndryshme me specialiste/specialistë të fushës në shkollë për ngacmimet apo përndjekjet që ndodhin nëpërmjet rrjeteve sociale²¹⁴; aktivitete me specialistet/specialistët e teknologjisë dhe ofrueset/ofruesit e shërbimeve teknologjike për të përcaktuar dhe aplikuar praktika të mira në këtë drejtim²¹⁵; aktivitete ndërgjegjëse për të denoncuar rastet e dhunës me baze gjinore nëpërmjet rrjeteve sociale dhe bashkëpunimi me policinë për menaxhimin dhe zgjidhjen e çdo rasti të identifikuar; organizimi i aktiviteteve të ndryshme “Siguria në Internet”, “Cyberbulling”, “Stop Trafikimi” etj. Këto aktivitete janë organizuar me fëmijët dhe prindër përfitues të qendrave sociale.

208. Programi i përbashkët i Kombeve të Bashkuara ‘Ti japim fund dhunës ndaj grave’ i zbatuar nga UNDP, UNFPA, UN Women me fonde të Qeverisë Suedeze.

209. Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK) Qendra për të Drejtat e Grave Rome (RWRC) dhe Aleanca LGBT, në kuadër të mbështetjes nga zbatimi i Programit rajonal të UN Women “Zbatojmë normat, ndryshojmë mendësitë II” me fonde të BE. Të dhënat janë marrë nga raporti final i fazës së II përgatitur nga UN Women për periudhën 1 shkurt 2020 – 31 korrik 2023

210. Me mbështetjen e Ambasadës Suedeze dhe UN Women.

211. Qendra Psiko-Sociale Vatra Vlorë

212. Bashkia Fushë-Arrëz, Vlorë, Pogradec, Përrenjas, Lushnje, Lezhë, Krujë, Korçë

213. Bashkinë Korçë

214. Bashkia Korçë

215. Bashkia Durrës

19. Çfarë masash ka marrë vendi juaj për të siguruar burime për organizatat e grave që operojnë për të parandaluar dhe reaguar ndaj DHBGJ-së gjatë pesë viteve të fundit?

Shteti shqiptar ka parashikuar disa forma të mbështetjes të organizatave të shoqërisë civile, konkretisht: **Alokimi i fondeve nëpërmjet Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC)** ent qendror publik. Gjatë viteve, **2019-2023** AMSHC-ja ka lidhur 251 kontrata me OJF-të në shumën totale të disbursuar 416,850,000 lek (rreth 4,115,004.94 euro), nga të cilat projektet fituese me fokus dhunën ndaj grave/dhunën në familje llogariten në vlerën totale 17,100,000 lek (rreth 168,805.53 euro) ose 4,1 % të shumës totale të buxhetit. **Në 2020** mungojnë financime për projekte në fushën kundër dhunës në familje.

Alokimi i fondeve nëpërmjet ndërmarrjeve sociale, mbështetet në ligjin nr. 65/2016 dhe në VKM përkatëse për ndërmarrjet sociale, që parashikohet një fond mbështetës në vlerën prej 249,760,000 Lekë (rreth 2 milion e 81 mijë euro) dhe gjatë periudhës objekt raportimi kanë marrë statusin e ndërmarrjeve sociale nëntë organizata jofitimprurëse.

Alokimi i fondeve nëpërmjet Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas²¹⁶ e cila ka parashikuar fonde buxhetore për organizatat jofitimprurëse që ofrojnë ndihmën juridike parësore për gratë dhe vajzat në nevojë, prej 4 milion lekë për çdo vit buxhetor, nga viti 2019 dhe në vijim. Në muajin mars 2023 janë financuar dy OJF²¹⁷.

Alokimi i fondeve nëpërmjet Ministres së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët²¹⁸, në zbatim të ligjit nr.75/ 2019 “Për rininë”, VKM²¹⁹ nr. 681, datë 02.09.2020 është financuar projekti për transformimin e sjelljeve të vajzave dhe djemve të rinj në Tiranë, Devoll e Bulqizë (përfitues 197 djem dhe 106 vajza), me qëllim edukimin mbi dhunën, përdorimin e drogës e shëndetit riprodhues, si dhe rritjen e kapaciteteve të 49 profesionisteve (gra dhe vajza staf shëndetësie, psikologe, mësuese, etj).

Alokimi i fondeve nëpërmjet Fondit Social²²⁰ ka si qëllim kontributin e drejtpërdrejtë në ofrimin e shportës së shërbimeve sociale për kategoritë në nevojë në nivel lokal përmes ngritjes së shërbimeve të reja ku nevoja e familjes dhe individit është me e madhe, si dhe në përmirësimin e shërbimeve ekzistuese si pjesë e planeve sociale të bashkive. Në pesë vite funksionimi të këtij mekanizmi financiar janë mbështetur njësitë e vetëqeverisjes vendore për ngritjen e 73 shërbimeve të përkujdesit shoqëror nga të cilat, kanë përfituar 51 bashki dhe 8 qarqe. Janë mbështetur financiarisht dy linja këshillimi, konkretisht “ALO 116-111” dhe Linja e këshillimit për gra dhe vajza; tre strehëza të specializuara në nivel rajonal për viktimat e trafikimit dhe fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore nga buxheti i shtetit për 28 punonjëse/punonjës është 21,6 milion lekë/vit, strehëza për LGBTI financohet nga buxheti i shtetit rreth 7 milion lekë çdo vit. Financohen dy shërbime kombëtare për viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit, totalisht me buxhet shteti – 22,8 milion lekë (48 përfituese/përfitues raste të DHF, apo të trafikuar-rreth 600 përfituese/përfitues); si dhe Qendra Liliu dhe dy one-stop-center, prej vitit 2023, në Fier dhe Shkodër²²¹, për trajtimin e fëmijëve viktimat të abuzimit seksual dhe formave të tjera të abuzimit, që për një vit kanë trajtuar 20 raste. Mbështeten financiarisht pesë qendra komunitare multifunkionale ku përfitojnë edhe gra të dhunuara si dhe katër shërbime/strehëza të emergjencës për gratë dhe vajzat e dhunuara që jetojnë dhe në zonat rurale: Gjirokastrë (vijon shërbimi 100% financim nga bashkia), Lezhë (2,729,299 lekë), Kukës (1,665,506 lekë), Berat (1,164,000 lekë).

216. DNJF është person juridik publik nën varësinë e Ministrit të Drejtësisë, që ka për mision, garantimin e NJ falas.

217. Qendra ‘Vatra’, Vlorë dhe Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza

218. Në Programin Vjetor të Financimit dhe Skemën e Shpërndarjes së Fondit Grant, Thirrja Publike Nr. II për projekte, e shpallur nga Agjencia Kombëtare e Rinisë mbështeti financiarisht organizatën “Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza”

219. “Për mënyrën e krijimit, të organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë”,

220. Informacion më i detajuar në shtojcën nr.3, të këtij raporti

221. Financuar nga UNICEF (qendra e Fierit dhe Shkodrës)

NJVV financojnë OJF-të: Ofrimi i shërbimit ligjor, psikologjik falas dhe linja telefonike falas²²², ofrimi i ambienteve për aktivitete ndërgjegjëse me viktimat e dhunës dhe për organizimin e trajnimeve për çështje të dhunës me bazë gjinore²²³, mbështetje financiare²²⁴ për qiranë e zyrave të këshillimit dhe kosto të tjera operative dhe prej vitit 2023 edhe qiranë e strehëzës, mbështetje me projekte të ndryshme OJF-të që punojnë për të parandaluar dhunën ndaj grave dhe vajzave²²⁵.

Organizatat ndërkombëtare ofrojnë mbështetje të vazhdueshme për OJF-të që punojnë për parandalimin dhe reagimin ndaj DHBGJ, konkretisht mbështetje për organizatat e grave duke i përfshirë ato në aktivitete të veçanta të projektit, si trajnime ose fushata ndërgjegjësimi²²⁶, realizimi i 11 Podcasts²²⁷ për të trajtuar dhe diskutuar në lidhje me çështjet e barazisë gjinore dhe për promovimin e saj në diskursin publik. Programi i Ekselencës për Gratë në Bashki²²⁸ (#WoMEP) të dedikuar në fuqizimin e këshilltareve si lidere të këshillave bashkiake, me fokus të veçantë rritjen e aftësive të tyre drejtuese dhe menaxhuese, kuptimin më të mirë të vendosjes së prioritetëve zhvillimore për qeveritë lokale, si dhe menaxhimin e buxheteve e politikave fiskale bashkiake. Rrjeti Shqiptar për Fuqizimin e Grave/AWEN²²⁹, që ka në përbërje 10 OJF ka pasur mbështetje të vazhdueshme financiare²³⁰ me një financim prej 24,3 MSEK (rreth 2,1 M EUR). E njëjta mbështetje²³¹ ofrohet nëpërmjet fazës së I-rë dhe II-të nëpërmjet Programeve të Përbashkëta të OKB-së ‘Ti japim fund dhunës ndaj Grave’, si dhe përmes programit të Policimit në Komunitet. Mbështetje me fonde rajonale²³² për të fuqizuar shërbimet re-integruese për gratë, viktimat të dhunës në familje. Rritja e kapaciteteve të stafeve të OJF-ve që punojnë për DHBGJ, gjyqësorit dhe institucioneve ka qenë në fokus të programit të trajnimit ndërkombëtar²³³ organizuar²³⁴ në pesë vitet e fundit. Janë zhvilluar dokumente programore për të parandaluar dhe reaguar ndaj dhunës me bazë gjinore nëpërmjet të cilave janë identifikuar dhe mbështetur²³⁵ OJF-të që punojnë në këtë fushë, janë mbështetur strehëzat për viktimat e trafikimit, u janë ofruar shërbime të ndryshme të mbijetuarave, duke paguar një pjesë të shpenzimeve (pjesërisht, sepse Qeveria e Shqipërisë dhe donatorë të tjerë kanë mbështetur financiarisht pjesa tjetër).

222. Bashkia Durrës financon Qendrën Komunitare “Sot për të Ardhmen”

223. Bashkia Lushnje

224. Bashkia Vlorë mbështet financiarisht Qendrën Vatra Vlorë

225. Bashkia Lezhë

226. Mbështetur nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

227. <https://www.facebook.com/OSCE.Albania/posts/252262420280804>

<https://www.facebook.com/OSCE.Albania/posts/267438885429824>

<https://www.facebook.com/OSCE.Albania/posts/280476064126106>

<https://www.facebook.com/OSCE.Albania/posts/292508846256161>

<https://www.facebook.com/OSCE.Albania/posts/297971522376560>

<https://www.facebook.com/OSCE.Albania/posts/317684427071936>

228. Zbatuar nga OSBE në Shqipëri

229. ADA mbështet rrjetin AWEN me fonde rajonale për të fuqizuar shërbimet re-integruese për gratë, viktimat të dhunës në familje.

230. SIDA

231. SIDA

232. ADA mbështet rrjetin AWEN

233. Mbështetura nga Sida

234. Policia Suedeze dhe Fondacioni Kvinna till Kvinna

235. UNICEF

20. Çfarë veprimesh ka ndërmarrë vendi juaj për të trajtuar portretizimin e grave dhe vajzave, diskriminimin dhe/ose paragjykimet gjinore në media, përfshirë mediat sociale gjatë pesë viteve të fundit?

Policia e Shtetit me qëllim parandalimin dhe eliminimin e çdo lloj forme të mundshme diskriminimi apo publikimi të materialeve, në internet, ka arritur vendosjen e bashkëpunimit me Kompaninë Meta Platforms INC dhe kompaninë e rrjetit social Tik-Tok. Kjo marrëveshje është arritur pas takimit të realizuar në muajin shkurt 2024 me përfaqësueset/përfaqësuesit e kompanisë Tik Tok të cilat/cilët, do të mundësojnë kthimin e përgjigjeve Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Kompjuterike, në Policinë e Shtetit për çdo hetim ku është i përfshirë Tik Tok, si dhe do të duhet të mbyllin të gjitha faqet që përmbajnë pamje e video të papërshtatshme, përfshirë këtu edhe problematikat ndërmjet të miturave/miturve.

Në muajin prill 2023, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin Nr.30/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, ku u përfshi dhe përkufizimi i seksizmit në media. Ligji nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar është tërësisht i përafuar me acquis komunitarire të Bashkimit Evropian, konkretisht me Direktikën 2010/13/EU “Audiovisual Media Directive” të amenduar me Direktivën 2018/1808 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, që ka garantuar shprehimisht mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore, si dhe respektimin e dinjitetit njerëzor, në transmetimet audiovizive. Konkretisht duke u fokusuar tek çështjet e barazisë gjinore ligji nr. 97/2013 i ndryshuar ka parashikuar: *Neni 32, pika 4: “... “Ofrues shërbimi mediatik audioviziv (OSHMA)” nuk transmetojnë programe me përmbajtje që të nxisin urrejtjen mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare dhe çdo formë tjetër diskriminimi.” Neni 42, pika 3/(b): “... Komunikimet me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive nuk lejohet ... të përfshijnë ose të mbështesin diskriminimin në bazë seksi, race ose origjine etnike, kombësie, moshe, besimi, feje, paaftësie ose orientimi seksual...” Neni 76, pika 1: “Shërbimet e ofruara sipas kërkesës së përdoruesit nuk lejohen të përfshijnë programe që nxisin urrejtjen mbi baza racore, etnike, gjinore, kombëtare ose fetare.”*

Gjithashtu, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) miratoi Kodin e Transmetimit të Mediave Audiovizive me vendimin nr. 60, datë 10.07.2023, në të cilin është shtuar një kapitull i veçantë, lidhur me luftën kundër seksizmit dhe portretizimit të stereotipeve gjinore në përmbajtjen mediatike audiovizive. Kodi është hartuar në zbatim të akteve dhe rekomandimeve ndërkombëtare, konkretisht të Rekomandimit Rec (2007)17 të Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare për standardet dhe mekanizmat e barazisë gjinore, Rekomandimit Rec (2017)9 të Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare mbi barazinë gjinore në sektorin e medias audiovizive, po ashtu edhe në përputhje me Strategjinë Kombëtare për barazinë gjinore 2021-2030. Kodi shprehimisht garanton mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, përfshirë promovimin e barazisë gjinore, parandalimin e diskriminimit gjinor dhe luftimin e seksizmit në mediat audiovizive. AMA, në cilësinë e autoritetit rregullator në fushën e mediave audiovizive, mban në vëmendje të veçantë e të vazhduar të gjitha përmbajtjet audiovizive të cilat duhet të garantojnë respektimin e kërkesave ligjore lidhur me problematikën e barazisë gjinore gjatë transmetimeve të tyre.

Pavarësisht përmirësimeve ligjore nuk janë parashikuar masa konkrete për platformat dhe rrjetet sociale, ku është evidentuar gjuhë seksiste dhe gjuhë urrejtje e shtuar ndaj komuniteteve dhe personave të ndryshëm përfshirë dhe komunitetin LGBTIQ+, sidomos gjatë vitit 2023. Avokati i Popullit e adresoi këtë problematikë të evidentuar, që cenon të drejtat e komuniteteve të ndryshme duke rekomanduar “*Marrjen e masave, për disa*

ndryshime legislative, me theks parandalimin e seksizmit në media dhe trajtimin e problemeve të gjeneruara nga ky fenomen”, duke i kërkuar institucioneve përgjegjëse të ndryshojnë dhe përmirësojnë legjislacionin, konkretisht Ligjin Nr.9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, Kodin Zgjedhor, Ligjin për Kinematografinë, Ligjin Nr.97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, etj.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bashkëpunim me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve gjithashtu kanë hartuar/nxjerrë në një rekomandim të përbashkët, ku kanë theksuar nevojën dhe detyrimin e partive politike si dhe organeve të medias, për respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, frenimin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes dhe stereotipizimit të grave në politikë, etj., referuar situatës së zgjedhjeve të viti 2021 (për më shumë detaje për këtë rekomandim referohuni te përgjigja e pyetjes 22 e këtij raporti).

Gjithashtu, në këtë drejtim edhe Bashkitë luajnë rol me rëndësi në edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut për portretizimin e grave dhe vajzave, diskriminimin dhe/ose paragjykimet gjinore në media, përfshirë mediat sociale, si dhe për rritjen e ndërgjegjësimin për adresimin e stereotipeve gjinore që përjetësojnë gratë nga media, përfshirë mediat sociale. Janë organizuar trajnime, me pjesëmarrjen e gazetareve/gazetarëve të qytetit, në të cilat është trajtuar tema mbi diskriminimin e grave dhe paragjykimet gjinore në media, për privatësinë dhe konfidencialitetin e çështjeve që lidhen me fëmijët, vajzat dhe gratë²³⁶.

Përpjekje për të adresuar portretizimin e grave dhe vajzave në media ka pasur edhe nga organizata të shoqërisë civile²³⁷, që kanë reaguar publikisht kundër dhunës digjitale, diskriminimit dhe paragjyimeve gjinore, duke i kërkuar Autoritetit të Mediave Audiovizive të trajtojnë me seriozitet përdorimin e gjuhës së urrejtjes në media, diskriminimin dhe paragjykimin, veçanërisht të drejtuar ndaj vajzave dhe grave.

21. Çfarë veprimesh ka ndërmarrë vendi juaj për të trajtuar dhunën ndaj grupeve të marginalizuara të grave dhe vajzave gjatë pesë viteve të fundit?

Në përgjigjet e pyetjeve të mësipërme (15-20) janë sqaruar masat e ndërmarra nga vendi për të trajtuar dhunën ndaj grupeve të marginalizuara të grave dhe vajzave, konkretisht grupet e cenueshme si viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit, dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje, nënat e reja, personat me aftësi të kufizuara, minoritetet, personat LGBTIQ+, të moshuarat/moshuarit, etj. Të gjitha këto grupe janë përfshirë/targetuar në ligjet e reja apo të përmirësuara mbi: shërbimet e kujdesit shoqëror, punësimin dhe programet e tij, sigurimet shoqërore, sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, strehimin social, pronësinë, ndihmën juridike, përshtatjen dhe aksesueshmërinë, mbrojtjen e fëmijëve, Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitura/Mitur, Kodin e Procedurave Penale, etj.

Gratë LGBTIQ+. Policia e Shtetit ka përmirësuar sistemin kompjuterik të përpunimit të të dhënave statistikore mbi krimet e urrejtjes, ku për çdo vepër të Kodit Penal, gjenerohet e dhëna e motivit për shkak të orientimit seksual. Për vitin 2019 janë 7 raste dhe për vitin 2020 nuk ka pasur raste të regjistruara për krimin me bazë urrejtjen, për shkak të orientimit seksual. Policia e Shteti t dhe Akademia e Policisë kanë rifreskuar modulet e trajnimit për punonjësit e policisë mbi çështjet LGBTI. Gjithashtu, mund të përmendim edhe disa të dhëna të evidentuara në Progres Raportin e Shqipërisë të vitit 2023; *Gjuha e urrejtjes dhe gjuha diskriminuese në media, veçanërisht në internet, veprat penale dhe diskriminimi kundër anëtarëve të komunitetit trans vazhdojnë dhe duhet të adresohen. Në vitin 2022, KMD trajtoi një rast të gjuhës së urrejtjes kundër komunitetit LGBTIQ. Në vitin*

236. Aktivitete të realizuara nga Bashkitë Lezhë dhe Krujë

237. Qendra Vatra pjesë e Rrjetit AWEN dhe organizata të tjera

2023 janë regjistruar dhe janë në procedim dy raste të reja të gjuhës së urrejtjes. Sipas të dhënave të organizatave të shoqërisë civile të bazuara në një anketë, rreth 40% e njerëzve në komunitetin LGBTIQ raportuan incidente diskriminimi, nga të cilat vetëm 20% u raportuan në polici. Nga numri i përgjithshëm i rasteve të referuara, vetëm 15% janë zgjidhur.

Gratë me aftësi të kufizuara²³⁸. Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara ka rekomanduar se shteti shqiptar duhet: Të sigurojë që ligji për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare të zbatohet duke përfshirë perspektivën e aftësisë së kufizuar dhe të adresohen risqe të veçanta të dhunës me bazë gjinore dhe pengesat për mbrojtje me të cilat përballen gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara²³⁹. Gjithashtu, ky Komitet ngriti shqetësimet e mbledhjes së të dhënave bazuar në qasje mjekësore të aftësisë së kufizuar dhe të fragmentuar, mos mbledhjes sistematike të dhënave, si dhe mos realizimit të analizave të të dhënave të disagreguara mbi situatën e personave me aftësi të kufizuara në konsultim të ngushtë me organizatat e tyre përfaqësuese me qëllim hartimin e politikave publike të përshtatshme. Komiteti rekomandoi për shtetin shqiptar a) të ngrejë mekanizma për mbledhjen e të dhënave dhe procedura raportimi në përputhje me Konventën, të cilat të ndiqen nga Instituti i Statistikave; b) të mbledhë të dhëna mbi dhunën ndaj personave me aftësi të kufizuara; c) të zhvillojë politika publike bazuar në evidenca, në bashkëpunim me organizatat përfaqësuese. Strategjia e barazisë gjinore është një politikë gjithëpërfshirëse e barazisë gjinore që adreson diskriminimin e shumëfishtë dhe format ndërsektoriale të diskriminimit me të cilat përballen gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara.

3.4 PJESËMARRJA, LLOGARIDHËNIA DHE INSTITUCIONET E PËRGJIGJSHME GJINORE

FUSHAT KRITIKE TË MBULUARA

- | | | |
|--|---|------------------------|
| G. Gratë në pushtet dhe vendimmarrje | I. Të drejtat e njeriut të grave | L. Fëmija vajzë |
| H. Mekanizmat institucionalë për përparimin e grave | J. Gratë dhe media | |

22. Çfarë veprimesh dhe masash ka ndërmarrë vendi juaj për promovimin e pjesëmarrjes së grave në jetën publike dhe në vendimmarrje gjatë pesë viteve të fundit?

Kodi zgjedhor dhe roli i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Kodi Zgjedhor i ndryshuar në vitin 2020 sanksionon detyrimin e subjekteve zgjedhore, administratës zgjedhore dhe gjykatës për respektimin e parimit të barazisë gjinore. Në këtë kuadër, Kodi legjitimon KQZ-në që të ushtrojë kontroll në rastet e shkeljes së këtij parimi dhe të ndërhyjë kryesisht për rivendosjen e tij, edhe në raste mosveprimi. KQZ në ushtrim të këtij funksioni ndërmori procedurat e nevojshme për plotësimin e vakancave të krijuara në Kuvend²⁴⁰ nga dorëzimi i 58 mandateve duke respektuar kriterin e gjinisë. Gjithashtu, ndryshimet ligjore normojnë

238. Shih botimin: “Të merren masa për mbledhjen e të dhënave sistematike mbi dhunën me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara”, hartuar nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPK) në bashkëpunim me Aleanca LGBTI si dhe Qendrën për të Drejtat e Grave Rome, në kuadër të iniciativës “Sigurimi i pajisjeve të nevojshme teknologjike për vajzat dhe gratë që i përkasin grupeve shoqërore më të rrezikuara, për të aksesuar shërbimet me fokus dhunën ndaj grave e vajzave”.

239. Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2019). Vëzhgimet përmbyllëse mbi raportin fillestar të Shqipërisë. <http://docstore.ohchr.org/SelfServices/FilesHandler.ashx?enc=6QkG1d%2FPPRiCAqhKb7yhspdJq2SN0FynLS%2BUiWUaqofjmfOrHJ5MLWvzpC5ePiublk65eOKd%2FNGE6rLwV%2B8UH2qHAe2phpnAZHHFMFuZbruUZnINmuu8vWWy5fRMtguz>, par 31 dhe 32.

240. Në vitin 2019, Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim dorëzuan 58 mandatet që kishin në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë

detyrimin e subjekteve politike të respektojnë parimet e përfaqësimit gjinor edhe në përbërjen e Komisioneve zonale të Administrimit Zgjedhor. Shtimi i sanksioneve për shkeljet e neneve dhe rregullave vlerësohet si i domosdoshëm për garantimin e barazisë gjinore. Është evidentuar se Kodi Zgjedhor (2020) parashikon dy standarde ligjore për kuotën gjinore, në zgjedhjet parlamentare kuota është 30%, ndërsa në zgjedhjet vendore është 50 %. KQZ u ka vendosur sanksione subjekteve zgjedhore për mos zbatim të kuotës gjinore. Ndërkohë, Ligji për Barazinë Gjinore detyron të gjitha institucionet e sektorit publik, përfshirë anëtarët/anëtarët e Komisioneve të Zonave Zgjedhore, të kenë jo më pak se 30% personel të secilës gjini në përbërjet e tyre. Administrata e së KQZ-së garanton një përfaqësim gjinor në 66 gra dhe 27 burra.

Pjesëmarrja në vendimmarrjen politike qendrore. Shqipëria ka hedhur hapa të rëndësishëm për promovimin e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrjen politike, sidomos në nivelin qendror. Numri i deputeteve gra në Kuvendin e Shqipërisë ka ardhur duke u rritur, nga 36 (29.5%) në vitin 2019, në 50 (35.7%) në vitin 2024. Në zgjedhjet Parlamentare/për Kuvendin, të datës 25 Prill 2021, u regjistruan 1841 kandidatë/kandidatë (732 gra dhe 1109 burra) dhe u zgjodhën 140 deputete/deputetë (50 gra dhe 90 burra). Që nga viti 2021, Kryetarja e Kuvendit është grua, pozicioni i Nënkretares/Nënkretarit mbahet nga një grua dhe një burrë. Në kabinetin qeveritar Kryeministri është burrë dhe pozicioni i Zëvendës Kryeministres është grua. Gjithashtu, është rritur numri i grave ministre, nga 6 gra në vitin 2019, në 10 gra në 2024. Në pesë ministritë me portofol buxhetor më të lartë për vitin 2024, tre drejtohen nga ministre gra.²⁴¹ Deri në vitin 2020, Ministria e Mbrojtjes (MM) drejtohej nga një grua, detyrë e mbajtur nga një grua që prej vitit 2013 në Shqipëri.²⁴² Kryenegociatorja për Integrimin Evropian është gjithashtu një grua. Sipas të dhënave për vitin 2022, katër gra janë Kryetare të Komisioneve Parlamentare (nga 8 komisione gjithsej) dhe një grua është Kryetare e Grupit Parlamentar (nga 4 grupe gjithsej).²⁴³

Në vitin 2020, një deputete shqiptare u emërua për herë të parë në postin e Zëvendës presidentes së Asamblesë Parlamentare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut.²⁴⁴ Gjykata Kushtetuese në vend drejtohet që prej vitit 2019 nga një grua.²⁴⁵ Sa i përket sistemit të drejtësisë, në Gjykatën e Lartë 15.4% e anëtareve/anëtarëve janë gra. Në Gjykatat e Apelit, gra Kryetare janë në masën 20%, ndërsa në gra Gjyqtare janë 39.7%. në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, gra Kryetare janë 45%, ndërsa gra Gjyqtare janë 50.7%. Në Gjykatat Administrative, gra Kryetare janë 33.3% ndërsa gra Gjyqtare janë 41.2%. Në Gjykatat e Apelit Administrativ, 66.7% janë gra Gjyqtare.²⁴⁶

Vendimmarrja politike vendore. Për zgjedhjet vendore të datës 30 Qershor 2019, u regjistruan 97 kandidatë/kandidatë për kryetare/kryetar bashkie (11 gra dhe 86 burra) dhe rezultuan fituese/fitues 61 kryetare/kryetarë bashkie (8 gra dhe 53 burra). U regjistruan si kandidatë/kandidatë për anëtare/anëtarë të këshillave bashkiake gjithsej 9882 persona (4842 gra dhe 5040 burra) dhe rezultuan fituese/fitues 1621 anëtare/anëtarë të këshillit bashkiak (707 gra dhe 914 burra). Në zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 06.03.2022 u regjistruan gjithsej 19 kandidatë/kandidatë për kryetare/kryetarë bashkie (3 gra dhe 16 burra) në 6 bashkitë u zhvilluan këto zgjedhje dhe rezultuan fituese/fitues 6 kryetare/kryetarë bashkie (2 gra dhe 4 burra). Pra numri i grave kryetare bashkie mbetet vërtet në shifra të ulëta dhe përgjithësisht pozicioni i grave/të rejave/vajzave në vendimmarrjen politike, sërish lë për të dëshiruar, sidomos nëse analizojmë përfaqësimin e grave/të rejave/vajzave nga grupe të cënueshme, që pësojnë diskriminim për shkak të përkatësisë së shumëfishtë e të ndërthurur (intersectionality).

241. Pesë ministritë me portofol buxhetor më të lartë për vitin 2024 janë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Infrastrukturës dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit si dhe Ministria e Mbrojtjes. Tre të parat drejtohen nga ministre gra. Shih: <https://arkiva.financa.gov.al/akti-normativ-nr-1-date-21-02-2024/>

242. Shih njoftimin për emërimin e ministres së parë grua, në: <https://www.facebook.com/MinistriaMbrojtjes/videos/marrja-e-detyr%C3%ABs-nga-ministria-e-mbrojtjes-znj-mimi-kodhe-li/592779867452215/>

243. INSTAT, "Burra dhe gra, 2023", fq. 109

244. Plani i Veprimit për Zbatimin e Rezolutës 1325 "Gruaja, paqja dhe Siguria" 2023-2027, fq.14.

245. Shih: [Gjykata Kushtetuese \(gjk.gov.al\)](https://gjk.gov.al)

246. INSTAT "Burra dhe gra, 2023", fq. 113.

Ndërgjegjësim dhe edukim për të drejtat e zgjedhëseve/zgjedhësve ka qenë në fokus të punës të KQZ-së që ka marrë disa masa për parandalimin e diskriminimit dhe promovimin e të drejtave të grupeve të nën përfaqësuar të grave dhe vajzave në procesin zgjedhor, të cilat përfshijnë: (i) Organizimin e fushatave informuese dhe edukuese për të rritur ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen e grave/të rejave/ vajzave në procesin zgjedhor, duke theksuar rëndësinë e votimit dhe të drejtave të tyre zgjedhore (25 takime edukuese, informuese me gratë e komunitetit rom në periudhën janar – mars 2023)²⁴⁷. Në këto takime është bërë thirrje për të kontrolluar emrin në Listën e Zgjedhëseve/Zgjedhësve dhe Qendrën e Votimit; (ii) Bashkëpunimi me OSHC dhe grupet e interesit për të monitoruar dhe raportuar raste të mundshme të diskriminimit gjatë procesit zgjedhor dhe për të ofruar mbështetje dhe ndihmë sipas nevojës; (iii) Krijimi i platformave dhe mekanizmave për të dëgjuar dhe adresuar shqetësimet dhe nevojat e grave/të rejave/vajzave në lidhje me procesin zgjedhor; (iv) Spote në TV dhe radio dedikuar grave/të rejave/vajzave rreth rëndësisë së përfshirjes së tyre në procesin zgjedhor, etj. KQZ ka hartuar një program të detajuar për informimin, edukimin dhe sensibilizimin e zgjedhëseve/zgjedhësve, me fokus të veçantë gratë/të reja/vajzat dhe rolin që ato duhet të kenë në zgjedhje.

Roli i institucioneve të pavarura të të drejtave të njeriut. Studimi i publikuar në vitin 2019 nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD)²⁴⁸ përbën përjashtjen e parë institucionale të konfigurimit gjinor në përbërjen e organeve të emëruara të pushtetit vendor nga i cili rezultoi se: a) nga 58 bashki që kanë dhënë informacion, 37 kanë më shumë se 1 zëvendëskryetare/zëvendëskryetar dhe 21 kanë vetëm një zëvendëskryetar (asnjë grua); b) në 20 bashki me të vetmin zëvendëskryetar burrë, asnjë nuk drejtohet nga kryetare grua. Nga 37 bashki me 2 apo më shumë zëvendëskryetare/zëvendëskryetarë, vetëm 15 kanë respektuar kuotën gjinore me 30% apo më shumë. 20 nga 37 bashki nuk kanë asnjë grua zëvendëskryetare megjithëse bashkia ka në strukturë të paktën 2 të tillë; c) nga 343 administratore/administratorë të emëruar në këto 58 bashki, janë vetëm 52 gra (ose 15%). Në përfundim të zgjedhjeve vendore të vitit 2023 në Shqipëri dhe shpërndarjes së mandateve të kryetareve/kryetarëve të njësive të vetëqeverisjes vendore, KMD dhe Avokati i Popullit (AP) me një rekomandim të përbashkët dhe në bashkëpunim me organizatat mbështetëse të kësaj nisme, rekomanduan sigurimin e përfaqësimit të balancuar gjinor në organet e emëruara të pushtetit vendor në Shqipëri, në zbatim të legjislacionit shqiptar, si edhe në përputhje me dokumentet ndërkombëtare të nënshkruara e ratifikuara.

Duke pasur si fokus fushatën zgjedhore të datës 25.04.2021, KMD në bashkëpunim me KQZ kanë dalë në një rekomandim të përbashkët, ku kanë theksuar nevojën dhe detyrimin e partive politike si dhe organeve të medias, për respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit. Konkretisht është rekomanduar që: partitë politike dhe organet e medias të shqyrtojnë miratimin apo të mbështeten në Kode të Sjelljes për fushatat zgjedhore në të cilat të ekzistojnë rregulla mbi diskriminimin, ngacmimin dhe gjuhën e urrejtjes; partitë politike, kandidatë/kandidatët, si dhe njerëzit që punojnë për ta, duhet të refuzojnë që në programet dhe fushatat e tyre të përdorin gjuhë diskriminuese ose të propozojnë politika dhe ligje diskriminuese, të shprehin ose mbështesin ide apo teori të superioritetit të një grupi personash bazuar në racën, origjinën etnike, fenë, gjininë, moshën, orientimin seksual, identitetin gjinor, aftësinë e kufizuar si dhe karakteristika të tjera të mbrojtura ose një kombinim i tyre; organet mediatike në mbulimin e fushatave zgjedhore prej tyre, të refuzojnë të përdorin apo të mbështesin gjuhë urrejtje; partitë politike të sigurojnë në listat e tyre një përfaqësim që pasqyron diversitetin e njerëzve në shoqëri etj.

Avokati i Popullit (AP) në partneritet me KMD realizoi gjatë vitit zgjedhor 2021 studimin “Dhuna ndaj grave në politikë”²⁴⁹, nisur nga problematika të tilla si përdorimi i gjuhës seksiste dhe diskriminuese gjatë fushatës zgjedhore. Analiza tematike identifikoi forma të ndryshme të dhunës që përjetojnë gratë në vendimmarrjen politike, si: përçmim dhe gjuhë ofenduese; ndërprerje e fjalës, tallje, fyerje, batuta; akuza të rreme në media; kërcënime; vënie në dyshim e aftësive të tyre; heqja nga listat e kandidatëve/kandidatëve të partisë; refuzimi i aksesit në financat e partisë gjatë fushatave zgjedhore; shkarkimi ose kërcënimi për shkarkimin e

247. Me mbështetjen e Qeverisë Britanike dhe dy organizatave që mbrojnë interesat e romëve “Voice of Roma” dhe “Irca”.

248. “Barazia gjinore dhe diskriminimi në organet e emëruara të pushtetit vendor” në bashkëpunim me UN Women Shqipëri

249. Mbështetur me ekspertizë teknike nga UNDP në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “T’i japim fund Dhunës ndaj Grave në Shqipëri”, financuar nga Qeveria e Suedisë.

tyre (dhe anëtareve/anëtarëve të familjes së tyre) nga poste shtetërore; akuza të rreme dhe thashetheme të natyrës seksuale; ngacmim seksual; injorim gjatë takimeve; konsiderimi i kontributit të tyre si pak ose aspak i rëndësishëm; kufizimi i rolit në votimin e vendimeve të paracaktuara; manipulimi i votës së grave gjatë procedurave të votimit; përjashtimi nga informacioni, etj. Për gratë që janë përpjekur të arrijnë pozicione drejtuese në parti – partia ku ato aderojnë është burimi kryesor i dhunës. Bazuar në këto gjetje, AP u adresoi rekomandime partive politike, organizatave politike të grave, KQZ, organizatave të shoqërisë civile, institucioneve të drejtave të njeriut, mediave.

Përfaqësimi në misionet diplomatike. Për vitin 2021, pjesëmarrja e grave në misionet diplomatike rezultoi si në vijim: 30.8% gra Ambasadore, 66,7% Ministre Fuqiptotë, 46,2% Ministre Këshilltare, 56,5% Këshilltare, 63,6% Sekretare të Para, 59% Sekretare të Dyta dhe 50% Sekretare të Treta.²⁵⁰

Përfaqësimi në strukturat e policisë. Në strukturat e policisë, numri i punonjëseve gra është shumë i ulët dhe nuk ka ndryshime të konsiderueshme në pesë vitet e fundit. Për vitin 2022, ndër 10,868 punonjëse/punonjës të policisë, klasifikuar sipas gradave dhe gjinisë, 14,8 % janë gra. Në nivelet e larta drejtuese, asnjë grua nuk ka qenë në pozicionin Drejtuese Madhore. Në vitin 2022, vetëm 1 grua zë nivelin e Drejtueses së Parë. Numri i punonjëseve gra vjen duke u rritur me uljen e nivelit të gradave dhe arrin nivelet më të larta për gradat Inspektore dhe Civile. Në vitin 2022, në totalin e grave të punësuar, gratë Inspektore përbëjnë 41,1 % dhe gratë Civile 38,2 %. Numri i burrave në strukturat e Policisë është shumë i lartë krahasuar me numrin e grave, me përjashtim të nivelit Civil, ku numri i grave tejkalon atë të burrave.²⁵¹ Politikat për çdo konkurrim në Akademinë e Sigurisë, bazohen në Rregulloren e Policisë së Shtetit²⁵², sipas së cilës “Në kuotat e pranimi për çdo konkurrim, përcaktohen edhe kuotat për gjininë më pak të përfaqësuar, fëmijët e punonjëseve/punonjësve të policisë të rënë në krye të detyrës dhe minoritetet”.²⁵³ Janë zhvilluar takime në të gjitha drejtoritë e qarqeve, për promovimin e sistemit arsimor të Akademisë së Sigurisë, duke evidentuar rëndësinë dhe nevojën e kandidateve të reja/gra për pranimin në Policinë e Shtetit. Në të gjitha grupet promovuese, marrin pjesë të reja /gra nga Drejtoritë Vendore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.²⁵⁴ Në këto takime vihet re një rritje e pjesëmarrjes dhe interesit të të rejave/grave për të aplikuar dhe për të qenë pjesë e forcave të Policisë së Shtetit. Gjithashtu, në vitin 2023 është bërë aktive *Shoqata e Grave në Policinë e Shtetit*²⁵⁵, e cila ka zhvilluar takime konsultative në Drejtorinë e Anti-terrorit, disa Drejtori Vendore të Policisë si dhe në Akademinë e Sigurisë, për çështjet e punonjëseve të reja/gra në Policinë e Shtetit (viti 2023).

Përfaqësimi në forcat e armatosura. Për herë të parë në vitin 2019 mori pjesë në mision në Afganistan një grua nëntogere në detyrë komandante toge; dhe po për herë të parë në prill 2019, 2 ushtarake gra oficere u bënë pjesë e misionit të Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut. Nga viti 2019, pjesëmarrja në misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut, ka vijuar me 2 gra ushtarake në vitin 2020; 1 grua ushtarake në vitin 2021; asnjë grua ushtarake në vitin 2022 (2 burra ushtarakë në këtë vit); 1 grua ushtarake në vitin 2023 dhe 2 gra ushtarake në vitin 2024.²⁵⁶ Në vitin 2019, gratë në forcat e armatosura përfaqësoheshin me 19,4%,²⁵⁷ ndërkohë që ky përfaqësim në vitin 2022 bie në 15,0%. Në vitin 2022, në totalin e grave të punësuar me gradë, gratë Oficere përbëjnë 40,9 %.²⁵⁸ Për vitin 2023, 4955 janë burra nën uniformë dhe 899 gra nën uniformë (ose 15.3%).

250. INSTAT “Burra dhe gra, 2023”, fq. 111.

251. INSTAT, “Burra dhe gra, 2023”, fq. 105. Shih: <https://www.instat.gov.al/al/publikime/librat/2023/burra-dhe-gra-2023/>

252. Miratuar me VKM nr. 750, datë 16.09.2015, ndryshuar me VKM 1143, datë 09.12.2020, ku në nenin 128, pika 2 përcaktohen “Kuotat për konkurrim”.

253. Ndryshuar (shtuar fjalë në pikën 2) me VKM nr. 1143, datë 9.12.2020

254. Sipas Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.1426, datë 06.10.2023.

255. Me Vendimin e Gjykatës Nr. 1124/1, datë 21.07.2023

256. Për detaje lutemi referohuni në tabelën në shtojcën IV të këtij raporti.

257. Raporti i V-të i shtetit për zbatimin e Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, 2021, paragrafi

122. Shih: <https://www.ecoi.net/en/file/local/2046178/N2226977.pdf>

258. INSTAT, “Burra dhe gra, 2030”, fq. 106. Shih: <https://www.instat.gov.al/al/publikime/librat/2023/burra-dhe-gra-2023/>

Vendimmarrja dhe biznesi. Në vitin 2022, përqindja e grave pronare ose administratore në ndërmarrjet aktive ishte 31,2% (nga 31,1% që ishte në vitin 2021). Përqindja e pronareve ose administratoreve gra është më e lartë në ndërmarrjet e vogla (me 1-4 të punësuar/punësuar) me 32,5 % gra, përqindje kjo më e lartë, krahasuar me vitin 2021. Në kategoritë e tjera të ndërmarrjeve (5-9, 10-49 dhe mbi 50 punonjëse/punonjës) përqindja e pronareve/administratoreve gra është rritur, krahasuar me vitin paraardhës. Numri i bizneseve me pronare ose administratore gra është më i madh në Sektorin e Shërbimit, sesa në Sektorin Prodhues, përkatësisht 33,4 % dhe 17,2 %.²⁵⁹ Përveç informacionit të dhënë në përgjigje të pyetjes 10 më sipër, në këtë raport (lidhur me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative 2024 – 2030), mbështetje për gratë në biznes është ofruar edhe përmes programit rajonal “Gratë në Biznes 2019-2022”.²⁶⁰ Si rrjedhojë e kësaj mbështetjeje, shërbimet këshillimore për ndërmarrjet e udhëhequra nga gratë ishin vazhdimisht në dispozicion gjatë gjithë periudhës së zbatimit të tij. Programi organizoi kurse të ndryshme trajnimi, webinarë ad-hoc dhe mentorim. Në vitin 2021 në Shqipëri kishte 17 projekte këshillimore lokale. Gjithashtu, fokusi i disa organizatave të shoqërisë civile mbetet rritja e përfaqësimit të grave në bordet drejtuese të kompanive, në përputhje me Direktivën e BE-së për rritjen e balancës gjinore në Bordet e Kompanive, miratuar në 17 tetor 2022.²⁶¹

Zbatimi i Parimeve të Fuqizimit të Grave. Parimet e Fuqizimit të Grave (PFG) janë një grup parimesh që ofrojnë udhëzime për biznesin se si të avancojnë barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në vendin e punës, treg dhe komunitet.²⁶² PFG informohen nga standardet ndërkombëtare të punës dhe të drejtave të njeriut dhe bazohen në njohjen dhe përgjegjësitë që bizneset kanë për të ndërmarrë veprime për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave. PFG-të janë mjeti kryesor për afrimin e korporatave në dimensionet e barazisë gjinore të Agjendës 2030 dhe OZHQ-ve. Duke iu bashkuar komunitetit të PFG-ve, biznesi/kompania tregon përkushtimin ndaj kësaj agjende në nivelet më të larta dhe punon në bashkëpunim me shumë palë, për të nxitur praktikën e biznesit që fuqizojnë gratë. Këto praktika përfshijnë pagë të barabartë për punë me vlerë të barabartë, praktika të zinxhirit të furnizimit të përgjigjshëm ndaj gjinisë dhe zero tolerancë ndaj ngacmimeve seksuale në vendin e punës. Gjatë vitit 2022, numri i nënshkrueseve/nënshkruesve të PFG-ve në Shqipëri u rrit në 38 kompani, nga 11 kompani që ishte në vitin 2021. Kjo përkthehet në veprime të brendshme dhe të jashtme nga partnerët e sektorit privat për të rritur ndërgjegjësimin për të drejtat e grave brenda kompanive të tyre dhe në komunitetet e tyre. Gjatë vitit 2023, mbi 40 gra sipërmarrëse shqiptare rritën aftësitë e rrjetëzimit dhe aksesin ndaj investitorëve potencialë të biznesit, duke përfshirë krijimin e lidhjeve me trembëdhjetë banka, kompani konsulence dhe komunikimi, të cilat janë pjesë e grupit nënshkrues të PFG-ve. Partnere nga sektori privat, gra sipërmarrëse, institucione qeveritare dhe përfaqësuese/përfaqësues të komunitetit ndërkombëtar krijuan rrjetëzime dhe diskutuan aksesin e ardhshëm në mundësitë e financimit, gjatë panairit të EXPO për Sipërmarrjen e Grave në Shqipëri, organizuar në Tiranë.²⁶³

Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029²⁶⁴, ndër të tjera përmban objektiva dhe masa për të fuqizuar vajzat dhe djemtë adoleshente/adoleshentë për të marrë pjesë veçanërisht në vendimmarrjen vendore përmes Këshillave Rinorë. Programe të ndryshme të zbatuara²⁶⁵, si ato për mbështetjen e krijimit të Këshillave Rinorë, U-Raport, Qytetet Miqësore për Fëmijët, UPSHIFT, PONDER etj., kanë mbështetur edukimin mediatik dhe politik, aftësitë e arsyetimit dhe debatit, dialogun me vajzat dhe djemtë për të ndikuar në vendimmarrje

.....
259. Po aty.

260. Program i përbashkët i SIDA dhe EBRD (me një financim për gratë në biznes në vlerën 73 MSEK).

261. Për më shumë shih: <https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2022/10/17/council-approves-eu-law-to-improve-gender-balance-on-company-boards/>. Organizata “Gratë në Borde, Shqipëri” (WOBAL) do të punojë në drejtim të zbatimit të kësaj direktive në Shqipëri.

262. Themeluar nga UN Women dhe UN Global Compact. Për më shumë shih: <https://www.weps.org/about>

263. Puna me bizneset dhe korporatat për nënshkrimin e Parimeve të Fuqizimit të Grave, si dhe aktivitetet e tjera në funksion të zbatimit të këtyre parimeve po mbështeten nga UN Women Shqipëri.

264. Shih: <https://riniafemijet.gov.al/2194-2/> Strategjia u hartua me mbështetjen e UNICEF, dhe masat e përmendura më sipër u përfshinë falë ekspertizës teknike të ofruar për këtë qëllim.

265. Me mbështetjen e UNICEF-it

për çështje që i prekin ato/ata. Takimet e Grupit të Deputeteve/Deputetëve “Miq të Fëmijëve”²⁶⁶ me djem dhe vajza adoleshente janë shumë të rëndësishme, pasi në këto takime deputetet/deputetët kanë mundësi të dëgjojnë prej vajzave e djemve çështje të ndryshme sociale dhe komunitare, duke përfshirë çështjet e pabarazisë gjinore, diskriminimit dhe përjashtimit etj.

Masa dhe veprime për përfshirjen e grave nga të gjithë grupet e shoqërisë në vendimmarrjen politike dhe publike në nivelin vendor janë parashikuar edhe si pjesë e politikës II të **SKBGJ 2021-2030**, fokusuar te krijimi i kushteve që mundësojnë pjesëmarrje dhe përfaqësim të barabartë në këtë drejtim. Nga monitorimi i zbatimit të këtyre masave për vitin 2022 rezultoi se 25% e aktiviteteve të parashikuara janë realizuar plotësisht, 62% pjesërisht dhe për 13% nuk ka informacion nga institucionet përgjegjëse mbi statusin e tyre të realizimit.²⁶⁷

Fuqizimi i grupeve të cënueshme për pjesëmarrjen në vendimmarrjen publike. Ndërhyrje të rëndësishme në këtë drejtim janë bërë veçanërisht me mbështetjen e Fondit të Përsheptimit të arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në Shqipëri, krijuar si bashkëpunim i Agjencive të Kombeve të Bashkuara me Qeverinë e Shqipërisë. Rezultatet nga zbatimi i fazës së dytë të këtij fondi, kanë adresuar edhe nevojën e fuqizimit të grupeve të cënueshme edhe në drejtim të nxitjes së pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrjen publike. Grupet e cënueshme, veçanërisht komunitetet rome dhe egjiptiane, PAK, të rejtat/rinjat, gratë dhe OSHC-të e fokusuar në të drejtat e tyre, u fuqizuan me informacion, njohuri dhe aftësi avokuese mbi të drejtat e tyre për të përfituar nga shërbime sociale, si dhe u angazhuan në mënyrë aktive në nivel vendor dhe kombëtar në forumet e avokimit dhe mekanizmat e konsultimit publik, në kërkim të të drejtave të tyre, si një mundësi për të ndikuar në planifikimin dhe vendimmarrjen gjithëpërfshirëse të politikave. Këto veprime sollën si rezultat përmirësimin e politikave vendore (p.sh. plane vendore sociale gjithëpërfshirëse, krijimin e shërbimeve të reja të kujdesit social, përgjigje më të mirë ndaj nevojave të komuniteteve vulnerabil, etj.).²⁶⁸

266. Grupi i Deputetëve “Miq të Fëmijëve” (GDMF) është grupim parlamentar vullnetar i 48 deputeteve/deputetëve, kryesuar nga kryetarja e Kuvendit dhe nuk ka natyrë politike. Ai përbëhet nga deputete/deputetë nga të gjitha grupeve parlamentare, që shprehin dëshirën për të kontribuar në adresimin e të drejtave të fëmijëve dhe realizimin e tyre në një mënyrë efektive gjatë ushtrimit të funksioneve legjislativ të Kuvendit, kontrollit parlamentar dhe gjatë diskutimit dhe miratimit të buxhetit të shtetit. Ky grupim është një vlerë e shtuar për të mbështetur dhe bashkëpunuar me të gjithë partnerët dhe grupet e shoqërisë të angazhuara dhe vetë fëmijët, në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe respektimin e tyre. Për më shumë shih: <https://www.parlament.al/struktura/9a2efb41-4237-4a38-8124-4d71d307c56c>

267. Raporti i monitorimit të zbatimit të SKBGJ 2021-2030, për vitin 2022, fq. 31.

268. Rezultate të suksesshme janë arritur veçanërisht nga zbatimi i projektit “Askush të mos mbetet pas II”, ku vetëm për vitin 2021, me mbështetjen e UNDP, më shumë se 1800 rome/romë dhe Egjiptiane/egjiptianë (371 familje) përfituan nga zbatimi i shërbimeve sociale të integruara në Lezhë, Krujë dhe Fier; 4 qendra komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara (Korçë, Shkodër, Roskovec dhe Pukë) u bënë funksionale dhe u fuqizuan kapacitetet e stafit të 13 qendrave komunitare përmes trajnimeve online dhe vizitave studimore; 6 organizata të personave me aftësi të kufizuara zbatuan projekte të granteve të vogla dhe fuqizuan kapacitetet e tyre për avokim, rrjetëzim dhe shprehje të të drejtave të tyre elektorale (që përfshijnë më shumë se 400 persona me aftësi të kufizuara). Me mbështetjen e UN Women, mbi 1200 gra dhe burra në 12 bashki ngritën zërin dhe morën pjesë në proceset e buxhetimit me pjesëmarrje; 840 gra dhe vajza vulnerabël, përfshirë të rejtat, të moshuarat, gratë rurale, gratë me aftësi të kufizuara dhe gratë e papuna kanë përfituar nga trajnimet dhe informimi dhe u fuqizuan të shprehin nevojat e tyre gjatë dëgjimeve buxhetore. Rreth 20% e shqetësimeve të ngritura janë diskutuar me bashkitë dhe u bënë prioritet në buxhetet e vitit 2022. Gjithashtu, kapacitetet e 30 përfaqësuesve/përfaqësuesve të OSHC-ve dhe 35 përfaqësuesve/përfaqësuesve të NJVV nga 12 bashki u fuqizuan jo vetëm për të aktivizuar dhe angazhuar komunitetin dhe gratë e të gjitha grupeve në buxhetimin me pjesëmarrje, por edhe për përpunimin dhe adresimin në mënyrë të duhur të nevojave të tyre. Rrjeti Prisma, po vijon të luajë rol të rëndësishëm në procesin e buxhetimit me pjesëmarrje.

23. Çfarë veprimesh ka ndërmarrë vendi juaj për të rritur aksesin e grave në shprehje dhe pjesëmarrje në vendimarrje në media, përfshirë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK) gjatë pesë viteve të fundit?

Gratë dhe të rejat luajnë një rol tepër të rëndësishëm në media dhe pozicioni i tyre si drejtuese edicionesh e programesh ka ardhur duke u përmirësuar. Ato kanë dhënë shembuj të profesionisteve të suksesshme që nga gazetaria në terren, e deri te modelet e drejtueseve të emisioneve me shikueshmëri më të lartë (prime time). Megjithatë, nevojitet ende shumë punë e përpjekje që gratë në media të zënë vendin që u takon sidomos në vendimarrjen mediatike.

Sfidat e profesionisteve gra në fushën mediatike mbeten të mëdha. Një studim²⁶⁹ i kryer mbi gratë në media në vitin 2020 evidentonte përqindjen e ulët të grave të ftuara në debatet me tema politike, ekonomike, etj., krahasuar me një prani më të lartë të tyre në programet talk show mbizotërimin e figurave gra dhe vajza në pozicionin e viktimës në shumë kronika dhe edicione; modelet e deformuara të gruas dhe vajzës në ekrane sidomos, po edhe në portale, të cilat dëmtojnë imazhin e vajzës/të resë/gruas dhe i japin frymëmarrje dhunës me bazë gjinore; kategoritë më të targetuara e të prekura nga gjuha e urrejtjes rezultojnë gratë, komuniteti Rom dhe Egjiptian, komuniteti LGBTIQ+, komunitetet fetare si edhe personat me aftësi të kufizuara; etj. Edhe pse situata nga viti 2020 ka ardhur duke u përmirësuar, nevojiten studime të tjera të ngjashme me të dhëna të krahasueshme për të arritur në konkluzione të përgjithësuara mbi pozicionin e grave në vendimarrjen mediatike.

Një tjetër studim i kryer në vitin 2021 “Dhuna ndaj grave gjatë zgjedhjeve dhe paragjykimet gjinore në mbulimin mediatik të zgjedhjeve të përgjithshme të Prillit 2021 në Shqipëri”²⁷⁰ evidenton se: Ndërsa ka shumë media që operojnë në Shqipëri, pronarët e mediave zakonisht ushtrojnë kontroll mbi përmbajtjen, duke kufizuar pavarësinë editoriale dhe duke inkurajuar autocensurën mes gazetarëve/gazetarëve, shumë prej të cilave/cilëve janë të punësuar/punësuar në mënyrë të pasigurt. Në të kaluarën, mediat kanë raportuar për raste të dhunës ndaj grave gjatë zgjedhjeve dhe dhunës ndaj grave në politikë, për shembull, rastet kur gratë candidate janë përballur me presionin për të dhënë dorëheqjen në vend që të zënë vendin e tyre si deputete, si dhe të sulmeve fizike ndaj grave candidate gjatë mitingjeve zgjedhore. Megjithatë, në tërësi, media shpesh nxit delegjitimimin e grave si aktore të qëndrueshme politike, duke i portretizuar gratë në jetën publike në mënyrë seksuale, duke raportuar pretendime të pabaza (dhe të parëndësishme) në lidhje me jetën e tyre personale, ose duke u fokusuar në veshjen dhe pamjen e tyre, në vend të punës dhe kontributit të tyre thelbësor në shoqëri. Pavarësisht se gratë përbënin 40% të kandidateve/kandidatëve për deputete/deputetë, në artikujt apo emisionet ku përmendeshin apo diskutoheshin kandidatet/kandidatët gjatë periudhës parazgjedhore vetëm 22% u dedikoheshin grave, ndërsa 78% burrave. Monitorimi sasior zbuloi një angazhim shumë të ulët nga media për çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e grave dhe barazinë gjinore. Vetëm 2% e artikujve apo transmetimeve në lidhje me zgjedhjet në periudhën parazgjedhore, 1% në periudhën zgjedhore dhe pas zgjedhore dhe 2% në periudhën që mbulon formimin e kabinetit të ri të ministere/ministrave përfshinin disa diskutime për të drejtat seksuale dhe riprodhuese, dhunën ndaj grave, të drejtat ekonomike, kulturore ose sociale të grave, ose pjesëmarrja politike e grave.

269. “Të ndryshosh narrativën për gratë në media”, mbështetur nga Fondacioni Friedrich Ebert. Shih: <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/17190.pdf>

270. Përgatitur nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të reja/Rinjve (Observatori) dhe mbështetur nga UN Women Shqipëri në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Fund dhunës ndaj grave në Shqipëri” financuar nga Qeveria e Suedisë nëpërmjet Fondit të Përsheptimit të OZHQ në Shqipëri. Shih: https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2022-06/media_brief_web.pdf

Organizimi i forumeve të përvitshme të gazetareve/gazetarëve²⁷¹, mentorimi dhe trajnimi i tyre për çështjet të barazisë gjinore, dhunës e mosdiskriminimit, është një praktikë shumë e mirë që ndikon në fuqizimin e rolit të grave në media. Shqipëria ka rritur dukshmërinë dhe ndërgjegjësimin për çështjet e barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave, përmes rritjes së raportimit të medias me ndjeshmëri gjinore. Gjatë vitit 2023 janë publikuar rreth 55 raporte mediatike me ndjeshmëri gjinore,²⁷² që mbulojnë buxhetimin e përgjigjshëm gjinor, pjesëmarrjen politike të grave dhe dhunën ndaj grave. Mbi 40 gazetarë/gazetare rriten kapacitetet e tyre, si dhe aftësitë e njohuritë e nevojshme për të raportuar në mënyrë efektive për dimensionet gjinore të buxheteve dhe ndikimin e tyre në segmente të ndryshme të shoqërisë, duke kontribuar në këtë rezultat.²⁷³

WikiGap²⁷⁴ është një iniciativë që synon të rrisë numrin e artikujve për gratë në Wikipedia në gjuhën shqipe. Në këtë kuadër, organizohen çdo vit takime (Edit-a-thons) me pjesëmarrjen e vullnetareve/vullnetarëve të cilat/cilët janë trajnuar se si të redaktojnë dhe shkruajnë artikujt. Vitet e fundit është rritur ndjeshëm numri i artikujve në gjuhën shqipe për gratë e suksesshme dhe frymëzuese shqiptare dhe joshqiptare.

Në vitin 2022, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) ndërmori një iniciativë për të përfshirë për herë të parë parimin e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit në Kodin e Transmetimit për Median Audiovizive dhe për këtë qëllim zhvilloi (gjatë periudhës janar – dhjetor 2022) katër dëgjesa publike. Ndryshimet synojnë përmirësimin e çështjeve të barazisë gjinore në media, shmangien e gjuhës seksiste dhe mbrojtjen e grave dhe vajzave viktimat të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje nga ri-viktimizimi gjatë raportimit të rasteve specifike në transmetimet mediatike.²⁷⁵

Në lidhje me pozicionimin e të rejave/grave në vendimmarrjen në TIK, siç u shpjegua edhe në përgjigjen e pyetjes 8 më sipër të këtij raporti, edhe pse numri i studenteve vajza të diplomuara në degën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) rezultojnë më të ulët se ai i djemve, në pozicionet drejtuese në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), si dhe në gradën shkencore “Doktor” në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit mbizotërojnë të rejat dhe gratë (përkatësisht me 55% dhe 62.3%).

Masat e marra për të rritur aksesin, përbalueshmërinë dhe përdorimin e TIK për gratë dhe vajzat (p.sh. qendrat e Wi-Fi falas, qendrat e teknologjisë në komunitet) janë realizuar edhe falë mbështetjes së organizatave ndërkombëtare. Për shembull, projekti BiblioTech²⁷⁶ përmes të cilit janë ngritur qendra të Wi-Fi në bibliotekat publike në disa qytete të mëdha, edhe pse i projektuar për vajza dhe djem, u shërben më së miri edhe të rejave/rinjve dhe grave/burrave, pasi qendrat ngrihen pranë bibliotekave publike. Ose bashkëpunimet e NJVV²⁷⁷ me përfaqësues/përfaqësues të industrisë së TIK, kanë mundësuar zona të sigurta interneti për vajza dhe djem. Filtrat e vendosur në këto zona, duke përfshirë shumë prej shesheve, parqeve dhe hapësirave të tjera publike, e bëjnë lundrimin të sigurt edhe për gratë.

271. Një praktikë e tillë e përvitshme zhvillohet në Shqipëri me mbështetjen e UN Women dhe çdo vit zgjidhen tematika të caktuara në fushën e barazisë gjinore, mosdiskriminimit dhe fuqizimit të grave.

272. Me mbështetjen e UN Women

273. UN Women i mbajti këto sesione për ngritjen e kapaciteteve me mediat gjatë gjithë vitit dhe në të gjitha fushat tematike, si dhe përmes forumeve mediatike.

274. Iniciativë që mbështetet nga Ambasada e Suedisë.

275. Autoriteti i Mediave Audiovizive, “Raport i Konsultimit publik të ndryshimeve të Kodit të Transmetimit Mediatik në Shqipëri”. Shih: ama.gov.al

276. Realizuar me mbështetjen e UNICEF

277. Bashkëpunimi i Bashkisë Tiranë me UNICEF

24. Ju lutemi, përshkruani mekanizmin aktual kombëtar të grave në vendin tuaj (njësi qeveritare dedikuar posaçërisht promovimit të barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave) dhe masat që vendi juaj ka marrë gjatë pesë viteve të fundit për ta krijuar dhe/ose forcuar atë.

Sipas legjisllacionit në fuqi²⁷⁸, autoriteti shtetëror përgjegjës për barazinë gjinore dhe luftën kundër dhunës në familje është ministria/ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore. Çështjet e barazisë gjinore për periudhën 2019 - 2024, vijnë në mbulohet nga **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)**, pra kjo ministri përfaqëson mekanizmin kombëtar për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në Shqipëri. Ky funksion në MSHMS ushtrohet dhe përmbushet përmes **rolit drejtues të Ministres në Këshillin Kombëtar të Barazisë Gjinore**, si dhe funksionimit të **Drejtorisë së Politikave të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore** përmes **Sektorit të Politikave të Barazisë Gjinore**.

Sektori i Politikave të Barazisë Gjinore përbëhet nga një shefe sektori dhe dy specialiste/specialistë. Gjatë vitit 2024 është hapur konkurs për të dy pozicionet të cilat/cilët pas përzgjedhjes, do të vijnë në punën, me detyra dhe përgjegjësi dedikuar çështjeve të barazisë gjinore dhe në përputhje me vizionin e mandatin e mekanizmit kombëtar të barazisë gjinore. Ky sektor koordinon punën me të gjitha ministrinë e linjës, institucionet e pavarura, njësitë e vetëqeverisjes vendore, organizatat e shoqërisë civile dhe ato ndërkombëtare, për çështjet e barazisë gjinore, fuqizimit të grave, si dhe zvogëlimit të dhunës në familje e dhunës me bazë gjinore. Në aspektin financiar, ka një rritje të buxhetit të këtij sektori kryesisht për pagat e personelit. Aktivitete të tjera lidhur me takimet informuese, fushatat ndërgjegjësuëse, fuqizimin e kapaciteteve të profesionisteve/profesionistëve, etj., zbatohen me mbështetjen financiare (shpesh edhe teknike) të organizatave ndërkombëtare.

Rrjeti i Nëpunësve/Nëpunës të Barazisë Gjinore. Institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor kanë detyrimin ligjor të bashkëpunojnë me ministrin/ministrin përkatëse/përkatës që mbulon çështjet e barazisë gjinore për të shkëmbyer informacion dhe për të lehtësuar përmbushjen e funksionit të saj/tij. Ky bashkëpunim dhe koordinim kryhet nëpërmjet Sektorit të Barazisë Gjinore. Për këtë qëllim, në çdo ministri është caktuar një **nëpunës/nëpunës e/i barazisë gjinore (NBGJ)** që trajton dhe adreson çështjet e barazisë gjinore dhe në secilën bashki emërohen një ose më shumë punonjëse/punonjës vendor të barazisë gjinore. Aktualisht janë caktuar NBGJ në 11 ministri, një pikë kontakti në Policinë e Shtetit si dhe 61 NBGJ të emëruara/emëruar në nivel vendor, të cilat/cilët në një pjesë të madhe të bashkive luajnë edhe rolin e koordinatores/koordinatorit vendor, për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje.

Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore (KKBGJ)²⁷⁹ është organi më i lartë këshillues për çështjet e barazisë gjinore dhe për sigurimin e integritetit gjinor në të gjitha fushat, veçanërisht në çështjet politike, sociale, ekonomike dhe kulturore. Këshilli ngrihet me Urdhër të Kryeministrit dhe rinovohet një herë në katër vjet. KKBGJ drejtohet nga Ministria/Ministri i MSHMS dhe në përbërje ka 9 përfaqësues / përfaqësues të ministrive të linjës në rang zëvendësministre / zëvendësministri dhe drejtuesesh / drejtuesish të lartë, si dhe tre përfaqësues / përfaqësues të shoqërisë civile, të cilat/cilët zgjidhen mbi bazën e një konkurrimi të hapur, duke pasur si kriter eksperiencën dhe kontributin për këto çështje.

Në nivel të Kuvendit, përveç **Aleancës së Grave Deputete**, çështjet e barazisë gjinore dhe të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje diskutohen (por edhe mbështeten e adresohen më tej) edhe në **Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, Nënkomisionin për Zhvillim të Qëndrueshëm, Grupimet**

278. Ligji Nr. 9770, datë 18.12.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri" dhe Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar.

279. Sipas Ligjit nr. 9770, datë 18.12.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri", nenet 11 dhe 12.

Vullnetare, etj. Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë ka si fusha të përgjegjësisë: marrëdhëniet e punës, çështjet sociale, sigurimet shoqërore, familja, gruaja dhe shëndetësia si dhe çështjet e agjendës së zhvillimit të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara dhe zbatimi i angazhimeve që rrjedhin prej saj. Nënkomisioni për Zhvillim të Qëndrueshëm²⁸⁰ ka si fushë të përgjegjësisë zhvillimin ekonomik dhe social, rritjen ekonomike të qëndrueshme, realizimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe Agjendën 2030 të OKB-së. Grupi Vullnetar për Popullsinë dhe Zhvillimin²⁸¹, ka si qëllim të avokojë për çështje që lidhen me popullsinë dhe zhvillimin dhe më konkretisht me shëndetin riprodhues, me çështje që lidhen me demografinë, moshimin, etj.

25. Çfarë mekanizmesh dhe mjetesh të tjera ka përdorur vendi juaj për të integruar barazinë gjinore në të gjithë sektorët? (p.sh. pikat fokale gjinore në Ekzekutiv, Legjislativ ose Gjyqësori; mekanizmat e koordinimit ndërministror; auditimet gjinore, konsultimet me organizatat e grave) gjatë pesë viteve të fundit?

Siç u sqarua në përgjigje të pyetjes 24 më sipër, integrimi i barazisë gjinore në të gjithë sektorët mundësohet përmes një sërë organesh, duke filluar nga:

- **Kuvendi i Republikës së Shqipërisë**, që sigurohet të përmbushë këtë detyrim përmes bashkëpunimit dhe mbështetjes së Ministrisë së Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale me strukturat e tilla si: Aleanca e Grave Deputetete, Komisioni për Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, Nënkomisionin për Zhvillim të Qëndrueshëm, Grupin Vullnetar për Popullsinë dhe Zhvillimin, etj.;
- **Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore**, si organi më i lartë këshillues për çështjet e barazisë gjinore dhe për sigurimin e integritetit gjinor në të gjitha fushat;
- **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**, si autoriteti kryesor përgjegjës dhe si institucioni qendror - mekanizëm kombëtar i barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave;
- **Nëpunëset/Nëpunësit e Barazisë Gjinore në nivelin qendror** (në ministritë e linjës);
- **Nëpunëset/Nëpunësit e Barazisë Gjinore në nivelin vendor** (në bashki).

Institucionet e pavarura (si Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Autoriteti i Mediave Audiovizive, etj.) dhe të të drejtave të njeriut (si Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi) Shkolla e Magjistraturës, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, Organizatat e Shoqërisë Civile, organizatat e punëtorëve/punëtorëve (sindikatat), organizatat ndërkombëtare dhe partnere/partnerë të tjerë të fokusuar në çështjet e barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave, gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm për integrimin e barazisë gjinore në të gjithë sektorët.

Integrimi gjinor ka vite tashmë që është prezantuar si një strategji për t'i përfshirë shqetësimet, përvojat dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave si pjesë të një dimensionit integral në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe programeve, në të gjitha sferat politike, ekonomike dhe sociale, në mënyrë që gratë dhe burrat të përfitojnë në mënyrë të barabartë dhe që pabarazia të mos përjetësohet. Po kështu edhe Buxheti Përgjigjshëm Gjinor është prezantuar si një mjet për të arritur integrimin gjinor. Analizat gjinore dhe vlerësimet e ndikimit gjinor po përdoren vazhdimisht si mjete të rëndësishme të kërkimore, gjetjet nga cilat po shërbejnë si udhërrëfyes për zhvillimin e një sërë dokumentesh të rëndësishme kombëtare. Proceset e konsultimeve me grupet e interesit, si organizatat e shoqërisë civile (me fokus të drejtat e grave, të rejtat/rinjë, barazinë gjinore, zhvillimin e qëndrueshëm, etj.), sindikatat, partnerët privatë, media, institucionet arsimore e shkencore, organizatat ndërkombëtare, etj., janë kthyer tashmë në mjete shumë të rëndësishme

280. Ngritur nga Kuvendi me vendimin nr. 34/2022 të datës 14.4.2022

281. Ngritur me Urdhër të Kryetares së Kuvendit nr 43, datë 18.07.2023

avokuese për hartimin e politikave sa më efektive, të përshtatshme e gjithëpërfshirëse. Gjatë periudhës 2019-2023 janë kryer një sërë analizash gjinore²⁸² dhe vlerësimesh të politikave ekzistuese, si dhe janë mbajtur një sërë takimesh konsultuese në kuadër të rishikimit të legjislacionit, apo përgatitjes së strategjive e planeve të veprimit, për të gjitha fushat kritike të Platformës për Veprim të Pekinit.

26. Nëse ka një institucion kombëtar për të drejtat e njeriut në vendin tuaj, çfarë masash ka marrë për të trajtuar shkeljet e të drejtave të grave dhe për të promovuar barazinë gjinore?

Institucioni i Avokatit të Popullit (AP), është përcaktuar si institucioni më i lartë kombëtar për promovimin, parandalimin e shkeljeve dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri. Në dhjetor 2020, AP u ri-akreditua me Statusin “A” nga Aleanca Globale e të Drejtave të Njeriut (GANHRI) që vlerëson dhe përcakton për llogari të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, cilësinë, standardet, peshën dhe rëndësinë e të gjitha institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut. AP në bashkëpunim me pushtetin vendor ka hapur edhe 7 zyra rajonale, me qëllim lehtësimin e komunikimit të qytetarëve/qytetarëve të këtyre zonave me institucionin, gjë që ka çuar në rritjen e besimit të qytetarëve tek AP.²⁸³ Mjeti ligjor që ka AP për vënien në vend të një të drejte të shkelur janë rekomandimet drejtuar institucioneve në nivel qendror dhe vendor, për marrjen e masave për problematikat e evidentuara nëpërmjet ankesave, rasteve me iniciativë, inspektimeve ose çështjeve të përcjella nga shoqëria civile. Dy shembuj që mund të përmendim në tërësinë e rekomandimeve të dhëna nga AP gjatë periudhës ku fokusohet ky raport, janë: rekomandimi i vitit 2022 për “Marrjen e masave për respektimin e të drejtave gjinore të bashkëpronësisë mbi banesat e përfituara nga grantet e rindërtimit si pasojë e dëmtimeve të tërmetit të vitit 2019”²⁸⁴, i cili ndikon drejtpërsëdrejti në përmirësimin e aksesit të grave në të drejtat pronësore, fuqizimin ekonomik të tyre; si dhe rekomandimi i vitit 2023 për “Marrjen e masave, për disa ndryshime legjislative, me theks parandalimin e seksizmit në media dhe trajtimin e problemeve të gjeneruara nga ky fenomen”, i cili ndikon drejtpërsëdrejti në ndalimin e përdorimit të gjuhës seksiste, si dhe të gjuhës së urrejtjeve për persona/grupe të caktuara, përfshirë anëtarët/anëtarët e komunitetit LGBTI+. Ky rekomandim u reflektua si në ndryshimet në ligjin për Mediat Audiovizive²⁸⁵ ku u përfshi dhe përkufizimi i seksizmit në media, edhe në Kodin e Transmetimit të Mediave Audiovizive²⁸⁶ miratuar në korrik 2023 nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, ku është shtuar një kapitull i veçantë, lidhur me luftën kundër seksizmit dhe portretizimit të stereotipeve gjinore në përmbajtjen mediatike audiovizive.

Në kuadër të mandatit të tij ligjor si promovues i të drejtave të grave dhe vajzave, avancimit të barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje, duke pasur parasysh këtu edhe përkatësinë e shumëfishtë (intersectionality), AP: (i) ka bërë deklaratat zyrtare në faqen zyrtare Web, mediave dhe platformës sociale FB, duke tërhequr vëmendjen e institucioneve, sidomos në rastet e dhunës në familje ose dhunës me bazë gjinore, që të intensifikojnë përpjekjet në mënyrë të koordinuar për t’ju përgjigjur viktimave/të mbijetuarave në kohë, me profesionalizëm dhe me shërbime të specializuara; (ii) ka organizuar vetë ose ka marrë pjesë në tryeza të rrumbullakëta mbi të drejtat e grave, ku ka ngritur rekomandimet e tij për fuqizimin e grave/vajzave, rritjen e buxheteve qendrore dhe vendore si mjete për adresimin e dhunës ndaj grave, fuqizimin e strukturave sociale dhe rolit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit në bashkitë e vendit për të garantuar

282. Realizuar sidomos me mbështetjen e UN Women, në bashkëpunim me organizata partnere të shoqërisë civile.

283. Përgjigjet e përgatitura nga Shqipëria në lidhje me listën e çështjeve të dërguara nga Komiteti CEDAW, korrik 2022, paragrafët 44 dhe 46.

284. Vendosur në dënimin nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare për garantimin e të drejtës së pronësisë për gratë bashkëshorte mbi pasuritë e paluajtshme, që përfitojnë me programet e rindërtimit të shtëpive të dëmtuara nga tërmeti i vitit 2019.

285. Ligjin Nr.30/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

286. Me Vendimin Nr. 60, datë 10.07.2023

mbështetjen e menjëhershme për viktimat e dhunës në familje, zbatimin e ligjit me korrektësi, si dhe nevojën e përmirësimeve ligjore për plotësimin e boshllëqeve në legjislacion; (iii) ka organizuar ditët e hapura në qytete dhe rajone të ndryshme të vendit, me synim informimin e sa më shumë qytetareve/qytetarëve nga të gjitha grupet, mbi rolin e institucionit dhe problematikat që mund të adresojnë.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²⁸⁷ (KMD), është një institucion i pavarur në ushtrimin e detyrës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë, ose për çdo shkak tjetër.²⁸⁸ KMD ka kompetenca për: ofrimin e ndihmës për viktimat e diskriminimit në ndjekjen e ankesave të tyre për diskriminim (shqyrtimin e ankesave, kryerjen e hetimeve administrative, vendosjen e sanksioneve administrative paraqitjen e padive dhe vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese); kryerjen e sondazheve të pavarura në lidhje me diskriminimin; monitorimin e zbatimit të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Ligjit për Barazinë Gjinore; publikimin e raporteve dhe dhënien e rekomandimeve për çdo çështje që lidhet me diskriminimin; rritjen e ndërgjegjësisë për nxitjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit; ofrimin e informacioneve të shkruara, në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave, si dhe në formate të përdorshme nga persona me aftësi të kufizuara; zhvillimin e dialogut të rregullt për çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë organizatat joqeveritare, etj.²⁸⁹

KMD për periudhën 2019 – mars 2024: (i) ka marrë pjesë në 482 procese gjyqësore, pozita procedurale e të cilit ka konsistuar si palë e paditur, palë e tretë apo palë kërkuese. (ii) i janë komunikuar 429 vendime gjyqësore, sipas gjykatave kompetente, për procese gjyqësore ku KMD ka marrë pjesë si palë e paditur (kur kërkohet shfuqizimi i vendimit të KMD-së), palë e tretë (kur kërkohet konstatimi i diskriminimit dhe dëmshpërblim) apo palë kërkuese (kur kërkohet lëshimi i urdhrat të ekzekutimit për vendimet e gjykatës të KMD-së). Nga këto vendime, në 115 raste, palë paditëse ose palë e tretë ka qenë një grua/e re/vajzë. Hetimi administrativ: gjatë vitit 2019, KMD ka marrë 1 vendim mospranimi (për shkak gjininë) dhe 2 vendime mosdiskriminimi (për shkak të gjinisë të shoqëruara me shkakun e bindjeve filozofike dhe gjendjes shëndetësore). Gjatë vitit 2020, KMD është shprehur me 7 vendime themeli mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të gjinisë dhe janë dhënë: 1 vendim diskriminimi, 3 vendime mosdiskriminimi, 2 vendime mospranimi, 1 vendim ndërprerje e procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore. Gjatë vitit 2021, KMD është shprehur me 15 vendime mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të gjinisë dhe janë dhënë: 3 vendime diskriminimi, 6 vendime mosdiskriminimi, 3 vendime ndërprerje e procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore, 2 vendime ndërprerje e procedurave hetimore pasi nuk është arritur të sigurohet informacioni i mjaftueshëm për të dalë me një vendim përfundimtar, 1 vendim pushimi për shkak se ankuesi i është drejtuar gjykatës për shqyrtimin e çështjes. Gjatë vitit 2022, KMD është shprehur me 7 vendime mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të gjinisë dhe janë dhënë: 2 vendime diskriminimi, 3 vendime mosdiskriminimi, 2 vendime mospranimi. Gjatë vitit 2023, Komisioneri është shprehur me 11 vendime mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të gjinisë dhe janë dhënë: 2 vendime diskriminimi, 5 vendime mosdiskriminimi, 4 vendime mospranimi. Pretendimet e hasura gjatë shqyrtimit të çështjeve lidhen kryesisht me diskriminimin në punësim (largim nga puna për shkak të gjinisë, trajtimi i pafavorshëm i punonjëseve / punonjësve gjatë marrëdhënieve të punësimit), trajtimin me strehim të përshtatshëm nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, trajtimin e qytetareve/qytetarëve nga forcat e policisë gjatë marrjes së kallëzimeve penale, përdorimi i gjuhës

287. Krijuar në bazë të Ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

288. Shih: <https://www.kmd.al/>

289. “Raporti Vjetor i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi 2023”, fq.28-30. Shih: <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2024/03/Raporti-i-KMD-2023.pdf>

së urrejtjes nga persona publikë, etj. Të dy këto institucione të rëndësishme janë mbështetur vazhdimisht edhe nga Agjencitë e Kombeve të Bashkuara: për të kryer ushtrime të ndryshme monitoruese në lidhje me të drejtat e fëmijëve (përfshirë të drejtën për mbrojtje nga dhuna, shfrytëzimi dhe abuzimi), të prekur nga COVID dhe tërmeti;²⁹⁰ për të zhvilluar materiale të ndryshme informative dhe aktivitete informuese – video, broshura, libra të ilustruar të praktikës gjyqësore, aktivitete në ditë të hapura, kanale online komunikimi, veçanërisht gjatë COVID, etj., sidomos me fokus vajzat dhe djemtë;²⁹¹ për të eksploruar mundësitë për të bashkëvepruar me Komitetin e Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) dhe Komitetin për të Drejtat e Fëmijëve (CRC), për të shpërndarë gjerësisht informacionin mbi vëzhgimet përfundimtare të këtyre Komiteteve, si dhe për të përgatitur dhe paraqitur raporte alternative për organet e Konventave;²⁹² për të ngritur observatorin e parë në Shqipëri për monitorimin e çështjes së vrasjes së grave (femicide);²⁹³ etj.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDMDHP) është institucion i pavarur i administratës publike që kryen hetim administrativ dhe ka të drejtën e aksesit në përpunimet e të dhënave personale, si dhe ka të drejtë të mbledhë të gjithë informacionin e nevojshëm për përmbushjen e detyrave të mbikëqyrjes; urdhëron bllokimin, fshirjen, shkatërrimin ose pezullon përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale; jep udhëzime përpara se përpunimet të kryhen dhe siguron publikimin e tyre. KDMDHP njihet dhe ka akses në informacionin dhe dokumentet, objekt ankimi, sipas ligjit “Për të drejtën e informimit” apo që lidhen me çështjen në shqyrtim, duke përfshirë edhe informacionet e klasifikuara “sekret shtetëror”. Të gjithë institucionet publike dhe private detyrohen të bashkëpunojnë me Zyrën e KDMDHP, duke i siguruar të gjithë informacionin që ajo kërkon për përmbushjen e detyrave ligjore.²⁹⁴ Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale është rishikuar në vitin 2023.²⁹⁵ Sipas Raport-progresit të KE për Shqipërinë 2023, për të siguruar përafrim efektiv me acquis të BE-së për mbrojtjen e të dhënave, kapacitetet e KDMDHP duhet të forcohen. Në vitin 2022, KDMDHP trajtoi 370 ankesa dhe kreu 48 inspektive administrative, duke nxjerrë 48 rekomandime dhe 63 sanksione administrative. Në përgjigje të rrjedhjeve masive të të dhënave personale në vitin 2021, KDMDHP nxori një vendim në nëntor 2022 që vendosi gjoba për Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave dhe Drejtorinë e Përgjithshme për Shërbimet e Transportit Rugor për përgjegjësinë e tyre përkatëse për shkeljet. Një gjetje ndërsektoriale e KDMDHP nga inspektimet e tij administrative ka qenë mungesa e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e të dhënave në administratën publike. Shqetësimet për trajtimin e të dhënave personale nga kompanitë private dhe administrata publike vazhduan edhe gjatë vitit 2022. Në përgjithësi, nevojiten masa mbrojtëse të forta ligjore dhe institucionale për të parandaluar shkeljet e të dhënave personale, për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për rreziqet përkatëse dhe për të rritur ndërgjegjësimin e institucioneve publike për detyrimet e përcaktuara në ligj.²⁹⁶

290. Avokati i Popullit u mbështet nga UNICEF në këtë drejtim.

291. Mbështetur sidomos nga UNICEF-i

292. Mbështetur sidomos nga UNICEF dhe UN Women

293. Bashkëpunim i UN Women me Avokatin e Popullit

294. <https://idp.al/rreth-nesh/>

295. Ligji nr. 78/2023, datë 21.9.2023 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 152, datë 20.10.2023. Ligji i plotë i përditësuar aksesohet në: <https://idp.al/wp-content/uploads/2024/01/Ligj-2008-03-10-9887-perditesuar-nga-QBZ-2.pdf>

296. Komisioni Evropian: Raport Progresi për Shqipërinë 2023, fq.30-31. Shih: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf

3.5 SHOQËRI PAQËSORE DHE GJITHËPËRFSHIRËSE

FUSHAT KRITIKE TË TRAJTUARA

E. Gratë dhe konfliktet e armatosura

I. Të drejtat e njeriut të grave

L. Fëmija vajzë

27. Çfarë veprimesh ka ndërmarrë vendi juaj për të ndërtuar dhe ruajtur paqen, për të promovuar shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm dhe për të zbatuar agjendën për gratë, paqen dhe sigurinë gjatë pesë viteve të fundit?

Shqipëria është zgjedhur për herë të parë në Këshillin e Sigurimit të OKB-së si anëtare jo e përhershme për periudhën kohore 2022-2023. Në kudër të këtij misioni është angazhuar për të promovuar shoqëri paqësore nëpërmjet qasjes gjinore duke u përqendruar në zbatimin e përforcuar të Agjendës “Gruaja, Paqja dhe Siguria” (Agjenda GPS), si dhe nëpërmjet proceseve të paqes me gjithëpërfshirëse, që respektojnë barazinë gjinore, fuqizimin e grave dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre.²⁹⁷ Rezoluta 1325, e miratuar nga Këshilli i Sigurisë i OKB-së (31 tetor 2000) vë theksin tek rëndësia e rolit dhe pjesëmarrjes së barabartë të grave në procesin e parandalimit dhe zgjidhjes së konflikteve, ndërtimin e paqes së qëndrueshme, duke vendosur në plan të parë agjendën për gratë, paqen e sigurinë në botë.

Shqipëria u është bashkuar vendeve që kanë një **plan për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për gruan, paqen dhe sigurinë”** (Rezoluta 1325) që në vitin 2018 kur miratoi edhe planin e parë të veprimit për zbatimin e saj.²⁹⁸ Gjatë zbatimit të Planit të Veprimit 2018-2020 u vu re një bashkëpunim aktiv mes institucioneve shtetërore përgjegjëse, organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë. Kjo qasje rezultoi në një realizim të 82% të masave të Planit të Veprimit 2018-2020.²⁹⁹ Qasja e ndjekur synoi në rritjen e numrit të grave dhe vajzave në sistem, si edhe pasjen e një sistemi që reflekton në tërësi aspektet e organizimit dhe funksionimit me ndjeshmëri gjinore. Edhe pse të dhënat flasin për një rritje të pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në forcat ushtarake, policore, apo edhe në sektorë të tjerë, numri i grave dhe vajzave në vendimarrje në sektorët e ruajtjes së sigurisë dhe paqes mbetet i ulët. Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë angazhuar në një numër të kufizuar aktiviteteve për Agjendën “Gruaja, Paqja dhe Siguria” (GPS), madje disa njësi të vetëqeverisjes vendore nuk e njohin Rezolutën 1325. Edhe ndërveprimi rajonal për Agjendën GPS u pa i nevojshëm të forcohet. Media dhe institucionet e arsimit të lartë u angazhuan në veprimtari të ndërlidhura me zbatimin e Agjendës GPS, por jo aktivisht.³⁰⁰

Pas miratimit dhe zbatimit të Planit të parë të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325, qeveria shqiptare, përmes Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, vijoi angazhimin dhe koordinimin e punës për të garantuar të njëjtën qasje ndaj kësaj politike dhe miratimin e Planit të dytë të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325.

297. Plani Kombëtar i Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për “Gruan, Paqen dhe Sigurinë” 2023 – 2027, fq.7

298. Me mbështetjen e UN Women, në bashkëpunim me Shoqatën e Grave me Probleme Sociale (SHGPS), sot Shoqata e Gruaja, Paqja dhe Siguria, përmes Fondit të Barazisë Gjinore.

299. Raporti i Monitorimit nr. 2, tetor 2019 - nëntor 2020, “Për zbatimin e Planit Ndërinstitucional të Veprimit për Zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, “Për Gruan, Paqen dhe Sigurinë” 2018 - 2020”, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Koalicioni për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, i përbërë nga mbi 30 OSHC kontribuoi gjithashtu në monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit 2018-2020.

300. Po aty.

Plani i dytë i Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325³⁰¹, për periudhën kohore 2023-2027, ka si vizion “Një shoqëri shqiptare ku gratë e vajzat kanë një rol të përforcuar dhe janë pjesëmarrëse aktive në ruajtjen e paqes, parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve, si dhe një shoqëri me kontribut të qëndrueshëm në nivel ndërkombëtar në garantimin e të drejtave të grave të përfshira në situatat e konfliktit”. Rritja e përfaqësimit dhe angazhimit të grave e vajzave në sektorin e sigurisë, duke reduktuar stereotipat gjinorë mbi përfshirjen e grave në proceset dhe pozitat vendimmarrëse në fushën e sigurisë, si dhe përforsimi i kontributit të vendit në një politikë ndërkombëtare garantuese të të drejtave të grave e vajzave të përfshira në situata konflikti dhe post-konflikti, janë konceptuar si pjesë e misionit që synohet të arrihet me zbatimin e këtij Plani të dytë të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325. Plani është në harmoni dhe respektim të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ 5 dhe OZHQ 16), në harmoni me Planin e Veprimit të NATO-s 2021-2027 për Agjendën GPS, i cili mbështet angazhimin e aleateve/aleatëve për të avancuar më tej barazinë gjinore, si dhe në harmoni me politikën e Bashkimit Evropian.

Vijimësia e politikës në kuadër të Agjendës GPS është pasqyrim i qëllimit për të përfshirë dhe pasur kontributin e grave dhe vajzave në jetën politike dhe publike në vend dhe për të shfrytëzuar kapacitetet e të gjithë shoqërisë. Një qasje më e thelluar ndaj sigurisë njerëzore, përfshirë aksesin në shkollim, kujdesin shëndetësor, mundësinë për të punuar dhe për të pasur qasje në drejtësi, ka marrë vëmendjen e nevojshme përmes këtij Plani të dytë të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325, duke vënë theksin edhe tek qasja inovative ndaj sigurisë e paqes, drejt një agjende që adreson sigurinë me një qasje më të butë ndaj sigurisë njerëzore, ekonomike apo edhe mjedisore. Pjesë e këtij Plani Veprimi janë masa që pasqyrojnë ndjeshmëri ndaj ndryshimeve klimatike, pasigurisë ushqimore, sëmundjeve pandemike si ajo e COVID 19, terrorizmit, krimit kibernetik, etj., që për nga natyra shtrihen përtej një shteti dhe destabilizojnë një vend po aq sa edhe cenimet apo pushtime territoriale. Siguria më e lartë njerëzore dhe qasjet inovative janë përfshirë edhe si një sugjerim i posaçëm i shoqërisë civile në vend. Bashkëpunimi brenda vendit, bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar është thelbësor për krijimin e një mjedisi të sigurt dhe të favorshëm për gratë e vajzat si ndërtuese të paqes, mbrojtëse të të drejtave të njeriut dhe aktiviste të shoqërisë civile. OSHC-të dhe aktorë të ndryshëm ndërkombëtarë luajtën një rol mjaft të rëndësishëm gjatë hartimit dhe zbatimit të planit të parë të veprimit si dhe gjatë hartimit të planit të dytë, e njëjloj pritet që të bashkëpunojnë edhe për zbatimin e tij. Totali i fondeve që nevojiten për të financuar këtë plan të dytë të veprimit, për pesë vitet e zbatimit të tij është 127,254,605 lekë, nga të cilat: 47,684,605 lekë janë për pagat dhe sigurimet për stafet e institucioneve qendrore dhe pjesa tjetër, 79,570,000 lekë, janë për trajnime/takime apo asistencë teknike. Hendeku i financimit është 16% ose 20,325,000 lekë, duke qenë se ende nuk janë marrë angazhime konkrete nga donatorët për zhvillimin e disa prej aktiviteteve që kanë lidhje me konferenca apo vizita studimore.

“Strategjia e Sigurisë Kombëtare (SSK) 2023-2028”³⁰² SSK synon të pasqyrojë në mënyrë sa më gjithëpërfshirëse sfidat dhe kërcënimet kryesore për sigurinë kombëtare të Shqipërisë, si dhe të përfshijë përgjigjet institucionale ndaj tyre. Nga analiza e situatës, mbi gjetjet nga e cila është përgatitur kjo strategji, rezulton se krahas ndryshimeve gjeopolitike dhe kërcënimeve të shtuara të sigurisë, sfida të rëndësishme shfaqen dhe në hapësirën kibernetike, ku teknologjia mund të përdoret në çdo kohë si armë kundër qëndrueshmërisë sociale, ekonomike dhe politike. Kërcënimet e sigurisë bëhen dhe më sfiduese për shkak të mungesës së një regjimi të kontrollit të armëve kibernetike. Siguria e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme; siguria energjetike; aktivitetet influencuese keqdashëse; degradimi i mjedisit; shpërthimet pandemike dhe epidemike; terrorizmi dhe radikalizimi drejt ekstremizmit të dhunshëm; krimi i organizuar; siguria ekonomike; korrupsioni; siguria publike; problemet social ekonomike; siguria ushqimore; emigracioni i jashtëligjshëm nëpër territorin e vendit tonë; emigrimi i shtetaseve/shtetasve shqiptarë dhe rreziku i një agresioni ushtarak, janë të gjithë elementë të analizuar në këtë strategji, mbi bazën e konkluzioneve nga të

301. Me mbështetjen e UN Women. Rol të rëndësishëm luajtën dhe Ambasada e Vendeve të Ulëta, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, dhe Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

302. Miratuar me Ligjin Nr. 14/2024 “Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë”. Shih: <https://www.mod.gov.al/images/PDF/2024/strategjia-kombetare-2024.pdf>

cilat janë formuluar dhe masat e veprimeve përkatëse. SSK zbatohet nga sistemi i sigurisë kombëtare, realizohet përmes një procesi gjithëpërfshirës, që angazhon të gjithë aktorët dhe faktorët e tjerë të shoqërisë që kanë mundësi dhe kapacitete për të kontribuar në shërbim të sigurisë. Përgjegjësinë kryesore institucionale për zbatimin e SSK-së e ka Këshilli i Ministrave, institucionet në varësi të tij dhe ministrinë e linjës.

Strategjia Ndërsektoriale e Luftës kundër Terrorizmit (SNLT), 2021–2025 dhe plani i saj i veprimit 2021–2023³⁰³. SNLT 2021–2025 përfaqëson dokumentin themelor kombëtar strategjik në luftën kundër terrorizmit që kombinon agjendën e integritetit në Bashkimin Evropian për përmbushjen e detyrimeve të kapitullit 24, në fushën e luftës kundër terrorizmit, me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit, përfshirë edhe ndërlidhjen me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Ajo përbën dokumentin strategjik që përcakton vizionin kombëtar për krijimin e një shoqërie pa kërcënime terroriste, me imazhin e një vendi të sigurt dhe me standarde evropiane të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke mbështetur edhe aspiratat për integritet në Bashkimin Evropian. “Shqipëria me një shoqëri pa trafikim, krim të organizuar dhe kërcënime terrorizmi, me një imazh të një vendi paqësor dhe me standarde evropiane të sigurisë”, është vizioni i kësaj strategjie, që synohet të arrihet përmes politikave dhe përparësive që synojnë parandalimin dhe uljen e kërcënimeve terroriste nëpërmjet: rritjes së rezultateve në luftën kundër terrorizmit përmes vendosjes dhe përdorimit të një sistemi efikas të vlerësimit të riskut, shoqëruar me forcimin institucional të njësive të angazhuara në këtë fushë; hartimit të një ligji organik në përputhje me standardet e BE-së për luftën kundër terrorizmit; ngritjes dhe funksionimit të Komitetit Ndërinstitucional për Bashkërendimin e Veprimeve në Luftën Kundër Terrorizmit; dhe ngritjes së një rrjeti të sigurt komunikimi për shkëmbimin e informacionit midis agjencive të angazhuara në luftën kundër terrorizmit. Kostoja e përgjithshme, e përllogaritur për zbatimin e kësaj strategjie dhe Planit të Veprimit, është 3,885,644,600 lekë (31,085,157 euro, me një kurs mesatar për referencë të përllogaritur me 125 lekë për 1 euro). Financimi i planit të veprimit të strategjisë do të realizohet vetëm nga buxheti i shtetit dhe për periudhën 2021–2023, buxheti i shtetit pritet të financojë zbatimin e planit përafërsisht në masën 100% të financimit të nevojshëm. Strategjia nuk shoqërohet me hendek financiar pasi kostot janë të përfshira brenda tavaneve buxhetore të parashikuara në PBA 2021–2023. Kostoja financiare pas vitit 2023, prej 1,212,944,200 lekë, pritet të financohet nga PBA 2022–2024 e në vazhdim.³⁰⁴

Strategjia Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit (SNPEDHNT) dhe planet e tyre të veprimit 2023–2025.³⁰⁵ SNPEDHNT 2023–2025 udhëhiqet nga prioritetet e qeverisë shqiptare në fushën e sigurisë dhe programi politik i Këshillit të Ministrave që ka të bëjë me komponentin “Shqipëria e sigurt”. Ky dokument strategjik përfaqëson një vëmendje të shtuar ndaj parandalimit të akteve terroriste, parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet krijimit të komuniteteve dhe institucioneve më të qëndrueshme, rehabilitimin dhe riintegrimin e personave të radikalizuar dhe të të kthyerave/kthyerve nga zonat e konfliktit dhe familjeve të tyre, zhvillimin e një komunikimi strategjik dhe parandalimin e radikalizimit online. Kjo strategji do të shërbejë si instrumenti kryesor për të bashkërenduar ndërveprimin institucional kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit. Theksi për arritjen e vizionit të kësaj strategjie do të vihet në parandalimin e akteve terroriste, duke përdorur një përgjigje të koordinuar nga institucionet shtetërore në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin. Çdo reagim duhet patjetër të marrë në konsideratë faktin se një sulm terrorist nuk do të jetë i suksesshëm nëse ekzistojnë planet e parandalimit të sulmeve terroriste dhe strukturat e nevojshme me qasje gjithëpërfshirëse për mbledhjen e trajtimit efikas të informacionit, ndërveprimin, dhe reagimit të shpejtë. Strategjia zbatohet përmes dy planeve të veprimit përkatësisht Planit të Veprimit të Luftës kundër Terrorizmit 2023–2025 dhe Planit të Veprimit të Parandalimit dhe Kundërshtimit të Ekstremizmit të Dhunshëm 2023–2025. Kosto totale e dy planeve të veprimit e integruar është në vlerën 2,363,960,315 lekë, ku 99% (ose 2,361,033,002 lekë)

303. VKM Nr. 1137, datë 16.12.2020. Shih: <https://cve.gov.al/wp-content/uploads/2021/03/vendim-2020-12-16-1137.pdf>

304. Strategjia Ndërsektoriale e Luftës kundër Terrorizmit, 2021–2025, dhe plani i veprimit 2021–2023, fq.48

305. VKM Nr.81 datë 14.02.2023. Shih: <https://cve.gov.al/wp-content/uploads/2024/05/Strategjia-CT-CVE-2023-2025-vkm-81-14-02-2023.pdf>

financohet nga PBA 2023–2025 dhe vetëm 1% është me mbështetje nga donatorët. Aktivitetet e parashikuara janë të financuara nga programet buxhetore të institucioneve përgjegjëse dhe nuk ka hendek financiar.³⁰⁶

Qendra Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH) u krijua³⁰⁷ si rezultat i një sërë masash që Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë për të trajtuar shfaqjen e ekstremizmit të dhunshëm tek shtetasit/shqiptarë që u bashkuan në radhët e organizatave ekstremiste në konfliktet në Lindjen e Mesme vitet e fundit. Kjo është një qendër për koordinimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të aktorëve lokalë të përfshirë në përpjekjet për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri dhe rajon, duke ndarë praktikën më të mira dhe duke zhvilluar masa të bazuara në dëshmi efektive për të luftuar kërcënimet nga ekstremizmi i dhunshëm. QKEDH administrohet nga Zyra e Kryeministrit dhe financohet nga Buxheti i Shtetit. Qëllimet e QKEDH janë: forcimi i koordinimit, bashkëpunimit dhe partneritetit në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, ndërmjet agjencive qeveritare, organizatave joqeveritare, sektorit privat, komuniteteve fetare dhe mediave, në identifikimin dhe zbatimin e ndërhyrjeve efektive; inkurajimi i hulumtimit vendor si mjet për të kuptuar kushtet, faktorët dhe shkaqet që nxisin radikalizimin që mund të kalojë në dhunë dhe qëndresën e komunitetit ndaj ekstremizmit të dhunshëm; forcimi i qëndresës së komunitetit dhe zvogëlimi i tërheqjes ndaj radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet programeve dhe politikave të arsimit, punësimit dhe parandalimit nga policia në komunitet; ulja e ndikimit të propagandës ekstremiste në rrjetet sociale dhe rekrutimit në internet, duke shfrytëzuar mediat sociale si kanale të komunikimit për të promovuar narrativa alternative dhe mesazhe pozitive. QKEDH synon të bashkëpunojë me aktorët e sektorit publik dhe privat për të ruajtur dhe promovuar vlerat e tolerancës dhe harmonisë fetare, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, sundimin e ligjit dhe demokracinë, si dhe ruajtjen e shoqërisë shqiptare nga ekstremizmi i dhunshëm.

Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet (SNSK) 2021 – 2026 dhe plani i veprimit 2021 – 2023.³⁰⁸ SNSK identifikon qartë përparësitë nëpërmjet politikave dhe objektivave strategjike kombëtare dhe përshkruan parimet udhëzuese që do të mbështesin përpjekjet ndërsektoriale për të siguruar sigurinë e publikut. SNSK krijon një themel për ndërtimin dhe nxitjen e mjedisit bashkëpunues në të cilin qeveria dhe qytetaret/qytetarët mund të kryejnë përgjegjësitë e tyre përkatëse të parandalimit dhe mbrojtjes në mënyrë më efektive. Politikat dhe objektivat specifikë të SNSK, janë në përputhje me disa prej OZHQ dhe Agjendës 2030, respektivisht: OZHQ 3, OZHQ 5, OZHQ 11 dhe OZHQ 16. Rritja e parametrave të sigurisë në komunitet; angazhimi dhe ndërveprimi me komunitetin; si dhe reformimi i shërbimit policor dhe rritja e kapaciteteve për sigurinë në komunitet janë tre qëllimet e politikave të SNSK-së të cilat do realizohen përmes masave të tilla si: forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për vlerësimin e riskut dhe dëmit dhe masat parandaluese; realizimi i vlerësimeve të riskut mbi baza lokale nga Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike (KVSP); parandalimi nëpërmjet edukimit; përdorimi i teknologjive të reja për kontrollin e territorit; funksionimi i plotë i KVSP-ve; krijimi i një fondi të veçantë për sigurinë në komunitet; fuqizimi i burimeve njerëzore; krijimi i zyrave të reja në zonat policore urbane dhe rurale, etj. Disa prej këtyre masave synohen të realizohen nëpërmjet financimit nga buxheti i shtetit, por gjithashtu të mbështetura edhe në donatorë, të cilët kanë programuar disa zëra në buxhetet e tyre. Kostoja e përgjithshme e përlllogaritur për zbatimin e kësaj strategjie dhe Planit të Veprimit është 7,760,392,246 lekë, ose 62,083,138 euro (kursi mesatar për referencë është përlllogaritur me 125 lek për 1 euro).

Strategjia Ndërsektoriale e Mbrojtjes së Viktimave të Krimit 2024-2030 (SNMVK).³⁰⁹ Ministria e Drejtësisë, në rolin e ministrisë përgjegjëse për hartimin dhe monitorimin e politikave strategjike në fushën e drejtësisë,

306. Strategjia Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023–2025 dhe planet e veprimit 2023–2025, fq.59.

307. Në vitin 2018. Shih: <https://cve.gov.al/>

308. Miratuar me VKM Nr. 1139, datë 24.12.2020. Shih: <https://qzb.gov.al/eli/vendim/2020/12/24/1139/ee9ac734-a09b-4eee-bf81-1a09d73a001d>

309. Miratuar me VKM nr.729, datë13.12.2023. Shih: <https://www.drejtesia.gov.al/strategjia-ndersektoriale-e-mbrojtjes-se-viktimave-te-krimit-2024-2030/>

për herë të parë ka hartuar SNMVK 2024-2030, e cila synon fuqizimin e viktimave të veprave penale, duke garantuar mbështetje, mbrojtje dhe një mjedis të sigurt, në mënyrë të tillë që viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit të raportojnë krimin. Kjo strategji ndërsektoriale synon të përmirësojë aksesin në drejtësi, të krijojë një skemë kompensimi, si dhe të lehtësojë aksesin në kompensim të viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve, duke garantuar një kompensim të drejtë dhe të përshtatshëm ndaj tyre. Informimi i viktimës, trajtimi me dinjitet i saj/tij, parandalimi i viktimizimit dytësor dhe riviktimizimit, mbështetja dhe mbrojtja për viktimat në çdo fazë të procesit dhe, kur është e nevojshme, edhe pas përfundimit të procesit penal, është një nga sfidat që kjo strategji ka adresuar. Perspektiva gjinore është integruar në përgatitjen, hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e SNMVK 2024-2030 si dhe programeve të shpenzimeve, me synimin për të promovuar barazinë midis grave dhe burrave dhe luftimin e diskriminimit, si dhe adresimin e çështjes së përfaqësimit të grave dhe burrave në masat që lidhen me mbrojtjen e viktimave të krimit. Treguesit gjinorë do të informojnë procesin e politikë-bërjes dhe do të sigurojnë që ndërhyrjet t'u përgjigjen nevojave dhe prioriteteve të ndryshme të mbrojtjes së grave dhe burrave, viktimat të krimit. Statistikat dhe treguesit gjinorë do të jenë një pjesë thelbësore e monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit dhe rezultateve të politikave, masave dhe aktiviteteve. Për këtë qëllim të dhënat e zbatimit të SNMVK 2024-2030 do të mblidhen dhe paraqiten të ndara sipas seksit, si klasifikim parësor dhe i përgjithshëm; dhe statistikat gjinore do të pasqyrojnë çështjet gjinore në këtë drejtim. Metodatat e mbledhjes së të dhënave do të marrin në konsideratë stereotipet gjinore, si dhe faktorët socialë e kulturorë që mund të nxisin paragjykimet gjinore në lidhje me mbrojtjen e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve të krimit.

28. Çfarë veprimesh ka ndërmarrë vendi juaj për të rritur udhëheqjen, përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e grave në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve, ndërtimin e paqes, veprimet humanitare dhe përgjigjen ndaj krizave, në nivel vendimmarrjeje, në situata konfliktesh të armatosura dhe konfliktesh të tjera, dhe në situata krize ose të brishta gjatë pesë viteve të fundit?

Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura (FA), në zbatim të SKBGJ 2021-2030 i kanë vënë çështjet gjinore në qendër të vëmendjes dhe punës së tyre. Në këtë funksion janë hartuar politika, strategji, plane, programe edukimi, si dhe janë zhvilluar një sërë aktiviteteve të veprimtarish ndërgjegjëse. Kështu mund të përmendim: integrimin e perspektivës gjinore në Strategjinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore 2020 - 2024³¹⁰; hartimin e Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2022-2030 në FA³¹¹; hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e politikave, procedurave të rekrutimit si dhe rishikimin e organikave (TOP) etj., për përfshirjen e perspektivës gjinore; sigurimin e qëndrueshmërisë së përfaqësimit të grave në FA për periudhën 2020-2025, etj.

Angazhimet për gratë, paqen dhe sigurinë janë integruar në politikat kyçe kombëtare dhe ndërmnistrore, si dhe në kornizat planifikuese e monitoruese: personeli grua është bërë pjesë e komisioneve të karrierës për promovim në detyrë të personelit; është rritur numri i pedagogëve gra në institucionet arsimore të FA (Akademinë e Forcave të Armatosura, Akademinë e Nënoficerëve/Nënoficerëve, Shkollën e Trupës); është rritur numri i personelit grua në ndjekjen e kurseve institucionale apo funksionale jashtë vendit, si dhe në ndjekjen e studimeve të larta në akademitë ushtarake jashtë vendit; në rekrutimet e bëra për kandidate/kandidatë për oficerë/oficerë të reja/rinje në dhjetor 2022 - dhjetor 2023, rreth 11% e fituesve ishin të reja dhe gra.

Zbatimi i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor gjithashtu ka qenë pjesë e ndërhyrjeve në këtë drejtim, reflektuar në programet në vijim:

- **Programi i “Arsimit Ushtarak”** përmban tregues gjinorë, konkretë të përshtatshëm dhe të

310. Miratuar me Urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 246, datë 24.02.2020

311. Miratuar me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr.651, datë 06.05.2022

matshëm: për vitin 2019, produkti 1 “Kapacitete të afta për trajnimin dhe arsimimin cilësor në Forcat e Armatosura”, Objektivi 1 “Arsimimi, kualifikimi, stërvitja dhe promovimi gjinor në përputhje me standardet e NATO-s”, njësia matëse “numri i grave të trajnuara” konkretisht 138 gra të trajnuara, shpenzimi faktik 89 000 lekë, kosto për njësi 645 mijë lekë, realizuar 100%.

- **Programi “Mbështetje Sociale për Ushtarake/Ushtarakët”** përmban tregues gjinorë konkretë, të përshtatshëm dhe të matshëm: për vitin 2019, produkti 1 “Përfitime të shpërndara për sigurimin suplementar të ushtarakeve/ushtarakëve dhe trajtim të veçantë si ish punonjëse/punonjës në ndërmarrjet ushtarake”, Objektivi 1 “Mbështetje me të ardhura të rreth 2,277 gra që trajtohen me pension suplementar”, njësia matëse “numri i grave të trajnuara financiarisht”, shpenzimi faktik 3,209,000 lekë, kosto për njësi 1,410,000 lekë.
- Për vitin 2024, janë 320 gra ushtarake përfituese të pensioneve. Për pensionin suplementar janë 1,412 gra ushtarake përfituese.³¹²
- Për vitin 2023 kanë përfituar 52 gra ushtarake dhe civile, ndihmë financiare (në raste sëmundjesh, fatkeqësish) në vlerë 3,743,000 lekë.
- Për vitin 2024, kanë përfituar 43 gra ushtarake, ndihmë financiare (në raste sëmundjesh, fatkeqësish) në vlerë 6,320,245 lekë.
- Për vitet 2019-2023, kanë përfituar 795 gra ushtarake në arsimim, trajnim të FA në Akademinë e Forcave të Armatosura (AFA), me kosto të përafërt 547,219,649 lekë.

Është bërë rishikimi i kurrikulave në të gjitha kurset institucionale që zhvillohen në Akademinë e Forcave të Armatosura, Akademinë e Nënoficerëve, për përfshirjen e temave për barazinë gjinore, temave me doktorantë/doktorantë etj.

- Janë organizuar trajnime, seminare në zbatim të Rezolutës 1325 të OKB-së, me përfaqësuese/përfaqësues nga vendet e NATO-s, me personelin gra të FA.
- Personalitetet më të larta civile dhe ushtarake në FA kanë organizuar takime me personelin gra në strukturat e FA-së, me fëmijët e ushtarakeve/ushtarakëve, janë dhënë stimuj, medalje për personelin gra, përparësi në trajtimin me shtëpi pushimi, etj.
- U zhvillua trajnim për integrimin gjinor nga ekipi ushtarak i SHBA (4 - 8 mars 2024) me pjesëmarrje të grave ushtarake të fushës së burimeve njerëzore, bashkëpunimit civil-ushtarak, pedagogë/pedagogë etj.

Legjislacioni shqiptar si Kodi i Punës, statusi i ushtarakëve/ushtarakut, politikat dhe procedurat, udhëzimet, etj., nuk kanë kritere përjashtuese apo diferencuese për gratë ushtarake apo civile. Procedurat dhe kriteret për rekrutimin, punësimin, përzgjedhjen e ushtarakeve/ushtarakëve për ndjekjen e akademive, kolegjeve, kurseve ushtarake sigurojnë mundësi të barabarta si për gratë dhe për burrat, ku procedurat e përzgjedhjes bazohen tek merita. Gratë në FA mbajnë grada madhore si Gjenerale Brigade, Kolonele dhe kanë apo kryejnë detyra me përgjegjësi të lartë Zëvendës Shefe e Shtabit të Përgjithshëm të FA, Komandante, Drejtore, ATASHE, Përgjegjëse Sektori etj. Në rekrutimet e bëra për ushtarë/ushtarë, oficerë/oficerë në periudhën 2020-2024 ka personel të rekrutuar apo punësuar edhe nga zona të largëta apo rurale pa pasur asnjë lloji kufizimi. Në Ministrinë e Mbrojtjes (MM) dhe strukturat e varësisë u është krijuar mundësi punësimi personave me aftësi të kufizuara, duke bërë përshtatje të infrastrukturës dhe ambienteve të punës për këtë qëllim. Gjithashtu mundësi punësimi në këtë institucion u është krijuar edhe të rejave/grave të cilat kanë përfunduar shkollat e larta me rezultate të shkëlqyera (ekselencë).

Në MM funksionon Drejtoria e Inspektimit të Përgjithshëm (DIP) e cila krahas të tjerave, ndjek edhe problemet e ankesave, rasteve të diskriminimit. Është njohur personeli i FA-së me aplikacionin në Website e MM-së për adresimin e rasteve të diskriminimit dhe ngacmimeve seksuale, etj. Në zbatim të Urdhrit të Ministrit të

.....
312. Një tabelë me të dhëna më të detajuara, mbi trajtimet dhe pensionet që përfitojnë personat në forcat e armatosura e gjeni në Shtojcën 5, bashkëlidhur këtij raporti.

Mbrojtjes për eliminimin e dhunës, ngacmimit dhe ngacmimit seksual në mjedisin e punës të strukturave të MM dhe FA³¹³ është hartuar formulari për raportimin e ngacmimit dhe ngacmimit seksual. Strukturat në MM u kanë krijuar mundësi lehtësimi grave në rastet e emergjencave nëpërmjet vënies në dispozicion të mjeteve të ndihmës mjekësore dhe transportit.

Gratë ushtarake kanë marrë pjesë në misione në Sudanin e Jugut (Misioni UNMISS) për vitet 2019-2024.³¹⁴ Është miratuar akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 3, datë 21.6.2023, “Për disa ndryshime në aktin normativ nr. 1, datë 20.3.2019, të Këshillit të Ministrave “Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut (UNMISS)”, miratuar me ligjin nr. 23/2019”, duke shtuar përfaqësimin e personelit ushtarak të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë me funksion: oficer/officer shtabi me gradë “kapiten-major”, me kohë dislokimi 1 (një) vit, duke filluar nga muaji qershor 2023, në Shtabin e Komandës Bor, Jonglei, në Sudanin e Jugut. Në kuadër të angazhimeve politike të Republikës së Shqipërisë në kuadër të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), Forcat e Armatosura do të japin kontributin e tyre në Republikën e Sudanit të Jugut, përkrah vendeve të tjera. Kjo pjesëmarrje rregullohet me:

Akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 21.6.2023, “Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH) në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Abyei (UNISFA)”;

Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 805/2023, “Për përcaktimin e statusit, mënyrave të pjesëmarrjes dhe masës së dietës ditore për vështirësi shërbimi të personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin e Kombeve të Bashkuara në Abyei (UNISFA)”.

29. Çfarë veprimesh ka ndërmarrë vendi juaj për të rritur përgjegjshmërinë gjyqësore dhe jogjyqësore për shkeljet e ligjit ndërkombëtar humanitar dhe shkeljet e të drejtave të njeriut të grave dhe vajzave në situata konfliktesh të armatosura dhe situata të tjera ose veprimeve humanitare dhe reagimit ndaj krizave gjatë pesë viteve të fundit?

Lufta kundër trafikimit të personave vazhdon të jetë një ndër prioritetet kyçe të qeverisë shqiptare dhe të gjithë strukturave të tjera me detyra dhe përgjegjësi në këtë drejtim. Ministria e Brendshme (MB)/Sektori i Antitrafikut është pika kryesore për koordinimin e përpjekjeve antitrafik në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Sektori i Antitrafikut ka si detyrë kryesore koordinimin e përpjekjeve antitrafik në shkallë vendi e më gjerë në drejtim të: parandalimit, mbrojtjes dhe asistencës ndaj viktimave të trafikimit /viktimave të mundshme të trafikimit (VT/VMT); ndjekjes penale të trafikantëve dhe personave të përfshirë në të; partneritetit, qoftë ndërmjet institucioneve shtetërore, po ashtu, atyre shtetërore të pavarura, si edhe partneritetit me organizatat vendase dhe organizmat ndërkombëtare, të cilat veprojnë aktivisht në përpjekjet antitrafik.

Gjatë periudhës raportuese, janë ndërmarrë masa të rëndësishme në drejtim të rritjes së bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional, për një përgjigje të bashkërenduar dhe efektive, me qëllim parandalimin, identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e VT/VMT, si dhe ndjekjen penale dhe dënimin e trafikantëve.

313. Urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 391, datë 31.03.2020 “Për miratimin e dokumentit “Politikat dhe procedurat për eliminimin e dhunës, ngacmimit dhe ngacmimit seksual në mjedisin e punës të strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura”.

314. Për detaje referohu te tabela e paraqitur në Shtojcën 4 të këtij raporti.

Marrëveshja e Bashkëpunimit për Funkcionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit të Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit të Personave³¹⁵, përfshin 15 institucione shtetërore dhe jo shtetërore. Fokusi kryesor i kësaj marrëveshjeje janë VT/VMT dhe mbrojtja e tyre, duke shqyrtuar çdo situatë rast pas rasti dhe duke ndërtuar disa standarde të pranuar nga të gjithë për mënyrën se si zhvillohet procesi i identifikimit, referimit dhe mbrojtjes së VT. Marrëveshja është produkt i një procesi të gjatë konsultimesh dhe debatesh konstruktive ndërmjet një numri të konsiderueshëm agjencish të rëndësishme shtetërore, jo shtetërore, të pavarura dhe të shoqërisë civile kombëtare dhe ndërkombëtare me një përvojë të gjatë në parandalimin dhe luftën ndaj trafikimit të personave, asistimin dhe mbrojtjen e VT jo vetëm në Shqipëri, por edhe përtej saj. Gjithashtu, me qëllim rritjen e rolit të inspektoreve/inspektorëve të punës në identifikimin fillestar të VMT dhe adresimin e qasjes me “në qendër” viktimën nëpërmjet arsimimit dhe formimit profesional, është anëtarësuar në Marrëveshje, Ministria e Financave nëpërmjet Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. Ndërsa, Ministria e Brendshme, përpos Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit përfaqësohet edhe nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara. Nisur nga fusha e përgjegjësisë është përfshirë në Marrëveshje edhe Ministria e Drejtësisë, si mbikëqyrëse e ndihmës juridike dhe kompensimit të VT. Ministria e Drejtësisë ka në juridiksionin e saj Komisionin Shtetëror për Ndihmë Ligjore Falas.

Autoriteti Përgjegjës për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit ³¹⁶ ka për detyrë bashkërendimin e procesit të identifikimit dhe referimit; si dhe udhëheqjen e zbatimit të Mekanizmit Kombëtar të Referimit lidhur me të gjitha rastet e VT/VMT të identifikuar dhe referuar në përputhje me Procedurat Standarde të Veprimit. Autoriteti Përgjegjës, në përbërjen e tij ka një përfaqësuese/përfaqësues nga Drejtoria e Politikave të Antitrafikut dhe Migracionit (konkretisht drejtorin/drejtoreshen, që ka dhe pozicionin e kryetares/kryetarit); katër përfaqësuese / përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (Sektori kundër Trafikeve të Paligjshme, Departamenti i Kufirit dhe Migracionit, Sektori i Dhunës në Familje dhe Mbrojtjes së të Miturve dhe Sektori kundër Krimit Kibernetik); si dhe nga një përfaqësuese/përfaqësues nga Shërbimi Social Shtetëror, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Drejtoria Konsullore në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe nga Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Anti-Trafik (KKSAT). Në mbledhjet e Autoritetit Përgjegjës ftohen të jenë të pranishme/pranishëm përfaqësuese/përfaqësues nga Prokuroria dhe nga anëtarë të tjerë të Mekanizmit Kombëtar të Referimit, në varësi të nevojave për mbështetje dhe ekspertizë, sipas rasteve që do të trajtohen. Sektori i Antitrafikut në MB, shërben si Sekretariati Teknik i Autoritetit Përgjegjës.

Plani Kombëtar të Veprimit (PKV) për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021-2023³¹⁷, është dokumenti më i rëndësishëm politik dhe strategjik në vend në fushën e antitrafikimit. PKV reflektonte edhe praktikën më të mira ndërkombëtare, si dhe situatën e pandemisë, për sa u përket faktorëve nxitës të trafikimit dhe formave të shfaqjes së tij, duke qenë se trafikimi i qenieve njerëzore përfshin si vendet fqinje dhe vendet anëtare të BE-së dhe ka tipare të ngjashme në të gjitha vendet pavarësisht diferencave që ato kanë nga pikëpamja sociale, ekonomike dhe kulturore. Ulja e kërcënimit dhe ndikimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda; mbrojtja e qytetareve/qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë; si dhe rritja e forcës parandaluese ndaj kërcënimeve të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda përbënin qëllimet kryesore të politikave të PKV 2021-2023. Kostoja e përgjithshme e përlogaritur për zbatimin e PKV 2021-2023 ishte 412,552,420 lekë ose 3,300,419 euro (kursi mesatar për referencë është përlogaritur me 125 lekë për 1 euro).

.....
315. Nënshkruar më 26 qershor 2023.

316. Ngritur me Udhëzim të Përbashkët Nr. 132, datë 08.09.2023 “Për ngritjen e Autoritetit Përgjegjës për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit” nënshkruar nga Ministri i Brendshëm, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministri i Financave dhe Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme.

317. Miratuar me VKM Nr. 670, datë 10.11.2021. Shih: <https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/VKM-nr-670-date-10.11.2021-Plani-Kombetar-Antitrafik-2021-2023.pdf>

Ministria e Brendshme³¹⁸ në tetor 2023 ka nisur procesin e përgatitjes së **Planit të ri Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2024-2025**. Plani Kombëtar i Veprimit ruan ato elementë të vlerësuar si pika më të forta në luftën kundër trafikimit, por edhe duke u përditësuar me një përjasje të re në përgjigje të nevojave dhe kontekstit të ri në të cilin ndodhemi. Në këtë Plan Veprimi janë ruajtur elementë të rëndësishëm që kanë të bëjnë me gjithëpërfshirjen e agjencive shtetërore dhe jo shtetërore, si dhe shtrirjen e veprimit të tij në të gjithë territorin e vendit, duke e vënë theksin sërish në forcimin e kapaciteteve dhe strukturave në nivel qendror dhe vendor dhe tek masat për mbrojtjen e grave/vajzave dhe fëmijëve, duke marrë në konsideratë interesin më të lartë të tyre. Drafti PKV 2024-2025 u finalizua në dhjetor 2023 dhe çdo aktivitet i parashikuar në dokument është i shoqëruar me koston financiare. Aktualisht është dërguar për mendim tek ministritë e linjës dhe do të miratohet 4-mujorin e dytë të vitit. Kostoja e përgjithshme e përllogaritur për zbatimin e PKV 2024 – 2025, është rreth 276,5 milionë Lekë, ose rreth 2,5 milionë Euro. (Kursi mesatar për referencë është përllogaritur me 110 lekë për 1 euro.) Për periudhën 2024-2025, shpenzimet e planifikuara në buxhetet e institucioneve përgjegjëse janë rreth 206,9 milionë lekë, të cilat janë planifikuara në buxhetin vjetor dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026. Hendeku financiar për këtë periudhën është 69,5 milionë lekë ose 25.2% e kostove indikative. Për periudhën 2024-2025, buxheti i shtetit pritet të financojë 74.8% të kostove indikative totale të zbatimit të planit për periudhën 2024-2025, ndërsa financimi huaj nuk është identifikuar.³¹⁹

Lidhur me pozicionin e cenueshmërisë së grave dhe veçanërisht fëmijëve, aktualisht në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë ka dy dispozita që në mënyrë të shprehur kriminalizojnë trafikimin e qenieve njerëzore, konkretisht: neni 110/a “Trafikimi i personave të rritur” dhe neni 128/b “Trafikimi i të miturave/miturve”. Në përmbajtjen e tyre gjejmë pasqyrim konceptet e “vulnerabilitetit” dhe “abuzimit me pozicionin e cenueshmërisë”, sipas përkufizimit në aktet ndërkombëtare, ku përfshihen edhe gratë dhe fëmijët. Konkretisht paragrafi i dytë i nenit 110/a, parashikon që: “Kur kjo vepër kryhet ndaj një personi të rritur të gjinisë femërore dënohet me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet”. Kurse neni 128/b lidhet me trafikimin e të miturave/miturve, të cilat/cilët janë më vulnerabël se të rriturat/rriturit dhe prandaj janë më të rrezikuara/rrezikuar për t’u bërë viktimë të trafikimit të qenieve njerëzore dhe për këtë arsye, ligjvënësi është kujdesur të parashikojë një nen të veçantë.

Gjithashtu për njësimin e praktikës gjyqësore, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka nxjerrë vendimin njësoes nr. 00-2022-1679 Vendimi (217) datë 27.07.2022 lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, ku ndër të tjera parashikon konceptet e “vulnerabilitetit” dhe “shpërdorimit të pozitës së cenueshmërisë”, duke theksuar se, gjykatat dhe prokuroria duhet të kenë në vëmendje qëë personat që jetojnë në një ambient social apo familjar me probleme ekonomike, financiare, personale apo psikologjike, duhen trajtuar me shumë kujdes, si VMT. Pra, në legjislacionin penal shqiptar, si dhe në vendimin njësoes të Gjykatës së Lartë, abuzimi me pozicionin e cenueshmërisë / pozitës vulnerabël, parashikohet si një nga mënyrat që trafikantët përdorin për realizimin e qëllimit të tyre.

318. Me mbështetjen e OSBE-së

319. Draft “Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2024-2025”, fq. 20-21. Shih: https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_697_Draft-PKV-Antitrafik-2024-2025--per-mendim.docx

30. Çfarë veprimesh ka ndërmarrë vendi juaj për të eliminuar diskriminimin dhe shkeljet e të drejtave të vajzave, përfshirë vajzat adoleshente gjatë pesë viteve të fundit?

Legjislacioni shqiptar bazohet në parimet e drejtësisë miqësore për të miturat/miturit, e cila ka në thelb të saj garantimin e respektit, efektivitetin e zbatimit të të drejtave të fëmijëve dhe interesin më të lartë të tyre. Kuadri ligjor vendas synon të garantojë elementët e domosdoshëm të drejtësisë miqësore të tillë si: aksesueshmëria, përshtatshmëria, efektiviteti në raport të drejtë me nevojat dhe respektim të të drejtave të fëmijëve. Parime të tilla si pjesëmarrja dhe informimi, interesi më i lartë i fëmijës, dinjteti, mbrojtja nga diskriminimi, shteti i së drejtës, qëndrojnë në themel të kuadrit ligjor shqiptar. Drejtësia miqësore përfshin të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të drejtën për pjesëmarrje dhe për të kuptuar procedurat, të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare si dhe të integritetit dhe dinjtetit. Gjithashtu “interesi më i lartë i fëmijës” paraqitet si një parim me shtrirje kapilare në gjithë legjislacionin tonë të brendshëm. Kuadri ligjor i drejtësisë për të mitura/mitur iu është përmbajtur instrumenteve ndërkombëtare të ratifikuara dhe është zhvilluar në përputhje me standardet e Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës, ato të BE-së dhe të Këshillit të Evropës.

Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë për të Mitura/Mitur (SNDM) 2022-2026 dhe plani i saj i veprimit³²⁰, është dokumenti i dytë politik për sistemin e drejtësisë për të mitura/mitur i iniciuar nga Ministria e Drejtësisë, që synon zbatimin me efektivitet të të drejtave të tyre. SNDM bazohet në rezultatet nga zbatimi i Strategjisë së Drejtësisë për të Mitura/Mitur dhe Planit të saj të Veprimit 2018–2021. “SNDM 2018–2021” synonte krijimin e kuadrit ligjor dhe institucional të drejtësisë penale për fëmijët; Sistemin e Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitura/Mitur; fillimin e trajnimit të profesionistëve / profesionistëve në çështjet e drejtësisë penale për të miturat/miturit; si dhe krijoi modelet e grupeve të profesionistëve/profesionistëve për menaxhimin e rasteve në nivel vendor.

Ngritja e Qendrës për Parandalimin e Krimeve të të Miturave/Miturve dhe të Rejave/Rinjve (QPKMR)³²¹ në vitin 2022 ishte një hap shumë i rëndësishëm që lehtëson edhe zbatimin e një sërë masash të strategjisë. “SNDM 2022–2026” synon të adresojë problemet me të cilat përballen të miturat/miturit që përfshihen në kryerjen e një veprë penale, mes konsolidimit të një sistemi të drejtësisë penale që ka përparësi shmangien e privimit e lirisë së tyre, kur një gjë e tillë është e mundur; si dhe adreson faktorët kriminogjenë përmes ndërhyrjes së hershme për parandalimin parësor të përfshirjes së fëmijëve në kriminalitet dhe të veprave penale të kryera ndaj tyre, përmes informimit, edukimit dhe ndërgjegjësimit të fëmijëve, prindërve, shoqërisë për nevojën e mbrojtjes së fëmijëve nga përfshirja në kryerjen e veprave penale ose nga viktimizimi prej tyre dhe përmes zbatimit të programeve të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit, në rastet kur fëmijët përfshihen në konflikte ose vepra penale.

320. Miratuar me VKM Nr. “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur 2022–2026, të planit të saj të veprimit dhe të pasaportës së indikatorëve”. Shih: https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2023/02/Vendim-i-KM-892-DATE-27_12_2022.pdf

321. Shih: <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://qpkmr.gov.al/wp-content/uploads/2022/12/vendim-2019-05-15-314-perditesuar-1-1.pdf>

Gjithashtu, vëmendje e shtuar do të tregohet për fëmijët në risk, (veçanërisht vajzat), me qëllim informimin e tyre për të drejtat, shërbimet dhe mekanizmat vendore, rivendosja e të drejtave mes qasjes në proceset civile, familjare, administrative dhe penale. Një risi e kësaj strategjie është rritja e kontributit dhe qasja proaktive e skuadrave probono dhe qendrave të këshillimit ligjor në zonat e targetura. Kostoja e përgjithshme e përllogaritur për zbatimin e planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë të Drejtësisë për të Mitur 2022 - 2026 është rreth 3,4 miliardë Lekë, ose rreth 28,5 milionë Euro³²².

Për periudhën afatmesme 2022-2024, kostoja është vlerësuar rreth 969,7 miliardë lekë, të cilat janë planifikuar në buxhetin vjetor dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2023-2025, të institucioneve përgjegjëse. Për vitin financiar 2022 janë marrë në konsideratë kostot e shpenzimeve e planifikuara. Për periudhën 2025-2026, kostoja indikative për zbatimin e Strategjisë është 1,8 miliardë lekë. Për këtë periudhë është supozuar që për aktivitete të caktuara në Planin e Veprimit do të jenë në dispozicion fondet nga Buxheti i Shtetit për shpenzime korente dhe investime. Pas vitit 2025, buxheti i shtetit pritet të financojë projektin “Ngritja dhe funksionimi i Institucionit për edukimin dhe rehabilitimin e të miturve/miturve në konflikt me ligjin”. Hendeku financiar për periudhën 2022-2026 është 500,7 milionë lekë ose 14.7% e koston indikative. Për periudhën 2022-2024, buxheti i shtetit pritet të financojë zbatimin e planit në masën 27%, ndërsa 56,4% janë shpenzimet e planifikuara për periudhën 2025-2026, ku peshën kryesore e zënë shpenzimet për Institucionin për edukimin dhe rehabilitimin e të miturve në konflikt me ligjin.

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026³²³ (AKDF) u hartua në emër të Qeverisë Shqiptare nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në koordinim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, si edhe në konsultim me aktorët, partnerët, OSHC, organizatat ndërkombëtare, etj.³²⁴ AKDF konsolidon dhe krijon vazhdimësi të punës së kryer në kuadër të Agjendës Kombëtare të mëparshme për të drejtat e fëmijëve (2017–2020), duke adresuar boshllëqet e vazhdueshme dhe sfidat e reja, si dhe duke reflektuar perspektivat inovative, sidomos ato të lidhura me Strategjinë e Bashkimit Evropian për të Drejtat e Fëmijëve. Ky dokument me qasje ndërsektoriale përbën bazën për të mundësuar koordinimin e përpjekjeve midis ministrive dhe sektorëve të ndryshëm; dhe udhëzon kornizën rregullatore kombëtare drejt një strategjie të harmonizuar dhe efektive për fëmijët. AKDF-ja përmban katër qëllime strategjike: i) Qeverisja e mirë në funksion të respektimit, mbrojtjes dhe përmbushjes së të drejtave të fëmijëve; ii) Eliminimi i të gjitha formave të dhunës dhe mbrojtja e fëmijëve; iii) Sistemet dhe shërbimet miqësore për fëmijë dhe adoleshente/adoleshentë; iv) Promovimi i të drejtave të fëmijëve në botën digjitale. Në këtë dokument janë parashikuar një sërë masash mbështetëse për zvogëlimin e diskriminimit dhe pabarazive për vajzat / adoleshentet. Kostoja e përgjithshme e përllogaritur për zbatimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026 është 1,603,948,852 lekë ose 12,831,591 euro. Kursi mesatar për referencë është përllogaritur me 125 lekë për 1 euro. Për periudhën 2021–2026, buxheti i shtetit pritet të financojë zbatimin e planit në masën 58% të financimit të nevojshëm, 23% pritet të financohet nga burime të tjera dhe donatorët, ndërsa 19% është hendeku financiar.

Masa të tjera të ndërmarra në drejtim të: informimit dhe sensibilizimit të vajzave dhe të rejave në lidhje me stereotipet gjinore, praktikat e dëmshme dhe ndikimin e tyre në përditshmëri; veprimeve për fuqizimin e vajzave dhe të rejave përmes aksesit dhe ofrimit të mundësive për arsim cilësor dhe edukim të vazhdueshëm apo trajnime për zhvillimin e aftësisë; masat dhe veprimet në drejtim të edukimit gjithëpërfshirës mbi shëndetin seksual dhe riprodhues; veprimet për të parandaluar martesën e hershme dhe të detyruar të fëmijëve; politikat dhe masat për zvogëlimin e të gjitha formave të dhunës ndaj vajzave; masat për rritjen e ndërgjegjësimit për ndarjen e barabartë të punëve të papaguara në familje dhe zvogëlimin e ngarkesës së vajzave në këtë drejtim; ofrimin e mundësive për pjesëmarrjen në jetën sociale dhe ekonomike, apo për fuqizimin e tyre në SHTIM dhe TIK; etj., u paraqiten në përgjigjet e dhëna më sipër për pyetjet specifike të lidhura me këto fusha, në këtë raport. Në Shqipëri funksionojnë edhe një sërë organizatash të shoqërisë civile, të cilat kanë në fokus çështjet e vajzave dhe të rejave/rinjve, si dhe

322. Kursi mesatar për referencë është përllogaritur me 118 lek për 1 euro.

323. Miratuar me VKM Nr. 659, datë 3.11.2021. Shih: <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/03/Agjenda-Kombetare-per-te-Drejtat-e-Femijeve.docx>

324. Me ministritë e tjera përgjegjëse, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile, organizatat ndërkombëtare, të cilat punojnë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve

që ofrojnë shërbime të caktuara (këshillim, informacion, mbështetje e shërbime, referim rastesh, etj.) në varësi të nevojave të vajzave, në fusha të caktuara.³²⁵

Platforma www.ISGURT.al që klasifikohet si një hotline (linjë për raportuar dhe kërkuar ndihmë) është një hapësirë e dedikuar, e cila shërben si një burim unik informacioni, manualesh, udhëzuesish në lidhje me internetin e sigurt për fëmijët, prindërit, mësueset/mësuesit, profesionistët/profesionistët që punojnë me/për fëmijët për të mbrojtur fëmijët nga abuzimi dhe shfrytëzimi online.³²⁶ Në 21 janar 2024 Grupi Parlamentar “Miq të Fëmijëve” i Kuvendit të Shqipërisë dhe iSGURT.al organizuan së bashku një seancë të hapur dëgjimore kushtuar sigurisë dhe mbrojtjes së fëmijëve, sidomos vajzave dhe grave në hapësirën kibernetike. Pjesë e seancës u bënë përfaqësueset/përfaqësuesit e ministrive kryesore dhe institucioneve përgjegjëse për sigurinë kibernetike, deputete/deputetë dhe përfaqësuese/përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile. Në vijim të seancës të gjitha/gjithë deputetet/deputetët e pranishme/pranishëm firmosën Paktin Kombëtar kundër Dhunës ndaj Fëmijëve, që synon të promovojë një bashkëpunim sa më të ngushtë ndërmjet institucioneve, shoqërisë civile dhe industrisë për të bërë të mundur krijimin e një hapësire digjitale ku çdokush është i mbrojtur dhe i sigurt.³²⁷

3.6 RUAJTJA, MBROJTJA DHE REHABILITIMI I MJEDISIT

FUSHAT KRIKTE TË TRAJTUARA

I. Të drejtat e njeriut të grave

K. Gratë dhe mjedisi

L. Fëmija vajzë

31. Çfarë veprimesh ka ndërmarrë vendi juaj për të integruar perspektivat dhe shqetësimet gjinore në politikat mjedisore, përfshirë përshtatjen dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike, ruajtjen e biodiversitetit dhe degradimin e tokës gjatë pesë viteve të fundit?

Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike dhe Planet e Veprimit³²⁸ (SKNK) është dokumenti kryesor strategjik që adreson ndryshimet klimatike në Shqipëri, miratuar nga Qeveria e Shqipërisë në vitin 2019. SKNK është hartuar në mbështetje të legjislationit të BE për mjedisin dhe klimën dhe synon fuqizimin e koordinimit mes sektorëve lidhur me masat e përshtatjes, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Në total, kosto për zbatimin SKNK është përllogaritur 11,036,250 lekë. Nga buxheti i shtetit pritët të mbulohen 2,970,620 lekë, ndërsa 6,925,800 lekë do mbulohen nga donatorë dhe 51,250 lekë nga të tjerë. Boshllëku financiar për veprimet prioritare është përllogaritur 1,088,580 lekë. Veprimet të cilat kërkojnë

325. Këtu mund të përmendim Linjën e Këshillimit për Gra dhe Vajza; ALO 116; Rrjetin “Zëri i të Rejave/Rinjve”; Qendrën “ACT for Society”, ACA, Qendrën Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin, Qendrën “Të ndryshëm dhe të Barabartë”, Qendrën “Vatra”, Forumin e Gruas Elbasan, Qendrën e Këshillimit Kukës, Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare, Strehëzën “Edlira Haxhiymeri”, Shoqatën “Unë, Gruaja” Pogradec, “Tjetër Vizion” Elbasan, “Gruaja te Gruaja”, Shkodër, Qendra e Gruas “Hapa të Lehtë” Shkodër, Qendra “Aulona”, “Jona” OJQ Sarandë, Marry Ward Loreto, Rrjeti i Qendrave komunitare “Sot për të Ardhmen”, “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci” etj.,

326. E hapur nga CRCA Shqipëri që në vitin 20215

327. Seanca u organizua në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për Internet të Sigurt si dhe fushatës së avokatësisë që CRCA/ECPAT Shqipëri është duke zbatuar si pjesë e Rrjetit të Monitorimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore për zbatimin e rekomandimeve të Komitetit të CEDAW dhe GREVIO për Shqipërinë, të mbështetur nga UN Women dhe SIDA. Shih: <https://www.isigurt.al/lajme/kuvendi-dhe-isigurt-se-bashku-per-mbrojtjen-e-femijeve-vajzave-e-grave-ne-hapesiren>

328. Miratuar me VKM Nr. Nr. 466, datë 3.7.2019 “Për miratimin e dokumentit strategjik dhe të planeve kombëtare për zbutjen e gazeve me efekt serrë dhe për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike”. Shih: <https://qbz.gov.al/share/GzkcixPLSVWPXuZoNVAqzg>

më shumë buxhet janë ato të bujqësisë, për vetë natyrën e investimeve infrastrukturore të ndërhyrjeve.³²⁹ Në tetor 2021, Shqipëria miratoi **Raportin e përditësuar të Kontributit Kombëtar të Pikësnuar (KKP)**³³⁰, i cili synon të ulë shkarkimet e gazrave serrë me 20,9% deri në 2030. Ky raport përfshin gratë dhe vajzat ndërmjet grupeve vulnerabël që preken nga rreziqet e ndryshimeve klimatike (Pika 3.3.3). Gjatë periudhës 2022-2024, administrata e vetëqeverisjes vendore ka filluar të punojnë për hartimin e Planeve Vendore të Energjisë dhe Klimës, në të cilat zënë vend të veçantë nevojat që kanë gratë dhe vajzat, si pjesë e grupeve të prekshme. Deri në Maj 2024, gjashtë bashki i kanë përfunduar këto plane dhe dy bashki të tjera janë në procesin e miratimit të Planeve për Energji të Qëndrueshme dhe Klimës, në kuadër të angazhimit të tyre në Konventën e Kryetareve/ Kryetarëve të Bashkive (Covenant of Mayors) për të ulur shkarkimet me 40% deri në 2030. Në mënyrë të veçantë këto plane parashikojnë masa për të zbutur varfërinë energjitike, e cila prek më së shumti shtresat më të varfra të shoqërisë, gratë dhe vajzat e papuna, ose me nevoja të veçanta.

Promovimi i arsimit të grave dhe vajzave në shkencë, inxhinieri, teknologji dhe disiplina të tjera që lidhen me mjedisin natyror. E fokusuar në fuqizimin e orientimit të nxënësve/nxënësve për karrierën në arsimin parauniversitar, Ministria e Arsimit dhe Sporteve (MAS) ka ndërmarrë masa që synojnë të mbështesin të gjitha/gjithë nxënësit, vajza dhe djem, në lidhje me orientimin drejt arsimit të mëtejshëm, zgjedhjes së profesioneve dhe përgatitjes për tregun e punës. Veprimtaritë për orientimin për karrierën në shkollë synojnë që të gjitha/gjithë nxënëset/nxënësit të jenë të mirinformuar, të ndjehen të mbështetur për ta bërë sa më efektiv kalimin në stadin tjetër të arsimit, si dhe të ndjekin në mënyrë të suksesshme rrugët e tyre të të nxënësve gjatë gjithë jetës. Këto veprimtari kanë synuar t'i orientojnë vajzat drejt profesioneve të reja, përtej stereotipeve gjinore, të ndjekin karrierat në SHTIM etj. Të tilla veprimtari përfshijnë ditët e karrierës, biseda me prindër, vizita në institucione të arsimit dhe formimit profesional, ditët e hapura të orientimit në bashkëpunim me universitetet, veprimtari në lidhje me antidiskriminimin dhe ndarjen gjinore të punës, aktivitete që mbështesin zhvillimin socio-emocional të nxënësve/nxënësve etj. Udhëzuesi i orientimit për karrierën të nxënësve/nxënësve në klasat VI - IX, i miratuar nga MAS me Nr. 600, datë 19.10.2023 ka përcaktuar piketa të rëndësishme në lidhje me gjithëpërfshirjen e vajzave dhe djemve. Fushata “Zgjidh zanatin” e ndërmarrë gjatë vitit shkollor 2023-2024 me fokus promovimin e arsimit profesional dhe përgatitjen e nxënësve/nxënësve për profesione të kërkuara në tregun e punës, synon gjithashtu nxitjen e vajzave për të zgjedhur profile dhe profesione të kërkuara në tregun e punës dhe për t'u orientuar drejt vendimmarrjeve profesionale.

Në kuadër të **programit “Toka në shkollë”**, një nismë e ndërmarrë nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për pajisjen e të gjitha shkollave me miniparcelë (kopshte të gjelbra në shkollë), nxënëset/nxënësit e të gjitha moshave, nën drejtimin e mësuesve/mësuesve të tyre, zhvillojnë aftësitë praktike për kultivimin e bimëve, me synim lidhjen e fëmijëve dhe të rejave/rinjve me natyrën dhe traditat, si një mjet për edukimin mjedisor dhe jo vetëm. Kopshtet e gjelbra në shkollë janë parcelë toke të kultivuara brenda oborrit në shkollë ose në afërsi të shkollave të vendosura në përdorimin të shkollës në bashkëpunim me bashkitë (NJVV). Ato ushqejnë frymën e komunitetit, qëllimin e përbashkët dhe vlerësimin kulturor duke ndërtuar ura midis nxënësve/nxënësve, stafit të shkollës, familjeve, bizneseve dhe organizatave lokale. Pjesë e rëndësishme e këtij programi është orientimi i vajzave dhe djemve drejt profesioneve që lidhen me shkencën, teknologjinë, kopshtarinë, mjedisin. Për të mbështetur shkollat në zbatimin e kësaj nisme është hartuar Udhëzuesi për zbatimin e nismës “Toka në shkollë” në arsimin parauniversitar (në mbështetje të krijimit të kopshteve të gjelbra në shkollë), Nr.1823/2, datë 24.03.2023.

Rajonalizimi i shkollave sjell më shumë efikasitet për nxënëset vajza, të cilat arsimohen në një mjedis më social dhe me mësuese/mësues të specializuar. Shumica e sistemeve të arsimit në mbarë botën bazohen në nocionin që nxënëset/nxënësit hyjnë, përparojnë dhe dalin nga “klasat” së bashku me një grup bashkëmoshataresh/ bashkëmoshatarësh. Në klasat ku, për arsye të ndryshme, moshë e nxënësve/nxënësve ndryshon me më

329. Shih: https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/2.-Strategjia-e-Ndryshimeve-Klimatike-dhe-Planet-e-Vepimit-Qershor-2019_-1.pdf (fq. 213)

330. <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/3.-Kontributi-Komb%C3%ABtar-i-Percaktuar-KKP-i-rishikuar-p%C3%ABr-Shqip%C3%ABrin%C3%AB-1.pdf>

shumë se një vit, nxënëset/nxënësit konsiderohen se punojnë në klasa të bashkuara (kolektive) duke përfshirë një ose më shumë nxënëse/nxënës, në varësi të numrit të tyre në një komunitet apo zonë të caktuar. Në këto klasa zakonisht punohet nga një mësuese/mësues i vetëm në arsimin fillor ose disa mësuese/mësues, sipas profilit në arsimin e mesëm të ulët. Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) vitet e fundit ka ndërmarrë një sërë masash për reduktimin (rajonalizimin) klasave kolektive dhe mbështetjen e klasave kolektive me infrastrukturën e nevojshme për të rritur cilësinë e shërbimit arsimor që ato ofrojnë. Rajonalizimi i klasave kolektive do t'u sigurojë vajzave arsim cilësor, në të njëjtin mjedis mësimor me bashkëmoshatarët e tyre.

NJV-të kanë vijuar të marrin masa për aksesin e grave në infrastruktura të qëndrueshme dhe të kursyeshme në aspektin kohor dhe të ngarkesës në punë (psh. akses në ujë të pastër, energji dhe bujqësi), si dhe për të mbrojtur dhe ruajtur njohuritë dhe praktikën e grave në komunitetet lokale në lidhje me ilaçet tradicionale, biodiversitetin dhe teknikën e ruajtjes.³³¹ Bashkitë³³² gjithashtu kanë ndërmarrë veprime për të përfshirë gratë dhe vajzat në politika mjedisore për të dhënë kontributin e tyre si dhe për punësim të barabartë për gratë dhe burrat në ndërmarrjen e pastrimit dhe gjelbërimit të qytetit dhe në zbatimin e çdo politike që lidhet me mjedisin. Në fokus të bashkive ka qenë puna intensive për ruajtjen e florës dhe faunës përmes bashkërendimit të punës mes shërbimeve publike, OJF, dhe shoqërisë civile mbi ruajtjen e mjedisit dhe trashëgimisë kulturore. Veprimtaritë ndërgjegjëse të bashkive³³³ në bashkëpunim me OJF-të kanë konsistuar në zbutjen e ndryshimeve klimatike, ruajtjen e biodiversitetit dhe degradimin e tokës pasi kjo ndikon drejtpërdrejt në jetën e grave sidomos në zonat rurale. Disa bashki në bashkëpunim me shkollat dhe shoqërinë civile kanë mbjellë fidanë përgjatë gjithë zonës së lumit, ullishte, pemë të ndryshme në çdo njësi administrative³³⁴, kanë ndërgjegjësuar qytetaret/qytetarët për promovimin dhe ruajtjen e natyrës pa ndërhyrë dhe pa e dëmtuar atë³³⁵, por edhe janë angazhuar për mirëmbajtjen dhe pastrimin e ambienteve pa ndryshuar dinamikën e tyre.³³⁶ Aktivitete të tjera konsistojnë në pastrimin e ambienteve publike, mbjelljen e pemëve, kufizimin e përdorimit të qeseve plastike, etj.³³⁷

Një sërë organizatash të shoqërisë civile³³⁸ kanë mbështetur nisma biznesi të drejtuara nga gra dhe vajza për të nxitur prodhime vendase me gjurmë të ulët karboni. Shembuj përfshijnë 11 start-up drejtuar nga gratë³³⁹, grupe fermeresh gra në Shkodër dhe Vorë mbështetur me teknologji bujqësore që rrisin përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike³⁴⁰, etj. Kontribute kanë dhënë edhe partnerët ndërkombëtarë për mbështetjen, pjesëmarrjen, udhëheqjen e grave në menaxhimin dhe qeverisjen e burimeve mjedisore dhe natyrore³⁴¹, rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me rreziqet mjedisore dhe shëndetësore specifike gjinore (p.sh. produktet e konsumit, teknologjitë, ndotja industriale) dhe promovimin, edukimin e grave dhe vajzave në shkencë, inxhinieri, teknologji dhe disiplina të tjera që lidhen me mjedisin natyror³⁴².

Rritja e ndërgjegjësimit të grave, të rejave e vajzave mbi rolin që ato luajnë dhe duhet të luajnë në çështjet mjedisore, bëhet edhe në kuadër të ditëve të caktuara informuese ndërkombëtare. Kështu, gjatë vitit 2022, më shumë se 10,000 individë u arritën përmes fushatës mediatike të organizuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural³⁴³ me rastin e 15 tetorit 2022, Ditës Ndërkombëtare të Grave Rurale. Gjatë

.....

331. Bashkia Dropull

332. Bashkia Lushnje

333. Bashkia Lezhë dhe Selenicë

334. Bashkia Selenicë

335. Si Parku i Qafështamës, Mali i Krujës, Kalaja e Krujës, Krasta e gjelbëruar, etj.

336. Veprimtari e realizuar nga Bashkia Krujë

337. Bashkia Pustec

338. Me mbështetje të donatorëve bilateralë dhe Agjencive të Kombeve të Bashkuara

339. Mbështetur nga REC Albania në kuadër të Green Enterprises Lead by Women in Albania,

340. Mbështetur nga Programi Global i OKB Adaptation Fund Climate Innovation Accelerator (AFCIA).

341. Kontribute të dhëna nga Ambasada Suedeze

342. Kontribute të dhëna nga UNICEF

343. Në bashkëpunim me UN Women dhe Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO), në kuadër të zbatimit të projektit "GREAT", financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Italisë. Të dhënat janë marrë nga Raporti për vitin 2022, vënë në dispozicion nga UN Women në kuadër të përgatitjes së këtij raporti.

kësaj fushate, u theksua kontributi i grave rurale në jetën ekonomike dhe sociale të vendit dhe luftën kundër stereotipeve të dëmshme. Fushata përfshinte një video³⁴⁴, e cila është prodhuar dhe shpërndarë në rrjetet sociale, dhe një deklaratë për gratë rurale shqiptare - sfidat dhe aspiratat, të cilat u ndanë edhe me mediat lokale. Aktivitete u organizuan gjatë gjithë javës duke informuar më shumë se 5000 gra.³⁴⁵

32. Çfarë veprimesh ka ndërmarrë vendi juaj për të integruar perspektivat gjinore në politika dhe programe për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe ndërtimin e aftësisë ripërtëritëse mjedisore dhe klimatike gjatë pesë viteve të fundit?

Gjatë vitit 2023, është miratuar **Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (SKZRF) 2023-2030**³⁴⁶, e cila trajton në mënyrë të veçantë ndikimin e fatkeqësive natyrore mbi gratë dhe vajzat, e reflektuar në kapitullin 6.4 të saj. Në këtë kapitull citohet se të gjitha fazat e menaxhimit të riskut të fatkeqësive dhe të gjitha projektet e identikuara nga SKZRF do të duhet të marrin në konsideratë elementin e grupeve të cënueshme dhe cilat do të jenë efektet për mirëqenien e tyre. Grupet më të cënueshme përbëhen nga familje të pafavorizuara financiarisht, komunitete të marginalizuara dhe të përjashtuara nga shoqëria, duke përfshirë minoritetet dhe anëtarët/anëtarët e komunitetit LGBTQ+, gratë, fëmijët, të moshuarat/moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara. Risku i fatkeqësisë varet nga aftësia ripërtëritëse e strukturës sociale, ekonomike dhe politike dhe mund të zvogëlohet duke zvogëluar ekspozimin dhe cënueshmërinë dhe duke rritur këtë aftësi ripërtëritëse. Grupet e cënueshme mund të përballen me sfida specifike gjatë dhe pas fatkeqësive. Këto përfshijnë mungesën e aksesit në informacion dhe komunikim, lehtësira dhe shërbime të paarritshme, mungesë aksesit në burimet e nevojshme mbështetëse, mungesë kornizash të politikave përfshirëse dhe të përgjigjshme gjinore, etj.

Strategjia parasheh një sërë masash për veprime specifike që adresojnë nevojat e grave dhe vajzave në zonat e prekura nga fatkeqësitë natyrore sidomos tërmeti dhe përmbytjet. Ky dokument adreson nevojën e përfshirjes së grupeve të grave dhe vajzave në vlerësimin dhe ndërmarrjen e masave parandaluese, adresimin e nevojave specifike gjatë përballjes me fatkeqësitë natyrore si dhe proceset e rimëkëmbjes pas ndodhjes së tyre. Strategjia parasheh nevojën e hartimit të proceseve të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor për këto masa. Gjatë procesit të hartimit të SKZRF-së janë përfshirë edhe OJF për të drejtat e grave dhe grupeve të tjera me cënueshmëri të lartë, duke u bërë kështu pjesë e politikave kombëtare lidhur me Sistemin e Mbrojtjes Civile dhe zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë.

Përfshirja e këtyre organizatave të shoqërisë civile është bërë edhe gjatë hartimit të **Planit Kombëtar për Emergjencat Civile (PKEC)**, miratuar në vitin 2023³⁴⁷. Në PKEC janë identifikuar problematikat lidhur me barazinë gjinore dhe janë identifikuar çështje të tilla si:

- **Lidhja e gjinisë me emergjencat civile.** Emergjencat dhe fatkeqësitë e mëdha mund të prekin në mënyrë të ndryshme gratë, vajzat, burrat dhe djemtë. Shpeshherë, pabarazitë gjinore shkaktojnë përkeqësimin e cënueshmërive ekzistuese në raport me ndikimin e fatkeqësive. Për të qenë të suksesshme, strategjitë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, duhet të përfshijnë aspektet gjinore ose të jenë me ndjeshmëri gjinore në të gjitha fazat. Komuniteti ndërkombëtar ka pranuar cënueshmërinë e shtuar të grave dhe ka parashikuar ligje dhe udhëzime për mbrojtjen e grave dhe

344. Shih: [Videos | UN Women - Albania](#)

345. Ngjarja kryesore u organizua në njësinë administrative Shirgjan në bashkinë Elbasan, ku gratë rurale nga zonat e Elbasanit, Korçës, Kolonjës dhe Pukës u mbledhën për të shprehur sfidat me të cilat përballen çdo ditë në komunitetet e tyre.

346. Miratuar me VKM Nr.94 datë 22.03.2023. Shih: https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/2024-01/strategjia_kombetare_-_albanian.pdf

347. Miratuar me VKM Nr. 807, datë 28.12.2023. Shih: <https://qzb.gov.al/eli/vendim/2023/12/28/807/b00e5401-bafe-409b-9e12-e6ecef236931;q=strategji>

vajzave gjatë periudhave të fatkeqësive, si dhe për përfshirjen e tyre të plotë në zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë. Karta humanitare dhe standardet minimale në përgjigjen ndaj fatkeqësive, të lëvizjes “Sphere”, shprehin qartë angazhimin në ndërhyrjet me ndjeshmëri gjinore, duke përfshirë luftën kundër dhunës me bazë gjinore, në të gjitha etapat e përgjigjes ndaj fatkeqësive dhe në secilin prej pesë sektorëve kryesorë (furnizimi me ujë dhe higjiena, ushqyerja, ndihma ushqimore, strehimi dhe shërbimet shëndetësore). Për më tepër, Komiteti i Përhershëm Ndër-Agjenci i Kombeve të Bashkuara (IASC) për ndihmën e koordinuar humanitare, ka udhëzime specifike për ndërhyrjet e lidhura me dhunën me bazë gjinore në kontekstin humanitar.

- **Parandalimi dhe përgjigja ndaj shfrytëzimit dhe ngacmimit seksual (PRSEAH)**, që përfshin strategjitë, politikat dhe parimet për eliminimin e çdo forme të shfrytëzimit apo ngacmimit seksual në kontekstin e mbrojtjes civile. Përfshirja e punonjësve/punonjësve të mbrojtjes civile në aktet e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual përbën një shkelje të rëndë të përgjegjësisë së tyre për të mos bërë dëm dhe për të mbrojtur personat e prekur nga krizat.
- **Barazia gjinore³⁴⁸ dhe përfshirja sociale³⁴⁹ (BGJPS)**, janë dy koncepte të ndërlidhura, të cilat ndihmojnë përmirësimin e mbrojtjes civile për kategoritë në vijim: personat e përjashtuar, gratë dhe personat me qëndrueshmëri të ulët ekonomike. BGJPS nxit politikat përfshirëse dhe fokusohet në rritjen e pushtetit të grupeve të cënueshme ose të marginalizuara dhe është një qasje që synon të eliminojë barrierat ekzistuese në mënyrë që të rrisë aksesin, si dhe të mundësojë vendimmarrjen dhe pjesëmarrjen e popullsisë të marginalizuar. BGJPS kërkon që të krijohen mjedise mundësuese në mënyrë që të gjitha/gjithë të angazhohen dhe të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga ndërhyrjet për zhvillim. Në kontekstin e rimëkëmbjes, BGJPS është një qasje që synon të eliminojë barrierat dhe të rrisë aksesin, të lehtësojë rritjen e përdorimit të shërbimeve të rehabilitimit, si dhe të përmirësojë përvojat e çdo përdoruesi.

Është e rëndësishme të theksohet se: gjatë proceseve të hartimit të dokumenteve strategjike lidhur me Sistemin e Mbrojtjes Civile pjesëmarrja në vendimmarrje e grave dhe vajzave ka qenë të paktën 50%; synohet promovimi i aksesit të grave në situata fatkeqësie në shërbime të tilla si pagesat e ndihmës, kompensimi dhe siguracioni në rast fatkeqësish; në lidhje me proceset e kompensimeve në raste fatkeqësie i jepet prioritet grave dhe vajzave kryefamiljare.

Në nivelin vendor, proceset e planifikimit për fatkeqësitë natyrore janë në fazën e hartimit dhe të planifikimit, duke përfshirë grupe të grave dhe vajzave në diskutimin e këtyre planeve vendore.³⁵⁰ Gjithashtu, veprimtari të tjera të bashkive lidhen me menaxhimin e riskut duke kontribuar në forcimin e aftësive ripërtëritëse dhe zvogëlimin e humbjeve nga fatkeqësitë³⁵¹, përpjekjet për të përfshirë gratë në programe të cilat ndikojnë në reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe ndërtimin e aftësisë ripërtëritëse mjedisore dhe klimatike nëpërmjet integritit, mbështetjes, pjesëmarrjes dhe udhëheqjes së grave në menaxhimin e mjedisit dhe burimeve natyrore³⁵²; garantimi i strehimit, rindërtimi i banesave, plotësimi i nevojave për ushqimin e veshje, kompensim i dëmeve që ka pësuar nga rënia e zjarrit në banesë, përgatitjen e dokumentacionit në

348. Barazia gjinore përfshin punën me burrat dhe djemtë, gratë dhe vajzat, me qëllim ndryshimin e qëndrimeve, sjelljeve, roleve dhe përgjegjësisë në shtëpi, në vendin e punës dhe në komunitet. Barazia gjinore nënkupton më tepër se sa thjesht barazi teorike në shifra apo ligje; ajo nënkupton më shumë liri dhe përmirësim të nivelit të përgjithshëm të jetës, në mënyrë që barazia të arrihet pa sakrifikuar përfitimet e burrave dhe grave.

349. Përfshirja sociale nënkupton procesin e përmirësimit të kushteve të individëve dhe grupeve me qëllim pjesëmarrjen e tyre në shoqëri, si dhe procesin e përmirësimit të aftësisë, mundësisë dhe dinjitetit të personave të pa favorizuar, bazuar në identitetin e tyre, me qëllim pjesëmarrjen e tyre në shoqëri.

350. Gjatë vitit 2023, procese të tilla përgatitore me grupe të grave dhe të vajzave janë zhvilluar në bashkitë Lezhë, Vorë, Durrës, Fushë Krujë, Fier, etj.

351. Bashkia Selenicë

352. Bashkia Lushnje

rast fatkeqësie natyrore (tërmet, përmytje masive) si dhe janë marrë masa parandaluese për fatkeqësitë natyrore nga fondi i bashkisë³⁵³ si edhe nga fondi i kushtëzuar i qeverisë shqiptare.

Një shembull interesant i përpjekjeve të njësive të vetëqeverisjes vendore për integrimin e perspektivës gjinore në çështjet që lidhen me menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë, është përfshirja e veprimeve të tilla në planet vendore të veprimit për barazinë gjinore, dokument i rëndësishëm ky që lokalizon politikat shtetërore për barazinë gjinore, e që gërsheton përpjekjet për të përparuar drejt barazisë gjinore në çdo fushë. Planet Vendore të Veprimit për Barazinë Gjinore miratohen në Këshillat Bashkiakë dhe si të tillë u jepet përparësi në zbatim e miratohen së bashku me parashikimet e kostove përkatëse. Bashkia Durrës³⁵⁴, është e para bashki në vend që ka bërë një gërshetim të tillë të veprimeve në Planin e saj Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2023-2025 (specifikisht në objektivin specifik III.3. “Nxitja e planifikimit të përgjigjshëm gjinor për përbalimin dhe zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore”). Kosto për zbatimin e këtyre masave me fokus të zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë është parashikuar në vlerën 2,778,962 lekë, nga të cilat 1,931,400 lekë janë hendek financiar.³⁵⁵

Partnerët ndërkombëtarë kanë prezantuar dhe forcuar zbatimin e ligjeve dhe politikave të përgjigjshme gjinore në lidhje me reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe ndërtimin e klimës dhe elasticitetit mjedisor (p.sh. ligjet ndaj fatkeqësive që trajtojnë cënueshmërinë e grave në fatkeqësi)³⁵⁶, rritjen e ndërgjegjësimit për cënueshmërinë disproporcionale të grave dhe vajzave ndaj ndikimit të ndryshimeve klimatike, degradimit mjedisor dhe fatkeqësive, si dhe promovimi i aksesit të grave në situata fatkeqësie në shërbime të tilla si pagesat e ndihmës, sigurimi për fatkeqësitë dhe kompensimi.³⁵⁷

Avokati i Popullit ka konstatuar se çështjet mjedisore duhet të jenë në qendër të vëmendjes së politikës dhe vendimmarrjes, pasi jo gjithmonë konsiderohen si çështje të ndërthurura me fusha të tjera (cross-cutting). Këto çështje, për shkak të natyrës dhe emergjencës së situatës në të cilën mbarë bota ndodhet aktualisht, nuk mund të jenë më dhe nuk mund të konsiderohen vetëm si pjesë e institucionit përgjegjës për mjedisin. Çështjet mjedisore, në të gjitha dimensionet e tyre, tashmë duhet të shihen ngushtësisht të ndërlidhura dhe me politikat e tjera për zhvillimin e vendit, si ekonomia, industria, energjia, bujqësia, blegtoria, shëndetësia, arsimi, etj. Nga ana tjetër, është e domosdoshme që në të gjitha analizat, vlerësimet, ndërhyrjet dhe masat që do të parashikohen në lidhje me çështjet mjedisore, të mbahet në konsideratë ndikimi i tyre i ndryshëm mbi gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë, nga të gjitha grupet e ndryshme, në shoqëri. Po kaq i rëndësishëm është edhe ndërgjegjësimi dhe edukimi që në fëmijëri të hershme lidhur me të drejtën për një mjedis të shëndetshëm. Avokati i Popullit konstaton se dimensionin gjinor në politikat sektoriale mjedisore është pothuajse i munguar, po ashtu vëren se nuk ka të dhëna të ndara sipas seksit dhe tregues gjinorë për ndikimet specifike të mjedisit mbi grupet e ndryshme të popullsisë, si të rejtat/të rinjtë, pjesëtarët/pjesëtarët e minoriteteve veçanërisht ato rome, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarat/të moshuarit, banoret/banorët e zonave rurale dhe periferive, etj., duke pasur parasysh këtu edhe përkatësinë e shumëfishtë (intersectionality).

.....
353. Bashkia Korçë

354. Me mbështetjen e UN Women

355. Shih: <https://durrës.gov.al/wp-content/uploads/2023/04/Vendimi-nr.151-date-22.12.2022.pdf>

356. Kontribute të dhëna nga Ambasada Suedeze

357. Kontribute të dhëna nga UNICEF

SEKSIONI I KATËRT

INSTITUCIONET DHE PROCESET KOMBËTARE

33. Ju lutemi, përshkruani strategjinë kombëtare ose planin e veprimit të vendit tuaj për barazinë gjinore, duke përfshirë emrin, periudhën që mbulon, prioritetin e tij, financimin dhe përputhjen me Agjendën për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030, duke përfshirë synimet në kuadër të OZHQ 5.

“**Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030**”³⁵⁸ (“SKBGJ 2021-2030”) u përgatit në emër të Qeverisë së Shqipërisë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në koordinim dhe konsultim me ministritë e tjera përgjegjëse, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile, akademinë, si dhe organizatat ndërkombëtare, të cilat punojnë për arritjen e barazisë gjinore dhe zvogëlimin e dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, në Shqipëri.

E konceptuar si vijim dhe e lidhur logjikisht me **Strategjinë e mëparshme për Barazinë Gjinore 2016-2020**³⁵⁹, “SKBGJ 2021-2030” përbën një udhërrëfyes drejt një shoqërie ku të gjithë individëve gra, burra, të reja, të rinj, vajza e djem, pavarësisht moshës, gjinisë, vendlindjes e vendbanimit, grupit etnik apo social, aftësive të kufizuara, përkatësisë e besimit fetar, shprehjes së identitetit gjinor e orientimit seksual, si dhe karakteristikave të tjera individuale, u jepen mundësi të barabarta të zhvillojnë potencialet e tyre; të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në vendimarrjen politike e publike; të zgjedhin e të zgjidhen; të edukohen dhe aftësohen gjatë gjithë jetës; të punësohen e punësojnë duke avancuar drejt profesioneve të reja e duke sfiduar stereotipet dhe ndarjen gjinore të punës; të ndikojnë në zhvillimin socio-ekonomik të vendit dhe të mbështeten për t’u zhvilluar në aspektin social dhe ekonomik; të krijojnë familje të shëndetshme, ku prindërit ndajnë përgjegjësitë në mënyrë të barabartë dhe ku komunikimi është çelësi i zgjidhjes së problemeve; të jetojnë të lirë nga praktikat e dëmshme dhe dhuna; si dhe ku grupet e cënueshme trajtohen me përparësi dhe mbështeten derisa të fuqizohen e gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në të gjitha fushat e jetës

358. Miratuar me VKM Nr.400, datë 30.06.2021. Shih: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2021/06/30/400/2387ac14-fd00-44cd-a291-bc00eb26f89f>

359. Miratuar me VKM Nr.733, datë 20.10.2016. Shih: <https://www.shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/SKGJB-AL-web.pdf>

- pra një shoqëri ku barazia nuk ngatërrohet me njëtrajtshmërinë dhe ku askush nuk duhet të mbetet pas. “SKBGJ 2021-2030” është e katërta e këtij lloji dhe padyshim reflekton (sikurse dhe strategjitë e mëparshme), përparësinë dhe vëmendjen e veçantë që Qeveria e Shqipërisë i kushton arritjes së barazisë gjinore, si dhe zvogëlimit të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, duke e konsideruar adresimin e duhur të tyre si kushte drejt një zhvillimi të qëndrueshëm. Kjo nënkupton lidhjen e drejtpërdrejtë të saj me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim II 2015-2020, si dhe me Programin Qeverisës 2017-2021.

E përgatitur për një **periudhë kohore dhjetë vjeçare**, “SKBGJ 2021-2030” ka një **lidhje të ngushtë me plotësimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) dhe të Agjendës 2030**. Në mënyrë specifike, ajo lidhet me OZHQ 5, OZHQ 1, OZHQ 2, OZHQ 3, OZHQ 4, OZHQ 8, OZHQ 10, OZHQ 11, OZHQ 13, OZHQ 16 si dhe OZHQ 17. Ky dokument strategjik reflekton në mënyrën e duhur edhe **plotësimin e standardeve apo detyrimeve që rrjedhin nga dokumente të tjerë ndërkombëtarë**, ku ndër më të rëndësishmit veçojmë Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), Deklaratën dhe Platformën për Veprim të Pekinit, si dhe Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave e Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), etj. “SKBGJ 2021 – 2030” lidhet gjithashtu edhe me Strategjinë e Barazisë Gjinore 2020 – 2025 të Bashkimit Evropian dhe bazohet veçanërisht në objektivat dhe masat e parashikuara në Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP III i BE) 2021-2025, ku specifikisht është synuar harmonizimi sidomos i qëllimeve strategjike, objektivave specifike dhe treguesve të matjes së progresit.

“Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030”³⁶⁰ (“SKBGJ 2021-2030”) u përgatit në emër të Qeverisë së Shqipërisë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në koordinim dhe konsultim me ministritë e tjera përgjegjëse, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile, akademinë, si dhe organizatat ndërkombëtare, të cilat punojnë për arritjen e barazisë gjinore dhe zvogëlimin e dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, në Shqipëri.

E konceptuar si vijim dhe e lidhur logjikisht me **Strategjinë e mëparshme për Barazinë Gjinore 2016-2020**³⁶¹, “SKBGJ 2021-2030” përbën një udhërrëfyes drejt një shoqërie ku të gjithë individëve gra, burra, të reja, të rinj, vajza e djem, pavarësisht moshës, gjinisë, vendlindjes e vendbanimit, grupit etnik apo social, aftësive të kufizuara, përkatësisë e besimit fetar, shprehjes së identitetit gjinor e orientimit seksual, si dhe karakteristikave të tjera individuale, u jepen mundësi të barabarta të zhvillojnë potencialet e tyre; të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në vendimarrjen politike e publike; të zgjedhin e të zgjidhen; të edukohen dhe aftësohen gjatë gjithë jetës; të punësohen e punësojnë duke avancuar drejt profesioneve të reja e duke sfiduar stereotipet dhe ndarjen gjinore të punës; të ndikojnë në zhvillimin socio-ekonomik të vendit dhe të mbështeten për t’u zhvilluar në aspektin social dhe ekonomik; të krijojnë familje të shëndetshme, ku prindërit ndajnë përgjegjësitë në mënyrë të barabartë dhe ku komunikimi është çelësi i zgjidhjes së problemeve; të jetojnë të lirë nga praktikatat e dëmshme dhe dhuna; si dhe ku grupet e cënueshme trajtohen me përparësi dhe mbështeten derisa të fuqizohen e gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në të gjitha fushat e jetës - pra një shoqëri ku barazia nuk ngatërrohet me njëtrajtshmërinë dhe ku askush nuk duhet të mbetet pas. “SKBGJ 2021-2030” është e katërta e këtij lloji dhe padyshim reflekton (sikurse dhe strategjitë e mëparshme), përparësinë dhe vëmendjen e veçantë që Qeveria e Shqipërisë i kushton arritjes së barazisë gjinore, si dhe zvogëlimit të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, duke e konsideruar adresimin e duhur të tyre si kushte drejt një zhvillimi të qëndrueshëm. Kjo nënkupton lidhjen e drejtpërdrejtë të saj me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim II 2015-2020, si dhe me Programin Qeverisës 2017-2021.

E përgatitur për një **periudhë kohore dhjetë vjeçare**, “SKBGJ 2021-2030” ka një **lidhje të ngushtë me plotësimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) dhe të Agjendës 2030**. Në mënyrë specifike, ajo lidhet

360. Miratuar me VKM Nr.400, datë 30.06.2021. Shih: <https://qzb.gov.al/eli/vendim/2021/06/30/400/2387ac14-fd00-44cd-a291-bc00eb26f89f>

361. Miratuar me VKM Nr.733, datë 20.10.2016. Shih: <https://www.shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/SKGJB-AL-web.pdf>

me OZHQ 5, OZHQ 1, OZHQ 2, OZHQ 3, OZHQ 4, OZHQ 8, OZHQ 10, OZHQ 11, OZHQ 13, OZHQ 16 si dhe OZHQ 17. Ky dokument strategjik reflekton në mënyrën e duhur edhe **plotësimin e standardeve apo detyrimeve që rrjedhin nga dokumente të tjerë ndërkombëtarë**, ku ndër më të rëndësishmit veçojmë Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), Deklaratën dhe Platformën për Veprim të Pekinit, si dhe Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave e Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), etj. “SKBGJ 2021 – 2030” lidhet gjithashtu edhe me Strategjinë e Barazisë Gjinore 2020 – 2025 të Bashkimit Evropian dhe bazohet veçanërisht në objektivat dhe masat e parashikuara në Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP III i BE) 2021-2025, ku specifikisht është synuar harmonizimi sidomos i qëllimeve strategjike, objektivave specifike dhe treguesve të matjes së progresit.

Vizioni i “SKBGJ 2021 – 2030”: “Një shoqëri e cila vlerëson barazinë dhe drejtësinë gjinore si kushte të domosdoshme drejt zhvillimit të qëndrueshëm social, ekonomik e politik të vendit, fuqizon të gjithë individët për të gëzuar të drejta dhe mundësi të barabarta në të gjitha fushat e jetës, nuk lejon që askush të mbetet pas, si dhe që mbështetet në parimin e tolerancës zero kundër praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, duke ndëshkuar dhunuesit dhe duke mbrojtur, rehabilituar e riintegruar personat e dhunuar”. Në të gjithë dokumentin strategjik dhe planin e veprimit të “SKBGJ 2021 – 2030”, theksohet **rëndësia e mbështetjes, trajtimit dhe fuqizimit të grave, të rejave dhe vajzave në tërësi**, përfshirë edhe nga grupe të cënueshme e që pësojnë diskriminim të shumëfishtë si: gra, të reja dhe vajza nga zonat rurale, nga minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, nëna të vetme, të dhunuara, të trafikuar, të moshuara, azilkërkuese, etj., pra nga të gjitha grupet në shoqëri. “SKBGJ 2021 – 2030” përbëhet nga **katër qëllime strategjike**: I. Përbushja e të drejtave ekonomike dhe sociale për gratë, të reja, vajzat dhe burrat, të rinjtë, djemtë në shoqëri dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave nga të gjithë grupet, duke synuar një rritje dhe qëndrueshmëri të ekonomisë mjedisore (së gjelbër), si dhe pjesëmarrjen e tyre të barabartë në digjitalizim; II. Përbushja e të drejtave të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve nga të gjitha grupet, për pjesëmarrje, përfaqësim dhe udhëheqje të barabartë në vendimmarrjen politike e publike në nivel vendor; III. Zvogëlimi i të gjitha formave të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje; IV. Aplikimi i integritetit gjinor si mjeti kryesor për arritjen e barazisë dhe drejtësisë gjinore në shoqëri.

Kostoja e përgjithshme e përlogaritur për zbatimin e “SKBGJ 2021 – 2030” është 3,358,697,259 Lekë (27,086,268 EUR).³⁶² Për periudhën 2021-2030, buxheti i shtetit pritet të financojë zbatimin e planit në masën 50.5% të financimit të nevojshëm, 33.9% pritet të financohet nga burime të tjera dhe donatorët, ndërsa 15.6% është hendek financiar. Kostot korente zënë rreth 80.1% të shpenzimeve totale, ndërsa pjesa tjetër (19.9%) është e parashikuar për kosto kapitale. Qëllimi i Politikës III, ka në terma financiare peshën më të madhe në zbatimin e strategjisë, përkatësisht 63.8%. Qëllimi i Politikës I arrin në vlerën 21.3%, ndërsa Qëllimet e Politikës IV dhe II arrijnë respektivisht 11.9% dhe 2.9 % të koston së përgjithshme të strategjisë. Për më shumë detaje mbi kostot referohuni te shtojca 6 e këtij raporti.

Monitorimi i zbatimit të “SKBGJ 2021 – 2030” kryhet rregullisht dhe **për vitin 2021** rezultojnë se: për qëllimin strategjik I, nuk është dhënë informacion për statusin e zbatimit për 44% të aktivitetëve, 22% e aktivitetëve janë realizuar, 22% e aktivitetëve janë në proces realizimi dhe 12% e aktivitetëve nuk janë realizuar; për qëllimin strategjik II, nuk është dhënë informacion për statusin e zbatimit për 33% të aktivitetëve, ndërsa 67% e aktivitetëve janë realizuar pjesërisht; për qëllimin strategjik III, 61% e aktivitetëve janë realizuar, 33% e aktivitetëve janë realizuar pjesërisht dhe 6% e aktivitetëve nuk janë realizuar; për qëllimin strategjik IV, 25% e aktivitetëve nuk janë realizuar, 50% e aktivitetëve janë në proces, ndërsa 25% e aktivitetëve janë realizuar pjesërisht.³⁶³ **Për vitin 2022**, nga monitorimi rezultojnë se: për qëllimin strategjik I, 31% e aktivitetëve janë realizuar plotësisht, 12% e aktivitetëve janë realizuar pjesërisht, 13% e aktivitetëve janë në proces realizimi, 21% e aktivitetëve nuk janë realizuar dhe për 23% të aktivitetëve nuk është dhënë informacion për statusin

.....
362. Kursi mesatar për referencë është përlogaritur me 124 lek për 1 euro.

363. “Raport monitorimi: Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planit të saj të Veprimit 2021-2030” për vitin 2021, fq. 6. Shih: <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/10/Raport-Monitorimi-per-vitin-2021-SKBGJ.pdf>

e zbatimit; për qëllimin strategjik II, 25% e aktiviteteve janë realizuar plotësisht, 62% e aktiviteteve janë realizuar pjesërisht dhe për 13% të aktiviteteve nuk është dhënë informacion për statusin e zbatimit; për qëllimin strategjik III, 57% e aktiviteteve janë realizuar plotësisht, 15% e aktiviteteve janë realizuar pjesërisht, 12% aktiviteteve janë në proces realizimi, 3% e aktiviteteve nuk janë realizuar dhe për 13% të aktiviteteve nuk është dhënë informacion për statusin e zbatimit; për qëllimin strategjik IV, 37% e aktiviteteve janë realizuar plotësisht, 16% e aktiviteteve janë realizuar pjesërisht dhe 47% aktiviteteve janë në proces realizimi.³⁶⁴ Raporti i monitorimit **për vitin 2023, është në proces përgatitjeje**. “SKBGJ 2021 – 2030” do të rishikohet pas 5 vitesh (në vitin 2025) për ta përshtatur me progresin në zbatimin e masave, por edhe për ta azhurnuar atë konform nevojave dhe programeve buxhetore afatmesme 2026-2028, të çdo institucioni.³⁶⁵

Planet Vendore të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ). Për një zbatim sa më korrekt të SKBGJ 2021-2030, si dhe për të përparuar drejt procesit të integritetit evropian, disa njësi të vetëqeverisjes vendore kanë nënshkruar Kartën Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore³⁶⁶ dhe po punojnë për zbatimin e saj. Nënshkrimi dhe zbatimi i Kartës Evropiane për Barazi, si dhe hartimi dhe zbatimi i Planeve Vendore të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) janë përcaktuar si masa për t’u zbatuar nga NJVV, edhe në SKBGJ 2021-2030. Deri tani në Shqipëri janë 18 bashki nënshkruese të Kartës³⁶⁷ (rreth 30% e totalit të bashkive në vend). Nga këto, 13 bashki kanë kaluar nëpër procesin e përgatitjes së PVVBGJ-ve dhe 12 prej tyre kanë pasur apo kanë konkretisht PVVBGJ të miratuara në Këshillin Bashkiak. Konkretisht: katër bashi kanë aktualisht PVVBGJ të miratuara e të vlefshme deri në fund të vitit 2024³⁶⁸; një bashki ka PVVBGJ të vlefshëm deri në fund të vitit 2025³⁶⁹; tre bashki kanë kaluar dy herë në procesin e hartimit dhe miratimit të PVVBGJ-ve (pra për vitet 2018-2020 dhe 2022 – 2024 ose 2025)³⁷⁰; gjashtë bashki kanë pasur një PVVBGJ që u ka përfunduar³⁷¹; një bashki e hartoi por nuk e miratoi PVVBGJ në Këshillin Bashkiak³⁷²; gjashtë bashki³⁷³ nuk kanë hartuar ende një PVVBGJ (nga të cilat katër e kanë nënshkruar Kartën Evropiane për Barazi gjatë periudhës 2022³⁷⁴-2023³⁷⁵), një prej tyre sapo e ka iniciuar procesin e hartimit të PVVBGJ (maj 2024).³⁷⁶ Masat dhe veprimet që parashikohen në këto PVVBGJ janë në përputhje të plotë me masat dhe veprimet që kërkohet të zbatohen nga NJVV në SKBGJ 2021-2030, në funksion të zbatimit të Kartës Evropiane për Barazi, por edhe të harmonizuara me EU GAP III, OZHQ-të, instrumentet ndërkombëtare (CEDAW, Konventa e Stambollit, Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit), etj.

364. “Raport monitorimi: Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planit të saj të Veprimit 2021-2030” për vitin 2022, fq 5-6. Shih: <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2023/06/Raporti-i-Monitorimit-SKBGJ-2022-.pdf>

365. SKBGJ 2021-2030, fq.45

366. Një dokument i përgatitur nga Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve Evropiane, që në vitin 2006 dhe rishikuar në vitin 2022. Shih: <https://charter-equality.eu/the-charter/observatoire-europeen-en.html>

367. Konkretisht bashkitë: Gjirokastrë, Korçë, Elbasan, Shkodër, Tiranë, Durrës, Përmet, Bulqizë, Librazhd, Cërrik, Dibër, Pogradec, Kamzë, Gramsh, Lushnjë, Kavajë, Lezhë, Vau i Dejës

368. Bashkitë Tiranë, Elbasan, Gjirokastrë dhe Gramsh, hartuar me mbështetjen e UN Women me fonde të BE

369. Bashkia Durrës hartuar me mbështetjen e UN Women me fonde të BE

370. Respektivisht bashkitë e Tiranës, Elbasanit dhe Durrësit, hartuar me mbështetjen e UN Women në të dy ciklet, me fonde ADA për PVVBGJ-të 2018-2020 dhe me fonde të BE për PVVBGJ 2022-2024

371. Respektivisht Bashkitë Korçë dhe Shkodër, për periudhën 2018-2020, me mbështetjen e UN Women dhe fonde të ADA; Bashkitë Bulqizë, Cërrik dhe Pogradec, Librazhd për periudhat 2020-2022 (Bulqiza) dhe 2020-2023 Cërrik, Librazhd dhe Pogradec, me mbështetjen e PLGP/USAID

372. Bashkia Dibër, për periudhën 2020-2023, e hartoi me mbështetjen e PLGP/USAID

373. Bashkia Përmet e ka nënshkruar Kartën në 2017 me mbështetjen e Delegacionit të BE dhe Bashkia Kamzë, që e ka nënshkruar Kartën në 2020 me mbështetjen e PLGP/USAID

374. Bashkia Lushnjë, me mbështetjen e UN Women dhe fonde të BE.

375. Bashkitë Kavajë, Lezhë, Vau i Dejës, me mbështetjen e UN Women dhe fonde të BE.

376. Bashkia Lezhë, organizoi takimin e parë për fillimin e procesit në 24 maj 2024, me mbështetjen e UN Women.

34. Ju lutemi, përshkruani sistemin e vendit tuaj për gjurmimin e pjesës së buxhetit kombëtar që investohet në promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave (Buxhetimi i Përgjigjshëm Gjinor), duke përfshirë përqindjen e përafërt të buxhetit kombëtar që investohet në këtë fushë.

Një nga synimet kryesore të reformës së Ministrisë së Financave ka qenë dhe mbetet zbatimi i plotë i Buxhetimit mbi bazë Programi dhe Performance. Për këtë qëllim, **Sistemi i Informacionit të Menaxhimit Financiar Shqiptar (AFMIS)** plotësisht funksional i shoqëruar me **Sistemin e Informacionit të Sistemit të Integruar të Planifikimit (IPSIS)**, i cili përforcon fuqishëm **lidhjen midis Planifikimit Strategjik dhe Buxhetimit Afatmesëm** (ndërfaqja mes tyre) rrit ndjeshëm lidhjen ndërmjet politikave gjinore të mishëruara në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore ose në strategjitë sektoriale, me programin buxhetor afatmesëm. Qëllimet dhe objektivat e politikave gjinore dhe treguesit kryesorë të performancës (KPI) përkatës të parashikuara në këto dokumente strategjike transferohen nga IPSIS në formularët specifikë të Deklaratës së Politikave të Programeve Buxhetore të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) në sistemin AFMIS. Bazuar në Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në Udhëzimin të Ministrit të Financave nr.7 datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, në çdo program buxhetor, duhet të ketë të paktën një objektivi gjinor si dhe tregues gjinorë të performancës, për të gjitha objektivat, ose aty ku është e mundur. Mbledhja e të dhënave të ndara sipas seksit dhe statistikave gjinore, si dhe përdorimi i tyre gjatë kryerjes së analizës së politikave, është e detyrueshme.

Gjatë përgatitjes së buxhetit, përdorueset/përdoruesit nga secili program buxhetor kërkohet të hedhin në formularët e PBA të dhënat aktuale për: (a) **Treguesit kryesorë gjinorë** të performancës në nivel qëllimesh dhe objektivash (IPSIS); (b) **Shumat e produkteve gjinore** (AFMIS) dhe (c) **Kostot e produkteve gjinore** (Sistemi i Thesarit dhe AFMIS). Në sistemin AFMIS, është vendosur një kuti e posaçme në nivel treguesi performance, të cilën nëpunëset/nëpunësit që hedhin të dhënat për programet buxhetore, duhet ta plotësojnë sa herë kanë të bëjnë me tregues gjinorë të performancës. Ky hap është i detyrueshëm dhe nuk lejon vijimin e procesit nëse nuk plotësohet. Pra etiketimi (gender tagging) kryhet në nivel treguesi performance, çka lejon më tej identifikimin e objektivit, programit buxhetor dhe institucionit që kanë lidhje me atë tregues. Kjo lidhje bën të mundur edhe identifikimin e produktit që është i lidhur me objektivin dhe treguesin e performancës, çka lejon më tej edhe përlogaritjen e shpenzimeve të parashikuara për arritjen e atij treguesi.

E njëjta logjikë, ndiqet edhe për buxhetin faktik. Gjatë hedhjes së të dhënave për realizimin e buxhetit faktik, bëhet lidhja e shpenzimeve me objektivat/treguesit/produktet specifike që janë realizuar me anë të atyre shpenzimeve. Këto të dhëna mundësojnë **hartimin e një deklarate gjinore** (Gender Budget Statement) për buxhetin vjetor, një **Aneksi të Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjinor** për çdo fazë të përgatitjes së PBA si dhe të **Buxhetit të Qytetareve/Qytetarëve**³⁷⁷ me lente gjinore për buxhetin vjetor përpara prezantimit të tij në Parlament.

Të dhënat e pesë viteve të fundit për parashikimet buxhetore që adresojnë çështje të barazisë gjinore në sektorë të ndryshëm, lidhur me fushat kritike të Platformës për Veprim janë si më poshtë:

377. Për më shumë shihni: <https://financa.gov.al/buxheti-i-qtetarit/>

Tabela 1. Parashikimet buxhetore që adresojnë fushat kritike të PVP në sektorë të ndryshëm.

Viti	Bujqësia	Punët e jashtme	Punët e brendshme	Shëndetësia dhe mbrojtja sociale	Kultura	Drejtësia	Arsimi	Financa dhe ekonomia	Infrastruktura	Mbrojtja
2019	0.1%	1.8%	8.50%	13%	2.20%	1%	44%	6.9%	0.01%	2.50%
2020	0.3%	1.6%	8.30%	14%	2.20%	1%	41%	7.0%	0.01%	2.60%
2021	5%	1%	4.20%	19%	2.50%	0.44%	63%	0.10%	0.01%	4.50%
2022	5.40%	2.70%	2.70%	14%	2.40%	0.04%	29%	2.40%	0.02%	1.30%
2023	5.00%	0.02%	5%	52%	2.60%	11.00%	40%	15.00%	0.02%	4%

Burimi: Të dhënat nga Ministria e Financave, në kuadër të përgatitjes së këtij raporti, Maj 2024.

Tabela 2. Numri i programeve dhe fondet buxhetore për Buxhetimin e Përgjigjshëm Gjinnor ndër vite.

Year	Nr. i programeve të BPGJ	Buxhetimi i Përgjigjshëm Gjinnor (BPGJ)	% e BPGJ ndaj buxhetit total	% BPGJ ndaj Produktit të Brendshëm Bruto (PBB)
2019	38	38,264,748	7.2%	2.3%
2020	43	52,630,418,850	9%	3%
2021	45	50,012,668,836	9%	3%
2022	48	60,380,387,485.13	9%	3%
2023	51	61,592,927,707	9%	3%
2024	76	737,377,663,130	10%	3%

Burimi: Të dhënat nga Ministria e Financave, në kuadër të përgatitjes së këtij raporti, Maj 2024.

Në PBA 2024 – 2026, janë parashikuar ndër të tjera, këto ndërhyrje lidhur me fushat kritike të PVP: Rritja e numrit të grave që përfitojnë shërbimet e këshillimit dhe informacionit bujqësor, ku 500 gra do të përfitojnë nga këto shërbime me një fond prej 2,300,000 lekësh; Politikat shëndetësore do të vijnë të mbështesin nënat e reja me shërbime të shëndetit parësor dhe dytësor, ku rëndësi të veçantë zënë investimet në maternitetet e reja me rreth 39,5 milionë lekë; Rritja e numrit të grave dhe vajzave që përfitojnë nga shërbimet e depistimit të kancerit të gjirit me anë të mamografisë së lëvizshme nga 5,450 gra në 5,550 për vitet 2024-2026 me një kosto prej 12,500,000 lekë, me synim parandalimin e rasteve duke rritur depistimin për kancerin e gjirit kundrejt totalit të grave (grup mosha 50-60 vjeç) nga 15.2% në vitin 2023 në 30.3% në vitin 2026; Rritja e numrit të grave dhe vajzave që përfitojnë nga shërbimet e depistimit të kancerit të qafës së mitrës nga 11,000 gra në 13,000 përgjatë 2024-2026, me një kosto prej 25,000,000 lekë me synim uljen e vdekshmërisë nga kanceri i qafës së mitrës nga 2.5/100 000 në vitin 2023 në 2.4/100 000 në vitin 2026; Sigurimi i shërbimit të transportit për 36,000 vajza dhe djem (44% vajza) që kanë vendbanimin e tyre mbi 2 km nga shkolla, si dhe për rreth

12,000 mësuese/mësues që punojnë mbi 5 km nga vendbanimi te qendra e përhershme e punës në shkollë; Punësimi nga programet e nxitjes së punësimit i 1,520 grave dhe vajzave nga 2,000 të regjistruara gjithsej, me një kosto prej 342,000,000 lekësh; Punësimi pas përfundimit të Formimit Profesional i 7,015 grave nga 11,500 përfituese/përfitues gjithsej (ose 61%) me një kosto prej 142,600,920 lekësh; Krijimi i mundësive të ndryshme të punësimit nëpërmjet arsimit profesional për 18,000 vajza dhe djem, nga të cilat/cilët 2,750 (15%) janë vajza me një kosto shkollimi 284,084,625 lekë; Mbështetje me pension familjar për 41,831 gra me një kosto prej 8,726,044,066 lekësh (kontribues dhe transfert nga buxheti); Financimi i Programit të “Bonusit të Bebes” për çdo të porsalindur, duke garantuar shpërblimin financiar nga 40,000-120,000 lekë për mbi 45,000 fëmijë/vit, si një mënyrë për të ndihmuar sidomos nënat dhe baballarët e rinj, të cilat/cilët nuk kanë qenë asnjëherë pjesë e tregut të punës, për të përballuar muajt e parë të lindjes së bebes; Financimi i politikës së mbështetjes së veçantë për gratë e papuna me 3 apo më shumë fëmijë deri 18 vjeç, me të ardhura familjare deri në 100,000 lekë në muaj, duke i mbështetur me pagesën e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, për periudhën e kujdesit ndaj fëmijës deri 5 vjeç dhe për vitin 2024 parashikohet të përfitojnë 8,000 gra krahasuar me 5,580 gra përfituese në vitin 2023, me një kosto prej 800,000,000 lekësh; Ofrimi i ndihmës juridike falas për rreth 5,000 individë që plotësojnë kushtet në zbatim të ligjit për ndihmën juridike falas, prej të cilëve 3,000 (59%) janë gra dhe vajza; Për gratë dhe vajzat e dhunuara, apo familje një prindërore, do të vijohet mbështetja me strehim social dhe kostoja për strehimin social të 850 grave dhe vajzave të kategorisë së përcaktuar sipas ligjit do të jetë 47,562,600 lekë, përlllogaritur si përpjesë e dy produkteve kryesore të skemave; etj.³⁷⁸

Sfidat në drejtim të bërjes së të gjitha buxheteve të përgjigjshme gjinore kanë qenë dhe vijojnë të jenë të shumta, ku ndër më të rëndësishmet përmendim: mungesa e të dhënave të ndara sipas seksit e statistikave gjinore, pa të cilat institucionet nuk mund të kryejnë analiza të thelluara gjinore; aftësitë e kufizuara teknike të nëpunësve/nëpunësve për të kryer analiza të tilla; fonde të pamjaftueshme për të adresuar plotësisht nevojat e identifikuar, etj.

35. Çfarë mekanizmesh formalë janë vendosur për palët e ndryshme të interesit për pjesëmarrje në zbatimin dhe monitorimin e Deklaratës dhe Platformës për Veprim të Pekinit dhe Agjendës për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030?

Shqipëria ka ndërmarrë një sërë veprimesh për të bërë të njohur, promovuar, zbatuar dhe monitoruar progresin në përparimin drejt përmbushjes së Agjendës për Zhvillim të Qëndrueshëm³⁷⁹, si dhe të një sërë dokumentesh e instrumentesh të rëndësishëm ndërkombëtarë, përfshirë këtu edhe Deklaratën dhe Platformën për Veprim të Pekinit. **Agjencia Shtetërore për Planifikimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës (SASPAC)** koordinon përpjekjet ndërqeveritare për arritjen e OZHQ-ve që nga dhjetori 2021. **Kuvendi** ka ngritur³⁸⁰ në vitin 2022 **Nënkomisionin për Zhvillim të Qëndrueshëm**, në përbërje të Komisionit të përhershëm Parlamentar, për Ekonominë dhe Financat. Fusha e përgjegjësisë së këtij nënkomisioni është zhvillimi ekonomik dhe social, rritja ekonomike e qëndrueshme, realizimi i objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe Agjenda 2030 e OKB-së.

378. Për më shumë detaje referohu te “Buxheti për Qytetaret/Qytetarët, 2024”, fq. 13-26. Shih: <https://financa.gov.al/buxheti-i-qytetarit/>

379. Këto zhvillime janë përshkruar me detaje në raportin e mëparshëm të zbatimit të Deklaratës dhe Platformës për Veprim, Pekin+25.

380. . Me Vendimin nr. 34/2022 të datës 14.4.2022. Nënkomisioni përbëhet nga 10 anëtare/anëtarë (7 gra). Shih: <https://www.parlament.al/struktura/d1d56719-80b6-4a1e-92df-b1b0314d0e00>

Qeveria e Shqipërisë konfirmoi udhëheqjen dhe përkushtimin ndaj OZHQ-ve duke ri-themeluar **Komitetin Ndërmnistror për OZHQ-të** dhe **Grupin Ndërinstitucional të Punës për OZHQ-të** në vitin 2023. OZHQ-të janë integruar si në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022 – 2030 (dhe në strategjinë e mëparshme SKZHI II 2015 - 2020) ashtu edhe në një tërësi strategjish sektoriale. Gjatë vitit 2024 po përgatitet Udhërrëfyti Kombëtar i OZHQ-ve 2024–2030 për t'ju dhënë përparësi veprimeve dhe masave për arritjen e këtyre objektivave në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit dhe progresin në procesin e anëtarësimit në BE. Raporti i Zhvillimit të Qëndrueshëm 2023 e renditi Shqipërinë në një të tretën e vendeve të para në nivel global (e 54-ta), duke kërcyer shtatë vende.³⁸¹

Nëpërmjet një Kuadri Bashkëpunimi për Zhvillim të Qëndrueshëm me Qeverinë e Shqipërisë, **OKB-ja** mbështet plotësisht dhe punon për arritjen e objektivit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian (BE), prioritetet kombëtare, si dhe harmonizimit dhe efektivitetit të ndihmës. Kjo përfshin angazhimin e Shqipërisë për arritjen e OZHQ-ve. Fondet e disponueshme përmes Kuadrit të Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm 2022 – 2026³⁸², janë: 94,4 milion USD (2022), 84,4 milion USD (2023) dhe 66,6 milion USD (2024).³⁸³

Mbledhja dhe reflektimi në këto procese i zërit të grave dhe vajzave nga grupet e cënueshme dhe i shqetësimeve të tyre realizohet përmes përfshirjes në mekanizma të caktuar të **organizatave të shoqërisë civile**, sidomos organizatave të të drejtave të grave, duke filluar që nga përfshirja e tyre në **Këshillin Kombëtar të Barazisë Gjimore (KKBGJ)**, si organi më i lartë këshillimor për politikën gjimore në Shqipëri (që në përbërjen e tij ka edhe përfaqësues/përfaqësues të tre organizatave të shoqërisë civile). Konsultimi që zhvillon shteti me OSHC-të si për hartimin e legjislacionit apo politikave të reja, ashtu dhe për rishikimin e atyre ekzistuese nën këndvështrimin gjimor, është një tjetër mekanizëm që siguron reflektimin e zërit dhe shqetësimeve të grave/ të rejave / vajzave, përfshirë edhe ato nga grupet e cënueshme në këto ligje dhe politika e strategji. Gjithashtu raportimet kombëtare që përgatiten për zbatimin e Deklaratës dhe Platformës për Veprim të Pekinit, Agjendës për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030, apo për zbatimin e shumë instrumenteve ndërkombëtarë, realizohen përmes proceseve gjithëpërfshirëse dhe konsultative, pra me pjesëmarrjen jo vetëm të institucioneve përgjegjëse shtetërore qendrore e vendore, por edhe me pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile (sidomos të OSHC-ve të fokusuara te gratë dhe grupet e cënueshme), organizatave ndërkombëtare, medias, sindikatave, etj.

36. Ju lutemi përshkruani se si palët e interesit kanë kontribuar në përgatitjen e këtij raporti kombëtar.

Ky raport kombëtar në emër të Qeverisë së Shqipërisë u përgatit përmes një procesi gjithëpërfshirës. Udhëheqja dhe koordinimi u realizuan nga **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**, si autoriteti kryesor përgjegjës i mekanizmit kombëtar për barazinë gjimore, në nivel ministrie.

Procesi nisi zyrtarisht më 8 shkurt, me mbështetjen dhe asistencën teknike të Zyrës së UN Women në Shqipëri.³⁸⁴ Përgatitjet paraprake u bënë deri më 23 shkurt, kur u krijua **Grupi Ndërmnistror i Punës**, i përbërë nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) përfaqësues / përfaqësues nga ministrinë e linjës dhe disa institucione të pavarura. Pyetësori për mbledhjen e informacionit paraprak, bazuar në dokumentin udhëzues për

381. Shih: [Sustainable Development Report 2023 \(sdgindex.org\)](https://sdgindex.org)

382. Nënshkruar në 25 tetor 2021. Shih: [PRINT Shtator shqip_new Updated Albania CF 2022-2026 OK.pdf \(un.org\)](https://www.un.org/development/desa/policy/2022-2026-OK.pdf)

383. Shih: [Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm | Kombet e Bashkuara në Shqipëri \(un.org\)](https://www.un.org/development/desa/policy/2022-2026-OK.pdf)

384. Dy konsulentë të kontraktuar nga UN Women (znj. Iris Aliaj dhe znj. Monika Kocaqi) mbështetën të gjithë procesin e përgatitjes deri në përfundimin e këtij raporti kombëtar.

shqyrtimet gjithëpërfshirëse në rang kombëtar, përkthyer në gjuhën shqipe, u nda me anëtarët/anëtarët e Grupit të Punës, si dhe me: 61 (gjashtëdhjetë e një) **Njësi të Vetëqeverisjes Vendore**, 32 (tridhjetë e dy) rrjete / koalicionet të **organizatave të shoqërisë civile**, 40 (dyzet) **organizata jo-fitimprurëse të fokusuara kryesisht te gratë, edhe nga grupet e cënueshme**, 9 (nëntë) **institucione të pavarura dhe të drejtave të njeriut** (si Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, etj.), me **Konfederatën e Sindikatave të Shqipërisë**, si dhe me 20 (njëzet) **organizata ndërkombëtare**, anëtare të Grupit Koordinues të Donatorëve për Barazinë Gjinore. Të dhënat cilësore, të përditësuara dhe të kategorizuara, si dhe statistikat gjinore u vunë në dispozicion nga institucionet përkatëse dhe në veçanti nga **Instituti i Statistikave të Shqipërisë** (INSTAT).

U hartua një kalendar i detajuar i hapave që u ndërmorën deri në përfundimin dhe miratimin e raportit dhe për çdo mbledhje, konsultim me grupet e interesit, apo takime vlerësuese e miratuese, është mbajtur komunikim i hapur me publikun e gjerë.³⁸⁵

U mbajtën 3 (tre) takime zyrtare të Grupit Ndërmintor të Punës, përkatësisht në 26 shkurt (22 pjesëmarrës/e, 5 burra); 12 prill (23 pjesëmarrës/e, 3 burra) dhe 30 prill (20 pjesëmarrës/e, 2 burra). U organizuan tre konsultime, respektivisht një me anëtarët e Grupit Tematik të Rezultateve për Barazinë Gjinore (GTRG) në datën 2 maj (19 pjesëmarrës/e, 1 burrë); një me përfaqësues dhe përfaqësues të shoqërisë civile, sindikatave, medias, organizatave të grave, organizatave rinore dhe organizatave ndërkombëtare, në datë 9 maj (46 pjesëmarrës/e, 6 burra), si dhe një me përfaqësues dhe përfaqësues të **Komisioneve apo Nënkomisioneve Parlamentare, Aleancës së Grave Deputete dhe Agjencisë Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës**, në datën 17 maj (20 pjesëmarrës/e, 1 burrë; 13 deputete të AGD).

Pas përditësimit të përmbajtjes nga të gjitha kontributet e dërguara me shkrim, si dhe nga komentet dhe sugjerimet e grupeve të interesit, raporti i përfunduar u dërgua për një konfirmim me shkrim nga të gjitha ministritë përkatëse të linjës, si dhe u miratua në mbledhjen e **Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore**, në datën 27 maj (31 pjesëmarrës/e, 4 burra; nga të cilat/cilët 14 anëtar/e të KKBGJ dhe Nëpunës/e Gjinor/e, 3 burra).

37. Ju lutemi përshkruani planin e veprimit të vendit tuaj dhe afatin kohor për zbatimin e rekomandimeve të Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (nëse është shtet palë), ose rekomandimet e Rishikimit Periodik Universal ose mekanizmave të tjerë të të drejtave të njeriut të Kombeve të Bashkuara që trajtojnë pabarazinë gjinore /diskriminimin ndaj grave.

Shqipëria përgatiti dhe dorëzoi raportin e pestë kombëtar për zbatimin e Konventës për Eliminimin e të Gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) në **janar 2021**, si dhe përgjigjet për listën e çështjeve të dërguara nga Komiteti CEDAW në **korrik 2022**. Më **18 tetor 2023**, Komiteti CEDAW mori në shqyrtim raportin e pestë periodik të Shqipërisë dhe në **25 Tetor 2023** miratoi Vërejtjet Përmblylëse.³⁸⁶

385. Për më shumë shih postimet në: <https://www.facebook.com/unwomenalbania/posts/pfbid02iPaQZ1etcDHKecV1ww2MmbcTCVqpRsGCuGKbf75z6mEiAc8zdto4x4zfqeSQGiutl> <https://www.facebook.com/unwomenalbania/posts/pfbid02bWrHw57j8SrSCcN31pn98tJdqXoiNFAFcUG5X9jTX75A8hAbBxzdrvaFgntF8w4yl> <https://www.facebook.com/unwomenalbania/posts/pfbid0kF3JhfDHZ7ZLottdrpqjFL5r4qgLoT8cn1vzFtoZj4oWA4cooFcMBANA5uDPRHGI> <https://www.facebook.com/unwomenalbania/posts/pfbid02ri4qnQ5C9Dk4nVbWnkBP88GwV6yKnG7vLa7oSYpTc3eUwAk6mf2K9eQ4EvAT4PsWI>

386. Shih: https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/TreatyBodyExternal/TBSearch.aspx?Lang=En&CountryID=2

Komiteti CEDAW kërkon nga Shqipëria që, **brenda dy vjetësh**, të dorëzojë **informacion me shkrim për hapat e ndërmarrë për zbatimin e rekomandimeve urgjente** për paragrafët: 12 (a) - Të shqyrtohet mundësia e rishikimit të Ligjit Nr. 9970/2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, në përputhje me angazhimin e marrë në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030 për përshpejtimin e realizimit de jure (ligjor) dhe de facto (real) të barazisë gjinore; 24 (b) - Të ndryshohet Kodi Penal për të përfshirë në të njëjtin përkufizim të përdhunimit bazuar në mungesën e dhënies së pëlqimit, i cili përfshin çdo akt seksual të kryer pa pëlqim dhe merr parasysh të gjitha rrethanat shtrënguese, në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut; 28 (b) - Të miratohet masa të veçanta të përkohshme, si kuota të detyrueshme me ligj dhe një sistem të përfaqësimit të barabartë gjinor, në përputhje me nenin 4(1) të Konventës dhe rekomandimin e përgjithshëm të Komitetit nr. 25 (2004) mbi masat e veçanta të përkohshme, për të siguruar përfaqësim të barabartë të grave, përfshirë të grave nga zonat rurale, grave me aftësi të kufizuara, grave që u përkasin pakicave etnike, dhe grave lesbike, biseksuale, transgjimore dhe interseks, në Kuvend dhe në organet legjislative bashkiake, në organet qeveritare, në shërbimin civil dhe shërbimin e jashtëm, në veçanti në nivelet vendimmarrëse; si dhe 36 (d) - Të zbatohet rreptësisht ndalimin e ndërprerjeve të shtatzënive për arsye të përzgjedhjes së seksit të foshnjave dhe të ofrojë shërbime, si linjat telefonike falas, për gratë/të rejat ndaj të cilave ushtrohet trysni për ndërprerjen selektive të shtatzënisë bazuar në gjininë e foshnjës.

Në këtë kuadër, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me mbështetjen e UN Women po përgatit **Planin e Veprimit për zbatimin e Vërejtjeve Përmbyllëse mbi raportin e pestë periodik të zbatimit të Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave** (CEDAW). Ky plan veprimi po përgatitet përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe me angazhimin e një sërë institucioneve përgjegjëse qendrore e vendore, institucione të pavarura, si dhe në konsultim me organizatat e shoqërisë civile. Një draft i parë i këtij plani, është përcjellë për rishikim nga aktorët përkatës në fillim të muajit maj 2024.

Shqipëria ndjek me rigorozitet dhe plotëson në kohë raportimet edhe për instrumente të tjerë ndërkombëtarë të rëndësishëm, përfshirë edhe rekomandimet e Rishikimit Periodik Universal. Angazhimi ndaj të drejtave të njeriut mbetet një përparësi dhe ky proces luan një rol thelbësor në promovimin e llogaridhënies dhe ndryshimeve pozitive. Shqipëria e përfundoi raundin e tretë të raportimit për Rishikimin Periodik Universal në **maj 2019** dhe po përgatitet për raundin e katërt (parashikuar për t'u mbajtur në nëntor 2024). Sipas kalendarit paraprak, afati për dorëzimin e raportit kombëtar është në fillim të muajit **gusht 2024**.³⁸⁷

Në periudhat ndërmjet dy raportimeve për çdo instrument ndërkombëtar, qeveria e Shqipërisë merr masa për të bërë të njohur të gjitha rekomandimet që dalin nga këto procese (përkthimin në gjuhën shqipe dhe shpërndarjen e tyre), koordinon veprimet dhe fillon zbatimin (bashkëpunon me institucionet përgjegjëse qendrore e vendore, por edhe me aktorë të tjerë të rëndësishëm si institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile, botën akademike, median, etj.), si dhe i mban në konsideratë rekomandimet e dhëna edhe në proceset e hartimit dhe miratimit të ligjeve, strategjive e politikave mbarëkombëtare.

.....
387. Shih: <https://upr.info/en/review/albania>

SEKSIONI I PESTË TË DHËNAT DHE STATISTIKAT

38. Cilat janë fushat më të rëndësishme në të cilat vendi juaj ka shënuar më shumë progres gjatë pesë viteve të fundit për sa i përket statistikave gjinore në nivel kombëtar?

Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT) prodhon statistika gjinore vjetore bazuar në Ligjin e Statistikave Zyrtare dhe Programin Kombëtar të Statistikave Zyrtare. Statistikat gjinore reflektojnë ndryshimet ose pabarazitë e situatës ndërmjet burrave / të rinjve / djemve dhe grave / të rejave / vajzave në fusha të tilla si popullsia, arsimi, tregu i punës, përfshirja sociale, shëndetësia dhe vendimmarrja. Njohja e situatës së grave / të rejave / vajzave dhe burrave / të rinjve / djemve në shoqëri, në të gjitha sferat e jetës orienton politikëbërësit/politikëbërësit drejt vendimmarrjeve të duhura për zhvillimin e politikave në këto fusha. Burimi kryesor i të dhënave për prodhimin e statistikave gjinore janë burimet administrative dhe anketat sociale të familjeve të kryera nga Instituti i Statistikave.³⁸⁸

Programi i Statistikave Zyrtare (PSZ) përcakton strategjinë e zhvillimit të statistikave zyrtare dhe Sistemit Kombëtar Statistikor për një periudhë pesëvjeçare dhe përmban aktivitetet statistikore kryesore të cilat duhet të kryhen nga prodhueset/prodhuesit e statistikave zyrtare gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu, PSZ specifikon institucionet e ngarkuara për prodhimin e statistikave zyrtare dhe institucionet furnizuese me të dhëna administrative. PSZ përgatitet në bashkëpunim të ngushtë me grupet e interesuara për statistika zyrtare dhe pas marrjes së mendimit të Këshillit të Statistikave, nëpërmjet Këshillit të Ministrave i paraqitet Kuvendit për miratim përfundimtar. Në vijim të PSZ 2017 – 2021, është përgatitur dhe miratuar PSZ 2022–2026³⁸⁹, që

388. Për më shumë shihni: <https://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/barazia-gjinore/#tab1>

389. LIGJ Nr. 30/2022, datë 24.03.2022 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022–2026”. Shih: <https://cluster1.albania.com/sq/kapitulli-18/>

sjell një qasje të re gjithëpërfshirëse, pasi është përgatitur me angazhimin e plotë të agjencive statistikore dhe të gjithë aktorëve kontribuues në prodhimin e statistikave. Ky program shërben për një fuqizim të mëtejshëm të sistemit, me ide inovatore, duke rritur besimin e përdoruesve / përdoruesve në statistika, duke bashkëpunuar me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, duke zhvilluar kapacitetet për një nivel të lartë profesional, ku shkenca e statistikës të gjejë zbatim në praktikë, si dhe duke zbatuar standardet për një qasje sa më të shpejtë në familjen evropiane dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, për një qëllim të përbashkët, ku askush të mos mbetet pas. Për zbatimin e PZS është miratuar edhe plani vjetor 2023.³⁹⁰

Si asnjëherë më parë, gjatë periudhës 2019–2020 Sistemi Kombëtar Statistikor dhe INSTAT-i, në veçanti, u përballën me situata përtej kufijve natyrorë, si pasojë e tërmete të nëntorit 2019 dhe pandemisë globale COVID-19. Situata e shkaktuar nga tërmetet e vitit 2019 detyruan INSTAT-in të rimernte në konsideratë planin e veprimit të vitit 2019 për t'iu përshtatur gjendjes së re të krijuar në zonat e dëmtuara, si dhe përfshirjen e stafit të tij në proceset e prodhimit të treguesve për matjen e këtyre pasojave në terren. Ndërtesat e vrojtura gjatë proceseve të përditësimit të hartave për zonat e censit, iu nënshtruan edhe një herë proceseve të përditësimit, për të evidentuar më saktë ndërtesat e dëmtuara dhe ato të cilat nuk mund të ofronin më karakteristikat e një banese. Për sa i takon pandemisë, në kushtet e reja të distancimit social, INSTAT-i: përcaktoi objektiva afatshkurtër në zbatim të misionit të tij dhe parimeve të statistikave evropiane; mori në konsideratë përshtatjen e metodave dhe metodologjive, si përdorimi i intervistave telefonike në vend të metodës tradicionale të grumbullimit të informacionit dhe shfrytëzimi me eficiencë i burimeve ekzistuese apo ndjekja me rigorozitet e rekomandimeve të Eurostat dhe institucioneve ndërkombëtare; hartoi plane të vazhdimësisë për çdo aktivitet statistikor - një risi kjo nëpërmjet së cilës mundësohet marrja e masa paraprake dhe në kohën e duhur për përballimin e situatave të ngjashme, duke garantuar mos ndërprerjen e prodhimit statistikor; siguroi kushtet e nevojshme për punën online nëpërmjet telepunës; krijoi platforma të reja për komunikimin online ndërmjet stafit dhe zhvilloi programe të reja kompjuterike për monitorim të situatës shëndetësore të stafit, ndjekjes dhe monitorimit të detyrave; krijoi një seksion të veçantë në faqen web, dedikuar COVID-19, ku publikoi të dhënat më frekvente; të cilat ndihmuan hartueset/hartuesit e politikave, analistët/analistët, studiueset/studiuesit për analiza të mëtejshme ekonomiko-sociale lidhur me situatën e krijuar në vend; si dhe hartoi dhe po zbaton një regjistër të detajuar risku, për të siguruar vazhdimësinë e veprimtarisë prodhuese dhe minimizimin e dëmeve në rastet e përballjes së situatave të ngjashme.³⁹¹

Për të reflektuar dallimet e mundshme gjinore në fusha të ndryshme të jetës, INSTAT publikon çdo vit një publikim të dedikuar **“Gratë dhe Burrat në Shqipëri”**.³⁹² Të dhënat e këtij botimi i shërbejnë politikëbërëseve/politikëbërësve, botës akademike, shoqërisë civile dhe përdoruesve/përdoruesve të ndryshëm, të analizojnë më gjerë kontekstin e barazisë gjinore në shoqërinë shqiptare. Ky publikim është krijuar në kapituj të veçantë, si: Popullsia; Shëndeti; Edukimi; Tregu i Punës dhe Mbrotjtja Sociale; Statistikat e krimit dhe të drejtësisë penale; Gratë në vendimmarrje; Treguesit socialë nga anketat e familjeve; Të drejtat e njeriut; Indeksi i pabarazisë gjinore dhe Seti minimal i treguesve gjinorë.³⁹³

Seti minimal i Treguesve Gjinorë është pjesë e këtij botimi që nga viti 2016 dhe përfshin 52 tregues, nga të cilët 22 janë tregues të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Treguesit janë të strukturuar në këto fusha: Strukturat ekonomike, pjesëmarrja në aktivitete prodhuese dhe aksesit në burime; Edukimi; Shëndeti dhe shërbimet përkatëse; Jeta publike dhe vendimmarrja; Të drejtat e njeriut, të grave dhe fëmijëve vajza. Ndërsa kapitujt mbi treguesit gjinorë nga anketat sociale në familje dhe treguesit mbi të drejtat e njeriut u përfshinë për herë të parë si risi në këtë botim, në vitin 2020. Duke filluar nga viti 2019, publikimi vjetor “Gratë dhe Burrat në Shqipëri”, shoqërohet dhe me një publikim interaktiv, i cili synon të paraqesë të dhëna në mënyrë

390. Me vendim të Kuvendit, Nr. 3/2023, datë 26.01.2023 “Për miratimin e planit vjetor 2023 për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022–2026”. Shih: <https://cluster1albania.com/sq/kapitulli-18/>

391. PSZ 2022 – 2026, fq. 4-5.

392. Shih: <https://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/barazia-gjinore/#tab3>

393. Lista e treguesve e vendosur nga Komisioni Statistikor në bashkëpunim me UN Women për matjen e treguesve gjinorë.

interaktive për përdorueset / përdoruesit, duke pasqyruar diferenat dhe ngjashmëritë midis grave dhe burrave në jetën e përditshme. Ky publikim digjital përmban tekst të shkurtër, mjete për vizualizim interaktiv, grafikë dhe tabela për çdo kapitull.³⁹⁴

Indeksi i Pabarazisë Gjinore (IPGJ), është një tregues i përbërë, i modeluar në mënyrë të tillë që të paraqesë nga ana sasiore humbjen potenciale në zhvillim njerëzor, si rezultat i pabarazive ndërmjet arritjeve të burrave dhe grave në dimensionet e shëndetit riprodhues, fuqizimit politik, arsimor dhe tregut të punës. IPGJ varion nga 0 në 1 dhe vlerat më të larta tregojnë më shumë pabarazi dhe më shumë humbje në zhvillimin njerëzor si pasojë e pabarazisë. IPGJ ndër vite rezulton: 0.10 në 2019; 0.06 në 2020; 0.09 në 2021 dhe 0.06 në 2022.³⁹⁵

Indeksi i Barazisë Gjinore (IBGJ) mat barazinë gjinore në gjashtë fusha thelbësore: puna, paraaja, dijet, koha, pushteti, shëndeti dhe në dy fusha të tjera: ndërthurjen e pabarazive dhe dhunës, bazuar në kuadrot konceptuale specifike. IBGJ u publikua për herë të parë në janar të vitit 2020, në bashkëpunim me Institutin Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE).³⁹⁶

Statistikat e të drejtave të njeriut janë një fushë e re dhe ende nuk janë zhvilluar plotësisht. INSTAT ka nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me Avokatin e Popullit, për zhvillimin e këtyre statistikave. Deri më tani janë zhvilluar vetëm statistika për ankesat për shkelje të pretenduara të të drejtave të trajtuara nga Avokati i Popullit, sipas llojit të së drejtës; si dhe statistikat që janë pjesë e publikimit Gratë dhe Burrat në Shqipëri 2020 dhe 2021, në një kapitull të veçantë. Bazuar në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Zyra e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCR) ka përgatitur tregues të të drejtave të njeriut ndërkombëtare (HRI) të përditësuar me treguesit e Objektive të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Bazuar në këtë material, Instituti i Statistikave ka hartuar treguesit e disponueshëm të OZHQ që lidhen me fushat e të drejtave të njeriut.

39. Cilat janë prioritetet e vendit tuaj për forcimin kombëtar të statistikave gjinore gjatë pesë viteve të ardhshme?

Referuar Programit të Statistikave zyrtare 2022-2026, INSTAT i ka dhënë përparësi statistikave gjinore duke i integruar ato specifikisht në këtë program. Përparësi do vijojë të këtë përmirësimi i publikimit “Gra dhe Burra në Shqipëri” dhe shtimi i numrit të treguesve gjinorë të publikuar, veçanërisht në fushën e të drejtave të njeriut dhe tregues OZHQ të lidhur me gjininë. Do të vijojë puna për prodhimin dhe publikimin e indekseve gjinore dhe setit minimal të treguesve gjinorë, të cilat mundësojnë një pamje të plotë të situatës së pabarazive në vend dhe bazë krahasimore me vendet e tjera.

Prioritet lidhur me statistikat gjinore për pesë vitet e ardhshme është edhe kryerja e anketave pranë familjeve, Anketa e Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave (VAWG) si dhe Anketa e Përdorimit të Kohës (TUS). Kryerja e këtyre anketave do të mundësojë përditësimin e të dhënave lidhur me dhunën dhe përdorimin e kohës, si dhe do të sigurojë një analizë të progresit krahasuar me raundin e kaluar të anketave të kryera. Për më tepër INSTAT, përveç të dhënave të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023, i cili do të sigurojë një panoramë të karakteristikave ekonomike dhe sociale të grave dhe burrave në momentin e censit, do të mundësojë gjithashtu edhe bazën për analiza më të thelluara në këtë drejtim.

394. Ky publikim është zhvilluar nga INSTAT me mbështetjen e UN Women.

395. Për më shumë shih: <https://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/barazia-gjinore/#tab2>

396. Shih: <https://www.instat.gov.al/al/publikime/librat/2020/indeksi-i-barazis%C3%AB-gjinore-p%C3%ABr-republik%C3%ABn-e-shqip%C3%ABris%C3%AB-2020/>

Gjithashtu, siç parashikohet në Programin Statistikor Zyrtar 2022–2026, në interes të përmirësimit të statistikave zyrtare, si dhe në përmbushje të rekomandimeve të Eurostat për standardizimin e prodhimit statistikor, gjatë pesë viteve të këtij programi, sistemi kombëtar statistikor, do të fokusohet në: a) Përmirësimin e metodologjisë statistikore; b) Modernizimin e metodave të mbledhjes së të dhënave; c) Reduktimin e afateve kohore të përpunimit dhe publikimit të të dhënave; d) Rritjen e të dhënave të transmetuara në Eurostat.

Për sa u takon fushave statistikore, institucionet prodhuese të statistikave zyrtare do të angazhohen në aktivitete statistikore përmirësuese në aspektet si më poshtë:

- Fusha e statistikave sociale dhe demografike: përmirësime në metodologji, mbledhjen e të dhënave, transmetimet në Eurostat dhe publikime të reja.
- Fusha e statistikave ekonomike: përmirësime në metodologji, afate kohore dhe tregues të rinj.
- Fusha e statistikave sektoriale: përmirësime në metodologji, metodat e mbledhjes së të dhënave, afate kohore dhe transmetime në Eurostat.
- Fusha e statistikave të mjedisit dhe multidomain: përmirësime në metodologji dhe transmetime në Eurostat, etj.

40. Cilëve tregues specifikë gjinorë³⁹⁷ u ka dhënë përparësi vendi juaj për monitorimin e progresit për OZHQ-të?

Instituti i Statistikave të Shqipërisë vazhdon t'i kushtojë një rëndësi të veçantë OZHQ-ve, pasi statistikatat janë instrumenti i zgjedhur për të vendosur bazën për monitorimin e zbatimit të këtyre qëllimeve në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Politikat dhe strategjitë që duhet të zhvillohen për arritjen e 17 objektivave dhe 169 targeteve duhet të mbështeten nga treguesit statistikorë për një vendimarrje të bazuar në të dhëna. Shqipëria, nëpërmjet INSTAT, që prej nëntorit të vitit 2019 është anëtare e Grupit të Nivelit të Lartë për Partneritet, Koordinim dhe Ngritje të Kapaciteteve për Statistikat për Agjendën për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030 (HLG-PCCB), grup ky i përbërë nga Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara, përfshirë agjencitë rajonale dhe ndërkombëtare si vëzhgues³⁹⁸, dhe që prej nëntorit të vitit 2020, Drejtoresha e Përgjithshme e INSTAT-it, është emëruar bashkëkryetare e këtij grupi.

Komuniteti statistikor i kushton shumë rëndësi OZHQ-ve. Në takimet e ndryshme organizuar nga Komisioni Statistikor i Kombeve të Bashkuara, UNECE dhe Eurostat, treguesit statistikorë të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm kanë pasur një rëndësi të veçantë në agjendën e tyre. Në këtë kontekst, Konferenca e Statisticienëve/Statisticienëve Evropianë, në qershor të vitit 2021, ka miratuar udhërrëfyesin e dytë të UNECE për statistikatat për OZHQ-të³⁹⁹, ku dhe INSTAT ka dhënë kontributin e tij. Ky botim përmban nëntë kapituj si dhe dy shtojca, ku jepen nga mesazhet kryesore deri te rekomandimet për përgatitjen e raportimeve vullnetare, shoqëruar me raste studimore dhe iniciativa të ndryshme nga e gjithë bota, në lidhje me ecurinë e OZHQ-ve. Shqipëria nga totali i 52 treguesve të ndjeshëm gjinorë të OZHQ-ve të lidhura me 12 fushat kritike të Platformës për Veprim të Pekinit, mbledh realisht 22 prej tyre, ku 16 llogariten plotësisht konform metodologjisë, ndërsa

397. Termi “tregues specifikë gjinorë” përdoret për t’iu referuar synimeve që kërkojnë shprehimisht kategorizim sipas seksit dhe/ose i referohen barazisë gjinore si objektiv bazë. Për shembull, treguesi i OZHQ-së 5.c.1 tregon përqindjen e vendeve me sisteme për gjurmimin e alokimeve publike që shkojnë për politikat dhe programet që promovojnë barazinë gjinore; objektivi themelor është promovimi i barazisë gjinore. Gjithashtu, termi do të përdoret për treguesit ku gratë dhe vajzat janë specifikuar si popullata e synuar (shihni UN Women. 2018. *Shndërrimi i premtimeve në veprime: Barazia Gjinore në Agjendën për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030* [Turning Promises into Action: Gender Equality in the 2030 Agenda for Sustainable Development]. Nju Jork).

398. <https://unstats.un.org/sdgs/hlg/members>

399. <https://unece.org/statistics/publications/CES-roadmap-sdg-2>

6 pjesërisht (sepse mungojnë të dhënat e nevojshme për të ndarë me tej treguesit siç kërkohen. Të dhënat për 61 tregues të OZHQ mblidhen dhe disponohen nga INSTAT⁴⁰⁰, ndërsa pjesa më e madhe e treguesve të tjerë për të cilët disponohen të dhëna, bazohen në informacione nga institucione të tjera në vend. Për disa tregues, informacioni nuk disponohet në vend, por publikohet nga organizata ndërkombëtare, si Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), etj. Treguesit nga korniza globale që disponohen në Shqipëri dhe për të cilët të dhënat mblidhen nga INSTAT, në shumicën e rasteve janë në përputhje me kërkesat e metodologjisë specifike të vendosur nga grupi i punës i OKB-së.

Ekzistojnë dy sfida kryesore për këtë grup treguesish:

1. Periodiciteti i mbledhjes së të dhënave për disa tregues nuk është i rregullt dhe në disa raste, informacioni më i fundit në dispozicion është shpesh shumë i vjetër.
2. Dimensionet dhe thellësia e ndarjes të kërkuara nga disa prej qëllimeve të OZHQ janë të pamjaftueshme për të dhënat e disponueshme aktualisht në Shqipëri (ndarjet e kërkuara në disa prej treguesve të OZHQ-ve, nuk mund të kryhen për shkak të mungesës së të dhënave të detajuara, apo mungesës së të dhënave për grupe të caktuara të popullsisë, siç mund të përmendim, personat me aftësi të kufizuara, grupet e ndryshme etnike/pakicat kombëtare, ndarjet urban/rural etj.). Treguesve të tjerë për të cilët disponohet informacion nga institucionet vendase, shpeshherë u mungon standardizimi me metodologjinë e kërkuar, gjë që përbën një sfidë tjetër për përputhshmërinë e këtyre treguesve me kornizën globale. Gjithashtu, mungesa e metodologjisë së standardizuar edhe brenda vendit krijon konflikte në raportimin e të dhënave pasi informacioni i dhënë nga institucionet qeveritare ndryshon në disa raste nga informacioni i raportuar nga INSTAT. Duke qenë se mekanizmat e mbledhjes së të dhënave të përdorura nga INSTAT janë të harmonizuara me standardet ndërkombëtare, është e rëndësishme që të riorganizohen më tej standardet dhe metodologjia për çdo tregues në sistemet e mbledhjes së të dhënave të përdorura nga institucionet e tjera qeveritare.

Treguesit në “Raportin e Harmonizimit të OZHQ me politikat sektoriale ekzistuese” janë klasifikuar në pesë grupe

1. të disponueshme,
2. tregues për të cilët informacioni është i disponueshëm me përpjekje (për rastet kur një tregues përfshin llogaritje shtesë bazuar në informacionin ekzistues;
3. treguesit për të cilët informacioni është pjesërisht i disponueshëm, për ata tregues ku të dhënat e disponueshme nuk janë të mjaftueshme për të pasqyruar të gjitha dimensionet e treguesit;
4. të padisponueshëm
5. të pazbatueshëm - për treguesit që nuk janë hartuar për Shqipërinë, por për grupe të tjera vendesh. Bazuar në këto konsiderata, disponueshmëria e treguesve nga kuadri global, për çdo OZHQ dhe në total, për vitin 2021, rezulton: 77 të disponueshëm, 23 të disponueshëm me përpjekje, 35 pjesërisht të disponueshëm, 94 jo të disponueshëm dhe 15 jo të aplikueshëm.⁴⁰¹

400. <https://www.instat.gov.al/al/sdgs/> dhe <https://www.instat.gov.al/media/11279/sdg-2022-shqip.pdf>

401. Raport Auditimi “Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, 2022”, fq.27, shih: <https://panel.klsh.org.al/storage/php7cjWxm.pdf>

INSTAT, lidhur me OZHQ një fokus të veçantë i ka kushtuar objektivit 5, ku pjesa më e madhe e treguesve prodhohen aktualisht. Në fokus mbeten treguesit lidhur me punën e grave në bujqësi 5.a.1 dhe 5.a.2, ku përpjekje të vazhdueshme janë kryer edhe në mbështetje të FAO për llogaritjen e këtyre treguesve, mirëpo të dhënat ekzistuese nuk mundësojnë llogaritjen e tyre, sipas metodologjisë së caktuar. Kështu kryerja e Censit të Bujqësisë do të jetë i rëndësishëm për sigurimit e të dhënave të duhura për llogaritjen e këtyre treguesve. Kryerja e anketës së dhunës dhe përdorimit të kohës do sigurojë të dhëna koherente lidhur me treguesit që kanë burim këto anketa, si p.sh. treguesi 5.2.1, 5.2.2, 5.3.1, 5.3.2. (Një listë me treguesit e OZHQ 5 që prodhohen aktualisht dhe vlerat e tyre për periudhën e raportimit, si dhe një listë e setit minimal të treguesve gjinorë, gjenden bashkëlidhur këtij raporti në shtojcën 7)

Duke konsideruar faktin se treguesit gjinorë shkojnë përtej Objektivit 5, INSTAT vazhdimisht përpaket për rritjen e treguesve të ndjeshëm gjinorë OZHQ të prodhuar. Përparësi do kenë treguesit që lidhen me të drejtat e njeriut, si dhe do të vazhdojë puna për sigurimin e ndarjeve dhe kombinimeve të të dhënave, të cilat sigurojnë një pamje të plotë të pabarazive jo vetëm midis burrave dhe grave por edhe ndërmjet grupeve të caktuara të popullsisë dhe karakteristikave të ndryshme të tyre (intersectionality). INSTAT, lidhur me OZHQ një fokus të veçantë i ka kushtuar objektivit 5, ku pjesa më e madhe e treguesve prodhohen aktualisht. Në fokus mbeten treguesit lidhur me punën e grave në bujqësi 5.a.1 dhe 5.a.2, ku përpjekje të vazhdueshme janë kryer edhe në mbështetje të FAO për llogaritjen e këtyre treguesve, mirëpo të dhënat ekzistuese nuk mundësojnë llogaritjen e tyre, sipas metodologjisë së caktuar. Kështu kryerja e Censit të Bujqësisë do të jetë i rëndësishëm për sigurimit e të dhënave të duhura për llogaritjen e këtyre treguesve. Kryerja e anketës së dhunës dhe përdorimit të kohës do sigurojë të dhëna koherente lidhur me treguesit që kanë burim këto anketa, si p.sh. treguesi 5.2.1, 5.2.2, 5.3.1, 5.3.2. (Një listë me treguesit e OZHQ 5 që prodhohen aktualisht dhe vlerat e tyre për periudhën e raportimit, si dhe një listë e setit minimal të treguesve gjinorë, gjenden bashkëlidhur këtij raporti në shtojcën 7) Duke konsideruar faktin se treguesit gjinorë shkojnë përtej Objektivit 5, INSTAT vazhdimisht përpaket për rritjen e treguesve të ndjeshëm gjinorë OZHQ të prodhuar. Përparësi do kenë treguesit që lidhen me të drejtat e njeriut, si dhe do të vazhdojë puna për sigurimin e ndarjeve dhe kombinimeve të të dhënave, të cilat sigurojnë një pamje të plotë të pabarazive jo vetëm midis burrave dhe grave por edhe ndërmjet grupeve të caktuara të popullsisë dhe karakteristikave të ndryshme të tyre (intersectionality).

41. Cilat kategorizime të të dhënave⁴⁰² ofrohen në mënyrë rutinë nga anketat kryesore në vendin tuaj?

Anketat pranë familjeve që kryhen nga INSTAT, kanë një metodologji të mirë-përcaktuar nga EUROSTAT, e cila është e harmonizuar në mënyrë të tillë që të mundësojë krahasueshmërinë e të dhënave jo vetëm në kohë por edhe midis vendeve evropiane. Kështu, kryerja e tyre bazohet tërësisht në rregulloret specifike, por për specifika të caktuara në konsultim me përdorues/përdorues dhe grupe interesi të ndryshëm, mund të përfshihen pyetje apo variabla specifike të nevojshme për vendin.

Pjesa e parë e pyetësorit në të cilin mblidhet informacion i përgjithshëm për anëtarët/anëtarët pranë familjeve (përbërja familjare me karakteristikat bazë socio-demografike), përfshin karakteristika të tilla si: moshë, gjinia, vendlindja, shtetësia, statusi martesor, statusi në punësim, niveli arsimor, etj., të cilat mblidhen rregullisht. Ende anketat sociale nuk mbledhin informacion mbi orientimin seksual. Censi i popullsisë dhe banesave, mblodhi informacion mbi besimin fetar dhe përkatësinë etnike të popullsisë në Shqipëri, por ky informacion nuk mblidhet rregullisht nga anketat sociale në INSTAT.

402. Siç specifikohet në A/RES/70/1, me shtimin e arsimit, statusit martesor, fesë dhe orientimit seksual.

SEKSIONI I GJASHTË

PËRFUNDIMI DHE HAPAT E RADHËS

Nga ky proces i rishikimit të zbatimit të Platformës për Veprim të Pekinit, për pesë vitet që lamë pas, institucionet anëtare të Grupit Ndërmarrës të Punës që u angazhuan në përgatitjen e raportit, përveç evidentimit të arritjeve dhe përparimit të bërë në të 12 fushat kritike, patën mundësi të identifikojë edhe sfidat dhe vështirësitë e ndeshura, si dhe të reflektojnë për një adresim sa më të mirë të tyre për vitet në vijim.

Qeveria e Shqipërisë i ka përfshirë fushat kritike të Platformës për Veprim në dokumentet kryesore kombëtare. Veprimet e ndërmarra për adresimin në mënyrën e duhur të këtyre fushave kritike, janë gërshtuar edhe me objektivat dhe masat për të bërë realitet zbatimin e Agjendës 2030 dhe Objektive të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Arritjet janë të shumta, por në mënyrë të përmbledhur për çdo fushë mund të themi se: (1) janë ndërmarrë një sërë masash për zvogëlimin e numrit të grave, të rejave e vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, që jetojnë në kushte të vështira ekonomike, përfshirë edhe gjatë situatës së pandemisë së Covid-19; (2) evidentohen suksese të vazhdueshme në arsimimin e grave, të rejave e vajzave, të bashkëshoqëruara edhe me një sërë përpjekjesh pozitive për formimin e tyre profesional dhe për orientimin gjithnjë e më shumë drejt profesioneve jo-tipike, që sfidojnë stereotipet gjinore, e që do jenë profesione të së ardhmes; (3) ka përpertime të dukshme në fushën e shëndetësisë, ku janë marrë masa të veçanta për mbrojtjen dhe kujdesin shëndetësor për nënën dhe fëmijën, apo zgjerimin e informacionit, programeve e shërbimeve mbi shëndetin seksual dhe riprodhues; (4) është bërë përmirësimi i kuadrit ligjor dhe i politikave për mbrojtjen nga dhuna në familje, si dhe ka përpjekje të vazhdueshme për zbatimin sa më korrekt dhe me efektivitet të tyre, shoqëruar kjo dhe me përmirësimin e kapaciteteve të profesionisteve/profesionistëve, informimin e publikut të gjerë, veçanërisht të grave, të rejave e vajzave nga grupet e cënueshme, apo dhe me zgjerimin e shtrirjen e shërbimeve mbështetëse të specializuara në përputhje me standardet ndërkombëtare; (5) janë marrë masat e duhura për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara “Gruaja, Paqja dhe Siguria”, si dhe vazhdojnë përpjekjet për të përfshirë sa më shumë gra e të reja në vendimmarrje dhe drejtim në forcat e armatosura; (6) janë mbështetur në mënyrë të vazhdueshme dhe është rritur numri i grave e sidomos i të rejave në sipërmarrje, përmes politikave favorizuese të start-up si dhe duke i orientuar e nxitur interesin e tyre veçanërisht për fusha që lidhen me digjitalizimin dhe ekonominë mjedisore; (7) u është dhënë përparësi grave në vendimmarrjen politike, me një kabinet qeveritar me 55% gra në përbërje dhe me një Zëvendës Kryeministër grua, një Kuvend që drejtohet nga një Kryetare grua dhe që në përbërje ka Komisione e Nënkomisione të drejtuara e me pjesëmarrje në numër të konsiderueshëm të grave; (8) janë bërë përpjekje të vazhdueshme për të fuqizuar

mekanizmin kombëtar të barazisë gjinore, përmes fuqizimit të partneriteteve me institucionet mbështetëse të këtij mekanizmi, fuqizimit të kapaciteteve të stafit, si dhe përpjekjeve për të rritur burimet financiare në këtë drejtim; (9) u është dhënë përparësi mbrojtjes dhe respektimit, por edhe njohjes nga publiku i gjerë i të drejtave të njeriut të grave, si dhe bashkëpunimit me institucionet e pavarura të të drejtave të njeriut për të pasur më shumë efektivitet në këtë drejtim; (10) janë mbështetur një sërë iniciativash që gratë, të rejat dhe vajzat të trajtohen në mënyrë korrekte, jo të stereotipizuar dhe duke shmangur gjuhën e urrejtjes në median vizive, të shkruar, e atë sociale, si dhe që ato të kenë më shumë zë në vendimmarrje në këtë fushë; (11) janë diskutuar gjithnjë e më shumë çështjet mjedisore dhe ndërthurja e tyre me çështjet gjinore, duke evidentuar rolin e rëndësishëm që duhet të kenë gratë, të rejat dhe vajzat në vendimmarrjen mjedisore, por edhe nevojat e tyre të ndryshme dhe mënyrat se si mjedisi ndikon në jetët e tyre; (12) është punuar dhe vazhdon puna për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, sidomos të vajzave e adoleshenteve, veçanërisht në lidhje me praktikën e dëmshme tradicionale, informimin mbi çështje të rëndësishme të lidhura me fuqizimin e tyre, orientimin drejt profesioneve të së ardhmes, mbrojtjen nga dhuna, diskriminimi e disavantazhimi gjinor e i shumëfishtë, fuqizimin e rolit të tyre në vendimmarrje, ekonomi, etj.

Aplikimi i integritetit gjinor dhe buxhetimit të përgjigjshëm gjinor si strategji dhe mjete për planifikim, zbatim, monitorim e vlerësim, janë provuar tashmë se të çojnë drejt suksesit të dëshiruar. Ndaj dhe, gjatë evidentimit të arritjeve në kuadër të përgatitjes së këtij raporti, aplikimi i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor listohet si ndër arritjet më të rëndësishme të pesë viteve që lamë pas. Kuptohet që ky është një proces i vazhdueshëm dhe zbatimi i tij do të bashkëshoqërojë të gjitha përpjekjet që shteti shqiptar do të vendosë të bëjë për të përparuar më tej drejt fuqizimit të grave dhe barazisë gjinore, edhe në vitet në vijim.

Drejtimit e përzgjedhura për pesë vitet në vijim, do të vijojnë të fokusohen te arsimi, të nxëniet gjatë gjithë jetës dhe formimi profesional. Një komb zhvillohet përmes arsimimit dhe edukimit të shtetaseve/shtetasve tij, ndaj dhe ofrimi i mundësive për arsim cilësor për gratë, të rejat dhe vajzat, nga të gjitha grupet në shoqëri dhe gjatë gjithë jetës së tyre, është domosdoshmëri për një zhvillim të qëndrueshëm.

Zvogëlimi i të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe vajzave, përfshirë dhunën kibernetike dhe femicidin, do të mbeten pjesë e prioritetëve kryesorë për vitet në vijim, për vetë rëndësinë që ka pasja e një shoqërie gjithëpërfshirëse e pa dhunë. Informimi dhe ndërgjegjësimi i popullsisë veçanërisht mbi stereotipet gjinore, normat dhe praktikën e dëmshme, si dhe modelet e trashëguara ndër shekuj të grave të shypura e pa të drejta, që kanë ushqyer e vijojnë të ushqejnë padrejtësitë, diskriminimin dhe dhunën në ditët e sotme, është domosdoshmëri. Gjithashtu, duhet punuar më shumë në drejtim të riintegritetit të qëndrueshëm të viktimave/ të mbijetuarave të dhunës ndaj grave. Por edhe trajtimi i dhunuesve përmes programeve rehabilituese që synojnë të korrigjojnë sjelljen e tyre të dhunshme, duhet të zgjerohet dhe shtrihet në mbarë vendin.

Gratë në sipërmarrje dhe sipërmarrjet e grave e të rejave duhet të vijojnë të mbeten pjesë e përparësive për vitet në vijim pasi pavarësia ekonomike dhe fuqizimi ekonomik janë hapa të sigurt drejt fuqizimit në tërësi të grave dhe përparimit drejt barazisë gjinore. Angazhimi i vajzave, të rejave dhe grave në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, në shkenca ekzakte, në digjitalizim e çdo fushë tjetër të së ardhmes është gjithashtu domosdoshmëri dhe përfshihet në drejtimit kryesorë të ndërhyrjeve të shtetit shqiptar në vitet në vijim.

Mbrojtja sociale e përgjigjshme gjinore, shërbimi shëndetësor universal, transfertat në para veçanërisht për gra nga grupe të caktuara, pensionet, shërbime sociale e komunitare të integruara, etj., do të bashkëshoqërojnë të gjitha përpjekjet dhe veprimet që do ndërmerren për të përmbushur Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Agjendën 2030.

Me rëndësi në vitet në vijim do të jetë edhe adresimi i vështirësive të ndeshura, për shembull për trajtimin e problemeve psiko-sociale, rehabilitimin dhe (ri)integrimin në komunitet, si dhe mbrojtjen sociale të

personave me probleme të shëndetit mendor (përfshirë këtu edhe viktimat/të mbijetuarat/të mbijetuarit e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore). Problemet e shëndetit mendor, të cilat duhet pranuar se janë shtuar sidomos pas situatës së pandemisë së Covid-19, jo gjithmonë kuptohen dhe trajtohen në mënyrën e duhur nga komuniteti dhe individët në Shqipëri. Për rrjedhojë, informimi dhe sensibilizimi i komunitetit në përgjithësi për rëndësinë e pranimi dhe trajtimit të personave me probleme të shëndetit mendor në mënyrën e duhur, merr rëndësi të veçantë dhe duhet të bëhet përmes angazhimit të një sërë institucionesh, organizatash e individësh, profesioniste/profesionistë të fushës, dhe jo vetëm.

Po kështu, formimi profesional i grave, të rejave dhe vajzave, në përputhje me nevojat e tyre dhe kërkesat e tregut të punës, veçanërisht të grave, të rejave dhe vajzave në zonat rurale, me synim fuqizimin ekonomik dhe rritjen e pavarësisë së tyre, është një vështirësi që duhet adresohet në mënyrën e duhur ndaj dhe do të renditet ndër veprimet kryesore prioritare për vitet në vijim. Trajtimi i çështjeve të barazisë gjinore përtej çështjeve sociale gjithashtu është sfidë, derisa të krijohet një nivel i të kuptuarit të njëjtë të rëndësisë së integritetit gjinor në çdo fushë. Kjo mund të arrihet përmes fuqizimit të kapaciteteve të profesionisteve/profesionistëve nga njëra anë, por edhe nga eksplorimi, pranimi dhe zbatimi i formave të reja të ndërhyrjes përmes integritetit gjinor në fusha dikur të quajtura si “neutrale” nga këndvështrimi gjinor. Këtu mund të rendisim për shembull çështjet mjedisore, ndryshimet klimatike, menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë, çështjet energjitike dhe të ujit, menaxhimin të mbetjeve, transportit, etj. Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në të gjitha këto fusha (siç edhe u shpjeguan në këtë raport). Për vitet në vijim, synimi kryesor do të jetë jo vetëm përparimi në drejtimet e përcaktuara, por edhe analizat më të thelluara gjinore, vlerësimi i ndikimit gjinor dhe integritetit gjinor në tërësi, në masat dhe veprimet që do zbatohen në këto fusha. Prokurimi i Përgjigjshëm Gjinor (PPGJ) për shembull, mund të jetë një tjetër mjet që edhe Shqipëria të fillojë ta eksplorojë e më pas ta zbatojë, për të arritur objektivat socio-ekonomike, duke marrë parasysh marrëdhëniet e fuqisë gjinore në zinxhirët e vlerave gjatë përzgjedhjes së shërbimeve, mallrave ose punëve. PPGJ synon të kapërcejë boshllëqet e pagave, të krijojë vende pune për gratë dhe të mohojë pabarazitë e punës lidhur me gjininë, masa këto tashmë të vëna në prioritet në politikat e qeverisë shqiptare. Nëse zbatohet në mënyrën e duhur, PPGJ përputhet me strategjinë e integritetit gjinor dhe përfshirjes sociale dhe u përgjigjet Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Prandaj, eksplorimi dhe zbatimi i PPGJ, me mbështetjen edhe të donatorëve potencialë dhe organizatave ndërkombëtare që e kanë këtë ekspertizë, mund ta ndihmojë Qeverinë e Shqipërisë që të përparojë më tej në përbushjen e qëllimeve të saj, duke i transformuar edhe proceset e prokurimit në sisteme që favorizojnë gjithëpërfshirjen dhe barazinë gjinore. Zhvillimi infrastrukturor vijon të mbetet një nga prioritetet e Shqipërisë, për vetë rëndësinë që ka kjo fushë. Por ky zhvillim duhet që të behet patjetër edhe me lentet gjinore. Infrastruktura e verbër gjinore është një nga shkaqet kryesore mungesës së aksesit të grave dhe vajzave në shërbimet bazë; një infrastrukturë e verbër gjinore nuk merr parasysh rolet, përgjegjësitë e ndryshme dhe nevojat e veçanta të grave, burrave, vajzave dhe djemve në një kontekst specifik dhe se si kjo ndikon në aftësinë e tyre për përdorimin ose aksesin në infrastrukturë. Këto konsiderata janë marrë parasysh dhe po orientojnë drejtimet e mëtejshme të ndërhyrjes infrastrukture. Vlerësimi i ndikimit gjinor dhe përcaktimi i matjes së progresit edhe me përmbushjen e treguesve të ndjeshëm gjinorë, do të përdoren si mjete që udhëzojnë zhvillimin e ardhshëm të infrastrukturës së përgjigjshme gjinore në Shqipëri.

Praktika e qasjes gjithëpërfshirëse e të koordinuar, ku ftohen të marrin pjesë dhe të kontribuojnë jo vetëm institucionet përgjegjëse për zbatim, por edhe të gjitha institucionet lokale, publike ose jo, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e pavarura e të të drejtave të njeriut (sidomos Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi), organizatat e shoqërisë civile, organizatat e punëtorëve/punëtorëve, rrjetet, koalicionet dhe organizatat që përfaqësojnë interesat e grupeve të cënueshme, organizatat ndërkombëtare, media, etj., është një praktikë tepër e suksesshme, e provuar që vlen si në hartimin e dokumenteve të rëndësishëm (ligjorë e të politikave) ashtu edhe në zbatimin e tyre, si dhe në monitorimin e vlerësimin e përparimit të bërë (siç ishte dhe rasti i hartimit të këtij raporti). Ndaj kjo praktikë do të bashkëshoqërojë të gjitha proceset përkatëse edhe në vitet në vijim.

SHTOJCA

Shtojca 1. Të dhëna në mbështetje të përgjigjeve të pyetjeve për dimensionin e parë “ zhvillim gjithëpërfshirës, prosperitet i përbashkët dhe punë e denjë”

Tabela 3. Buxheti i planifikuar kundrejt shpenzimeve aktuale për zbatimin e SKPA 2019-2022

Programet	Amounts are in ALL billion							
	2019		2020		2021		2022	
	Planifikuar	Shpenzuar	Planifikuar	Shpenzuar	Planifikuar	Shpenzuar	Shpenzuar	Shpenzuar
Labour market	1,720	1,480	1,699	1,547	2,737	2,466	2,287	1,992
VET	3,238	2,695	3,237	2,901	2,855	2,437	2,868	2,533
Total	4,958	4,175	4,936	4,448	5,592	4,903	5,155	4,525

Burimi: Raport progresi për vitin 2022 për zbatimin e SKPA 2019-2022

Tabela 4. Tabela 4: Kosto totale e parashikuar për zbatimin e SKPA 2023-2030

Kosto e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023-2030		Kosto indikative (në ALL)	Burimi i mbulimit Buxhet shteti dhe financim i huaj	Hendeku financiar ALL	%
Qëllimi i politikës 1	OBJEKTIVI SPECIFIK 1.1: Reduktimi i mospërputhjes së aftësive për të gjitha profesionet	29 522 288 976	26 761 582 497	2 760 706 479	9%
	OBJEKTIVI SPECIFIK 1.2: Rritja e nivelit të aftësive të grave dhe burrave në moshë pune	1 224 197 588	694 860 124	529 337 464	43%
	OBJEKTIVI SPECIFIK 1.3: Funksionimi më i mirë i tregut të punës për të gjithë	3 548 552 652	3 034 853 32	513 699 332	14%
Qëllimi i politikës 2	OBJEKTIVI SPECIFIK 2.1: Ndërmjetësim me gjithëpërfshirës i punësimit	26 211 384 015	17 238 944 066	8 972 439 949	34%
	OBJEKTIVI SPECIFIK 2.2: Sigurimi i punës së denjë për të gjithë dhe kudo	15 007 443 434	10 611 453 432	4 395 990 002	29%
Total		75 513 866 666	58 341 693 439	17 172 173 227	23%

Burimi VKM Nr. 173, datë 24.03.2023 fq.34

Tabela 5. Rritja e nivelit të pagës minimale ndër vite

Viti	Paga minimale	Shënime
2019	26,000 lekë	VKM Nr. 809, datë 26.12.2018
2020	26,000 lekë	VKM Nr. 809, datë 26.12.2018
2021	30,000 lekë	VKM nr.1025, datë 16.12.2020
2022 (prill)	32,000 lekë	VKM Nr.158, datë 12.03.2022
2022 (shtator)	34,000 lekë	VKM Nr. 604, datë 14.9.2022
2023 (prill)	40,000 lekë	VKM Nr. 113, datë 01.03.2023
2024	40,000 lekë	VKM Nr. 113, datë 01.03.2023

Shtojca 2. Të dhëna në mbështetje të përgjigjeve të pyetjeve për dimensionin e dytë “eliminimi i varfërisë, mbrojtja sociale dhe shërbimet shoqërore”

Tabela 5. Numri i pjesëmarrëseve/pjesëmarrësve sipas llojit të Programit të Nxitjes së Punësimit

	2020	2021	2022	2023 (janar-shkurt)
VKM 17 (Punësim i subvencionuar, trajnim në punë, praktika)	1105	1896	1790	807
VKM 535 (Komuniteti-Punësimi)	0	207	1267	995
VKM 348 (Vetëpunësim)	0	44	286	235
VKM 608 (COVID-Punësim)	1722	2687	1001	184
VKM e vjetër (përfunduar në 2020)	1319	0	0	0
Total	4146	4834	4,344	2221

Tabela nr.5 më poshtë pasqyron shërbimet sipas tipologjisë, llojit të qendrave të përkujdesit shoqëror dhe mënyrës së financimit, numër dhe përqindje, në nivel qarku, të realizuar në muajin maj 2023

Shërbimet sipas llojit të institucioneve	Gjithsej	Parashoqërore	Rezidenciale	Strehëza	Komunitare	Qendër zhvillimi	Qendër ditore	Familje	Të specializuara	Këshillim	Situatë emergjente	Kujdes alternativ
Publike	357	80	27	7	44	24	45	26	39	10	42	13
Qendrore	92	20	19	2	5	5	8	3	12	2	11	5
Qarku	4	2	0	0	0	0	0	0	0	1	1	0
Bashkia	212	44	6	5	34	14	31	21	22	6	24	5
Të përziera	49	14	2	0	5	5	6	2	5	1	6	3
Jo Publike	532	113	46	19	77	25	64	46	56	29	40	17
OJF	276	66	16	11	41	17	35	21	27	23	14	5
Donatorë	63	16	2	1	14	0	5	6	9	3	5	2
Privatë	165	26	27	7	19	6	19	14	15	3	19	10
Të përziera	28	5	1	0	3	2	5	5	5	0	2	0
Të përziera	258	45	10	4	42	11	39	27	25	22	28	5
Gjithsej	1.147	238	83	30	163	60	148	99	120	61	110	35
NË %	100	21	7	3	14	5	13	9	10	5	10	3

INFORMACION PËR INVENTARIN E SHËRBBIMEVE TË KUJDESIT SOCIAL PËR FAMILJEN

- 1) Shërbimet para shoqërore të ofrohen nga strukturat e posaçme të shërbimeve shoqërore (NVNR dhe NJMF)
- 2) Shërbime rezidenciale janë shërbimet që ofrohen në qendrat rezidenciale dhe, në çdo rast, përfshijnë të paktën shërbime të kujdesit 24-orësh dhe afatgjatë për individë në nevojë.
- 3) Strehëzat e përkohshme për viktimat e trafikimit (fëmijë dhe gratë e vajzat)
- 4) Strehëza e përkohshme për LGBTI+
- 5) Strehëza e përkohshme për gratë dhe vajzat viktimat të dhunës në familje
- 6) Qendrat one-stop të specializuara për të viktimat e formave të rënda të dhunës, kryesisht viktima të abuzimit seksual
- 7) Qendrat one-stop të specializuara për fëmijët viktimat të formave të rënda të dhunës, kryesisht viktima të abuzimit seksual
- 8) Shërbime komunitare janë shërbime gjysmë ditore ose të plotë ditore, të ofruara në qendra ditore, sipas kategorisë së përfituesve.
- 9) Shërbimet e specializuara lëvizëse, asistencë në familje janë shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në familje për të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuara (fizike, intelektuale dhe mendore)
- 10) Shërbime komunitare për fuqizimin e familjes dhe integrimin social dhe ekonomik të tyre
- 11) Shërbime komunitare për mbështetjen e fëmijës dhe familjes (CHILD HUB) për parandalimin e institucionalizimit dhe ndarjes së fëmijës nga familja biologjike
- 12) Shërbimi i prindërimit pozitiv
- 13) Shërbim këshillimi për gratë dhe vajzat viktimat të dhunës në familje dhe trafikimit
- 14) Shërbimi i këshillimit online për fëmijët në situatë rreziku
- 15) Shërbimi i emergjencës 72 orë u ofrohet individëve që kanë nevojë për asistencë të menjëhershme për shkak të një situatë që u kërcënon jetën dhe shëndetin, të cilëve u sigurohet minimalisht në mënyrë të menjëhershme akomodimi, ushqimi dhe mjedisi i mbrojtur.
- 16) Shërbimi i përkujdesjes alternative siguron zhvillimin, arsimimin, shëndetin dhe mirëqenien e fëmijës dhe i ofrohet fëmijës kur nuk është në interesin më të lartë të tij të qëndrojë në një mjedis familjar të caktuar.

Tabela 6. Numri i infeksioneve të reja të rasteve të HIV te popullata gra, për 1,000 popullatë të paprekur Ky tregues sigurohet nga Instituti i Shëndetit Publik.

	2019	2020	2021	2022	2023
Femra (15-24)	0.004	0.005	0.015	0.005	0.022
Femra (15-49)	0.024	0.025	0.033	0.029	0.026
Femra (50+)	0.027	0.019	0.013	0.015	0.020
Femra (të gjitha moshat)	0.025	0.022	0.024	0.023	0.024

INFORMACION I DETAJUAR PËR SHËNDETIN MENDOR

Decentralizimi dhe deinstitutionalizimi i shërbimeve të shëndetit mendor vijon të jetë prioritet i shtetit shqiptar së bashku me fuqizimin e shërbimeve të shëndetit mendor në Kujdesin Shëndetësor Parësor nëpërmjet ngritjes së qendrave socio-shëndetësore, ndërhyrje kjo e pilotuar në vitin 2022 dhe që u shtri në më shumë se 100 qendra shëndetësore (ku aktualisht janë punësuar dhe ofrojnë shërbime psiko-sociale dhe rehabilituese rreth 88 psikologe/psikologë, 14 punonjëse/punonjës social, 17 logopede/logopedë dhe 30 fizioterapiste/fizioterapistë) dhe shtimi i shërbimeve komunitare të specializuara në shëndet mendor (si Qendra Komunitare të Shëndetit Mendor/QKSHM dhe Shtëpi Mbështetëse). Aktualisht, janë ngritur dhe funksionojnë 10 QKSHM dhe 14 Shtëpi Mbështetëse (në këto të fundit akomodohen rreth 150 persona me çrregullime kronike të shëndetit me mendor, prej të cilave/cilëve 65 gra). Gjithashtu, gjatë viti 2023 u ndryshua VKM nr. 456, datë 22.5.2013 “Për përbërjen dhe mënyrën e funksionimit të Komitetit Kombëtar të Shëndetit Mendor” (miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.539, datë 13.09.2023), e cila kishte në fokus shëndetin mendor të fëmijëve dhe adoleshenteve/adoleshentëve, nëpërmjet ngritjes së një nënkomiteti kushtuar Shëndetit Mendor të Fëmijëve dhe Adoleshenteve/Adoleshentëve. Nënkomiteti ndihmon komisionin për analizën dhe vlerësimin e situatës së shëndetit mendor të fëmijëve dhe adoleshenteve/adoleshentëve dhe shërbimet sociale dhe shëndetësore për këtë grup moshë, duke i propozuar Komitetit ndërhyrje strategjike ose programore, si dhe ndryshime rregullatore, të cilat synojnë përmirësimin e shëndetit mendor për fëmijët dhe adoleshentet/adoleshentët.

Në këtë kuadër, me mbështetjen e OBSH dhe UNICEF gjatë 2023-2024 janë zbatuar një sërë aktivitete për përmirësimin e shëndetit mendor dhe mirëqenies psikosociale dhe zhvillimit të fëmijëve dhe adoleshenteve/adoleshentëve në Shqipëri. Në fillim, gjatë muajve maj-korrik 2023, u krye një analizë e thellë (sekondare) e të dhënave të sondazhit të HBSC 2021/22. Qëllimi i kësaj analize ishte vlerësimi i shëndetit dhe mirëqenies mendore tek fëmijët dhe adoleshentet/adoleshentët (11, 13 dhe 15 vjeç) dhe korrelacionet me faktorët socio-demografikë, karakteristikat shëndetësore të sjelljes/mënyrës së jetesës dhe COVID-19. Gjetjet kryesore u diskutuan në katër tryeza të rrumbullakëta në Lezhë (1), Elbasan (1) dhe Kukës (2). Në total morën pjesë 44 profesioniste/profesionistë të arsimit dhe shëndetësisë, të cilat/cilët theksuan rëndësinë e kryerjes së studimeve kërkimore për sjelljet e adoleshenteve/adoleshentëve, ku një ndër gjetjet kryesore është fakti se janë vajzat ato që raportojnë më shumë probleme të shëndetit mendor.

- Një Shkollë Verore për Shëndetin Mendor u organizua në Pogradec nga data 2-6 gusht dhe mblodhi 25 të reja/rinj nga pesë qytete të ndryshme të Shqipërisë, përkatësisht Tirana, Vlora, Gjirokastra, Puka dhe Kukësi. Aktiviteti synonte të krijonte një mjedis mbështetës për pjesëmarrëset/pjesëmarrësit që të mësojnë më shumë, të diskutojnë dhe të hartojnë veprime lokale për sfidat e shëndetit mendor. Sa i përket gjinisë, 7 nga pjesëmarrësit ishin djem dhe 18 ishin vajza. Gjatë këtyre ditëve ato/ata mundën gjithashtu të identifikonin çështjet kryesore në lidhje me shëndetin mendor në qytetet e tyre dhe të konceptonin 5 nisma lokale që u organizuan më vonë gjatë vitit dhe përfshinë rreth 104 të reja/rinj.

- U organizuan 10 sesione trajnimi gjithëditore me stafin e kujdesit shëndetësor parësor në lidhje me depresionin pas lindjes edhe në cilësinë e tyre si kujdestare/kujdestarë parësor të fëmijëve. Gjithsej, në Elbasan dhe Lezhë janë trajnuar 195 (191 gra; 118 nga zonat rurale) profesioniste/profesionistë shëndetësorë, përfshirë mami, infermiere/infermierë, mjeke/mjekë të përgjithshëm, mjeke/mjekë obstetër-gjinekologë, neonatologë/neonatologë, vaksinuese/vaksinues dhe specialiste/specialistë të shëndetit mendor në Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor apo qendrave shëndetësore.
- MSHMS, nëpërmjet ISHP në bashkëpunim me ekspertet/ekspertët e ASCAP, dhe eksperte/ekspertët të projektit zhvilluan një manual të përshtatur për të adresuar nevojat psikosociale të fëmijëve dhe adoleshenteve/adoleshentëve që përballen me sfidat e shëndetit mendor. Ky burim, i titulluar “Të flasim për çështjet e shëndetit mendor me nxënëset/nxënësit - Një udhëzues për të mbështetur shërbimet psikosociale në shkollë”, u krijua për të promovuar mirëqenien psikosociale të fëmijëve dhe adoleshenteve/adoleshentëve në mjediset arsimore. Për të lehtësuar prezantimin e këtij manuali të ri mbështetës, u zhvilluan dy sesione trajnimi gjithëpërfshirëse në Lezhë dhe Elbasan. Gjithsej 36 punonjëse/punonjës psikosocialë nga shkollat e mesme të Lezhës dhe Elbasanit morën pjesë aktive në këto sesione trajnimi, me një shpërndarje gjinore prej 33 gra/të reja dhe 3 burra/të rinj.
- Një vëmendje e veçantë i është dhënë edhe ndërhyrjeve digjitale në favor të shëndetit mendor. Në këtë kuadër u organizuan dy sesione trajnimi në Lezhë dhe Elbasan për të prezantuar platformën online “ifightDepression” si një ndërhyrje e dobishme për trajtimin e depresionit të lehtë dhe të moderuar në shkollë. Morën pjesë gjithsej 36 pjesëmarrëse/pjesëmarrës, nga të cilat/cilët 26 psikologe/psikologë dhe 10 punonjëse / punonjës socialë, me një shpërndarje gjinore prej 33 gra/të reja dhe 3 burra/të rinj: që punojnë në arsimin e mesëm dhe shkollë të mesme. Në takim ishin të pranishëm edhe përfaqësuese/përfaqësues nga Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor, Qendra Komunitare për Shëndet dhe Mirëqenie dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- 43 sesione informative me fëmijë dhe adoleshente/adoleshentë të moshës shkollore u organizuan gjatë tetorit 2023 - marsit 2024. Qëllimi i kësaj ndërhyrje ishte përmirësimi i të kuptuarit rreth mirëqenies mendore, përmirësimi i sjelljeve të komunitetit ndaj adoleshenteve/adoleshentëve me depresion ose kushte të tjera të shëndetit mendor si dhe promovimin e shëndetit mendor pozitiv, duke i angazhuar në mënyrë aktive të rejtat/rinjtë. Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve/pjesëmarrësve ishte 1207. Gjithashtu, angazhimi i 15 punonjëseve/punonjësve shëndetësorë të shkollës, 4 punonjëseve/punonjësve socialë, 27 psikologe/psikologëve, 42 mësueseve/mësuesve dhe 22 specialisteve/specialistëve të promovimit të shëndetit nënvizoi natyrën bashkëpunuese dhe multidisiplinare të projektit.
- Janë mbajtur 25 sesione trajnimi gjithë ditore me profesioniste/profesionistë të kujdesit shëndetësor parësor mbi identifikimin e hershëm, mbështetjen e menjëhershme dhe referimin për problemet e shëndetit mendor dhe kushtet për fëmijët dhe adoleshentët/adoleshentët. Gjithsej janë trajnuar 525 profesioniste/profesionistë shëndetësorë në Kukës, Tiranë, Lezhë dhe Berat, në total 525 staf nga të cilët 441 gra/të reja, përfshirë mjeke/mjekë familje, infermiere/infermierë, mjeke/mjekë të përgjithshëm, specialiste/specialistë të shëndetit mendor, psikologe/psikologë në qendra shëndetësore, si dhe personeli shëndetësor i shkollës.
- Dokumenti “Unë mbështes miqtë e mi” u përkthye dhe u kontekstualizua për Shqipërinë duke ofruar udhëzime për mbështetjen mes bashkëmoshatare/bashkëmoshatarëve. Gjatë vitit 2024 do të vijojnë aktivitetet për të mbështetur edukimin nga bashkëmoshataret/bashkëmoshatarët duke përdorur këtë mjet. Për temën e shëndetit mendor të të rejave/rinjve, janë zbatuar edhe një sërë aktivitetesh të ndryshme me personelin multidisiplinar të qendrave të kujdesit shëndetësor parësor (mjeket/mjekët e përgjithshëm, mjeke/mjekë familjarë, psikologe/psikologë, punonjëse/punonjës socialë, infermiere/infermierë), stafin e shkollave parauniversitare (staf psiko-social, mësuese/mësues), Qendrat Komunitare të Shëndetit Mendor (psikiatre/psikiatër për fëmijë dhe adoleshente/adoleshentë), psikologe/psikologë, punonjëse/punonjës


socialë, infermiere/infermierë, logopedë/logopedë etj.) dhe personel të mbrojtjes sociale të njësive të vetëqeverisjes vendore (Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, etj.), duke ndarë informacion mbi rrugët e integruara për identifikimin, kujdesin dhe rehabilitimin e fëmijëve dhe adoleshenteve/adoleshentëve që kanë nevojë për mbështetje për shëndetin mendor dhe mirëqenien psikosociale, në të gjithë sektorët, mbi aktet rregullatore për optimizimin e ofrimit dhe aksesit në kujdesin e integruar për fëmijët dhe adoleshentët/adoleshentët që kanë nevojë për mbështetje për shëndetin mendor dhe mirëqenien psikosociale, në të gjithë sektorët si dhe mbi procesin e monitorimit për kujdesin e integruar për fëmijët dhe adoleshentët/adoleshentët që kanë nevojë për mbështetje për shëndetin mendor dhe mirëqenien psikosociale.

- Një fushatë kundër stigmës për shëndetin mendor është zhvilluar dhe zbatuar nga MSHMS në bashkëpunim me një Organizatë Rinore, mbështetur nga OBSH, duke angazhuar adoleshente/adoleshentë dhe të reja/rinj nga rrethet e Elbasanit dhe Tiranës, bazuar në ndërhyrjet e bazuara në prova (programi nga bashkëmoshataret/bashkëmoshatarët), duke arritur në më shumë se 600 persona (kryesisht të reja/rinj, por edhe prindër dhe mësuese/mësues) dhe më shumë se 3000 të reja/rinj nëpërmjet mediave sociale. Aktivitetet kryesore të fushatës ishin: Fushata e mesazheve video me ndikim, informimi dhe prezantimi i projektit nga OJQ Rinore, Pjesëmarrje në JAVA e OKB-së dhe panairin e organizuar nga Ministria, sesione dhe panaire informative, ekspozita MentArt: shfaqja e Shprehjeve Artistike të Shëndetit Mendor, si dhe arritja dhe angazhimi i mediave sociale.


Tabela 7. Numri i grave të depistuar çdo vit në kuadër të programit për kancerin e qafës së mitrës

Viti	Gra të depistuar
2019	14,000
2020	10,200
2021	8,250
2022	10,400
2023	9,230
Total	52,080


Grafiku 1. Prirja në kohë e incidencës (bruto -CIR dhe te standardizuar-SIR) së kancerit të qafës së mitrës



Grafiku 2. Rritja e numrit të mamografive depistuese në vite për gratë



Grafiku 3. Priorja në kohë e nivelit të vdekshmërisë (bruto – CMR dhe të standartizuar -SMR) nga kanceri i gjirit



Shtojca 3. Të dhëna në mbështetje të përgjigjeve të pyetjeve për dimensionin e tretë “liria nga dhuna, stigma dhe stereotipat”.

Akte të rëndësishme të miratuara në zbatim të ndryshimeve ligjore të cituara në këtë raport janë:

- Udhëzim i Përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 9, datë 17.06.2020 “Për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe unifikimin e regjistrimit të tyre”.
- Procedurat Standarde të Veprimit për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë

gjinore nga punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror në kuadër të bashkëpunimit si anëtarë të mekanizmit të koordinuar të referimit (shkurt 2020);

- Udhëzim i Ministrit nr. 744 datë 15.11.2019 ‘Për miratimin e standardeve minimale të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat/të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, në qendrat rezidenciale emergjente (afatshkurtra) publike dhe jopublike (strehëzat emergjente)
- Protokollin e Menaxhimit të Rasteve të dhunës në familje në nivel vendor, përmes Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR), përfshirë dhe protokollin e njëjtë për përdorim në situata të emergjencave (pandemia e Covid-19)
- Protokollin e Menaxhimit të Rasteve të dhunës seksuale tek të rriturit/riturit, në nivel vendor përmes qasjes shumë-sektoriale të koordinuar
- Procedurat standarde të veprimit për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore nga punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore në kuadër të bashkëpunimit si anëtarë të mekanizmit të koordinuar të referimit. (2020)

Po ashtu, Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë kanë hartuar dhe shpërndarë një sërë dokumentacioni (Letra Porosie) drejtuar Komisariateve të Policisë në të gjithë vendin për zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore.

Gjatë vitit 2020, u morën masa për përmirësimin e kuadrit nënligjor, edhe për t’iu përgjigjur situatës së shkaktuar nga pandemia e COVID-19 dhe në veçanti rritjes së rasteve të dhunës në familje si pasojë e masave të kufizimit të lëvizjes së shtetasve. Aktet e miratuara përfshijnë:

- Protokollin e MSHMS nr. 254, datë 10 prill 2020 “Për funksionimin e qendrave rezidenciale publike dhe jopublike që ofrojnë shërbime strehimi për viktimat/të mbijetuarat e dhunës në familje dhe për viktimat/të mbijetuarat e trafikimit në situatën e pandemisë COVID-19”.
- Udhëzim i MSHMS Nr. 253, datë 10 Prill 2020 për menaxhimin e rasteve që përfshijnë fëmijët në nevojë për mbrojtje gjatë urgjencës COVID-19.
- Akti Normativ i Këshillit të Ministrave Nr. 9, datë 25 Mars 2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Akte të tjera ligjore që kanë lidhje me dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore ndaj grave. Gjatë periudhës së raportimit, Shqipëria ka miratuar edhe një sërë aktesh të tjera ligjore që sigurojnë shërbime gjithëpërfshirëse për viktimat e dhunës në familje dhe ato to formave të tjera të dhunës me bazë gjinore ndaj grave. Ndër to përfshihen:

- **Ligji nr. 10/2021 ‘Për azilin në RSH’**, ndër të tjera rregullon kushtet për përpunimin e kërkesave të azilkërkuesve, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe ofron garanci shtesë për personat nga grupe të veçanta, ku ndër të tjera përfshihen gratë shtatzëna, viktimat e gjymtimit gjenital femëror, personat nga komuniteti LGBTI ose personat, viktimat të torturës, përdhunimit apo formave të ndryshme të dhunës psikologjike, fizike apo seksuale.
- **Ligji nr. 13/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 108/2013, “Për të Huajt”**, ku parashikohet mbrojtje më e mirë për viktimat e huaja të trafikimit, si dhe viktimave të dhunës me bazë gjinore.
- Ligje të tjera të përmendura edhe më sipër që i parashikojnë si kategori të posaçme përfituese viktimat e dhunës me bazë gjinore janë: Ligji nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”; Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”; Ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”; Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 65/2016 “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”, etj.

Tabela 8. Ndihma juridike e garantuar nga shteti

Kategoria e veçantë	Ndihmë Juridike Parësore	Ndihmë Juridike Dytësore	Kategoria Total
Viktima të dhunës në familje	1131	112	1243
Viktima të abuzuar seksualisht	12		12
Viktima të trafikimit të qenieve njerëzore	92	1	93
Viktima të mitur	21		21
Të mitur në konflikt me ligjin	2		2
Fëmijët, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore	0	2	2
Fëmijët nën kujdestari, të cilët kanë nisur një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor	0	1	1
Personat që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar/ KMCAP	527	102	629
Statusi i të verbrit	115	29	144
Personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm dhe vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor dhe	0		
Personat, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar	3		3
Personat, përfitues të skemave të mbrojtjes sociale	767	119	886
Përfitues të ndihmës ekonomike	89		89
Persona, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor	0		
Persona, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim	1		1
Pensionistë/Pensioniste	112	25	137
E papërcaktuar kategoria e veçantë përfituese	116	1	117
Nr. Total i kategorive të veçanta - Ndihmë Juridike Parësore & Dytësore - 2023	2867	392	3259
Romë/egjiptiane	411	-	411
Të mitur total	399	-	399

7	Center for Women and Girls “Shelter”, Berat	2021 2022-2023 2024	4 violence cases and 2 trafficking cases (VMT) and 6 cases 2022
8	Shelter 48 hours, Kukës In 2021 the Center has organized awareness campaigns for the mission and operation of the center.	2021 2022(5 raste) 2023 2024	Awareness campaigns were carried out in 14 administrative units of Kukës municipality by the coordinator of the center and for SPZ of the centers. Meetings with members of the municipal council on the services offered by shelters and ETN, treated 5 cases of violence, 5 cases outside the center with counseling.
10	Counseling Line for women and girls, Tiranë	2020	742 beneficiaries
11	Counseling Line for women and girls. Tiranë	2022 2023 2024	683 beneficiaries

Tabela 9. Rastet e krimeve kibernetike të trajtuara nga Drejtoria per Hetimin e Krimeve Kibernetike⁴⁰⁵

Viti	Vepra penale	Raste të trajtuara dhe zbuluara	Raste te trajtuara të pazbuluara	Raste total	Autore arrestuar	Autorë proceduar në gjendje të lirë	Autorë gjithsej
2019	Neni 117/2 “Pornografia	0	5	5	-	-	-
2020	Neni 117/2 “Pornografia	6	4	10	3	5	8
2021	Neni 117/2 “Pornografia	113	7	120	2	136	138
2022	Article 117/2 “Pornography”	99	21	120	1	100	102
2023	Article 117/2 “Pornography”	24	13	37	1	25	26
2023 ⁴⁰⁶	Article 121/a ‘ Stalking” (on-line)	1	0	1	0	1	1

405. Të gjitha rastet janë referuar pranë Prokurorive të Rretheve Gjyqësore, të Juridiksionit të Përgjithshëm. Është ndjekur në vazhdimësi problematika e shantazheve në rrjet e cila u krijon pasoja materiale por dhe iu rrezikon jetën e shtetasve në Republikën e Shqipërisë, ku pas një analizimi të hollësishëm është bërë dhe njoftim për shtyp në lidhje me parandalimin e pasojave në vazhdimësi.

406. Gjatë periudhës korrik dhjetor 2023

Tabela 10. Buxheti për fondin social

	2020	2021	2022	2023
Qendra strehëza Kukës	3,901,500	6,768,552	6,768,552	6,768,552
Qendra strehëza Berat	-	3,181,245	2,049,707	1,665,506
Qendra strehëza Gjirokastrë	-	3,087,000	3,087,000	1,164,000
Shelter in Gjirokastrë	6,400.138	4,120,396	1,987,018	1,987,018

Shtojca 4. Të dhëna në mbështetje të përgjigjeve të pyetjeve për dimensionin e katërt “pjesëmarrja, llogaridhënia dhe institucionet e përgjigjshme gjinore”

Tabela 11. Pjesëmarrja e FARSH në misionet e OKB - Sudani i Jugut. Burimi: Ministria e Mbrojtjes, 2024

Vitu	Numri i pjesëmarrësve/pjesëmarësve në mision
2019	2 ushtarake gra
2020	2 ushtarake gra
2021	1 ushtarake grua
2022	2 ushtarakë burra
2023	1 ushtarake grua
2024	2 ushtarake gra


Tabela 12. Numri i grave dhe burrave nën uniformë për vitin 2023. Burimi: Ministria e Mbrojtjes, 2024.

Viti	Total	Numër		Përqindje	
		Burra	Gra	Burra	Gra
2023	5,854	4,955	899	84.7%	15.3%

Tabela 13. Të dhëna për personelin e Forcave të Armatosura për vitin 2023. Burimi: Ministria e Mbrojtjes, 2024.

Kategoria	Total	Numër		Përqindje	
		Burra	Gra	Burra	Gra
Oficere/Oficerë	1,762	1,386	376	78.7%	21.3%
Nënoficere/Nenoficerë	2,652	2,293	359	86.5%	13.5%
Ushtare/Ushtarë	1,438	1,276	162	88.7%	11.3%
Civile/Civilë	1,748	1,094	654	62.6%	37.4%

Grafiku 4. Personeli i FA për vitin 2023 (në %). Burimi: Ministria e Mbrojtjes, 2024.



TË DHËNA NË LIDHJE ME PYETJEN 22 “PËRFAQËSIMI NË VENDIMARRJEN POLITIKE E PUBLIKE”.⁴⁰⁷

Members of parliament by political parties and sex, 2022

Subjekti politik	Numër-Number		%		Subject
	Burra Men	Gra Women	Burra Men	Gra Women	
Partia Socialiste (PS)	45	29	60,8	39,2	Socialist Party
Partia Demokratike “Aleanca për Ndryshim”	41	18	69,5	30,5	Alliance for Change Democratic Party
Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI)	2	2	50,0	50,0	Socialist movement for Integration
Partia Social Demokrate	2	1	66,7	33,3	Republican Party
Gjithsej	90	50	64,3	35,7	Total

Burimi: Kuvendi i Shqipërisë
Source: Parliament of Albania

Composition of parliament by position, 2022

Posti	Numër-Number		%		Position
	Burra Men	Gra Women	Burra Men	Gra Women	
Kryetar Parlamenti	0	1	0,0	100,0	Head of Parliament
Nënkryetar Parlamenti	1	1	50,0	50,0	Spokesperson of Parliament
Deputete	82	43	65,6	34,4	Member of Parliament (MP)
Kryetarë të Komisioneve Parlamentare	4	4	50,0	50,0	Chairs of Parliamentary Committees
Kryetarë të Grupeve Parlamentare	3	1	75,0	25,0	Chairs of Parliamentary Groups

Burimi: Kuvendi i Shqipërisë
Source: Parliament of Albania

Number of employees in the police force by grades and sex


Punonjësit në policë sipas gradave	2018		2019		2020		2021		2022		Number of employees in the Police Force by grades
	Burra Men	Gra Women	Burra Men	Gra Women	Burra Men	Gra Women	Burra Men	Gra Women	Burra Men	Gra Women	
Drejtuës Madhor	1	-	1	-	1	-	1	-	1	-	Major Director
Drejtuës i Lartë	5	1	6	1	7	-	7	-	7	-	High Director
Drejtuës	29	-	28	1	27	1	28	1	38	1	Director
Drejtuës i Parë	107	10	97	11	92	11	94	11	106	15	First Director
Kryekomisar	277	28	310	29	298	27	299	27	250	25	Head commissar
Komisar	417	35	490	56	476	59	480	59	446	49	Commissar
Nënkomisar	1.313	176	1.197	172	1.219	199	1.231	202	1.258	242	Vice commissar
Inspektor	6.431	681	6.322	661	6.689	671	6.756	679	6.597	661	Inspector
Civil	484	577	471	581	474	598	460	583	557	615	Civilian
Gjithsej	9.064	1.508	8.922	1.512	9.283	1.566	9.356	1.562	9.260	1.608	Total

Vitet Year	Numër-Number		%	
	Burra Men	Gra Women	Burra Men	Gra Women
2016	6.562	1.389	82,5	17,5
2017	7.012	1.571	81,7	18,3
2018	6.925	1.563	81,6	18,4
2019	6.519	1.569	80,6	19,4
2020	6.315	1.574	80,0	20,0
2021	6.206	1.563	79,9	20,1
2022	5.061	892	85,0	15,0

Burimi: Ministria e Mbrojtjes
Source: Ministry of Defense

407. Burimi: INSTAT: Gra dhe burra, 2023”.

Number of employers in armed forces by grades and sex, 2022



Burimi: Ministria e Mbrojtjes
Source: Ministry of Defense

Participation in diplomatic missions

Shënimi: Të dhënat e fundit i referohen vitit 2021 / Note: The data refers to the year 2021

Posti	Numër-Number		%		Position
	Burra Men	Gra Women	Burra Men	Gra Women	
Ambasador	36	16	69,2	30,8	Ambassador
Ministër Fuqiplotë	3	6	33,3	66,7	Minister Powerful
Ministër Këshilltar	7	6	53,8	46,2	Minister Counsellor
Këshilltar	10	13	43,5	56,5	Counsellor
Sekretar i Parë	8	14	36,4	63,6	Secretary, First
Sekretar i Dytë	16	23	41,0	59,0	Secretary, Second
Sekretar i Tretë	2	2	50,0	50,0	Secretary, Third

Burimi: Ministria e Punëve të Jashtme
Source: Ministry of Foreign Affairs

Positions in School of Magistrates

Posti	2019		2020		2021		2022		Position
	Burra Men	Gra Women	Burra Men	Gra Women	Burra Men	Gra Women	Burra Men	Gra Women	
Këshilli Drejtues	11	5	8	6	8	6	11	4	Steering Council
Drejtori	1	0	1	0	1	0	1	0	Director
Studentë konkurrues	84	165	97	180	82	176	93	224	Competitive students
Studente fitues	19	39	26	50	25	42	26	51	Winners Student


Burimi: Shkolla e Magjistraturës
Source: School of Magistrates

Positions in School of Magistrates

Posti	2019		2020		2021		2022		Position
	Burra Men	Gra Women	Burra Men	Gra Women	Burra Men	Gra Women	Burra Men	Gra Women	
Këshilli Drejtues	11	5	8	6	8	6	11	4	Steering Council
Drejtori	1	0	1	0	1	0	1	0	Director
Studentë konkurrues	84	165	97	180	82	176	93	224	Competitive students
Studente fitues	19	39	26	50	25	42	26	51	Winners Student

Burimi: Shkolla e Magjistraturës
Source: School of Magistrates


Winners student in School of Magistrates



Burimi: Shkolla e Magjistraturës
Source: School of Magistrates

Percentage of persons age 15-49 who use an account in a bank and percentage who own a mobile phone

	Burra Men	Gra Women	
Përdorimi një llogarie në një bankë	33,6	39,2	Use bank account
Telefon celular personal	90,1	94,2	Own mobile phone



Burimi: Anketë Demografike e Shëndetit 2017-18

Active enterprises by sex of owner/administrator and economic activity, in (%)

Aktiviteti ekonomik	2020		2021		2022		Economic activity
	Burra Men	Gra Women	Burra Men	Gra Women	Burra Men	Gra Women	
Gjithsej	68,6	31,4	68,9	31,1	68,8	31,2	Total
Prodhuesit e të mirave	83,1	16,9	83,0	17,0	82,8	17,2	Producers of goods
Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	82,3	17,7	82,9	17,1	81,5	18,5	Agriculture, Forestry, Fishing
Industria	79,4	20,6	79,0	21,0	78,9	21,1	Industry
Ndërtimi	90,2	9,8	89,5	10,5	88,8	11,2	Construction
Prodhuesit e shërbimeve	66,3	33,7	66,7	33,3	66,6	33,4	Producers of services
Tregtia	65,0	35,0	65,7	34,3	65,8	34,2	Trade
Transporti dhe magazinimi	93,4	6,6	93,1	6,9	91,9	8,1	Transport & Storage
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	71,0	29,0	71,4	28,6	71,6	28,4	Accommodation and food service activities
Informacioni dhe komunikadoni	75,1	24,9	75,5	24,5	74,6	25,4	Information & Communication
Shërbime të tjera	59,4	40,6	59,9	40,1	59,8	40,2	Other Services

Burimi: Regjistri i ndërmarrjeve, INSTAT

Source: Business register, INSTAT

Active enterprises by sex of owner/administrator and number of employed, in (%)

Grupuar sipas numrit të punësuarve	2020		2021		2022		Group by the number of employed
	Burra Men	Gra Women	Burra Men	Gra Women	Burra Men	Gra Women	
Gjithsej	68,6	31,4	68,9	31,1	68,8	31,2	Total
1-4	67,2	32,8	67,6	32,4	67,5	32,5	1-4
5-9	76,1	23,9	76,4	23,6	76,1	23,9	5-9
10-49	78,0	22,0	77,2	22,8	76,7	23,3	10-49
50+	77,2	22,8	76,3	23,7	76,1	23,9	50+

Shtojca 5. Të dhëna në mbështetje të përgjigjeve të pyetjeve për dimensionin e pestë “shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse”.

Tabela 14. Trajtimi i personelit të FA me pensione/pagesa të veçanta për periudhën 2019-2022.
Burimi: Ministria e Mbrojtjes, 2024

EMËRTIMI	Viti 2019			Viti 2020			Viti 2021			Viti 2022		
	Gra	Burra	Gjithsej	Gra	Burra	Gjithsej	Gra	Burra	Gjithsej	Gra	Burra	Gjithsej
Numri i personave që përfitojnë sigurim suplementar ushtarak	2,003	25,773	27,776	2,023	26,030	28,053	2,043	26,291	28,334	2,063	26,554	28,617
Numri i personave që përfitojnë trajtim të veçantë si ish pilotë	-	233	233	-	235	235	-	234	234	-	233	233
Numri i personave që përfitojnë trajtim të veçantë si ish punonjës/e në ndërmarrjet ushtarake	274	181	455	247	163	410	245	161	406	242	160	402
Numri i personave që përfitojnë trajtim të veçantë si ish punonjës të flotës detare	-	61	61	-	59	59	-	59	59	-	58	58


Shtojca 6. Të dhëna në mbështetje të përgjigjeve të seksionit të kartërt të raportit

Tabela 15. Kostot e planifikuara për zbatimin e SKBGJ 2021 - 2030 për të katër qëllimet strategjike

QËLLIMI I POLITIKAVE	Natyra/ Tipologjia e Kostove	Kostoja Totale 2021-2030	Kostot e Planifikuara PBA 2021-2023/ Burime të tjera dhe Donatoret	Kosto për tu Planifikuar në Buxhetin 2024- 2030	Hendeku Financiar 2021-2030
PI: Përmbushja e të drejtave ekonomike dhe sociale për gratë, të rejat, vajzat dhe burrat, të rinjtë, djemtë në shoqëri dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave nga të gjithë grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese, etj.), duke synuar një rritje dhe qëndrueshmëri të ekonomisë mjedisore (së gjelbër), si dhe pjesëmarrjen e tyre të barabartë në digjitalizim.	Current	696,104,214	435,418,581	189,638,980	
	Capital	20,010,000	6,900,000	11,557,500	72,599,153
P II: Përmbushja e të drejtave të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve nga të gjithë grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese, etj.) për pjesëmarrje, përfaqësim dhe udhëheqje të barabartë në vendimmarrjen politike e publike në nivel vendor.	Current	98,284,272	32,277,760	11,988,480	
	Capital	0	0	0	54,018,032
P III: Zvogëlimi i të gjitha formave të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje	Current	1,523,129,993	770,164,420	423,441,572	
	Capital	648,945,000	271,870,000	312,155,000	394,444,001
P IV: Aplikimi i integritetit gjinor si mjeti kryesor për arritjen e barazisë dhe drejtësisë gjinore në shoqëri	Current	394,963,280	115,505,108	252,962,424	
		264,500	264,500	0	26,495,748
TOTAL [ALL]		3,381,701,259	1,632,400,369	1,201,743,956	547,556,934
TOTAL [Euro]		27,271,784	13,164,519	9,691,484	4,415,782
1 euro 124 ALL					

Burimi: Të dhëna nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në kuadër të përgatitjes së këtij raporti, maj 2024.

Grafiku 5. Ndarja e shpenzimeve për zbatimin e SKBGJ 2021 - 2030



Shtojca 7. Të dhëna në mbështetje të përgjigjeve të seksionit të kartërt të raportit

TREGUESIT PËR OZHQ 5. BURIMI, INSTAT, 2023

Objekti	Targeti	Treguesi	Përkufizimi	Përafrimi me definicionin e Kombet e Bashkuara	2019	2020	2021	2022
					29.5	29.5	35.7	35.7
Qëllimi 5. Të arrihet barazia gjinore dhe të fuqizohen të gjitha gratë dhe vajzat	Synimi i SDG 5.5 Sigurimi i pjesëmarrjes së plotë dhe efektive të grave dhe mundësive të barabarta për të udhëheqje në të gjitha nivelet e vendimmarjes në jetën politike, ekonomike dhe publike	Treguesi 5.5.1 a Përqindja e ulëseve që mbahen nga gratë në (a) parlamentin kombëtar	Përqindja e ulëseve që mbahen nga gratë në (a) parlamentin kombëtar	100% përputhshmëri				

Targeti	Treguesi	Përkufizimi	Përafrimi me definicionin e Kombet e Bashkuara	2019
				43.7
Synimi i SDG 5.5 Sigurimi i pjesëmarrjes së plotë dhe efektive të grave dhe mundësive të barabarta për të udhëheqje në të gjitha nivelet e vendimmarjes në jetën politike, ekonomike dhe publike	Treguesi 5.5.1 b Përqindja e vendeve të mbajtura nga gratë në qeveritë lokale	Përqindja e ulëseve që mbahen nga gratë në (b) qeveritë lokale, në 1 janar të vitit raportues, momentalisht matet si numri i vendeve të mbajtura nga gratë anëtare të këshillit të 61 bashkive të Shqipërisë	100% përputhshmëri	

RAPORTI NARRATIV KOMBËTAR PËR ZBATIMIN E PLATFORMËS PËR VEPRIM

Targeti	Treguesi	Përkufizimi	Përafrimi me definicionin e Kombet e Bashkuara	2019	2020	2021	2022
				34.7%	35.4%	35.5%	34.9%
Synimi i SDG 5.5 Sigurimi i pjesëmarrjes së plotë dhe efektive të grave dhe mundësive të barabarta për të udhëheqje në të gjitha nivelet e vendim marrjes në jetën politike, ekonomike dhe publike	Treguesi 5.5.2 Përqindja e grave në pozicionet manaxheriale	Ky tregues i referohet numrit të femrave si pjesë e totalit të numrit të personave të punësuar në menaxhimin e lartë dhe të mesëm. Për qëllimet e këtij treguesi, menaxhmenti i lartë dhe i mesëm korrespondojnë në grupin e parë 1 në të dy Klasifikimin Ndërkombëtar Standard të Profesionet (ISCO) -08 dhe ISCO-88 minus kategorinë 14 në ISCO-08 (mikpritjen, shitjet me pakicë dhe menaxherët e shërbimeve të tjera) dhe minus kategori 13 në ISCO-88 (menaxherët e përgjithshëm), pasi që këto përbëjnë kryesisht menaxherët e ndërmarrjeve të vogla. Nëse statistikë nuk janë të ndara në nën-major nivel, atëherë grupi kryesor 1 i ISCO-88 dhe ISCO-08 mund të përdoret si një proxy.	100% përputhshmëri				

SETI MINIMAL I TREGUESVE GJINORW. BURIMI INSTAT: [HTTPS://WWW.INSTAT.GOV.AL/AL/TEMAT/TREGUESIT-DEMOGRAFIK%C3%AB-DHE-SOCIAL%C3%AB/BARAZIA-GJINORE/#TAB2](https://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/barazia-gjinore/#TAB2)

Treguesit gjinorë Gender indicator		Viti/Year 2020		Viti/Year 2021		Viti/Year 2022		SDG
		Burra- Men	Gra - Women	Burra- Men	Gra - Women	Burra- Men	Gra -Women	
I	Strukturat ekonomike, pjesëmarrja në aktivitete produktive dhe akses në burime -Economic structures, participation in productive activities and access to resources							
1	Numri mesatar i orëve të shpenzuara në punën e brendshme të papaguar sipas gjinisë -Average number of hours spent on unpaid	2:06 hours	5:43 hours	2:06 hours	5:43 hours	2:06 hours	5:43 hours	5.4.1
2	Numri mesatar i orëve të shpenzuara në punën e paguar dhe të papaguar (barra totale e punës), sipas gjinisë -Average number of hours spent on paid and unpaid work combined (total work burden), by sex	11:54 hours	9:45 hours	11:54 hours	9:45 hours	11:54 hours	9:45 hours	
3	Norma e pjesëmarrjes në forcën e punës për grupmoshën 15-24, sipas gjinisë -Labour force participation rates for 15-24, by sex	43.0%	28.5%	41.1%	31.5%	43.6%	33.8%	
3.1	Norma e pjesëmarrjes në forcën e punës për grupmoshën 15+, sipas gjinisë -Labour force participation rates for 15+, by sex	66.9%	52.3%	67.2%	52.6%	68.4%	56.5%	
4	Përpjesa e të punësuarëve që janë të vetpunësuar, sipas gjinisë(15+) -Proportion of employed who are own-account workers, by sex (15+)	39.3%	25.8%	39.0%	23.3%	38.1%	23.7%	
5	Përpjesa e të punësuarëve që janë duke punuar si punëtorë kontribues në familje, sipas gjinisë (15-64) -Proportion of employed who are working as contributing family workers, by sex	15.0%	26.1%	12.9%	25.0%	14.8%	26.6%	
6	Përpjesa e të punësuarëve që janë punëdhënës, sipas gjinisë -Proportion of employed who are employer, by sex	5.2%	1.3%	6.0%	1.4%	6.0%	1.6%	

Treguesit gjinorë Gender indicator		Viti/Year 2020		Viti/Year 2021		Viti/Year 2022		SDG
		Burra- Men	Gra - Women	Burra- Men	Gra - Women	Burra- Men	Gra -Women	
I	Strukturat ekonomike, pjesëmarrja në aktivitete produktive dhe akses në burime -Economic structures, participation in productive activities and access to resources							
7	Përqindja e firmave në pronësi apo administrim të femrave,në total -Percentage of adult population who are entrepreneurs, by sex	25.5%		24.1%		31.2%		
7.1	Përqindja e firmave në pronësi të femrave, deri ne 4 punonjës -Percentage of firms owned by women, with 0 to 4 employees	25.8%		24.2%		32.5%		
7.2	Përqindja e firmave në pronësi të femrave, 05-09 punonjës -Percentage of firms owned by women, with 05 to 09 employees	23.9%		23.6%		23.9%		
7.3	Përqindja e firmave në pronësi të femrave, 10-49 punonjës -Percentage of firms owned by women, with 10 to 49 employees	22.0%		22.8%		23.3%		
7.4	Përqindja e firmave në pronësi të femrave, 50 + punonjës -Percentage of firms owned by women, 50 + employees	22.8%		23.7%		23.9%		
8	Përqindja e shpërndarjes së të punësuarve sipas sektorëve për cdo gjini -Percentage distribution of employed population by sector, each sex	55.5%	44.5%	55.5%	44.5%	54.0%	46.0%	
8.1	Bujqësi -Agriculture	31.8%	41.4%	28.8%	40.0%	28.7	40.1	
8.2	Prodhim -Manufacturing	8.8%	14.1%	9.4%	13.5%	8.8	14.7	
8.3	Ndërtim -Construction	12.2%	0.6%	14.2%	0.5%	13.5	0.6	
8.4	Industi nxjerrëse, energji, gaz dhe furnizim me ujë -Mining and quarrying & Electricity, Gas and Water supply	3.3%	1.1%	4.0%	0.9%	4.3	0.9	
8.5	Shërbime të tregut -Market Services	31.7%	21.6%	30.1%	22.3%	30.9	22.5	
8.6	Shërbime jo të tregut -Non-market Services	12.2%	21.2%	13.6%	22.9%	13.8	21.2	

9	Punësimi jo formal si një përqindje e totalit të punësimit jo bujqësor, sipas gjinisë -Informal employment as a percentage of total non-agricultural employment, by sex	34.1%	21.9%	34.8%	21.4%	33.3%	21.1%	8.3.1
10	Papunësia sipas grupmoshës dhe gjinisë -Youth unemployment by sex							8.5.2
10.1	15+	11.5%	11.9%	11.3%	11.8%	10.6	11.4	
10.2	15-64	12.0%	12.4%	11.8%	12.4%	10.9	11.7	
10.3	15-24	27.0%	25.9%	25.5%	29.2%	24.1	25.9	
10.4	25-54	11.0%	11.8%	10.3%	10.3%	9.9	10.4	
10.5	55-64	6.5%	7.1%	8.9%	10.6%	7.2	8.9	
10.6	65+	1.2%	0.3%	4.1%	0.1%			
11	Pjesa e popullsisë me llogari depozituese në banka, sipas gjinisë -Proportion of adults (18 years and older) with an deposit account at a bank or other financial institution or with a mobile-money-service provider, by sex	56.5%	43.5%	56.7%	43.3%	55.9%	44.1%	8.10.2
11.1	Pjesa e popullsisë me llogari huamarrëse në banka, sipas gjinisë -Proportion of adults (18 years and older) with an loan account at a bank or other financial institution or with a mobile-money-service provider, by sex	56.8%	43.2%	56.7%	43.3%	56.5%	43.5%	
12	Pjesa e popullsisë së rritur që zotërojnë tokë, sipas gjinisë -Proportion of adult population owning land, by sex	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	5.a.1
13	Hendeku gjinor në paga -Gender gap in wages	6.6%		4.5%			6.2%	8.5.1
14	Pjesa e të punësuarëve (15+) që punojnë me kohë të pjesshme, sipas gjinisë -Proportion of employed (15+) working part-time, by sex	14.4%	22.3%	13.4%	23.6%	12.1%	21.2%	
15	Norma e punësimit e personave të moshës 25-49 vjeç me një fëmijë nën 3 vjeç që jeton në familje dhe pa fëmijë që jetojnë në familje, sipas gjinisë -Employment rate of persons aged 25-49 with a child under age 3 living in a household and with no children living in the household, by sex	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	
16	Pjesa e fëmijëve nën moshën 3 vjeç në kujdes formal -Proportion of children under age 3 in formal care	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	
17	Pjesa e individëve që përdorin internetin, sipas gjinisë, mosha (16-74) -Proportion of individuals using the Internet, by age (15-59) sex							17.8.1
17.1	Gjatë 3 muajve të fundit / Within the last 3 months	73.2%	71.2%	80.3%	78.3%	83.7	81.5	

RAPORTI NARRATIV KOMBËTAR PËR ZBATIMIN E PLATFORMËS PËR VEPRIM

17.3	Më shumë se 1 vit më parë / More than one year ago	5.2%	4.5%	3.7%	3.5%	2.0	2.1	
17.4	Asnjëherë nuk e kam përdorur / Never used it	19.8%	22.6%	15.2%	17.4%	11.3	13.0	
18	Pjesa e individëve që përdorin telefon/telefona celular, sipas gjinisë -Proportion of individuals using mobile/ cellular telephones, by sex and age (15-59)	94.1%	89.2%	94.1%	89.2%	94.1%	89.2%	5.b.1
19	Pjesa e familjeve që kanë akses në media (radio, TV, internet), sipas gjinisë së kryefamiljarit -Proportion of households with access to mass media (radio, TV, Internet), by sex of household head							
19.1	Pjesa e familjeve me akses në TV, sipas gjinisë së kryefamiljarit -Proportion of households with access to mass media TV, by sex of household head	93.0%	91.0%	93.0%	91.0%	93.0%	91.0%	
19.2	Pjesa e familjeve me akses në cel, sipas gjinisë së kryefamiljarit -Proportion of households with access to mass media cel, by sex of household	88.0%	80.0%	88.0%	80.0%	88.0%	80.0%	
19.3	Pjesa e familjeve me akses në internet, sipas gjinisë së kryefamiljarit -Proportion of households with access to mass media internet, by sex of household head	12.0%	12.0%	12.0%	12.0%	12.0%	12.0%	

Treguesit gjinorë Gender indicator		Viti/Year 2020		Viti/Year 2021		Viti/Year 2022		SDG
		Burra- Men	Gra - Women	Burra- Men	Gra - Women	Burra- Men	Gra -Women	
II	Arsimi/ Education							
20	Norma e alfabetizimit në grupmoshën 15-24 vjeç, sipas gjinisë -Literacy rate of persons aged 15-24 years old, by sex	98,4%	96,1%	98,4%	96,1%	98,4%	96,1%	
21	Raporti i regulluar neto i regjistrimit në arsimin fillor, sipas gjinisë -Adjusted net enrolment ratio in primary education by sex	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	
22	Raporti i regjistrimit bruto sipas gjinisë -Gross enrolment ratio by sex							
22.1	Raporti i regjistrimit bruto, Filllore ISCED level 1 -Gross enrolment ratio in primary education by sex	102.2	97.2	98.2	92.5	96.1	89.5	
22.2	Raporti i regjistrimit bruto, arsimi mesëm i ulët ISCED level 2 -Gross enrolment ratio in lower secondary education by sex	98.9	93.3	99.2	93	97.9	91.5	
22.3	Raporti i regjistrimit bruto në arsimin e mesëm ISCED level 3 -Gross enrolment ratio in upper secondary education by sex	96.8	90.1	98.7	89.9	95.7	90.2	
23	Raporti i regjistrimit bruto në arsimin e lartë, sipas gjinisë ISCED level 5-8 -Gross enrolment ratio in tertiary education, by sex	47.7	71.3	49.6	73.2	51.5	74.7	
24	Indeksi i barazisë gjinore -Gender parity index							
24.1	Indeksi i barazisë gjinore, Filllore ISCED level 1 -Gender parity index in primary education by sex	0.95		0.94		0.93		
24.2	Indeksi i barazisë gjinore, arsimi mesëm i ulët ISCED level 2 -Gender parity index in lower secondary education by sex	0.94		0.94		0.94		
24.3	Indeksi i barazisë gjinore në arsimin e mesëm ISCED level 3 -Gender parity index in upper secondary education by sex	0.93		0.91		0.94		
24.4	Indeksi i barazisë gjinore në arsimin e lartë, sipas gjinisë ISCED level 5-8 -Gender parity index in tertiary education, by sex	1.49		1.48		1.45		
25	Pjesa e femrave të diplomuara në arsimin e lartë në shkencë, inxhinieri, prodhim dhe ndërtim -Share of female science, engineering, manufacturing and construction graduates at tertiary level	55.3%	44.7%	57.1%	42.9%	55.2%	44.8%	
26	Pjesa e femrave në mesin e mësuesve të arsimit të lartë dhe profesorëve -Proportion of females among tertiary education professors	58.8%	41.2%	56.2%	43.8%	54.2%	45.8%	
27	Regjistrimi neto në klasën e parë të arsimit fillor, sipas gjinisë -Net intake in first grade of primary education, by sex	65.1	63.4	66.4	64.0	68.7	67.5	
28	Shkalla e përfundimit të arsimit fillor, sipas gjinisë -Primary education completion rate, by sex	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	
29	Diplomimet në arsimin e mesëm të ulët, sipas gjinisë ISCED level 2 -Graduation from lower secondary education, by sex	52.3%	47.7%	52.9%	47.1%	52.0%	48.0%	

Treguesit gjinorë Gender indicator		Viti/Year 2020		Viti/Year 2021		Viti/Year 2022		SDG
		Burra- Men	Gra - Women	Burra- Men	Gra - Women	Burra- Men	Gra -Women	
II	Arsimi/ Education							
30	Norma e tranzicionit për arsimin e mesëm, sipas gjinisë -Transition rate to secondary education, by sex	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	
31	Niveli i arsimit për popullsinë e moshës 25 dhe lart, sipas gjinisë -Education attainment of population aged 25 and over, by sex							
31.1	Me arsim fillor dhe 8/9 vjeçar Primary and Lower secondary	43.7%	54.0%	43.2%	52.9%	41.9%	51.4%	
31.2	Me arsim të mesëm Upper Secondary	39.6%	27.1%	39.9%	27.6%	39.9%	27.3%	
31.3	Me arsim të lartë Tertiary	16.6%	18.9%	16.9%	19.5%	18.3%	21.4%	
III	Shëndeti dhe shërbimet e lidhura me të/ Health and related services							
32	Përdorimi i kontraceptiveve në mesin e grave që janë të martuara ose në një marrëdhënie, moshë 15-49 vjeç -Contraceptive prevalence among women who are married or in a union, aged 15-49	60.5%		60.5%		60.5%		3.7.1
33	Shkalla e vdekshmërisë nën 5, sipas gjinisë -Under-five mortality rate, by sex	11.67	10.08	10.72	12.95	9.1	6.0	3.2.1
34	Vdekshëria amtare për 100 mijë lindje -Maternal mortality ratio	3.6		7.35		0		3.1.1
35	Mbulimi i kujdesit gjatë shtatzanisë, moshë 15-49 vjeç -Antenatal care coverage, ages 15-49	88.4%		88.4%		88.4%		
36	Pjesa e lindjeve ku kanë marrë pjesë profesionistë të kualifikuar të shëndetit -Proportion of births attended by skilled health professional	99.98%		99.97%		99.96%		3.1.2
37	Përdorimi i pirjes së duhanit mes personave të moshës 15 e lart, sipas gjinisë -Smoking prevalence among persons aged 15 and over, by sex	67%	34,5%	0.67	34,5%	0.67	34,5%	3.a.1
38	Përqindja e të rriturve që janë obezë, sipas gjinisë, moshë (15-59) vjeç -Proportion of adults who are obese, by sex and age (15-59)	18.1%	24.4%	18.1%	24.4%	18.1%	24.4%	
39	Numri i femrave të moshës 15-49 vjeç që jetojnë me HIV/AIDS -Number of Women aged 15-49 living with HIV/AIDS	51	16	51	22	50	16	3.3.1
40	Akcesi në drogërat anti-retroviral, sipas gjinisë -Access to anti-retroviral drug, by sex	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	
41	Jetëgjatësia në moshën 60 vjeçare, sipas gjinisë -Life expectancy at age 60, by sex	19.4	22.1	18.7	21.4	21.1	22.8	
42	Shkalla e vdekshmërisë që i atribuohet sëmundjes kardiovaskulare, kancerit, diabetit ose sëmundjes kronike të frymëmarrjes Mortality rate attributed to cardiovascular disease, cancer, diabetes or chronic respiratory disease by sex							3.4.1
42.1	Diabet			5.2	3.8	5.4	2.3	
42.2	Sistemi i frymëmarrjes			15.8	5.7	8.6	4.4	
42.3	Sistemi i qarkullimit të gjakut			337.2	156.7	250.2	117.3	
42.4	Tumoret			133.5	90.0	131.0	84.0	

RAPORTI NARRATIV KOMBËTAR PËR ZBATIMIN E PLATFORMËS PËR VEPRIM

Treguesit gjinorë Gender indicator		Viti/Year 2020		Viti/Year 2021		Viti/Year 2022		SDG
		Burra- Men	Gra - Women	Burra- Men	Gra - Women	Burra- Men	Gra -Women	
IV	Jeta publike dhe vendimmarrja/ Public life and decision-making							
43	Përqindja e femrave në pozita ministore në qeveri -Women's share of government ministerial positions	52.9%	47.1%	20.0%	80.0%	20.0%	80.0%	
44	Përqindja e ulëseve të mbajtura nga femrat në parlamentin kombëtar -Proportion of seats held by women in national parliament	70.5%	29.5%	64.30	35.70	64.30	35.70	5.5.1
45	Përqindja e femrave në pozicione menaxheriale -Women's share of managerial positions	64.6%	35.4%	64.5%	35.5%	65.1%	34.9%	5.5.2
46	Përqindja e femrave police -Percentage of female police officers	85.6%	14.4%	85.7%	14.3%	85.2%	14.8%	
47	Përqindja e femrave gjykatëse -Percentage of female judges	53.6%	46.4%					
V	Të drejtat e njeriut të grave dhe të vajzave / Human rights of women and girl children							
48	Përqindja e grave dhe vajzave të moshës 15+ i nështruar dhunës fizike, seksuale ose psikologjike nga partneri aktual ose ish-intim në 12 muajve të mëparshëm -Proportion of ever-partnered women and girls aged 15 years and older subjected to physical, sexual or psychological violence by a current or former intimate partner in the previous 12 months, by form of violence and by age	33.7%		33.7%		33.7%		5.2.1
49	Përqindja e grave dhe vajzave të moshës 15+ i nështruar dhunës seksuale nga persona të ndryshëm nga partneri gjatë 12 muajve të mëparshëm -Proportion of women and girls aged 15 years and older subjected to sexual violence by persons other than an intimate partner in the previous 12 months, by age and place of occurrence	0.0%		0.0%		0.0%		5.2.2
50	Përhapja e gjymtimit/ prerjes të organeve gjenitale të femrave (vetëm për vendet përkatëse) -Prevalence of female genital mutilation/ cutting (for relevant countries only)	n/a		n/a		n/a		5.3.2
51	Përqindja e femrave të moshës 20-24 vjeç që janë martuar ose hynë në një marrëdhënie para moshës 18 vjeç -Percentage of women aged 20-24 years old who were married or in a union before age 18	6.1%		6.1%		6.1%		5.3.1
52	Shkalla e lindshmërisë të adoleshenteve -Adolescent birth rate age per 1000 women in that age group	13.3%		12.1%		10.0%		3.7.2

REFERENCA

- <https://rm.coe.int/state-report-addressed-to-grevio-/1680ac0c69>
- <https://unstats.un.org/sdgs/dataportal/countryprofiles/alb#goal-5>
- <https://www.instat.gov.al/media/12598/burra-dhe-gra-2023.pdf>
- <https://arkiva.financa.gov.al/punesimi/>
- <https://arkiva.financa.gov.al/punesimi-dhe-aftesimi-profesional/>
- <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/03/24/173/006a8e4b-bc79-4032-9553-60814bc2527f>
- <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/03/24/173/006a8e4b-bc79-4032-9553-60814bc2527f>
- <https://shendetesia.gov.al/barazia-gjinore/>
- <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2021/06/30/400/2387ac14-fd00-44cd-a291-bc00eb26f89f>
- <https://qbz.gov.al/eli/fz/2022/30/38f028cc-c3bc-4956-96cf-dc221db20efe>
- <https://unglobalaccelerator.org/pathfinder-countries/albania>
- <https://albania.unfpa.org/sq/publications>
- www.instat.gov.al/publikime/
- <https://akshi.gov.al/grate-ne-tech-rol-i-tyre-ne-fushen-e-tik/>
- <https://www.instat.gov.al/al/temat/kushtetsociale/teknologjis%C3%AB-s%C3%AB-informacionit-dhe-komunikimit-tik-n%C3%AB-familjedhe-nga-individ%C3%ABt/#tab2>
- https://www.instat.gov.al/media/11157/ict-2022_shqip.pdf
- https://www.instat.gov.al/media/12854/ict-2023_shqip.pdf
- <https://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2024/03/Plani-i-monitorimit-te-AD-per-vitin-2023.-1.pdf>
- <https://www.coursehero.com/file/151885569/Vendim-621-date-22102021-Per-miratimin-e-SKA-2021-2026pdf/>
- <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2022/06/01/370/8fd7b0cf-6848-431f-8bcb-5d08d16deaa7>
- <https://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2024/03/Plani-i-monitorimit-te-AD-per-vitin-2023.-1.pdf>
- <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/09/20/542/96f316d6-b135-42fb-a64a-abbba9484c8>
- <https://financa.gov.al/akti-normativ-nr-1-date-21-02-2024/>
- <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Minimumi%20jetik%20ok.pdf>
- <https://riniafemijet.gov.al/en/strategjia-kombetare-e-rinise-2022-2029-tashme-miratuar/>
- <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2022/06/29/460/a49807d6-28cb-4973-94ea-60d89bf8d41c>
- <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/716>
- <https://startupalbania.al/>
- [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:42018Y1218\(01\)](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:42018Y1218(01))
- <https://rm.coe.int/a5-brochure-youth-sector-strategy-2030-albanian/1680a0d17a>
- <https://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/Strategjia-kombetare-2020-2023-okay.pdf>
- <https://shendetesia.gov.al/legjislacioni-4/>
- <https://www.qbz.gov.al/eli/vendim/2022/04/06/210/8590c194-dc8b-4fa3-aa49-4140d87e11bb;q=strategjia%20>
- <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2023/12/Plani-Kombetar-i-Veprimit-per-HIV-AIDS-2020-2025.pdf>
- <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2021/02/15/20/99aaf4f2-4855-4db8-a4b6-5ffae6b85502>
- https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/Plani_i_Vperimit_per_Zhvillimin_e_Sherbimeve_te_Shendetit_Mendor_2013_-_2022.pdf
- <https://riniafemijet.gov.al/2194-2/>
- <https://riniafemijet.gov.al/wp-content/uploads/2022/07/Ligji-Nr.75.Date-4.11.2019-Per-Rinine.pdf>
- <https://www.ippf.org/>
- <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/02/VKM-nr.-160-dt.-19.02.2020.pdf>
- <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/07/Ligj-Nr.125-2020-Shtesa-dhe-ndryshime-te-LDHF-6996-2016.pdf>
- <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/07/VKM-Nr.-327-dat%C3%AB-2.06-00000002.pdf>
- <https://documents.un.org/doc/undoc/gen/n23/352/80/pdf/n2335280.pdf?token=xDUwUo8sR7leWbMMfE&fe=true>
- https://www.qag-al.org/publikime/legal_review_report.pdf

- <https://qbz.gov.al/eli/fz/2020/191/4a6fb792-6c8d-4637-ba0f-fa0ece007562>
- <https://documents.un.org/doc/undoc/gen/n23/352/80/pdf/n2335280.pdf?token=xDUwUo8sR7IeWbMMfE&fe=true>
- <https://www.qag-al.org/publikime/femicidi.pdf>
- <https://rm.coe.int/grevio-first-baseline-report-on-albania/16807688a7>
- https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CEDAW%2FC%2FALB%2FCO%2F5&Lang=en
- https://www.qag-al.org/publikime/legal_review_report.pdf
- https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf
- https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2022-02/WEB_Strategjia%20Kombetare%20-%20EN.pdf
- <https://www.youtube.com/watch?v=U8YRSnwMuY8>
- https://www.youtube.com/watch?app=desktop&feature=youtu.be&v=AFsp82m4nEY&fbclid=IwAR1GF4tZDL-mAhiQWxTFeP66t0bCjvA2KKUmUdAqnBIKJ_0eN1djqx9B9Cag
- [Gender Equality Dialogues \(buzzsprout.com\)](http://GenderEqualityDialogues(buzzsprout.com))
- <http://acpd.org.al/?p=1054>
- <https://www.ascap.edu.al/kurrikula>
- <https://www.ascap.edu.al/praktika-e-punes-se-sherbimit-psiko-social-shkollor/>
- <https://www.ascap.edu.al/parimet-per-etiken-profesionale-te-sherbimit-psiko-social-shkollor/>
- <https://arsimi.gov.al/udhezim-nr-34-date-16-11-2018-per-ndalimin-e-telefonit-celular-ne-institucionet-arsimore-parauniversitare/>
- <https://www.facebook.com/OSCE.Albania/posts/252262420280804>
- <https://www.facebook.com/OSCE.Albania/posts/267438885429824>
- <https://www.facebook.com/OSCE.Albania/posts/280476064126106>
- <https://www.facebook.com/OSCE.Albania/posts/292508846256161>
- <https://www.facebook.com/OSCE.Albania/posts/297971522376560>
- <https://www.facebook.com/OSCE.Albania/posts/317684427071936>
- <http://docstore.ohchr.org/SelfServices/FilesHandler.ashx?enc=6QkG1d%2FPPrICAqhKb7yhspdJq2SN0FynLS%2BUiWUaqofjmf0rHJ5MLWvzpC5ePiublk65eOKd%2FNGE6rLwV%2B8UH2qHAë2phpnAZHHFMFuZbruUZnNmuu8vWWy5fRMtguz>
- <https://arkiva.financa.gov.al/akti-normativ-nr-1-date-21-02-2024/>
- <https://www.facebook.com/MinistriaMbrojtjes/videos/marrja-e-detyr%C3%ABs-nga-ministria-e-mbrojtjes-znj-mimi-kodhe-li/592779867452215/>
- [Gjykata Kushtetuese \(gjk.gov.al\)](http://GjykataKushtetuese(gjk.gov.al))
- <https://www.ecoi.net/en/file/local/2046178/N2226977.pdf>
- <https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2022/10/17/council-approves-eu-law-to-improve-gender-balance-on-company-boards/>
- <https://riniafemijet.gov.al/2194-2/>
- <https://www.weps.org/about>
- <https://www.parlament.al/struktura/9a2efb41-4237-4a38-8124-4d71d307c56c>
- <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/17190.pdf>
- https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2022-06/media_brief_web.pdf
- <https://www.kmd.al/>
- <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2024/03/Raporti-i-KMD-2023.pdf>
- <https://idp.al/rreth-nesh/>
- <https://idp.al/wp-content/uploads/2024/01/Ligj-2008-03-10-9887-perditesuar-nga-QBZ-2.pdf>
- https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf
- <https://www.mod.gov.al/images/PDF/2024/strategjia-kombetare-2024.pdf>
- <https://cve.gov.al/wp-content/uploads/2021/03/vendim-2020-12-16-1137.pdf>
- <https://cve.gov.al/wp-content/uploads/2024/05/Strategjia-CT-CVE-2023-2025-vkm-81-14-02-2023.pdf>
- <https://cve.gov.al/>

- <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/12/24/1139/ee9ac734-a09b-4eee-bf81-1a09d73a001d>
- <https://www.drejtesia.gov.al/strategjia-ndersektoriale-e-mbrojtjes-se-viktimave-te-krimet-2024-2030/>
- <https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/VKM-nr-670-date-10.11.2021-Plani-Kombetar-Anti-trafik-2021-2023.pdf>
- https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_697_Draft-PKV-Antitrafik-2024-2025-per-mendim.docx
- https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2023/02/Vendim-i-KM-892-DATE-27_12_2022.pdf
- <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://qpkmr.gov.al/wp-content/uploads/2022/12/vendim-2019-05-15-314-perditesuar-1-1.pdf>
- <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/03/Agjenda-Kombetare-per-te-Drejtat-e-Femijeve.docx>
- <https://www.isigurt.al/lajme/kuvendi-dhe-isigurt-se-bashku-per-mbrojtjen-e-femijeve-vaj-zave-e-grave-ne-hapesiren>
- <https://qbz.gov.al/share/GzkcixPISvWPXuZoNVAqzg>
- https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/2.-Strategjia-e-Ndryshimeve-Klima-tike-dhe-Planet-e-Veprimit_Qershor-2019_-1.pdf (fq. 213)
- <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/3.-Kontributi-Komb%C3%ABtar-i-Percaktuar-KKP-i-rishikuar-p%C3%ABr-Shqip%C3%ABrin%C3%AB-1.pdf>
- Videos | UN Women – Albania
- https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/2024-01/strategjia_kombetare_-_albanian.pdf
- <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/12/28/807/b00e5401-bafe-409b-9e12-e6ecef236931;q=strategji>
- <https://durre.gov.al/wp-content/uploads/2023/04/Vendimi-nr.151-date-22.12.2022.pdf>
- <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2021/06/30/400/2387ac14-fd00-44cd-a291-bc00eb26f89f>
- <https://www.shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/SKGJB-AL-web.pdf>
- <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/10/Raport-Monitorimi-per-vitin-2021-SKBGJ.pdf>
- <https://charter-equality.eu/the-charter/observatoire-europeen-en.html>
- <https://financa.gov.al/buxheti-i-qytetarit/>
- <https://www.parlament.al/struktura/d1d56719-80b6-4a1e-92df-b1b0314d0e00>
- Sustainable Development Report 2023 (sdgindex.org)
- PRINT_Shtator_shqip_new_Updated_Albania CF 2022-2026 OK.pdf (un.org)
- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm | Kombet e Bashkuara në Shqipëri (un.org)
- <https://www.facebook.com/unwomenalbania/posts/pfbid02iPaQZ1etcDHKecV1ww2MmbcTCVqpRsGCuGKbf75z6mEiAc8zdt04x4zfqeSQGiutl>
- <https://www.facebook.com/unwomenalbania/posts/pfbid02bWrHw57j8SrSCcN31pn98tJdqXoiNFAFcuG5X9jTX75A8hAbBxzdrvaFgntF8w4yl>
- <https://www.facebook.com/unwomenalbania/posts/pfbid0kf3JhfDHZ7ZLottdrpqjFL5r4qgLorT8cn1vzFtoZj4oWA4cooFcMBANA5uDPRHGI>
- <https://www.facebook.com/unwomenalbania/posts/pfbid02ri4qnQ5C9Dk4nVbWnkBP88GwV6yKnG7vLa7oSYpTc3eUwAk6mf2K9eQ4EvAT4PsWL>
- https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/TreatyBodyExternal/TBSearch.aspx?Lang=En&CountryID=2
- <https://upr.info/en/review/albania>
- <https://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/barazia-gjinore/#tab1>
- <https://cluster1albania.com/sq/kapitulli-18/>
- <https://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/barazia-gjinore/#tab3>
- <https://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/barazia-gjinore/#tab2>
- <https://www.instat.gov.al/al/publikime/librat/2020/indeksi-i-barazis%C3%AB-gjinore-p%C3%ABr-republik%C3%ABn-e-shqip%C3%ABris%C3%AB-2020/>
- <https://unstats.un.org/sdgs/hlg/members>
- <https://unece.org/statistics/publications/CES-roadmap-sdg-2>
- <https://www.instat.gov.al/al/sdgs/>
- <https://www.instat.gov.al/media/11279/sdg-2022-shqip.pdf>
- <https://panel.klsh.org.al/storage/php7cjWxm.pdf>

